



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

MANUAL I MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK PËR BANKA

S H T A T O R 2 0 1 5



Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit nr. 03/L-09 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 16 të Statutit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi Ekzekutiv, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2015 miratoi:

MANUAL I MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK PËR BANKA

Prishtinë, gusht 2015

BOTUES

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ©
Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 243
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT

www.bqk-kos.org

AUTORË

Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare

REDAKTOR TEKNIK

Butrint BOJAJ

P Ë R M B A J T J A

1. HYRJE.....	9
2. QËLLIMI I MANUALIT	11
3. PROCESI I MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK	12
3.1. Hapi 1 – Të kuptuarit e institucionit.....	14
3.1.1. Objektivat	14
3.1.2. Përshkrimi.....	14
3.1.3. Procedurat	15
3.1.4. Shtojca I – 1: Mostra (shembull) mbi njohuritë themelore të bankës / informatat specifike (core knowledge).....	20
3.1.5. Shtojca I – 2: Mostra (shembull) mbi profilin e rrezikut të bankës (risk profile).....	23
3.2. Hapi 2 – Vlerësimi i rrezikut të institucionit.....	28
3.2.1. Objektivat	28
3.2.2. Përshkrimi.....	28
3.2.3. Procedurat	39
3.2.4. Shtojca II: Matrica e rrezikut.....	40
3.2.5. Shtojca III: Format i përmbledhës i vlerësimit të rrezikut.....	41
3.3. Hapi 3 – Planifikimi dhe caktimi i aktiviteteve mbikëqyrëse	42
3.3.1. Objektivat	42
3.3.2. Përshkrimi.....	42
3.3.3. Procedurat	43
3.3.4. Shtojca IV: Format i ilustrativ për planin mbikëqyrës	44
3.4. Hapi 4 – Përkufizimi i aktiviteteve të ekzaminimit.....	45
3.4.1. Objektivat	45
3.4.2. Përshkrimi.....	46
3.4.3. Procedurat	47
3.4.4. Shtojca V – 1: Format i memorandumit të fushëveprimit - (scope memo) për ekzaminimet në vend	49
3.4.5. Shtojca V – 2: Mostra (shembull) i memorandumit të fushëveprimit (scope memo) për ekzaminimet në vend.....	49
3.4.6. Shtojca VI: Shembull i letër informimit dhe letër kërkesës është paraqitur në vazhdim:.....	56
3.5. Hapi 5 – Ekzaminimet në vend (on-site).....	66
3.5.1. Objektivat	66
3.5.2. Përshkrimi.....	67

3.5.3.	Procedurat minimale të vlerësimit të fushëveprimit.....	67
3.5.4.	Procedurat standarde të vlerësimit të fushëveprimit.....	67
3.5.5.	Sistemi i vlerësimit CAMELS	68
3.5.6.	Procedurat	69
A.	<i>PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I EKZAMINIMIT</i>	70
	Shtojca VII: Letrat e punës	71
B.	<i>EKZAMINIMI I KUALITETIT TË MJETEVE DHE RREZIKUT KREDITOR</i>	72
1.	Përshkrimi.....	72
2.	Procedurat e vlerësimit	72
2.1.	Vlerësimi i fushëveprimit minimal	72
2.2.	Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	74
C.	<i>EKZAMINIMI I RREZIKUT TË LIKUIDITETIT</i>	81
1.	Përshkrimi.....	81
2.	Procedurat e vlerësimit	81
2.1.	Vlerësimi i fushëveprimit minimal	81
2.2.	Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	82
D.	<i>EKZAMINIMI I RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT</i>	90
1.	Përshkrimi.....	90
2.	Procedurat e vlerësimit	90
2.1.	Vlerësimi i fushëveprimit minimal	90
2.2.	Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	91
E.	<i>EKZAMINIMI I RREZIKUT OPERACIONAL</i>	95
1.	Përshkrimi.....	95
2.	Procedurat e vlerësimit	95
2.1.	Vlerësimi i fushëveprimit minimal	95
F.	<i>EKZAMINIMI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT</i>	106
1.	Përshkrimi.....	106
2.	Procedurat e vlerësimit	106
2.1.	Vlerësimi i fushëveprimit minimal	106
2.2.	Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	108
G.	<i>EKZAMINIMI I FITIMEVE</i>	111
1.	Përshkrimi.....	111
2.	Procedurat e vlerësimit	111
2.1.	Vlerësimi i fushëveprimit minimal	111

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	112
<i>H. EKZAMINIMI I MENAXHMENTIT</i>	116
1. Përshkrimi.....	116
2. Procedurat e vlerësimit.....	116
2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal.....	116
2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	118
<i>I. EKZAMINIMI I NDJESHMËRISË NDAJ RREZIKUT TË TREGUT</i>	
129	
1. Përshkrimi.....	129
2. Procedurat e vlerësimit.....	129
2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal.....	129
2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	130
<i>J. EKZAMINIMI I AUDITIMIT DHE KONTROLLEVE TË</i>	
<i>BRENDSHME</i>	136
1. Përshkrimi.....	136
2. Procedurat e vlerësimit.....	136
2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal.....	136
2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	138
<i>K. EKZAMINIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE</i>	159
1. Përshkrimi.....	159
2. Procedurat e vlerësimit.....	159
2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal.....	159
2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard.....	161
<i>L. KONKLuzionet e Ekzaminimit</i>	170
Shtojca VIII. Axhenda (programi) e ekzaminimit.....	173
Shtojca IX. Formati i raportit të ekzaminimit.....	175
<i>M. PËRCAKTIMI I SHPESHTËSISË SË EKZAMINIMIT</i>	184
<i>N. MBIKËQYRJA E KONSOLIDUAR</i>	185
<i>O. UDHËZUESI PËR VLERËSIMIN SIPAS SISTEMIT CAMELS</i>	191
1. Vlerësimi i përgjithshëm.....	191
1.1. Vlerësimi i përgjithshëm: 1.....	191
1.2. Vlerësimi i përgjithshëm: 2.....	191
1.3. Vlerësimi i përgjithshëm: 3.....	192
1.4. Vlerësimi i përgjithshëm: 4.....	192
1.5. Vlerësimi i përgjithshëm: 5.....	193

2.	Vlerësimet e komponenteve	193
2.1.	Mjaftueshmëria e kapitalit	193
2.2.	Kualiteti i mjeteve.....	194
2.3.	Menaxhmenti	196
2.4.	Fitimet.....	198
2.5.	Likuiditeti	199
2.6.	Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut	200
3.6.	Hapi 6 – Ekzaminimet nga jashtë (off-site)	202
3.6.1.	Objektivat	202
3.6.2.	Përshkrimi.....	202
3.6.3.	Procedurat	204
3.6.4.	Shtojca X: Përmbledhje e treguesve kryesorë	211
4.	EKZAMINIMI I DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA.....	213
5.	HYRJA NË FUQI.....	213

1. HYRJJE

Konform kompetencave që burojnë nga legjislacioni në fuqi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së sistemit financiar është i bazuar në tre parimet e mëposhtme:

- Mbrojtja e depozitarëve;
- Stabilitetin financiar;
- Sistemi financiar efikas dhe konkurrues.

Mbrojtja e depozitarëve është ndër arsyet më thelbësore për mbikëqyrjen dhe rregullimin e sistemit bankar e financiar. Një pjesë e konsiderueshme e pasurive të individëve, bizneseve dhe qeverive mbahet në institucionet bankare.

Përveç shqetësimit për sigurinë e depozitorëve, mbikëqyrja e sistemit financiar duhet të sigurojë një kornizë të qëndrueshme për kryerjen e pagesave. Një sistem i sigurt, i pranueshëm dhe i besueshëm i pagesave të është shumë i rëndësishëm për ekonominë. Në këtë mënyrë, mbikëqyrja dhe rregullimi bankar, duhet të parandalojë që luhatjet në aktivitetin afarist dhe problemet në institucionet individuale të pengojnë qarkullimin e transaksioneve në të gjithë ekonominë dhe të rrezikojnë besimin e publikut në të gjithë sistemin financiar.

Një aspekt tjetër i një sistemi efikas bankar është ofrimi i shërbimeve cilësore për konsumatorët me çmime konkurruese. Prandaj, mbikëqyrja bankare dhe rregulloret duhet të krijojnë dhe mirëmbajnë një kornizë rregullative që inkurajon efikasitet dhe konkurrencë dhe siguron një nivel adekuat të shërbimeve financiare. Gjithashtu, është e rëndësishme që mbikëqyrja dhe rregullimi i sektorit financiar të ketë një qasje që jo domosdoshmërisht kufizon aktivitetet e bankave komerciale dhe institucioneve të tjera dhe i vë në disavantazh konkurrues apo pengon aftësinë e tyre për t'u shërbyer nevojave kreditore dhe të tjera konsumatorëve të tyre. Në fund, mbikëqyrja dhe rregullativa bankare duhet të nxisin një sistem bankar i cili mund t'iu adaptohet shpejt kushteve të ndryshueshme ekonomike, avancimeve teknologjike dhe qasjeve të mbikëqyrjes.

Në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, BQK-ja ka rishikuar politikat, procedurat dhe praktikën e saj mbikëqyrëse në mënyrë që të sigurojë një kornizë mbikëqyrëse dinamike, efikase, të strukturuar dhe të orientuar në rrezik. Rezultati i kësaj ka qenë miratimi i qasjes së mbikëqyrjes të bazuar në rrezik.

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik është një proces i strukturuar, por prapë fleksibil dhe progresiv i disenjuar që të identifikojë, vlerësojë, matë, monitorojë dhe kontrollojë/zvogëlojë (mitigojë) faktorët kryesorë të rrezikut të cilëve u janë ekspozuar bankat individuale dhe e gjithë industria financiare. Duke përdorur qasjen e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, vlerësohen politikat për vlerësimin e rrezikut dhe praktikatat e përdorura nga bankat për të kontrolluar/zvogëluar rrezikun. Fokusi i vëmendjes mbikëqyrëse sipas mbikëqyrjes së bazuar në rrezik është në fushat e rrezikut të cilat paraqesin rrezik më të lartë për sigurinë dhe mirëqenien e bankave. Mbikëqyrja e bazuar në rrezik gjithashtu mbështet BQK-në në arritjen e objektivave të saj rregullatore, duke marrë parasysh nevojën për të angazhuar burimet e saj në mënyrën më efikase dhe efektive.

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik iu ofron ekzaminerëve mënyrat dhe mjetet që në mënyrë sistematike t'i marrë parasysh të gjitha aktivitetet funksionale (linjat afariste apo fushat operative) të bankave, në kuadër të secilës fushë funksionale, të vlerësojë nivelin e rrezikut, cilësinë e menaxhimit të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut (rritje, rënie dhe stabile). Kjo rezulton me zhvillimin e profilit të rrezikut për bankën.

Ky manual lehtëson trajtimin e mbikëqyrjes së vazhdueshme të bankave nga stafi i Departamentit Mbikëqyrës të Bankave në kuadër të BQK-së dhe do të shfrytëzohet nga stafi si manual referues, udhëzues pune dhe si mjet trajnues. Manuali mund të përditësohet në mënyrë periodike në mënyrë që të mbajë zhvillimet dhe ndryshimet në industrinë bankare të Kosovës.

2. QËLLIMI I MANUALIT

Qëllimi i këtij manuali është që të organizojë dhe formalizojë objektivat dhe procedurat mbikëqyrëse që ofrojnë udhëzime për ekzaminerët bankarë të BQK-së, si dhe për të rritur cilësinë dhe zbatimin e vazhdueshëm të procedurave mbikëqyrëse. Manuali ofron udhëzime specifike për:

- Përcaktimin dhe vendosjen e strategjisë mbikëqyrëse për çdo bankë;
- Përcaktimin e procedurave që do të përdoren në ekzaminimin e të gjitha fushave të një banke, duke përfshirë edhe ato procedura që do të mundësojnë zbulimin e hershëm të trendëve, që nëse vazhdojnë, mund të rezultojnë në përkeqësim të kushteve të bankës;
- Vlerësimin e përshtatshmërisë së praktikave dhe procedurave të institucionit për menaxhim të rrezikut, si dhe nivelin e pajtueshmërisë me to;
- Vlerësimin e performancës së përgjithshme dhe aktiviteteve të menaxhmentit dhe bordit të drejtorëve;
- Përgatitjen e letrave të punës që mbështesin konkluzionet e arritura dhe ndihmojnë në vlerësimin e punës së kryer;
- Përdorimin e kriterëve objektive si bazë për konkluzionet e përgjithshme dhe për komentet dhe kritikën të cilat gjenden në raportin e ekzaminimit në lidhje me gjendjen dhe kualitetin e bankës dhe menaxhmentin e saj.

Ekzaminerët inkurajohen që të përdorin këtë manual si manual referues, udhëzues pune dhe si mjet trajnues. Në shumicën e seksioneve të manualit, janë ofruar procedurat që formojnë bazën e procesit mbikëqyrës të secilës bankë në mënyrë individuale. Këto procedura kanë për qëllim që të çojnë në mbikëqyrje të vazhdueshme dhe objektive të secilit institucion. Ekzaminerët duhet të jenë në gjendje të rrisin nivelin e profesionalizmit dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar duke inkurajuar secilën bankë që të përcjellë praktikën më të mira që ekzistojnë aktualisht në këtë industri. Megjithatë, në asnjë rast, kjo qasje nuk guxon të ndalojë zhvillimin dhe zbatimin praktikave konceptualisht të shëndosha dhe inovative nga institucionet individuale.

3. PROCESI I MBIKËQYRJES SË BAZUAR NË RREZIK

Procesi i mbikëqyrjes është një cikël i plotë. Është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili përbëhet nga hapat e mëposhtëm:


1. Të kuptuarit e institucionit – Të kuptuarit e karakteristikave unike të institucionit, kulturës së korporatës dhe profilit të rrezikut të institucionit;
2. Vlerësimi i rreziqeve të institucionit – Fokusimi i përpjekjeve mbikëqyrëse mbi ato fusha që paraqesin rrezikun më të madh për sigurinë dhe mirëqenien e një institucioni në përputhje me profilin e bankës;
3. Planifikimi dhe caktimi i aktiviteteve mbikëqyrëse - Zhvillimi i një plani që pasqyron shqetësimet e mbikëqyrjes, se si janë duke u adresuar ato apo si do të adresohen;
4. Përkufizimi i aktiviteteve të ekzaminimit – Detajimi i procedurave dhe veprimeve që do të kryhen;
5. Ekzaminimit në vend (on-sitte) – Testimi dhe verifikimi i të dhënave të ofruara nga institucioni; dhe,
6. Ekzaminimet nga jashtë (off-site)– Një proces i vazhdueshëm i cili përfshin analiza periodike të informatave të dorëzuara nga bankat dhe ngjarjeve të tjera, që mund të ndikojnë në gjendjen e përgjithshme të një institucioni.

Në mënyrë që t'i mundësohet BQK-së të përmbushë objektivat e saj mbikëqyrëse dhe të zbatoj ciklin mbikëqyrës, përgjegjësitë e mbikëqyrjes së bankave bëhet kryesisht nga Departamenti i Mbikëqyrjes e Bankare. Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare aktualisht është i organizuar në tri divizione: divizioni i mbikëqyrjes në vend të bankave, divizioni për raportim dhe analiza (off-site) dhe divizioni për mbikëqyrje të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. Divizioni i mbikëqyrjes në vend është përgjegjës për ekzaminimet në vend. Divizioni i raportimit dhe analizave është përgjegjës për kryerjen e analizave në BQK (off-site), si në baza makro ashtu edhe në mikro apo banka individuale. Divizioni i mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare kryen ekzaminimet në vend të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.

Fokusi duhet të jetë në arritjen e një procesi të plotë dhe të koordinuar të mbikëqyrjes të bazuar në rrezik. Përmbajtja dhe formati i dokumenteve të përgatitura janë fleksibil dhe duhet t'i përshtaten praktikave të mbikëqyrjes të BQK-së, si dhe strukturës dhe

kompleksitetit të institucioneve. Lidhja në mes të gjashtë fazave të procesit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe rezultatet e tyre specifike është ilustruar në skemën e mëposhtme.

Skema 1. Korniza konceptuale e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik



3.1. Hapi 1 – Të kuptuarit e institucionit

3.1.1. Objektivat

- Të kuptojë dhe përditësojë të dhënat lidhur me bankën – profilin e saj të rrezikut dhe praktikat e menaxhimit;
- Të zhvillojë bazën për krijimin e një strategjie mbikëqyrëse të përshtatshme për bankën.

3.1.2. Përshkrimi

Pikënisje për mbikëqyrjen e bazuar në rrezik të secilës bankë është zhvillimi i të kuptuarit të institucionit, menaxhmentit të tij dhe praktikave bankare. Ky hap është shumë i rëndësishëm për përshtatjen e strategjisë së mbikëqyrjes me karakteristikat e secilës bankë dhe përshtatjes së asaj strategjie në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me ndryshimin e rrethanave. Me një theks më të madh në planifikim dhe monitorim, aktivitetet mbikëqyrëse mund të fokusohen në rreziqet e rëndësishme për bankat dhe shqetësimet e mbikëqyrjes që ndërlidhen me ato rreziqe.

Duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike dhe të tregut brenda sektorit ekonomik në Kosovë dhe shpejtësinë me të cilën kushtet financiare dhe profili i rrezikut të një banke mund të ndryshojë, është e rëndësishme që të mbikëqyren ngjarjet dhe ndryshimet në profilin e rrezikut të një banke dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme në strategjinë mbikëqyrëse të bankës. Në këtë këndvështrim, BQK-ja do të sigurohet që njohuritë themelore të bankës / informatat specifike (core knowledge) siç specifikohet në Shtojcën I - 1 është përgatitur dhe përditësuar të paktën në baza tremujore.

Përmbledhja institucionale e bankës duhet të ofrojë një përmbledhje që komunikon, në mënyrë koncize, informatat të cilat tregojnë gjendjen aktuale të bankës dhe vënë në pah çështjet kryesore, duke përfshirë gjetjet dhe shqetësimet e ekzaminimeve të mëhershme. Përmbledhja duhet të ofrojë një pasqyrë të strukturës së bankës, kushteve financiare dhe profilit aktual dhe të ardhshëm të rrezikut. Për më shumë, pasqyra do të përmbajë informata të cilat kanë të bëjnë me pronësinë, kapitalin dhe strukturën e grupit (aty ku është e zbatueshme), rrjetin e degëve, plotësimin me personel, sistemin e qeverisjes korporative, profilin afarist, strategjinë e bankës, rreziqet, sfidat me të cilat përballet institucioni, si dhe vlerësimet rregullative dhe vlerësimet e tjera.

Informatat për hartimin dhe përditësimin e përmbledhjes institucionale të bankës duhet të mblidhen nga burimet e besueshme në dispozicion të ekzaminerëve. Këto burime do të përfshijnë raportet e ekzaminimeve në vend, raporteve të rregullta prudenciale dhe ligjore, raportet *ad-hoc*, rezultatet e publikuara financiare, raportet e

jashtme të agjencive vlerësuese, takimet formale dhe joformale me bordin e drejtorëve dhe menaxhmentin e lartë, auditorët e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe raportet dhe takimet me autoritetet e tjera mbikëqyrëse/rregullatore.

Burimet e tjera të informacionit përfshijnë raportet e mediave, inteligjencën e tregut (informata rreth konkurrencës në treg), si dhe ankesat e paraqitura kundër bankës.

3.1.3. Procedurat

- I. Mblidhni informacionet për të përgatitur dhe/apo përditësuar përmbledhjen institucionale të bankës.
 - A. Shqyrtoni raportet e ekzaminimit, vlerësimet sipas rrezikut, CAMELS dhe CAELS.
 - B. Shqyrtoni dokumentet lidhur me ndonjë vendim të BQK-së ku përcaktohen masat që duhet t'i zbatojë banka.
 - C. Shqyrtoni dosjet e korrespondencave të bankës për informacionet përkatëse: letrat në mes të BQK-së dhe bankës; artikuj të marrë nga gazetat të cilat ndërlidhen me aktivitetet e bankës dhe stafin e saj; publicitet negativ; ngjarjet negative ekonomike në komunitet; fatkeqësitë natyrore; vdekja apo zhdukja e menaxherit të lartë; zotimet e mëdha financiare si sponsor apo institucion udhëheqës në një projekt apo zhvillim të madh, etj.
 - D. Kontaktoni njësinë përkatëse të licencimit në lidhje me aplikacionet e bankës të miratuara së fundmi apo aplikacionet në pritje. Shqyrtoni aplikacionet, sipas nevojës, për një bashkim, blerje apo themelim të një dege apo filiali të ri.
 - E. Kontrolloni të dhënat e bankës për informata të rëndësishme që mund të shkaktojnë ndryshim në profilin e saj të rrezikut (ndryshime në auditorët e jashtëm, keqpërdorime të mëdha, pagesa të mëdha të kredive të klasifikuara më herët).
- II. Komplettoni dhe/apo përditësoni përmbledhjen institucionale të bankës.
 - A. Kushtet e përgjithshme: Përmbledhni gjendjen e përgjithshme të bankës, bazuar në nivelin e shqetësimit, vlerësimit të sistemeve për menaxhimin e rrezikut dhe përshtatshmërinë e mbikëqyrjes nga menaxhimenti. Çdo çështje (shqetësim) kyç në lidhje me strategjitë e përdorura duhet të vihet në pah.

B. Përmbledhje e bankës:

1. Historiku: Përmbliidhni historikun e bankës. Përfshini datën e themelimit të saj, ndryshimet e emrit (nëse ka), bashkimet dhe blerjet, konvertimet e licencës, etj.
2. Struktura e aksionarëve: Shënoni emrat e aksionarëve që zotërojnë 10% ose më shumë të aksioneve të përgjithshme, numrin e aksioneve të mbajtura dhe përqindjen aksionare gjatë tre viteve të fundit. Nëse banka është në pronësi të një kompanie holding apo kompanisë amë, kjo paraqitet edhe në strukturën aksionare të kompanisë holding apo të kompanisë amë - deri në masën e njohur. Specifikoni vendin e ndonjë pronari të huaj (Shqyrtoni raportet vjetore të kompanisë holding apo kompanisë amë për të marrë këtë informacion).
3. Struktura e kapitalit: Listoni komponentët e kapitalit të bankës gjatë tre viteve të fundit në formë tabelare duke përfshirë edhe treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit.
4. Organizatat e ndërlidhura: Paraqitni në formë tabelare filialet e bankës, degët dhe çfarëdo organizate tjetër të ndërlidhur, duke treguar përqindjen në pronësi të bankës për secilën apo sesi është e ndërlidhur organizata.
5. Vizioni, misioni dhe strategjia: Theksoni vizionin, misionin, vlerat, dhe qëllimet strategjike të bankës dhe iniciativat. Komentoni mbi rreziqet e mundshme që ndërlidhen me iniciativat strategjike të bankës, parashikimet, projeksionet për fushat kyçe të performancës, projeksionet buxhetore dhe/ose tregjet dhe produktet e reja.
6. Linjat kyçe funksionale: Identifikoni linjat kyçe funksionale të bankës dhe produktet e ofruara në secilën linjë. Gjithashtu përfshini shërbimet kryesore mbështetëse siç janë teknologjia informative dhe e komunikimit.
7. Korniza për menaxhimin e rrezikut: Jepni detaje të strukturave për menaxhimin e rrezikut, sistemeve dhe procedurave të përdorura për të menaxhuar rreziqet e ndryshme të pranishme në operacionet e bankës. Nëse pronari i bankës së huaj është përgjegjës për vendosjen dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut, jepni detaje në lidhje me përfshirjen e bankës së Kosovës në shqyrtimin dhe rregullimin e sistemeve për adresimin e tendencave specifike të rrezikut të institucionit dhe profilit të rrezikut. Detyrat

dhe përgjegjësitë e individëve dhe departamenteve të përfshira në procesin e menaxhimit të rrezikut duhet të përcaktohen qartë. Duhet të përfshihen raportet e Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë, limitet ekzistuese dhe mundësitë e sistemeve të TI-së.

8. Rrjeti i degëve: Shënoni numrin e degëve, agjencive dhe pikave tjera të përfaqësimit dhe adresat e tyre përkatëse.
9. Përbërja e stafit: Theksoni numrin e përgjithshëm të stafit të bankës duke treguar stafin menaxhues dhe jomenaxhues. Aty ku është e nevojshme, komentoni mbi mjaftueshmërinë e burimeve njerëzore sidomos në fushat kryesore operationale sa i përket numrit, kualifikimeve dhe shkathtësive. Diskutoni shqetësimet në lidhje me lëvizjen e stafit.
10. Auditorët e jashtëm dhe avokatët: Tregoni emrat, adresat, numrat e telefonit, auditorin dhe avokatin përgjegjës dhe tregoni numrin e viteve që këta auditorë dhe avokatë i kanë ofruar shërbime bankës. Përveç kësaj, merrni parasysh detyra të tjera konsulente që auditori apo zyra e avokatëve mund të ketë të kryer për bankën.
11. Bordi i drejtorëve: Paraqitni në formë tabelare, emrat, moshën, profesionet, kualifikimet, përvojën dhe pozitat e të gjithë anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe kompanitë në të cilat ata kanë aksione. Për më tepër, anëtarët e bordit të drejtorëve duhet të shpalosin qartë çfarëdo marrëdhënie tjetër afariste të cilën e kanë ata apo bashkëshorti/ja e tyre me bankën apo filialet e saj.
12. Menaxhmenti i lartë: Paraqitni në formë tabelare emrat, moshën, kualifikimet dhe përvojën e të gjithë menaxherëve të lartë dhe kompanitë në të cilat ata kanë aksione. Më tej, menaxhmenti i lartë duhet të shpalosë qartë çdo marrëdhënie tjetër afariste të cilën ata apo bashkëshorti/ja e tyre e kanë me bankën apo filialet e saj.
13. Komitetet e bordit të drejtorëve: Theksoni përbërjet e komiteteve të ndryshme të bordit të drejtorëve dhe termat e tyre të referencës. Komentoni mbi çfarëdo parregullsie; d.m.th, mospjesëmarrja nga ndonjë anëtar, mosmbajtja e takimeve të rregullta, dominimi nga ndonjë anëtar, etj.
14. Komitetet e menaxhmentit: Theksoni përbërjet e komiteteve të ndryshme të menaxhmentit dhe termat e tyre të referencës. Komentoni mbi çfarëdo parregullsie (shih shembujt e listuar në pikën 13 më lart).

15. Përshkrimi i menaxhmentit: Komentoni mbi përshtatshmërinë e mbikëqyrjes së bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit sa i përket:

- a. Kornizës së përgjithshme të menaxhimit të rrezikut;
- b. Politikave dhe procedurave në fushat kyçe të rrezikut;
- c. Sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe,
- d. Planifikim strategjik dhe krijim i politikave.

Gjithashtu komentoni mbi sistemin e informimit të menaxhmentit në aspektin e besueshmërisë dhe gjenerimit me kohë të raporteve financiare dhe/ose rregullatore.

16. Njëzet huamarrësit më të mëdhenj: të prezantohen në formë tabelare, njëzet huamarrësit më të mëdhenj duke treguar palën përfituese, limitet, bilancin aktiv dhe datën e maturimit, llojin e ekspozimit dhe llojin e sigurisë. Gjithashtu, tregoni shumën e mbetur të ekspozimit për çdo huamarrës si përqindje e kapitalit rregullator.

17. Njëzet depozitarët më të mëdhenj: të prezantohen në formë tabelare njëzet depozitarët më të mëdhenj, duke treguar emrin e klientit, shumën, llojin e depozitave dhe koston (normën e interesit).

18. Renditja sipas sektorit: Paraqitni në formë tabelare pozitën e bankës në raport me bankat e tjera në Kosovë. Tregoni gjithsej depozitat dhe gjithsej mjetet sipas shumës, përqindjes dhe pjesëmarrjes në treg. Gjithashtu përfshini gjithsej kapitalin dhe treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

C. Rezultatet e ekzaminimeve, gjetjet e auditimit dhe vlerësimet kreditore nga agjencitë vlerësuese:

1. Rezultatet e ekzaminimeve të kaluara në vend: Paraqitni në formë tabelare rezultatet e tre ekzaminimeve të fundit në vend duke treguar vlerësimet përkatëse të përgjithshme, CAMELS si dhe vlerësimet e rreziqeve.
2. Gjetje të rëndësishme të ekzaminimit të fundit në vend: Përmbliidhni gjetjet e konsiderueshme të ekzaminimit të fundit në vend.

3. Gjetjet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm: Përmblihdhini gjetjet kryesore të auditimit të jashtëm të fundit dhe auditimit të brendshëm dhe pikat kryesore të takimeve prudenciale me auditorët.
4. Vlerësimet kreditore nga agjencitë vlerësuese: Tregoni vlerësimet e fundit të marra nga banka për vet bankën apo kompaninë amë apo holding. Siguroni vlerësimin, datën e caktimit të tij dhe emrin e kompanisë ose agjencisë vlerësuese.

D. Analizat periodike nga ekzaminimi nga jashtë:

Ofroni një përmbledhje të konkluzioneve të përgjithshme të bankës duke u bazuar në raportet e fundit financiare dhe komentoni mbi fushat vijuese:

1. D1 – Mjaftueshmëria e kapitalit;
2. D2 – Kualiteti i mjeteve;
3. D3 – Menaxhmenti;
4. D4 – Fitimet;
5. D5 – Menaxhimi i likuiditetit dhe i fondeve;
6. D6 – Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut.

E. Shkeljet e ligjit dhe mospajtueshmëria me kërkesat rregullatore dhe mbikëqyrëse:

Komentoni mbi pajtueshmërinë e bankës me ligjet në fuqi, rregullat, rregulloret dhe udhëzimet të lëshuara nga BQK-ja. Theksoni çdo shkelje që është vërejtur dhe veprimin e ndërmarrë ose që do të merret.

F. Shqyrtimi i rrethanave të jashtme:

Identifikoni dhe komentoni mbi çfarëdo faktori të jashtëm mjedisor që mund të kenë ndikim negativ në operacionet dhe gjendjen e bankës; për shembull, prona, borxhet dhe tregjet e kapitalit, si dhe kushtet e tjera të rëndësishme ekonomike.

G. Qëndrueshmëria financiare dhe vlerësimi i stres-testit:

1. Shqyrtimi i stabilitetit financiar: Komentoni mbi performancën financiare të bankës, përparësitë dhe dobësitë, efektin e përhapjes së dobësive (contagion effect) në sistemin financiar, në rast të vonesës.
2. Tregoni supozimet dhe rezultatet e stres-testit të kryer brenda Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare dhe nga departamentet e tjera brenda BQK-së, si dhe nga vetë banka.

3.1.4. Shtojca I – 1: Mostra (shembull) mbi njohuritë themelore të bankës / informatat specifike (core knowledge)



Datë: dita-muaji-viti

Emri i bankës: xxxxxx

Adresa e bankës: xxx, nr.xx, Prishtinë, Kosovë

Data kur janë zhvilluar njohuritë kryesore: dita-muaji-viti

Përgatitur nga: xxxxx xxxxxx - ekzaminer përgjegjes për XXX

Azhurnimi i fundit: dita-muaji-viti

Profili i bankës

(Vlerësimet e ekzaminimit formojnë formën për aktivitet e ardhshme mbikëqyrëse. Disa nga këto vlerësime janë përfshirë në këtë profil të njohurive kryesore. Pasi të keni përfunduar profilin, përmbledh të dhënat e pasqyruara këtu. Përditëso profilin, nëse është e nevojshme në mes të ekzaminimit dhe gjithmonë para fillimit të çdo ekzaminimi.)

Historia e bankës

(Data e licencimit, data e hapjes për të bërë biznes, bashkimet apo përvetësimet, numri i degëve, emri dhe aktiviteti apo llojet e biznesit të filialeve dhe subjektit të varur, nëse filialet nuk janë në pronësi të plotë, përfshijë emrat dhe përqindjen e pronësisë të pronarëve të tjerë, aplikimet në pritje të korporatës).

Vlerësimet dhe historia e mbikëqyrjes (ekzaminimeve)

(Listo vlerësimet sipas rreziqeve, CAMELS dhe përbërësit e vlerësimit për 5 ekzaminimet e fundit dhe ndonjë çështje të rëndësishme, që ka kërkuar vemendje të bordit apo menaxhmentit, Nëse ndonjë çështje e rëndësishme është identifikuar ose nëse banka është nën ndonjë dokument veprimi të mbikëqyrjes, shëno veprimet korrektuese të ndërmara për përcjellje nga mbikëqyrja. Nëse është pronë e huaj, përfshijë këtu informatat e marra nga mbikëqyresit e huaj.)

Pronësia

(Listo aksionarët e rëndësishëm (>25% aksione në pronësi), përqindjen e tyre të pronësisë, Interesat kryesore në bizneset e tyre dhe ndonjë pozicion të mbajtur në bankë (drejtor apo pozitë tjetër menaxhuese). Nëse aksionari është ndonjë bankë tjetër apo entitet shërbyes financiar, shëno nëse entiteti është në pronësi të huaj dhe nëse është kështu, shëno vendin e origjinës të pronësisë, mbikëqyrësin e tij të jashtëm dhe strukturën e tij të pronësisë, p.sh. a janë aksionet e saj të tregtuara publikisht, ndonjë aksionar të rëndësishëm.)

Bordi dhe struktura e bordit

(Listo drejtorët aktualë, përqindjen e pronësisë, profesionet e tyre dhe funksionet e tyre në komitetet e bordit siç mund të jetë: komiteti i auditimit, komiteti i riskut, etj.. Përshkruaj strukturën e bordit si: bordin menaxhues si dhe bordin ekzekutiv.)

Pozitat kryesore menaxhuese dhe struktura organizative

(Listo 5-10 pozitat më të larta menaxhuese dhe identifikoj individualisht se çka përfshijnë këto pozita. Detajo kompensimin total për çdo pozitë kyçe dhe sesi janë përcaktuar bonuset, performanca, rritja apo në bazë të vjetërsisë. Përshkruaj strukturën organizative dhe kulturën, pra, a janë vendime të marra duke u bazuar në hierarki, komitete, apo në ndonjë mënyrë tjetër, a janë komunikime të hapura apo të kontrolluara, etj.)

Mjedisi i kontrollës

(Diskuto programin apo funksionin e kontrollit kualitativ të bankës, funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe ndërlidhjen e strukturës raportuese siç mund të jetë me menaxhmentin ose bordin ose komitetet e tij, mjaftueshmerinë e auditit, fushëveprimin, testimin, si dhe shëno kompaninë e jashtme të tanishme audituese. Shëno lokacionet e objekteve mbështetëse të teknologjisë informative, mbështetjen dhe shërbimet e teknologjisë informative. Diskuto masat e sigurisë fizike të ndërtesave (nevojën për kode-fjalëkalime për vizitor gjatë ekzaminimit, qasjen për kyçje në sistemin elektronik të bankës nga ekzaminerët, etj.)

Kultura korporative e bankës dhe toleranca e rrezikut

(A është banka refuzuese e rrezikut, tolerante, apo pranuese e rrezikut? A ka banka plan strategjik. Qëllimi apo visioni i korporatës? Si u komunikohen klientëve dhe të punësuarëve ndryshimet në politika? Si shihet banka nga konkurrentët – lider, inovatore, përcjellëse, etj.)

Produktet e bankës, shërbimet dhe tregjet

(Përshkruaj produktet dhe shërbimet kryesore të bankës, duke veçuar produktet e reja që nga ekzaminimi i fundit dhe përqindjen e bilancit të gjendjes ose të të hyrave. A janë produktet dhe shërbimet e zhvilluara dhe krijuara drejtpërdrejt nga banka apo nga ndonjë person i jashtëm? Përshkruaj fokusin e bankës në tregje dhe fushat e shërbimit, p.sh. global, regjional, lokal dhe ndonjë çështje lidhur me fushat e tregut.)

3.1.5. Shtojca I – 2: Mostra (shembull) mbi profilin e rrezikut të bankës (risk profile)



PROFILI I RREZIKUT TË BANKËS: xxxxxxxxx

<ul style="list-style-type: none"> - <u>Emri i bankës:</u> xxxxxxxx - <u>Adresa</u> : Rruga: “xxxx”, Nr. xx, Prishtinë. - <u>Personi kontaktues i bankës:</u> xxxxxxx XXXXX telefoni (038-XXX-XXX) lok: xxx - <u>Kryeshefi ekzekutiv:</u> Xxxxxx XXXXX - <u>Data fillestare e përgatitjes së profilit të rrezikut të bankës:</u> dita-muaji-viti 	<p><u>Informatat financiare</u> (me datë dita-muaji-viti):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjithsej mjetet: xxx milion euro. - Gjithsej kreditë bruto: xxx milion euro. - Gjithsej depozitat: xxx milion euro. - Gjithsej huamarrjet: xxx milion euro. - Fitimit neto: xx milion euro - ROAA: xx.x% - Rezervat për humbje nga kreditë / kreditë joperformuese: xxx.x%. - Kreditë me vonesa¹/ gjithsejt kreditë: x.x%. - Kreditë e klasifikuara (problematike) ² / gjithsej kreditë: x.x%
<p><u>Lloji i ekzaminimit të fundit në vend:</u> Ekzazimi i plotë / Ekzaminimi i fokusuar</p> <p><u>Data e fillimit të ekzaminimit:</u> dita-muaji-viti</p> <p><u>Data e përfundimit të ekzaminimit:</u> dita-muaji-viti</p> <p><u>Informatat financiare të datës:</u> dita-muaji-viti.</p>	<p><u>Ekzaminer përgjegjës:</u></p>

¹ Kreditë me vonesa (klasifikuara) përfshijnë: kreditë vrojtuese, nënstandard, të dyshimta dhe kreditë e klasifikuara si humbje.

² Kreditë problematike përfshijnë: kreditë nënstandard, dyshimta dhe humbje.

Vlerësimi i përgjithshëm i bankës:

	Ekzaminimi Aktual	Ekzaminimi Paraprak (t-1)	Ekzaminimi Paraprak (t-2)
Data e fillimit të ekzaminimit	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti
Ekzaminimi me të dhëna financiare deri më	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti	Dita-muaji-viti
Vlerësimi i përgjithshëm	X	X	X
Vlerësimi i komponenteve:			
Kapitali	X	X	X
Kualiteti i mjeteve	X	X	X
Menaxhmenti	X	X	X
Fitimet	X	X	X
Likuiditeti	X	X	X
Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut	X	X	X

BIOGRAFIA DHE STRUKTURA E BANKËS xxxxx

(Data e licencimit, pjesëmarrja në sektorin bankar, struktura e pronesisë, kompania mëmë dhe pjesëmarrja në grup, kapitali aksionar, degët, numri i punëtorëve, etj.)

PROFILI DHE STRATEGJIA E BANKËS

(Data e licencimit, pjesëmarrja në sektorin bankar të treguesve kryesor, përmend ndonjë produkt të veçantë që ofron, qëllimi i kreditimit në sektor të caktuar, kreditimi në sektor dhe përqendrimi me i madh.)

Specifikat e bankës - *(Banka menaxhohet nga Xxxxxxx XXXXX - kryeshef ekzekutiv dhe nga Xxxxxxx XXXXXX – zv/kryesheshef ekzekutiv.*

Ndryshimet kryesore në bankë që nga periudha e ekzaminimit të fundit me informatat financiare: dita-muaji-viti.

(specifiko ndryshimet në antaret e bordit të drejtorve dhe menaxhment të lart)

VLERESIMI SIPAS SISTEMIT CAMELS NGA EKZAMINIMI I FUNDIT I DATËS: dita-muaji-viti

Profili i përgjithshëm i rrezikut të bankës: *koment*

Mjaftueshmëria e kapitalit

(Vlerësimi: X)

Arsyetimi për vlerësimin:

Rreziku kreditor dhe kualiteti i mjeteve (Vlerësimi: X)

Arsyetimi për vlerësimin:

Menaxhmenti / Qeverisja (Vlerësimi: X)

Arsyetimi për vlerësimin:

Fitimet (Vlerësimi: X)

Arsyetimi për vlerësimin:

Rreziku i likuiditetit (Vlerësimi: X)

Arsyetimi për vlerësimin:

Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut (Vlerësimi: X)

Arsyetimi për vlerësimin:

Rreziku operacional

Arsyetimi për vlerësimin:

Kontrollet e brendshme

Arsyetimi për vlerësimin:

Auditimi i brendshëm

Arsyetimi për vlerësimin:

Pajtueshmëria me rekomandimet e BQK-së nga ekzaminimin i fundit

Arsyetimi për vlerësimin:

Ekzaminimi i fokusuar gjatë muajit: dita-muaji-viti

Arsyetimi për vlerësimin:

PROFILI I BANKËS BAZUAR NË VLERËSIMIN E SISTEMIT TË CAELS³ TË DATËS: dita-muaji-viti

(arsyetimi për vlerësimin e rrezikut të përgjithshëm të bankës)

Tabela më poshtë reflekton profilin e rrezikut aktual të bankës:

³ CAELS = Capital, Asset Quality, Earnings, Liquidity and Sensitivity to market risk.

Profili i rrezikut të bankës xxx më datë dita-muaji-viti

Kategoria e rrezikut	Sasia e rrezikut të vetvetishëm	Kualiteti i menaxhimit të rrezikut	Niveli i përgjithshëm i rrezikut	Drejtimi i rrezikut
Rreziku i përgjithshëm				
Rreziku kreditor				
Rreziku i likuiditetit				
Rreziku i ndjeshmërisë ndaj tregut				
Rreziku i operacional				

Kapitali*Arsyetimi për vlerësimin:***Kualiteti i mjeteve/rreziku kreditor***Arsyetimi për vlerësimin:***Fitimet***Arsyetimi për vlerësimin:***Likuiditeti***Arsyetimi për vlerësimin:***Rreziku i tregut***Arsyetimi për vlerësimin:***Rreziku operacionale***Arsyetimi për vlerësimin:***VLERËSIMI LIDHUR ME STABILITETIN MAKRO PRUDENCIAL****Sektori bankar dhe ekonomia e Kosovës***(Bazuar në informatat nga njësitë organizative brenda BQK-së, përgjegjëse për stabilitetin makroprudencial)***Ambienti (ekonomia) i jashtëm ku operon kompania (banka) mëmë**

Vlerësimi:

PARASHIKIMET DHE RREZULTATET E STRES-TESTEVE TË DMB-së: dita-muaji-viti

Në vijim është paraqitur përmbledhja e rezultateve të stres testit - Solvenca e bankës XXX më datë dita-muaji-viti:

(Paraqit tabelën e përmbledhjes së rezultateve të stres-testit)

QËLLIMI DHE STRATEGJIA E MBIKËQYRJES BANKARE

Vlerësimi:

Hapi 2 – Vlerësimi i rrezikut të institucionit

3.1.6. Objektivat

- Përcaktoni pikat e forta dhe të dobëta të bankës.
- Vendosni bazën duke përgatitur profilin e rrezikut dhe matricën e rrezikut të bankës për përcaktimin e aktiviteteve mbikëqyrëse që do të kryhen.

3.1.7. Përshkrimi

Në mënyrë që të përqendrohen aktivitetet mbikëqyrëse në fushat me rrezik të madh në një bankë, ekzamineri përgjegjës në bashkëpunim me ekzaminerë të tjerë duhet të kryejë vlerësimin e rrezikut. Vlerësimi i rrezikut nxjerrë në pah si anët e forta ashtu edhe dobësitë e një institucioni dhe ofron një bazë për përcaktimin e aktiviteteve mbikëqyrëse që do të kryhen. Për më tepër, vlerësimi duhet të zbatohet në të gjithë spektrin e rreziqeve me të cilat përballet një institucion duke përfshirë:

- 1) **Rrezikun kreditor** – potenciali që një huamarrës apo palë tjetër nuk do të mund të kryejë obligimet e tij/saj.
- 2) **Rrezikun e tregut** – rreziku ndaj kushteve të një institucioni që rezultojnë nga lëvizjet e pafavorshme në normat apo çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutorapo çmimet e kapitalit.
- 3) **Rrezikun e likuiditetit** – mundësia që një institucion nuk do të jetë në gjendje të përbushë obligimet e tij në kohën e duhur për shkak të pamundësisë që të

likuidojë mjetet apo të sigurojë financimin adekuat (të referuar si 'financimi i rrezikut të likuiditetit') apo nuk mundet që lehtësisht t'i lirojë apo zvogëlojë ekspozimet pa i ulur në mënyrë të konsiderueshme çmimet e tregut për shkak të thellësisë joadekuate të tregut apo çrregullimeve të tregut ('rreziku i likuiditetit të tregut').

- 4) **Rrezikun operacionale** – mundësia që sistemi joadekuat i informimit, problemet operacionale, shkeljet në kontrollet e brendshme, mashtrimi apo katastrofat e paparapara të rezultojnë me humbje.
- 5) **Rrezikun e vendit dhe i transferit** - rreziku që kushtet ekonomike, sociale dhe politike si dhe ngjarjet në një vend të huaj do të ndikojnë në institucion.

Aktivitetet afariste të një institucioni paraqesin kombinime dhe koncentrim të ndryshme të këtyre rreziqeve varësisht nga natyra dhe fushëveprimi i aktivitetit të caktuar. Prandaj, gjatë kryerjes së vlerësimit të rrezikut, duhet të merret parasysh mjedisi i përgjithshëm i rrezikut të një institucioni, besueshmëria e programit të brendshëm për menaxhimin e rrezikut, adekuatshmëria e sistemeve të teknologjisë së informimit, si dhe rreziqet e ndërlidhura me secilin prej aktiviteteve të rëndësishme të biznesit.

Pika fillestare në procesin e vlerësimit të rrezikut është vlerësimi i tolerancës së rrezikut të institucionit dhe perceptimi i menaxhmentit për pikët e forta dhe të dobëta të institucionit. Një vlerësim i tillë duhet të përfshijë diskutimet me menaxhmentin dhe shqyrtimin e dokumenteve mbështetëse, planeve strategjike dhe politikave. Në përgjithësi, pritet që menaxhmenti të ketë kuptuar qartë tregjet e institucionit dhe mjedisin e përgjithshëm bankar dhe sesi këta dy faktorë ndikojnë në institucion (për shembull, përdorimi i teknologjisë, produkteve dhe kanaleve të saj për shpërndarje).

Në vlerësimin e mjedisit të përgjithshëm të rrezikut të një institucioni, personi kontaktues duhet të bëjë një vlerësim paraprak të menaxhimit të rrezikut të brendshëm të institucionit. Kjo përfshin një vlerësim të përshtatshmërisë së auditimit të brendshëm të institucionit, rishikimin e kredive dhe funksionet e pajtueshmërisë. Auditimet e jashtme gjithashtu sigurojnë informacione të rëndësishme në lidhje me profilin e rrezikut dhe kushtet e institucionit që mund të përdoret në vlerësimin e rrezikut.

Monitorimi efektiv i rrezikut kërkon nga institucionet që të identifikojnë dhe masin të gjitha ekspozimet materiale ndaj rrezikut. Rrjedhimisht, aktivitetet për monitorimin e rrezikut duhet të mbështeten nga sistemi i menaxhimit të informtave që ju ofron menaxherëve dhe drejtorëve të lartë raporte në kohë dhe të besueshme mbi kushtet financiare, performancën e operimit dhe ekspozimin ndaj rrezikut të organizatës së konsoliduar (zyra kryesore dhe çdo filial). Sistemi i menaxhimit të informtave i tillë

duhet t'i sigurojë menaxherëve të angazhuar në menaxhmentin ditor të aktiviteteve të organizatës raporte të rregullta dhe mjaft të detajuara për këtë fushë të përgjegjesisë.

BQK-ja përdor një matricë të rrezikut për të përmbledhur nivelet e rrezikut në aktivitetet e një institucioni. Kjo matricë gjithashtu përmbledh cilësinë e funksionit për menaxhimin e rrezikut në kontrollimin apo lehtësimin e rreziqeve të tilla dhe identifikon drejtimin (p.sh. ↑, ↓ apo ↔) të atyre rreziqeve pasi t'i merr parasysh faktorët e jashtëm dhe të brendshëm të cilët mund të ndikojnë në profilin e rrezikut të institucionit. Matrica është një mjet fleksibil që dokumenton procesin e ndjekur për të vlerësuar rrezikun e përgjithshëm të një institucioni dhe shërben si bazë për përgatitjen e vlerësimit përmbledhës të rrezikut.

Matrica shërben si bazë për përgatitjen e përmbledhjes së vlerësimit të rrezikut. Një mostër e matricës së rrezikut është paraqitur në Shtojcën II: Matrica e rrezikut.

Hapat e mëposhtëm do të udhëzojnë ekzaminerët në përgatitjen e Matricës së rrezikut.

1) Identifikimi i aktiviteteve të rëndësishme/fushave funksionale:

Aktivitete të rëndësishme përfshijnë çfarëdo linje të rëndësishme të biznesit, njësi apo proces. Aktivitetet e konsiderueshme janë identifikuar nga burime të ndryshme duke përfshirë skemën organizative të institucionit, planin strategjik të biznesit, ndarjet kapitale dhe raportimin financiar të brendshëm dhe të jashtëm si bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave.

Identifikimi i aktiviteteve domethënëse është i rëndësishëm për të përcaktuar rreziqet e vetvetishme në aktivitetet e institucionit. Me qëllim të vlerësimit të rrezikut, BQK-ja ka identifikuar rreziqet më të zakonshme, kryesisht, rreziku kreditor, i likuiditetit, i tregut, i vendit apo i transferit dhe rreziku operacional të cilat duhet të planifikohen në aktivitete kaq të rëndësishme, në mënyrë që të ndihmojë ekzaminerët në identifikimin e rreziqeve të vetvetishme të secilit aktivitet.

2) Përcaktimi i sasisë së rreziqeve të vetvetishme:

Pasi të identifikohen rreziqet e rëndësishme, duhet të përcaktohet sasia e rreziqeve të vetvetishme në ato aktivitete. Nëse institucioni përdor kategori të tjera të rrezikut përveç atyre të përcaktuara nga BQK-ja, ekzaminerët duhet të sigurohen që kategoritë e tilla shtesë të rreziqeve të jenë të përfshira nën kategoritë e përdorura nga BQK-ja.

BQK-ja ka zhvilluar kriteret cilësore dhe sasiore që do të përdoren për vlerësimin e sasisë së rreziqeve të qenësishme në një institucion. Për çdo lloj të rrezikut (me përjashtim të rrezikut operacional) janë zgjedhur kriteret

sasiore në të cilat janë vendosur standardet për të përcaktuar vlerën e rrezikut të çdo kriteri. Për kriteret e tjera, vlerësimi gjykues do të përdoret për të përcaktuar vlerën e rrezikut, e cila do të kombinohet për të nxjerrë një vlerë të vetme të rrezikut. Niveli i përgjithshëm i rrezikut do të përcaktohet duke përdorur normën mesatare të rrezikut për secilin kriter. Ekzistojnë tri nivele të rrezikut: i ulët, i mesëm dhe i lartë. Të tri nivelet përkufizohen si më poshtë:

- a. Rreziku *i lartë* i vetvetishëm ekziston kur ka një probabilitet më të lartë se mesatarja e një ndikim negativ në kapitalin e një institucioni apo të ardhurave për shkak të ekspozimit dhe të pasigurisë nga ngjarjet e mundshme në të ardhmen.
- b. Rreziku *mesatar* i vetvetishëm ekziston kur ka një probabilitet mesatar të një ndikimi negativ në kapitalin e një institucioni apo të ardhurat për shkak të ekspozimit dhe të pasigurisë nga ngjarjet e mundshme në të ardhmen.
- c. Rreziku *i ulët* i vetvetishëm ekziston kur ka një probabilitet i ulët i një ndikimi negativ në kapitalin e një institucioni apo të ardhurat për shkak të ekspozimit dhe të pasigurisë nga ngjarjet e mundshme në të ardhmen.

Është me rëndësi që të mbahet në mend se vlerësimi i sasisë së rrezikut bëhet pa i marrë parasysh proceset e menaxhimit dhe të kontrollit; këta faktorë merren parasysh në vlerësimin e cilësisë së sistemeve të institucionit për menaxhim të rrezikut.

3) Vlerësimi i kualitetit të menaxhimit të rrezikut:

Gjatë vlerësimit të cilësisë së menaxhimit të rrezikut të një institucioni për rrezikun e vetvetishëm në atë institucion, ekzamineri duhet t'i kushtojë rëndësi në radhë të parë të gjeturave që lidhen me elementet e mëposhtme kyçe të një sistemi të shëndoshë të menaxhimit të rrezikut:

- a) Mbikëqyrja e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë;
- b) Politikat, procedurat dhe limitet;
- c) Matjet e rrezikut, monitorimi dhe sistemi i informimitit e menaxhmentit;
- d) Kontrollat e brendshme.

Ekzamineri duhet të vlerësojë fuqinë relative të proceseve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit për çdo rrezik të identifikuar duke përdorur katër elemente kryesore të mësipërme. BQK-ja ka vendosur kritere të ndryshme për

vlerësimin e çdo elementi kyç dhe rezultati përcaktohet në bazë të një vlerësimi gjykues. Një vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së menaxhimit të riskut do të përcaktohet duke përdorur një mesatare të thjeshtë të pikëve për katër elementet kryesore. Vlerësimi për cilësinë e menaxhimit të riskut duhet të vlerësohet si i fortë, i pranueshëm, apo i dobët. Këto vlerësime janë definuar si:

- a. Menaxhimi *i fortë* i rrezikut tregon që menaxhmenti në mënyrë efektive identifikon, monitoron dhe kontrollon apo lehtëson të gjitha llojet e rreziqeve të qenësishme në institucion. Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti marrin pjesë në menaxhimin e rreziqeve dhe sigurohen se ekzistojnë politikat dhe kufizimet e duhura. Politikat dhe kufizimet mbështeten nga procedurat për monitorimin e rrezikut, raportet dhe sistemi i informimit të menaxhmentit të cilat ofrojnë informatat dhe analizat e nevojshme për të dhënë përgjigjet në kohë dhe në mënyrë të duhur ndaj ndërrimit të kushteve dhe kontrollet e brendshme dhe procedurat e auditimit janë të përshtatshme me madhësinë dhe aktivitetet e institucionit. Ka disa përjashtime në politikat dhe procedurat e përcaktuara dhe asnjë nga këto përjashtime nuk do të çojë në një humbje të konsiderueshme të institucionit.
- b. Menaxhimi *i pranueshëm* i rrezikut tregon që sistemet për menaxhimin e rrezikut të institucionit edhe pse zbatohen në mase të madhe, mund të kenë mungesa në një shkallë modeste. Vlerësimi reflekton aftësinë e menaxhmentit për t'u përballur me sukses me ekspozimet ekzistuese dhe të parashikueshme të cilat mund të lindin gjatë kryerjes së planit të biznesit të institucionit. Përderisa institucioni mund të ketë probleme të vogla të menaxhimit të rrezikut, këto probleme janë të njohura dhe janë duke u zgjidhur. Në përgjithësi, mbikëqyrja e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë, politikat dhe kufizimet, procedurat e monitorimit të rrezikut, raportet, sistemi i menaxhimit të informatave dhe sistemet e kontrollit të brendshëm konsiderohen efektive në ruajtjen e një institucioni të sigurt dhe të shëndoshë. Rreziqet në përgjithësi janë duke u kontrolluar në një mënyrë që nuk kërkon më shumë se vëmendje normale të mbikëqyrjes.
- c. Menaxhimi *i dobët* i rrezikut tregon sistemet e menaxhimit të rrezikut të cilët kanë mungesa të mëdha dhe prandaj janë shkak për më shumë se vëmendje normale mbikëqyrëse. Kjo mund të karakterizohet me një mbikëqyrje joadekuate të bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë, politika, procedura dhe limite joadekuate monitorim të dobët dhe sistem për menaxhimin e informatave joadekuatë. Sistemi i kontrollit të brendshëm mund të jetë i mangët në aspekte të rëndësishme, veçanërisht nëse shfaqen përjashtime të vazhdueshme të kontrollit ose

nga dështimi për të ndjekur politikat dhe procedurat e shkruara. Mangësitë e ndërlydhura në këto sisteme mund të ketë efekte negative në sigurinë dhe shëndetin e institucionit apo të mund të çojnë në gabime materiale të pasqyrave financiare nëse nuk merren veprimet korrigjuese.

4) Përcaktimi i nivelit të përgjithshëm të rrezikut (rreziku neto)

Rreziku neto për secilën kategori të rrezikut është përcaktuar duke balancuar sasinë e rrezikut të vetvetishëm me cilësinë e sistemeve të menaxhimit të rrezikut të institucionit. Për shembull, rreziku kreditor mund të përcaktohet si vetvetishëm i lartë në një institucion, megjithatë, probabiliteti dhe madhësia e humbjes së mundshme mund të reduktohet duke pasur standarde shumë konservative të vlerësimit të kredisë, administrimin efektiv të kredisë, rishikim të fortë të brendshëm dhe një sistem të mirë të paralajmërimit të hershëm. Rrjedhimisht, pas llogaritjes së këtyre faktorëve lehtësues, profilit të përgjithshëm të rrezikut dhe nivelit të shqetësimit mbikëqyrës, rreziku kreditor mund të jetë mesatar. Tabela në vijim jep udhëzime për përcaktimin e rrezikut neto duke balancuar sasinë e vërejtur dhe shkallën e rrezikut me forcën e perceptuar të sistemeve të menaxhimit të rrezikut.

Tabela 1. Rreziku i përbërë – pasqyrë e rrezikut neto

Sistemet e menaxhimit të rrezikut (kualiteti)	Rreziku i vetvetishëm i aktivitetit (sasia)		
	i ulët	mesatar	i lartë
	Vlerësimi i nivelit të përgjithshëm të rrezikut (vlerësimi i rrezikut neto)		
I dobët	I ulët ose mesatar	Mesatar ose i lartë	I lartë
I pranueshëm	I ulët	Mesatar	I lartë
I fortë	I ulët	I ulët, mesatar ose i lartë	Mesatar ose i lartë

Pasi ekzamineri të ketë vlerësuar rrezikun e përbërë të secilit aktivitet apo funksion të rëndësishëm të identifikuar, një vlerësim i përgjithshëm i rrezikut të përbërë duhet të bëhet për përgatitjen e fushëveprimit të një ekzaminimi në vend dhe për qëllimet analitike dhe planifikuese. Ky vlerësim është hapi përfundimtar në zhvillimin e matricës së rrezikut duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të përgjithshëm.

Për të lehtësuar qëndrueshmërinë në përgatitjen e matricës së rrezikut, më poshtë janë dhënë përkufizimet e përgjithshme të nivelit të rrezikut neto për kategoritë e rrezikut:

- a. *Rreziku i lartë i nivelit të përgjithshëm të rrezikut* në përgjithësi do t'i caktohej një institucioni ku sistemi i menaxhimit të rrezikut nuk e ka zbutur në mënyrë të konsiderueshme rrezikun e lartë të vetvetishëm. Aty ku rreziku i vetvetishëm është mesatar, sistemi i menaxhimit të rrezikut që ka një dobësi të konsiderueshme mund të rezultojë me rrezik të lartë të nivelit të përgjithshëm. Kjo mund të jetë për shkak se menaxhmenti nuk e ka kuptuar mjaftueshëm rrezikun dhe nuk ka kapacitete të sigurta për të paraparë dhe për t'iu përgjigjur ndryshimit të kushteve.
- b. *Rreziku mesatar i nivelit të përgjithshëm të rrezikut* zakonisht do t'i caktohej një institucioni ku sistemi i menaxhimit të rrezikut në përgjithësi e zbutë rrezikun. Aty ku ka rrezik të vetvetishëm të ulët, dobësitë në sistemin e menaxhimit të rrezikut mund të rezultojnë me një vlerësim mesatar të rrezikut. Në anën tjetër, një sistem i fortë i menaxhimit të rrezikut mund të zvogëlojë rrezikun e një aktiviteti me rrezik të lartë të vetvetishëm në mënyrë që çfarëdo humbje e mundshme financiare nga aktiviteti do të kishte vetëm ndikim mesatar negativ në gjendjen financiare të institucionit.
- c. *Një rrezik i ulët i nivelit të përgjithshëm të rrezikut*, zakonisht i caktohet një institucioni ku rreziku i vetvetishëm është i ulët. Një institucioni me rrezik të ulët të vetvetishëm mund t'i caktohet një rrezik i ulët i nivelit të përgjithshëm kur kontrollet e brendshme dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut të jenë të forta dhe në mënyrë efektive të zbusin një pjesë të konsiderueshme të rrezikut.

5) Drejtimi i rrezikut

Drejtimi i rrezikut shton perspektivën drejt qasjes së mbikëqyrjes të bazuar në rrezik. Në përgjithësi, drejtimi i rrezikut është funksion i tri gjërave:

- a. Ndryshimet në mjedisin e jashtëm;
- b. Ndryshimet në madhësinë relative dhe kompleksitetin e një aktiviteti (apo inicimin e një aktiviteti të ri) brenda një institucioni;
- c. Gjendja aktuale e menaxhimit dhe sistemet e ndërlidhura të menaxhimit të rrezikut.

Rreziku mund të jetë në rritje, stabil apo në rënie.

Rreziku në rritje (↑)

Rreziku në rritje tregon se duke qenë të gjitha gjërat të barabarta, ekziston një mosbalancë në mes të aktiviteteve aktuale apo të planifikuara të një institucioni dhe sistemeve themelore të menaxhimit të rrezikut. Veçanërisht, profili i rrezikut të institucionit tejkalon aftësinë e sistemit të tij për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar apo zbutur rrezikun. Nëse nuk zbatohet veprimi korigjues, institucionet të cilat përjetojnë një rrezik në ngritje i ekspozohen një mundësie më të madhe të humbjes që mund të ketë ndikim material negativ në pozitën e tij financiare.

Kjo mosbalancë mund të shkaktohet nga disa faktorë të ndryshëm si:

- a. Ndryshimet në mjedisin e jashtëm apo konkurrues; p.sh. një mjedis konkurrues në rritje mund të shkaktojë rrezik strategjik ose rritje të kategorive të tjera të rrezikut siç është rreziku kreditor, edhe nëse institucioni nuk ka nisur asnjë ndryshim të brendshëm.
- b. Rritja e përgjithshme e paqëndrueshmërisë së tregut do të shkaktojë një rritje të rrezikut të likuiditetit dhe tregut. Përderisa sistemet ekzistuese mund të kenë qenë adekuate për të mbështetur operacionet në një mjedis të qëndrueshëm, ato mund të jenë të pamjaftueshme për kompensimin e rritjes së paqëndrueshmërisë së tregut dhe rritjes në humbjet nga ekspozimet. Ekzamineri duhet të shikojë në të dhënat e jashtme, të tilla si raportet e lajmeve, trendet e industrisë dhe tregut dhe aktivitetet e institucioneve në kuadër të tregut për të gjykuar nëse një institucion përballet me rrezikun në rritje.

Rreziku në rritje mund të jetë rezultat i faktorëve të brendshëm, të tillë si ndryshimi në menaxhim, strategji ose plan të biznesit. Ekzamineri zakonisht mbështetet edhe në monitorimin nga (off-site) dhe në një sistem të paralajmërimit të hershëm për të identifikuar rritjen e rreziqeve nga faktorë të brendshëm. Situatat e rrezikut në rritje zakonisht karakterizohen nga instanca të shumta të raporteve kyçe të cilat ose tejkalojnë ose mbesin mbrapa në krahasim me bankat e grupit të njëjtë krahasues dhe alarmet që përsëriten në sistemin e paralajmërimit të hershëm. Shenjat paralajmëruese shtesë që tregojnë rrezikun në rritje përfshijnë:

- a. Rritjen e shpejtë të madhësisë së të gjitha asetëve, apo në kuadër të një segmenti të asetëve;
- b. Rritje e përqendrimit të kredive apo burimeve të financimit;
- c. Pozicione të pazakonshme të mëdha në instrumentet e derivateve; apo,
- d. Fillimi i shpejtë i aktiviteteve të reja biznesore.

Rreziqet mund të rriten edhe nga përkeqësimi i sistemeve ekzistuese të menaxhimit të rrezikut të institucionit. Për shembull, në përpjekje për të shkurtuar shpenzimet, menaxhimi e lë fushëveprimin e operacioneve të pandryshuar, por zvogëlon buxhetin e menaxhimit të rrezikut për 50 për qind. Gjithashtu, rreziku mund të rritet nëse menaxhmenti nuk ka zbatuar një plan të vazhdimësisë së menaxhmentit dhe planin e trajnimit dhe nuk është në gjendje të plotësojë me personel të kualifikuar pozitat kyçe të lira në menaxhimin e rrezikut. Ekzaminimi në vend do të jetë mjeti kryesor për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rrezikut.

Rreziku stabil (↔)

Rreziku i qëndrueshëm (stabil) nënkupton që cilësia e sistemeve të menaxhimit të rrezikut të institucionit është e mjaftueshme për të balancuar dhe mbështetur nivelin e rrezikut të supozuar. Megjithatë, keni parasysh se kjo nuk kërkon një mjedis statik, të pandryshueshëm. Për shembull, rreziku stabil mund të përdoret për të përshkruar një situatë në të cilën:

- a. Nuk ka pasur hyrje të reja në treg;
- b. Strukturat e pronësisë kanë mbetur stabile;
- c. Janë prezantuar pak produkte të reja apo inovacione;
- d. Rishikimi i raporteve monitoruese nga divizioni për raportin dhe analiza nga jashtë (off-site), e po ashtu edhe sistemi i paralajmërimit të hershëm tregojnë se ka pak ose aspak ndryshime domethënëse në madhësi, përqendrime ose përzierje të produkteve;
- e. Planet strategjike dhe buxhetet mbështetëse kanë mbetur të njëjtat, më relativisht pak ndryshime në nivelet e personelit ose të nivelit të burimeve që mbështesin linjat e produkteve; ose,
- f. Të gjitha aspektet e sistemeve mbështetëse të menaxhimit të rrezikut mbeten në fuqi, duke përfshirë edhe përbërjen e personelit dhe nivelet, linjat e raportimit dhe funksionet mbështetëse të tilla si raportimi dhe sistemi informativ i menaxhmentit.

Në anën tjetër, kushtet brenda një institucioni mund të kenë ndryshuar. Nivelet e rrezikut mund të janë rritur për shkak të rritjes së konkurrencës, futjes së produkteve të reja apo rritjes së madhësisë.

Megjithatë, një institucion ende mund të shfaqë një profil të qëndrueshëm të rrezikut nëse sistemet e menaxhimit të rrezikut janë zgjeruar për të kompensuar rritjen e nivelit të rrezikut. Për shembull, një institucion mund të ketë zbatuar një aktivitet tregtar që nga ekzaminimi paraprak. Vet zbatimi i këtij aktiviteti e rritë profilin e rrezikut të institucionit. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të mëtejshëm, ekzaminimet kanë gjetur se menaxhmenti ka zbatuar mekanizmat e duhur për kufizimin e rrezikut, duke përfshirë kufizimet e pozicionit, monitorimin në kohë reale dhe ndarjen e funksionit shitës dhe funksionit operacional (back office). Në këtë rast, profili i përgjithshëm i rrezikut të institucionit ende mund të konsiderohet si i qëndrueshëm.

Rreziku në rënie (↓)

Rreziku në rënie përshkruan një situatë ku faktorët e jashtëm janë duke u bërë gjithnjë e më pakë ndikues, apo ku një institucion është duke kanalizuar apo thjeshtëzuar operacionet. Për shembull, një institucion i cili i ekspozohet më pak konkurrentëve dhe/apo konkurrentëve më pak të vështirë mund të përjetojë një rënie në rrezikun e vetvetishëm. Periudhat e aktivitetit të ulët ekonomik gjithashtu mund të korrespondojë me rënien e rrezikut të vetvetishëm.

Nga perspektiva e brendshme, një institucion mund të zvogëlojë ekspozimin ndaj rrezikut duke eliminuar përdorimin e strategjive komplekse, linjave të produkteve apo shërbimeve. Në thelb, një institucion i cili koncentrohet në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të cilat janë të ndryshme dhe të cilat janë kuptuar mirë, ka një profil më të ulët të rrezikut se një institucion që merret me produktet ekzotike apo ka mungesë të ndryshueshmërisë. Prandaj, përderisa një institucion kalon nga strategjitë komplekse në strategji të thjeshta, linja të produkteve apo shërbimeve, zakonisht ulet edhe rreziku i vetvetishëm.

Së fundmi, rreziku i vetvetishëm gjithashtu mund të zvogëlohet nëse institucioni përmirëson sistemet e menaxhimit të rrezikut pa rritje korresponduese në profilin e tij të rrezikut. Për shembull, zbatimi i një funksioni efektiv të auditimit të brendshëm, me të gjitha gjërat e tjera që mbesin të pandryshueshme, do të zvogëlojë nivelin e rrezikut operacional në institucion. Megjithë shkallën e këtyre përmirësimeve si dhe zvogëlimin korrespondues të rrezikut mund të gëzojmë vetëm nëpërmjet procesit të ekzaminimit në vend.

6) Përcaktimi i nivelit të përgjithshëm të rrezikut

Pasi ekzamineri të përcaktojë nivelin e përgjithshëm të rrezikut për secilën kategori të rrezikut, duhet të bëhet një vlerësim i nivelit të përgjithshëm të

rrezikut për qëllime analitike dhe të planifikimit. Ky vlerësim është hapi i fundit në zhvillimin e matricës së rrezikut. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut është i bazuar në mesataren e thjeshtë të të gjitha niveleve të përgjithshme të rrezikut. Drejtimi i rrezikut të përgjithshëm gjithashtu përcaktohet në bazë të gjykimit të drejtimit të secilit nivel të rrezikut të përngjithshëm individual.

Pas zhvillimit dhe analizave të matricës së rrezikut, ekzamineri përgatit një vlerësim me shkrim për të shërbyer si mjet i brendshëm i planifikimit të mbikëqyrjes dhe për të lehtësuar komunikimin me mbikëqyrësit e tjerë. (Formati përmbledhës i vlerësimit të rrezikut është paraqitur në Shtojcën III). Qëllimi është zhvillimi i një dokumenti që paraqet një pamje gjithëpërfshirëse dhe të përqendruar në rrezik të institucionit duke përshkruar fushat e shqetësimit të mbikëqyrjes dhe duke shërbyer si një platformë për zhvillimin e planit mbikëqyrës.

Formati dhe përmbajtja e dokumentit janë fleksibil dhe duhet të përshtaten me institucionin individual. Vlerësimi i rrezikut pasqyron dinamikën e institucioneve, prandaj, duhet të marrë parasysh strategjitë biznesore evoluese të institucionit dhe të ndryshohen pasi të ndodhin ndryshime të rëndësishme në profilin e rrezikut. Vlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë të dhëna nga mbikëqyrësit e tjerë të ndikuar dhe njësitet e specializuara në mënyrë që të sigurojë se janë identifikuar rreziqet e rëndësishme të institucionit. Vlerësimi i rrezikut duhet të:

- a. Përfshijë një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut të organizatës.
- b. Përshkruaj llojet (kreditore, tregut, likuiditetit, vendore ose transfer, operacionale), nivelin (i lartë, mesatar, i ulët), dhe drejtimin (në rritje, i qëndrueshëm (stabil), në rënie) e rreziqeve.
- c. Identifikojë të gjitha funksionet kryesore, linjat e biznesit, aktivitetet, produktet dhe personat juridikë nga të cilët burojnë rreziqet të mëdha dhe çështjet kyçe që do të mund të ndikojnë në profilin e rrezikut.
- d. Shqyrtojë marrëdhënien ndërmjet mundësisë së ndodhjes të një ngjarje negative dhe ndikimit të mundshëm në një institucion (p.sh., gjasat e dështimit të sistemit kompjuterik mund të jenë të vogla, por ndikimi financiar mund të jetë domethënës).
- e. Përshkruaj sistemet e institucionit për menaxhimin e rrezikut. Shqyrtime dhe vlerësime të rrezikut të kryera nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm duhet të diskutohen, ashtu si edhe aftësia e institucionit për të shtuar dhe për të menaxhuar rreziqet e saj në mënyrë të përshtatshme.

Ekzamineri duhet të përpiqet të identifikojë shkakun e trendëve të pafavorshme, e jo vetëm të raportojë simptomat. Për shembull, nëse rreziku i likuiditetit të një institucionit është në rritje për shkak të rënies së depozitave bazë, duhet të adresohen arsyet për këtë rënie të depozitave bazë. Duke identifikuar shkakun e rënies, ekzamineri do të jetë në gjendje të vlerësojë perspektivat për ndryshimin e rënies.

Është e rëndësishme që vlerësimi i rrezikut të pasqyrojë një analizë të plotë që çon në përfundime në lidhje me profilin e rrezikut të institucionit dhe jo vetëm në përsëritje të fakteve. Për shembull, nuk mjafton që një raport i lartë i kredive ndaj depozitave vetëm të raportohet si shqetësim i likuiditetit. Ekzamineri duhet të analizojë me kujdes strukturën e detyrimeve për të formuar një gjykim në lidhje me seriozitetin e shqetësimit. Rëndësia e raportit relativisht të lartë në mes të kredive dhe depozitave në një institucion detyrimet e të cilit janë të gjitha depozitat bazë praktikisht shumë të qëndrueshme është ndoshta më pak shqetësuese se i njëjti raport, në një institucion me një strukturë me detyrime shumë të paqëndrueshme. Rreziku i likuiditetit mund të jetë i lartë në situatën e fundit dhe i mesëm apo i ulët në atë të parën edhe pse raporti është i njëjtë.

3.1.8. Procedurat

- I. Kompletioni dhe/apo përditësoni matricën e rrezikut duke:
 - A. Përcaktuar sasinë ose nivelin e rrezikut të vetvetishëm në çdo fushë funksionale apo aktivitet;
 - B. Vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rrezikut për të menaxhuar rreziqet për secilën fushë funksionale;
 - C. Përcaktuar profilin funksional të rrezikut të përbërë për secilën fushë funksionale;
 - D. Përcaktuar vlerësimin e profilit të rrezikut për secilin rrezik të vetvetishëm në të gjithë institucionin;
 - E. Vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut për çdo rrezik të vetvetishëm në të gjithë institucionin (për secilin sistem të menaxhimit të rrezikut dhe bazat e përgjithshme);
 - F. Vlerësimi i përbërjes së përgjithshme të rrezikut për secilin rrezik të vetvetishëm në të gjithë institucionin;
 - G. Përcaktimi i drejtimit të përbërjes së rrezikut të përgjithshëm për rreziqet e vetvetishme në të gjithë institucionin; dhe,

H. Përcaktimi i rrezikut të përgjithshëm të vetvetishëm, sistemeve të menaxhimit të rrezikut të përgjithshëm, përbërjes së përgjithshme të rrezikut dhe drejtimit të përbërjes së përgjithshme të rrezikut.

II. Plotësoni vlerësimin me shkrim të rrezikut i cili duhet të përfshijë siç vijon:

- A. Një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut të bankës;
- B. Llojet e rreziqeve të vetvetishme, niveli dhe drejtimi i tyre;
- C. Identifikimi i të gjitha funksioneve kryesore, linjave biznesore dhe produkteve nga të cilat dalin rreziqet e mëdha;
- D. Një përshkrim i sistemit për menaxhimin e rrezikut;
- E. Marrëdhëniet në mes mundësisë së një ngjarje negative dhe potencialit të saj për të ndikuar në bankë;
- F. Një koment mbi sistemin e konsoliduar të menaxhimit të rrezikut dhe funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

3.1.9. Shtojca II: Matrica e rrezikut

PROFILI I RREZIKUT TË BANKËS				
Kategoria e rrezikut	Sasia e rrezikut të vetvetishëm <i>(i ulët, mesatar, i lartë)</i>	Kualiteti i menaxhimit të rrezikut <i>(i dobët, i pranueshëm, i fortë)</i>	Niveli i përgjithshëm i rrezikut <i>(i ulët, mesatar, i lartë)</i>	Drejtimi i rrezikut <i>(në rritje ↑, stabil ↔, në rënie ↓)</i>
RREZIKU I PËRGJITHSHËM	I lartë	I dobët	I lartë	Në rritje ↑
KREDITË -huadhënia për persona juridikë -huadhënia individuale -huadhënia komerciale -pasuritë e patundshme -Ndërmarrje të vogla të mesme	I lartë	I dobët	I lartë	Në rritje ↑
TREGU	Mesatar	I dobët	Mesatar	

- depozitat dhe vendimet për investime				Në rritje ↑
LIKUIDITETI - thesari dhe investimet -Tregtia -derivativat -swaps -ndërbankar -depozitat dhe vendimet për investime	Mesatar	I dobët	Mesatar	Në rritje ↑
OPERACIONAL -operacionet individuale -operacionet për persona juridikë -sistemet dhe proceset -politikat dhe procedurat -burimet njerëzore -sistemet e pagesës -sistemet e informimit -Shërbimet e brendshme dhe të jashtme të auditimit -modelet	I lartë	I dobët	I lartë	Në rritje ↑
VENDI / TRANSFERI	Mesatar	I pranueshëm	Mesatar	Stabil ↔

3.1.10. Shtojca III: Format i përmbledhës i vlerësimit të rrezikut

- SISTEMI I BRENDSHËM I MENAXHIMIT TË RREZIKUT

- Struktura e menaxhimit të rrezikut
- Kategoritë e rrezikut
- Politikat, procedurat dhe limitet
- Diskutimi mbi vlerësimin e rreziqeve nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm ose ndonjë kontrollues tjetër i pavarur.

- VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIKUT
 - Klasifikimi i përgjithshëm i rrezikut
 - Trendi/drejtimi i rrezikut të përgjithshëm
 - Komentet narrative mbështetëse

- VLERËSIMI INDIVIDUAL I RREZIKUT
 - Vlerësimi i nivelit të përgjithshëm të rrezikut
 - Drejtimi i rrezikut
 - Komentet narrative mbështetëse

- REKOMANDIMET PËR VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN
 - Komentet për nevojën e lëshimit të udhëzimit apo rekomandimit tek institucioni duke u bazuar në rezultatin e vlerësimit të profilit të institucionit
 - Komentoni për nevojën për ndryshime në planin mbikëqyrës, nëse ka.

3.2. Hapi 3 – Planifikimi dhe caktimi i aktiviteteve mbikëqyrëse

3.2.1. Objektivat

- Të ofrojë një urë lidhëse ndërmjet shqetësimeve të mbikëqyrjes dhe bankës dhe aktiviteteve që do të kryhen, e cila me kalimin e kohës, do t'i mundësojë BQK-së të përcaktojë efikasitetin e menaxhmentit të bankës në identifikimin, matjen, monitorimin, kontrollin dhe zbutjen e rreziqeve brenda institucionit.

3.2.2. Përshkrimi

Ekzaminerët e bankës duhet të zhvillojnë dhe mirëmbajnë një plan mbikëqyrës⁴ (formati ilustrativ për planin mbikëqyrës është treguar në Shtojcën IV) që është

⁴ Ekzistojnë dy lloje të planit mbikëqyrës: një plan i gjerë industrial apo sektorial dhe një plan institucional specifik. Plani i gjerë industrial i jep prioritet burimeve të ekzaminimit edhe të rrezikut relativ të profilit të të gjitha bankave në treg edhe rëndësisë së tyre sistemike. Planet specifike bankare janë tema e këtij seksioni.

aktual dhe relevant me madhësinë dhe kompleksitetin e bankës dhe ndryshimet në profilin e rrezikut. Në përgjithësi, një plan mbikëqyrës mund të zhvillohet në baza vjetore dhe të rishikohet në baza tremujore për të reflektuar trendet e rreziqeve të reja. Plani mbikëqyrës ofron një urë në mes të shqetësimeve të identifikuar përmes vlerësimit të rrezikut dhe aktiviteteve mbikëqyrëse të cilat do të kryhen. Plani duhet të inkorporojë një orar për aktivitetet që do të ndërmerren për periudhën e caktuar të planifikimit.

Për të qenë efektiv, planifikimi kërkon një deklaratë fillestare të objektivave dhe identifikimin e strategjive të ndërlidhura që duhet të arrihen. Një plan i mirë duhet të demonstrojë që shqetësimet e mbikëqyrjes të identifikuar në matricën e rrezikut dhe në narrativin e vlerësimit të rrezikut, si dhe mangësitë e vërejtura në ekzaminimet e mëparshme janë duke u adresuar apo do të adresohen në të ardhmen.

Ekzamineri përgjegjës kërkon informacionin nga institucioni me qëllim të kryerjes së një shqyrtimi preliminar dhe përgatitjen e memorandumit për fushëveprimin e ekzaminimit në vend. Memorandumi i fushëveprimit identifikon objektivat kryesore dhe fushëveprimin e ekzaminimeve në vend të planifikuara. Letra informuese dhe letërkërkesa e ekzaminimit identifikon informata e nevojshme për kryerjen e suksesshëm të ekzaminimit në vend, i prezanton ekzaminerët të cilët do të kryejnë ekzaminimin, dhe i dërgohet institucionit paraprakisht para datës së fillimit të ekzaminimit.

3.2.3. Procedurat

- I. Përgatitni dhe/apo përditësoni planin mbikëqyrës për institucionet të cilat do të ekzaminohen.
 - A. Shqyrtoni vlerësimin e rrezikut më të fundit që është përgatitur duke u bazuar në pasqyrimin institucional më të fundit të bankës dhe matricën e rrezikut të përfunduar së fundmi.
 - B. Shqyrtoni raportin e fundit të ekzaminimit duke përfshirë edhe vlerësimet notuese të CAMELS.
 - C. Shqyrtoni çfarëdo korrespondence të dërguar apo pranuar që nga ekzaminimi i fundit në vend.
 - D. Përcaktoni dhe listoni shpeshtësinë (p.sh. mujore, tremujore) dhe fushëveprimin e analizave si dhe çfarëdo çështje apo shqetësim të identifikuar.
 - E. Përcaktoni kohën dhe fushëveprimin e ekzaminimit në vend të ardhshëm. Tregoni numrin e propozuar të ditëve të punës të cilat nevojiten për të përfunduar ekzaminimin.

- F. Përcaktoni kohën, fushëveprimin dhe nevojat e stafit për ekzaminimet në vend të mëvonshme dhe analizat nga jashtë (off-site) gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm.

3.2.4. Shtojca IV: Formati ilustrativ për planin mbikëqyrës

Emri i bankës:				
Data e raportimit:				
A. Shqetësimet e mbikëqyrjes:				
Identifiko shqetësimet e mbikëqyrjes duke rishikuar si në vijim:				
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimin e rrezikut; • Vlerësimi sipas rreziqeve dhe sipas CAMELS; • Informatat e tjera në dispozicion (p.sh. të gjeturat nga ekzaminimi i kaluar, raportet e auditorit të jashtëm, ndërlidhjet me palë të ndryshme); • Ngjarjet e tjera signifikante (p.sh. përvetësimet, shkriret) 				
B. Strategjitë mbikëqyrëse dhe aktivitetet që duhet të ndiqen:				
Identifiko strategjitë për të adresuar shqetësimet e mbikëqyrjes si edhe aktivitetet specifike që duhet të bëhen në (institucionin bankar, kompanitë holding dhe degët kryesore jobankare brenda grupit).				
1. Monitorimi nga jashtë (off-site)				
Komentet:				
Siguro informatat nga aktivitetet e propozuara të mbikëqyrjes nga jashtë (off-site) duke marrë parasysh objektivat, fushëveprimin dhe shqetësimet specifike mbikëqyrëse.				
Nr.	Aktiviteti	Objektivi / Fushëveprimi	Periudha	Vërejtjet
2. Ekzaminimi në vend				
Komentet:				
Siguro informatat nga ekzaminimet në vend duke marrë parasysh objektivat,				

fushëveprimin datën e ekzaminimit të fundit dhe shqetësimet specifike mbikqyrëse.

Nr.	Aktiviteti	Objektiva/Fushëveprimi	Perioda	Vërejtjet
Nënshkruar	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi	Data	
Përgatitur nga (<i>Ekzamineri përgjegjës</i>)				
Shqyrtuar nga (<i>Udhëheqësi i Divizionit</i>)				
Aprovuar nga (<i>Drejtori i Departamentit</i>)				

SHËNIM:

3.3. Hapi 4 – Përkufizimi i aktiviteteve të ekzaminimit

3.3.1. Objektivat

- Identifikimi i objektivave kryesore dhe fushëveprimi i ekzaminimit në vend;

- Identifikimi i ekzaminerëve të caktuar për ekzaminim dhe përcaktimi i detyrave gjatë ekzaminimit;
- Listimi i çështjeve që do të zhvillohen si rezultat i ekzaminimit.

3.3.2. Përshkrimi

Procedurat e ekzaminimit duhet të jenë të përshtatura (ekzaminim i plotë ose i fokusuar) ndaj karakteristikave të çdo institucioni, duke pasur parasysh madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të saj. Procedurat duhet të përqendrohen në zhvillimin e dokumentacionit të duhur për të vlerësuar në mënyrë adekuate aftësinë e menaxhmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar apo zbutur rreziqet. Procedurat duhet të përfundojnë deri në shkallën e nevojshme për të përcaktuar nëse menaxhmenti i institucionit kupton dhe në mënyrë adekuate monitoron dhe kontrollon ose zbut llojet dhe nivelet e rreziqeve që janë marrë përsipër.

Memorandumi i fushëveprimit (shih formatin e memorandumit të fushëveprimit – scope memo – për ekzaminimet në vend të paraqitur në Aneksin V - 1) është një produkt integral në metodologjinë e bazuar në rrezik pasi ai t'i ketë identifikuar objektivat kyçe dhe fushëveprimin e ekzaminimit në vend. Fokusi i aktiviteteve të ekzaminimit në vend, i identifikuar në memorandumin e fushëveprimit, duhet të orientohet në një qasje nga lart-poshtë që përfshin rishikimin e sistemeve të institucionit për menaxhimin e rrezikut të brendshëm dhe një nivel të duhur të testimit të transaksioneve. Metodologjia e bazuar në rrezik ofron fleksibilitet në sasinë e testimeve të transaksioneve në vend. Edhe pse fokusi i ekzaminimit qëndron në proceset e institucionit, nivelin e duhur të testimit të transaksioneve dhe rishikimit të mjeteve do të jetë i nevojshëm për të verifikuar integritetin e sistemeve të brendshme. Nëse sistemet e brendshme konsiderohen të besueshme, atëherë testimi i transaksionit duhet të fokusohet në një nivel të mjaftueshëm për të vërtetuar se sistemet janë efektive dhe të sakta. Në anën tjetër, nëse sistemet e menaxhimit të brendshëm konsiderohen të pabesueshme ose të paefektshme, atëherë testimi i transaksionit duhet të rregullohet duke rritur numrin e testimit të transaksioneve në kuadër të mostrës së përzgjedhur. Memorandumi i fushëveprimit duhet të përshtatet me madhësinë, kompleksitetin dhe vlerësimin aktual të institucionit dhe duhet të përcaktojë objektivat e ekzaminimit.

Memorandumi i fushëveprimit duhet të përfshijë:

- a. Fushëveprimin dhe objektivat e ekzaminimit;
- b. Përmbledhjen e profilit të rrezikut të institucionit dhe çdo ndryshim në pasqyrën institucionale pas përfshirjes së informatave nga shqyrtimi

preliminar i informatave nga ekzaminimet në vend (on-site) edhe analizave nga jashtë (off-site);

- c. Përmbledhjen e takimit para fillimit të ekzaminimit;
- d. Përmbledhjen e shqyrtimit të auditimit;
- e. Fokusin dhe procedurat e ekzaminimit;
- f. Planifikimin e resurseve (stafit).

3.3.3. Procedurat

- I. Përgatitni memorandumin e fushëveprimit për ekzaminimin e ardhshëm të planifikuar në vend sipas formatit të shfaqur në Shtojcën V – 2 (Mostra – shembull i memorandumit të fushëveprimit për ekzaminimet në vend).
 - A. Shqyrtoni vlerësimin e fundit të rrezikut, matricën e rrezikut, raportin e ekzaminimit RE si dhe vlerësimet sipas rreziqeve, CAMELS dhe CAELS.
 - B. Shqyrtoni planin mbikëqyrës të bankës.
- II. Mbani një takim para fillimit të ekzaminimit me menaxhmentin e lartë të bankës për të diskutuar çështjet në vijim:
 - A. Tregun primar të synuar dhe linjat e biznesit, si dhe ndryshimet e rëndësishme në produkte ose shërbime të bankave duke përfshirë fushat e rritjes;
 - B. Kushtet ekonomike brenda tregjeve të synuara dhe çdo faktor tjetër të jashtëm që ndikon në linjat primare të biznesit;
 - C. Fushat që përfaqësojnë rrezikun më të lartë për bankën dhe/ose tregjet;
 - D. Ndryshimet në menaxhmentin e bankës, personelin kyç ose operacional që nga ekzaminimi i kaluar;
 - E. Rezultatet e auditimeve të brendshme dhe të jashtme dhe rishikimin e kontroleve të brendshme, duke përfshirë çdo përcjellje të gjendjes të kërkuar nga menaxhmenti;

- F. Çfarëdo ndryshimesh materiale të orareve të auditimit të brendshëm ose të jashtëm apo të fushëveprimit dhe mjaftueshmërisë së personelit të auditimit;
- G. Konsideratat e korporatës (d.m.th. blerje të propozuara apo të kryera kohëve të fundit, përvetësimet, shkrirjet ose konsideratat e shitjeve të aseteve);
- H. Ndryshimet në teknologji duke përfshirë sistemet operative, ofruesit e teknologjisë/shërbimeve, softueri kyç, bankingu përmes internetit, apo planet për produktet/aktivitetet e reja që përfshijnë teknologji të reja që nga ekzaminimi i kaluar;
- I. Çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe rregullat që drejtojnë biznesin bankar;
- J. Çështjet e tjera që mund të ndikojnë në profilin e rrezikut;

Shqetësimet e menaxhmentit rreth mbikëqyrjes së bankës ose të BQK-së duke përfshirë çdo fushë, që banka do të donte që BQK-ja të marrë parasysh në fushëveprimin e ekzaminimit me arsye për përfshirje.

- III. Përgatitja e letër informimit dhe letër kërkesës siç definohet në Aneksin VI (shembulli i letër informimit dhe letër kërkesës).
 - A. Për të eliminuar dyfishimin dhe për të minimizuar barrën rregullative në një institucion, letër kërkesa nuk kërkon informacione që janë dhënë në mënyrë të rregullt për, apo janë në dispozicion brenda BQK-së, siç janë raportet rregullative dhe informatat financiare tjera të ndryshme.
 - B. Gjërat që nuk janë të nevojshme për të mbështetur procedurat e përzgjedhura të ekzaminimit nuk duhet të kërkohen;
 - C. Bëni dallimin e informacionit që do të dërgohet me postë tek ekzamineri përgjegjës për shqyrtimin paraprak, që do të kryhet jashtëvendngjarjes nga informacioni që do të mbahet në bankë për rishikim gjatë ekzaminimit në vend. Informacioni që nuk gjenerohet lehtësisht duhet të shqyrtohet gjatë ekzaminimit në vend (p.sh. politikat, procesverbali i takimeve të bordit të drejtorëve. Informacioni mund të dërgohet në mënyrë elektronike apo në letër.
 - D. Letra informuese dhe letër kërkesa për menaxhmentin e bankës dërgohet së paku 10 ditë pune para fillimit të ekzaminimit në vend.

3.3.4. Shtojca V – 1: Formati i memorandumit të fushëveprimit - (scope memo) për ekzaminimet në vend

- 1) PËRMBLEDHJE E GJENDJES SË BANKËS
- 2) FUSHËVEPRIMI DHE OBJEKTIVAT
 - Specifikimi i llojit të ekzaminimit (i plotë / i fokusuar) dhe arsytet mbështetëse për llojin e ekzaminimit;
 - Objektivat e ekzaminimit.
- 3) PËRMBLEDHJE E PROFILIT TË RREZIKUT
 - Gjendja financiare (me të dhënat e fundit);
 - Vlerësimi i rrezikut;
 - Çështjet shqetësuese.
- 4) PËRMBLEDHJE PËR TAKIMIN PARA FILLIMIT TË EKZAMINIMIT
- 5) PËRMBLEDHJE E AUDITIMIT DHE SISTEMIT TË BRENDSHËM TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT
 - Përcaktoni përshtatshmërinë e funksionit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe sistemit të brendshëm të menaxhimit të rrezikut për të caktuar nivelin e besueshmërisë.
- 6) FOKUSI DHE PROCEDURAT E EKZAMINIMIT
 - Fushat e përqendrimit (koncentrimit) gjatë ekzaminimit.
- 7) PLANIFIKIMI I RESURSEVE (STAFIT)

3.3.5. Shtojca V – 2: Mostra (shembull) i memorandumit të fushëveprimit (scope memo) për ekzaminimet në vend

MEMORANDUMI I FUSHËVEPRIMIT (scope memo)				
Emri i bankës	xxxxx	Vlerësimi sipas CAMELS: X (x-x-x-x-x-x)	Vlerësimi sipas CAELS: X (x-x-x-x-x)	Data e përgatitjes: Dita-muaji-viti
Lloji i ekzaminimit:	Ekzaminimi i plotë / i fokusuar			
Data e fundit e ekzaminimit:	dita-muaji-viti			
Data e fillimit të ekzaminimit:	dita-muaji-viti			
Të dhënat financiare deri me:	dita-muaji-viti			
Planifikimi i ditëve të punës:	xxx			

1) Përmbledhje e gjendjes së bankës:

Specifikimi i gjendjes së përgjithshme financiare të bankës duke përfshirë treguesit kryesorë financiarë që e karakterizojnë atë bankë. Po ashtu, krahasimi me sektorin bankar në parametrat kryesor të saj, si dhe ndaj bankës mëmë është i domosdoshëm.

2) Fushëveprimi dhe objektivat:

- Përcaktimi i gjendjes financiare dhe vlerësimi i performancës financiare të bankës sipas rreziqeve;
- Vlerësimi i pajtueshmërisë së bankës me legjislacionin në fuqi me theks të veçantë në kërkesat për raportim dhe treguesit ligjor dhe rregullativ;
- Rishikimi i fushave të rritjes, siç janë degët e reja dhe linjat e reja të biznesit, si dhe proceset për menaxhimin e rreziqeve të involvuara.

3) Përmbledhje e profilit të rrezikut:

- Kushtet financiare

Më datë xx xxxxx xxxx, banka xxx kishte vlerësimin e përgjithshëm x, për shkak të dështimit të bankës për të përmbushur kërkesat rregullative të mjaftueshmërisë së kapitalit. Raporti i kapitalit bazë (gjithsej kapital) ndaj gjithsej mjeteve të peshuara me rrezik ishte x%, që është nën kërkesën rregullative prej xx%. Kualiteti i mjeteve është i kënaqshëm edhe përkundër faktit që niveli i kredive joperformuese është në rritje. Likuiditeti dhe fitimet janë vlerësuar të jenë të kënaqshme.

- Vlerësimi i Rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të bankës xxx ishte mesatar duke marrë parasysh rrezikun e lartë kreditor dhe operacional. Rreziku kreditor është i lartë për shkak të menaxhimit të dobët nga ana e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë në proces të lejimit dhe administrimit të kredive, ndërsa rreziku operacional është i lartë për shkak të mungesës së politikave dhe procedurave për operacionet të jashtme si dhe për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Kontrollet e brendshme joadekuate, po ashtu kanë ndikuar në rrezik të lartë operacional. Rreziku i likuiditetit është mesatar, por në rritje për shkak të varësisë së bankës në depozitat e paqëndrueshme. Rreziku i normës së interesit është i ulët ndërsa rreziku i kursit të këmbimit valutor është i mesatar, por në rritje.

- Çështjet shqetësuese

Shqetësimet mund të përfshijnë lëvizjen e lartë të stafit, rritjen e kreditimit në sektorin e bujqësisë, degët e reja, planet për të themeluar një njësi të lizingut apo përvetësimi i një banke,.

Profili i rrezikut të bankës xxxxx me datë dita-muaji-viti

Kategoria e rrezikut	Sasia e rrezikut të vetvetishëm	Kualiteti i menaxhimit të rrezikut	Niveli i përgjithshëm i rrezikut	Drejtimi i rrezikut
Rrez. i përgjithshëm	xxx	xxx	xxx	xxx
Rreziku kreditor	xxx	xxx	xxx	xxx
Rreziku i likuiditetit	xxx	xxx	xxx	xxx
Rreziku i tregut	xxx	xxx	xxx	xxx
Rreziku operacional	xxx	xxx	xxx	xxx

4) Përmbledhje për takimin para fillimit të ekzaminimit:

Menaxhmenti është informuar me planin e tij për të ekzaminuar bankën xxx, një nga bankat më të mëdha në Kosovë me degë në të gjithë vendin. Është vlerësuar që banka (nuk) është e vetëdijshme për rreziqet që e përcjellin. Gjithashtu, është diskutuar për dobësitë e konstatuara në fushën e kreditimit ku banka ka informuar BQK-në që ata janë duke punuar në to. Lidhur me rritjen e kreditimit në sektor të

bujqësisë, banka duhet të kuptojë rreziqet e involvuara, megjithatë, nuk ka sistem adekuat për të menaxhuar këto rreziqe dhe ekspertiza e huadhënësve në këtë sektor është e panjohur. Banka është gjithashtu në dijeni të lëvizjes së madhe të stafit dhe aktualisht është në procesin e zhvillimit të politikave për menaxhimin e burimeve njerëzore, e cila do të përfshijë një skemë të mbajtjes së stafit.

5) Përmbledhje e auditimit dhe sistemit të brendshëm të menaxhimit të rrezikut:

Auditimi është kryer në mënyrë adekuate, megjithatë, menaxhimi nuk i përgjigjet çështjeve të ngritura në raportet e auditimit. Sistemet e menaxhimit të rrezikut janë konsideruar të jenë joadekuate për shkak të mbikëqyrjes së dobët të bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë të rrezikut kreditor dhe operacional. Sistemi i kontrollit të brendshëm është joadekuat për shkak mungesës së politikave të rëndësishme, siç janë politikat e këmbimit valutor dhe mungesa e ndarjes së detyrave në sektorin e menaxhimit të parasë. Për shkak të këtyre dobësive, mbështetja në sistemet e brendshme për menaxhimin e rrezikut do të jenë minimale.

6) Fokusi dhe procedurat e ekzaminimit:

Më poshtë është bërë një përmbledhje lidhur me fokusin dhe procedurat e ekzaminimit:

Rreziku kreditor. Pasi që rreziku kreditor është vlerësuar të jetë i lartë dhe është në trend të rritjes, do të aplikohen procedurat standarde të vlerësimit (siç diskutohen më vonë në seksionet individuale të rrezikut në këtë manual) dhe procedurat e zgjeruara (nëse është e nevojshme). Mbikëqyrësit kryesisht do të fokusohen në:

- Rritjen e fundit të mjeteve joperformuese;
- Rritjen e kreditimit në sektorin bujqësor dhe kualifikimet e kreditorit në lidhje me këtë sektor;
- Limite për një huamarrës koncentrimet e mundshme;
- Dokumentacionin e kredisë;
- Rishikimin e kredisë;
- Procedurat për kredidhënie.

Rreziku operacional. Rreziku operacional është vlerësuar i lartë me një trend në rritje. Për shkak të kësaj, procedurat standarde (nëse ka nevojë) do të përdoren në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së funksionit të menaxhimit të rrezikut. Fushat kryesore të fokusit do të jenë:

- Zgjerimi i rrjetit të degëve;
- Sistemi i dobët i kontrollit të brendshëm veçanërisht në sektorin e menaxhimit të parasë;
- Mungesa e politikave për këmbimin valutor dhe burimeve njerëzore dhe politikat joadekuate të teknologjisë informative.

Rreziku i likuiditetit. Pasi që rreziku i likuiditetit është vlerësuar i ulët me një trend në rritje, procedurat standarde mund të aplikohen me vëmendje të kushtuar në përqendrimin e institucionit në depozitat e paqëndrueshme.

Rreziku nga aktiviteti i këmbimit valutor. Rreziku nga aktiviteti i këmbimit valutor konsiderohet që është mesatar dhe është në rritje. Duhet të aplikohen procedurat standarde të vlerësimit. Një ekzaminer që është duke shqyrtuar këtë fushë duhet të ketë parasysh se institucionit i mungon një politikë e operacioneve të këmbimit valutor për të drejtuar operacionet e këmbimit valutor, prandaj mund të ketë nevojë për të aplikuar procedurat e zgjeruara për të vlerësuar tërësisht kualitetin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut, nëse ekzistojnë.

Rreziku i normës së interesit. Pasi që rreziku i normës së interesit është vlerësuar i ulët dhe është stabil, do të përdoren procedurat minimale për të konfirmuar nivelin e rrezikut dhe kualitetin e menaxhimit të rrezikut. Procedurat standarde mund të aplikohen nëse një mbikëqyrës vlerëson se ekziston një shqetësim që justifikon zgjerimin e vlerësimit.

Mjaftueshmëria e kapitalit. Pasi që kapitali i institucionit është nën kërkesat rregullative për kapitalin, procedurat standarde mund të aplikohen për të vlerësuar nivelin e kapitalit dhe të gjenden arsyet e dështimit të institucionit në plotësimin e kërkesave rregullative.

Fitimet. Performanca e fitimeve është marginale. Të ardhurat nga kreditimi vazhduan të jenë burimi kryesor i të ardhurave. Procedurat standarde mund të aplikohen me fokus në vlerësimin e efektit të rritjes së kredive joperformuese dhe hapjen e degëve të reja të cilat mund të rritin shpenzimet operative.

Planifikimi strategjik. Planifikimi strategjik i bankës xxx duhet të jetë në korrelacion me veprimet e tij. d.m.th. rritja e planifikuar e kredive gjatë vitit xxxx, duhet të jetë konsistente me oreksin për rrezik të bordit të drejtorëve dhe eksperiencën si dhe

ekspertizën e menaxhmentit. Ekzaminimi do të fokusohet në:

- Vlerësimin e proceseve të buxhetimit dhe supozimet e përdorura për të krijuar buxhetin dhe planin strategjik;
- Vlerësimin e planit për rritje në raport me rritjen aktuale dhe numrin e stafit të nevojshëm që të mbajë dhe menaxhojë rritjen.

Përbërësit e CAMELS dhe vlerësimi i rrezikut. Ekzaminimi paraprak, i zhvilluar me xx xxxxx xxxx, ka rezultuar me vlerësimin në CAMELS xxxxxx/x. Profili i përgjithshëm i rrezikut të bankës është vlerësuar i kënaqshëm dhe është përmirësuar në krahasim me ekzaminimin e kaluar. Nivelet e kapitalit të bankës janë të mira, vazhdojnë të jenë në kufi me minimumin e kapitalit të peshuar me rrezik. Kualiteti i mjeteve dhe praktikatat e administrimit të kredive janë vlerësuar të mira. Kreditë e klasifikuara dhe joperformuese kanë evidentuar përkeqësim dhe kanë shënuar trend rritës në krahasim me ekzaminimin e kaluar. Fitimet e bankës duhet të përmirësohen, edhe përkundër trendit pozitiv të fitimeve, për shkak të humbjeve të akumuluar nga vitet paraprake. Nivelet e likuiditetit të bankës dhe praktikatat e menaxhimit të likuiditetit janë të mira. Praktika e menaxhimit të rrezikut të tregut duhet të përmirësohet. Rreziku i përgjithshëm operacional është i lartë. Banka është urdhëruar të sigurojë politikë adekuate për menaxhimin e rrezikut operacional, të themelojë komitetin për menaxhimin e rrezikut operacional dhe të përcaktohen treguesit kryesorë të rrezikut.

Procedurat e ekzaminimit. Varësisht nga niveli i rrezikut, specifikohen procedurat e ekzaminimit, minimale apo standarde.

7) Planifikimi i resurseve (stafit):

Duke pasur parasysh fushat e ekzaminimit, vlerësohet se nevojiten gjashtë ekzaminerë. Ekzaminimi pritët të zgjatë dhjetë ditë. Burimet e tjera të nevojshme përfshijnë pajisjet për zyre, lloptopë dhe transport.

Në vazhdim është paraqitur një shembull mbi planifikimin e resurseve.

AKTIVITETET	Personat Përgjegjës			Ditet në dispozicion			Totali
	EP	UD	DD				
PERIUDHA PARA EKZAMINIMIT	EP	UD	DD	17	3	2	22
EKZAMINIMI I MENAXHMENTIT	EP			29			29
Vlerësimi i Menaxhmentit dhe planit strategjik: Procedurat minimale me kohën shtesë për rishikim të plote SMR dhe procedurat tjera në lidhje me rrezikun.	EP			10			10
Kapitali: Procedurat Minimale	1 S	0 ER	2 E	2	0	6	14
Te hyrat: Procedurat Minimale	1 S	0 ER	3 E	2	0	5	17
Rreziku Kreditor: Procedura standarde për të dhënë kohë për të rishikuar kredite të mëdha; kredit të reja (fokusimi në standardet e shkruara dhe proceset e monitorimit); kredit në vonesë dhe jo-performuese; kolektimin e kredive me probleme; dhe efektivitetin e menaxhimit të rrezikut kreditor.	1 S	4 ER	2 E	20	20	20	140
Rreziku i Likuditetit: Procedurat Standarde	1 S	0 ER	0 E	10	0	0	10
Rreziku i Tregut: Procedurat Minimale	1 S	2 ER	0 E	2	6	0	14
Rreziku Operacional: Procedurat standarde për të vlerësuar kontrollat, stafin, sistemin e TI, dhe efektivitetin e përgjithshëm të SMR	1 S	1 IT	1 E	10	5	10	25
IT: Procedurat standarde	0 S	0 ER	1 IT	0	0	15	15
Funksioni i Auditimit dhe Kontrollat e Brendshme: Procedura standarde	1 S	0 ER	1 E	15	0	15	30
Kontrollimi i letrave të punës dhe fajllimi i dokumenteve të ekzaminimit	1 EP	3 S	9 E	8	5	1	32
Raporti i Ekzaminimit dhe Takimi me Bordin e Drejtoreve: Draftoje raportin dhe diskuto gjetjet	1 EP	1 UD	1 DD	10	5	2	17
Rishikoje Draft Raportin:							
Te tjera: Përcjellja e zotimeve të menaxhmentit sa i përket qeshtjeve apo rekomandimeve në raportin e kaluar të ekzaminimit	ER			4			4
Total							379
Buxheti (nga Profili i Rrezikut)	379			Përmbledhje e diteve të punës			
Realizimi				EP; UD; DD	1		
Dallimi:	379			Senior (S)	3		
Arsyetim: Ditet e punës pritet të jenë më të larta se sa në ekzaminimet e kaluara për shkak të implementimit të RBS dhe kërkesat për trajnim të stafit				E;ER;IT	9		

Shkurtesa	Shpjegimi
DD	Drejtori i Departamentit të mbikëqyrjes bankare
UD	Udheheqësi i divizionit të mbikëqyrjes në vend
EP	Ekzamineri Përgjegjës
S	Ekzamineri i lartë bankar
E	Ekzamineri bankar
IT	Ekzamineri bankar për Teknologji Informative
ER	Ekzamineri i Ri bankar

3.3.6. Shtojca VI: Shembull i letër informimit dhe letër kërkesës është paraqitur në vazhdim:



Dita muaji viti

z./znj. XXXXX XXXXXXXX

Kryeshef/e ekzekutiv/e

Emri i bankës

Rruga "XXXXXXXX", nr. XX

XXXXXXXX, Kosovë

Tema: Fillimi i ekzaminimit të xxxx në bankën xxx

I/E nderuar z./znj. xxxxx;

Në përputhje me nenin 57 të Ligjit nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), do të kryejë ekzaminim e plotë, në bankën xxxxx duke filluar më datë xx xxxxxx xxxx, duke përdorur informatat financiare të datës xx xxxxxx xxxx, përveç nëse kërkohet ndryshe.

Informatat e kërkuara në shtojcën e bashkangjitur të letër kërkesës, duhet të jenë të gatshme në mënyrë elektronike ose në kopje në letër, sipas datave të specifikuar në Shtojcë. Në mënyrë që të na mundësoni të kompletojmë ekzaminimin në kohë, ju lutemi të na siguroni informatat e përgjithshme siç specifikohet në Pjesën I dhe të gjitha politikat dhe procedurat në ditën e parë të ekzaminimit. Përveç nëse është specifikuar një datë tjetër në letër kërkesë, informatat e kërkuara duhet të sigurohen (të jenë të gatshme) jo më vonë se data xx xxxxxx xxxx.

Ju lutem të keni parasysh se gjatë ekzaminimit, ekzaminerët mund të kërkojnë shpjegime, sqarime ose informata shtesë, para, gjatë dhe pas ekzaminimit. BQK-ja vlerëson bashkëpunimin tuaj. Nëse konsiderohen të nevojshme, informatat shtesë mund të kërkohen nga ana jonë për qëllim të kompletimit të ekzaminimit.

Ju lutem që të klasifikoni të gjitha dokumentet e kërkuara në atë mënyrë që ato të korrespondojnë me numrat e specifikuar në këtë letër kërkesë.

Ekzaminimi do të kryhet nga një ekip prej xx ekzaminerëve, udhëhequr nga z./znj. XXXXXX XXXXXX, ekzaminer përgjegjës për bankën xxxxx. Për tu sqaruar në lidhje me ndonjë informatë të kërkuar, mos hezitoni ta kontaktoni z./znj. XXXXXXXX përmes telefonit në numrin xxx/xxx-xxx ose përmes emailit: XXXXXX.XXXXXX@bqk-kos.org.

Planifikojmë që takimin hyrës me menaxhmentin e lartë të bankës xxxx ta mbajmë më datë xx xxxxxx xxxx, në ora 10:00 për të diskutuar profilin e rrezikut të bankës dhe fushë veprimin e ekzaminimit tonë. Pjesëmarrësit nga BQK-ja do të jenë Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare (z. XXXXXX XXXXX), Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend (z. XXXXX XXXXXXXXXXX) dhe Ekzamineri Përgjegjës (z./znj. XXXXXX XXXXXXXX). Gjithashtu, gjatë ekzaminimit planifikojmë takime shtesë me menaxhmentin e lartë gjatë ekzaminimit që t'ju mbajmë të informuar për procesin e ekzaminimit. Po ashtu, do të caktojmë një takim përmbyllës për t'ju informuar mbi konkluzionet dhe gjetjet tona gjatë ekzaminimit.

Ekzaminimi do të fokusohet në fushat e rrezikut kreditor, rrezikut operacional (duke përfshirë teknologjinë informative), auditimit të brendshëm, kontrolleve të brendshme, rrezikut të likuiditetit, ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut, si dhe vlerësimin e kapitalit dhe të fitimeve.

Në përfundim të ekzaminimit, ne do të vlerësojmë komentet tuaja lidhur me procesin pas përfundimit të ekzaminimit.

Me respekt,

XXXXXX XXXXX
Drejtore
Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare

LETËR KËRKESA E INFORMATAVE PËR EKZAMINIM

I. Informatat e përgjithshme – ju lusim që t’i keni të gatshme në ditën e arritjes të ekzaminerëve të BQK-së, informatat siç vijon:

1. Raportet vjetore të bankës xxxx dhe bankës mëmë.
2. Plani strategjik i bankës.
3. Struktura organizative e bankës.
4. Listën e anëtarëve të bordit të drejtorëve, menaxhereve të lartë, komitetet e bordit dhe menaxhmentit, me listën anëtarëve të komiteteve (ju lutem shënoni anëtarët e komiteteve dhe kryesuesit e komiteteve, duke përfshirë: emrin, pozitën, vitet në bankë ose në bord, apo edhe në ndonjë aktivitet tjetër jashtë bankës).
5. Procesverbalet e bordit të drejtorëve dhe të të gjitha takimeve të komiteteve që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
6. Procesverbalet e mbledhjeve vjetore të aksionarëve apo dhe ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme të aksionarëve që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).

II. Rreziku kreditor (portofoli kreditor) - ju lusim që t’i keni të gatshme pikat nga 7 deri në 10, në datën e arritjes së ekzaminerëve të BQK-së informatat siç vijon:

7. Kopjet e të gjitha politikave dhe procedurave të rifreskuara të kredive, duke përfshirë politikat e brendshme për rishikimin e kredive dhe politikat për vlerësimin e kolateralit.
8. Kopje të limiteve të zyrtarëve të bankës dhe komiteteve të kreditimit.
9. Raportet e menaxhmentit dhe/ose bordit të drejtorëve për të gjeturat sa i përket shkeljeve të ligjit, limiteve të kreditimit dhe kredive të palëve të ndërlidhura, me detajet sesi ato janë përmirësuar apo do të përmirësohen në të ardhmen.
10. Procesverbalet e të gjitha mbledhjeve të komiteteve për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut kreditor ose dhënies së kredive, apo edhe ndonjë prezantim ose diskutim që ka të bëjë me tolerancën ndaj rrezikut apo pranimin e rrezikut të bankës.
11. Me datë xx xxxxxx xxxx, dërgo listën e portofolit të kredive me datë xx xxxxxx xxxx. Lista duhet të jetë e ndarë në kolona me këto informata: emrin e huamarrësit, shumën e kredisë së lejuar në momentin e disbursimit, datën e disbursimit, datën e maturimit, normën e interesit,

- llojin e kredisë, shuma në shfrytëzim, statusi i klasifikimit të kredisë, kreditë e riprogramuara, kreditë e personelit të bankës, shumën e provizionit, përqindjen e provizionit, numrin e ditëve në vonesë, sektorin e industrisë dhe informatat në lidhje me kolateralin dhe/apo garantuesit.
12. Ndryshimet e personelit në kredi dhënie, produktet kreditore, sistemin e brendshëm të kategorizimit dhe menaxhimin e portofolit të kredive.
 13. Kopje të raporteve të rishikimit të brendshëm të kredive dhe datat e rishikimeve të kredive të kryera që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
 14. Lista e kredive të riprogramuara.
 15. Kopjet e raporteve të koncentrimin të kredive që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx). Raporti duhet të përmbaj koncentrimin sipas huamarrësve, sektorit të industrisë, rajoneve gjeografike, tipit të kredive dhe sipas ndonjë fushe tjetër të identifikuar nga banka për nevoja të monitorimit.
 16. Kopjet e raporteve të brendshme të menaxhimit të portofolit (duke përfshirë raportet e analizave të portofolit që detajon nivelin dhe trendin në kreditë në vonesa dhe humbje, si dhe trendin në kreditë e ristrukturuara dhe ripërtërira, përjashtimet nga politikat, përjashtimet nga dokumentimi i administrimit të kredive, pasqyrat financiare të rifreskuara të huamarrësit, përjashtimet e kolateralit dhe listën e mungesës apo skadimit të sigurimit të kolateralit, etj.).
 17. Raportet e shpërndarjes të portofolit kreditor bazuar në sektor (tregti, bujqësi, hoteleri, etj.) dhe bazuar në kategori (korporata, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, etj.). Raporti duhet të përfshijë shumat totale dhe provizionet për secilën kategori.
 18. Raportet për kreditë që tejkalojnë 10% të Kapitalit të Klasit të 1, siç është definuar në rregulloren e BQK për Ekspozimet e Mëdha.
 19. Listën e kredive jopërllogaritëse (emrin, shumën, ditët në vonesë, datën e maturimit, datën kur ka kaluar në kredi jopërllogaritëse) dhe shumat e provizioneve lidhur me to.
 20. Listën e produkteve kreditore të riprogramuara duke përfshirë edhe ditë vonese para riprogramimit të kredisë.
 21. Listën e kredive të shlyera apo të kthyera që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxxxx xxxx).
 22. Listën e kredive të personave te brendshëm, përfshirë palët e ndërlidhura dhe interesin e tyre. (emrin, zyrtar/drejtor/aksionar, shumën aktuale të ekspozimit, shumën e lejuar dhe datën e maturitetit).

23. Listën e zërave jashtë bilancor (garancionet, letër kreditë, emrin, shumën, datën e lejimit, statusin e klasifikimit, datën e maturimit dhe kolateralin)
24. Listën e kredive të shlyera dhe kolateralin e lidhur me të, të cilat janë ende në librat e bankës si aset (emrin e huamarrësit, vlerën në libra, datën e përjashtimit dhe datën e vlerësimit të kolateralit).
25. Barazimi i llogarisë së provizioneve për humbje nga kreditë.
26. Ndonjë informatë tjetër lidhur me karakteristikat e rrezikut të portofolit kreditor, siç janë indikatorët ekonomik, trendët e industrisë dhe produktet e reja të planifikuara apo tanimë të lëshuara në treg.
27. Kopjet e ndonjë raporti tjetër të menaxhimit të kredive, i paidentifikuar më parë, të cilat mund të ndihmojnë rishikimin tonë të menaxhimit të rrezikut kreditor dhe kualitetit të mjeteve.

Portofoli i investimeve dhe letrave me vlerë

28. Politikat dhe procedurat për investimet dhe letrat me vlerë dhe datat e aprovimit të tyre nga ana e bordit të drejtorëve. Përfshirë limitet e aprovuara të investimeve (llojin, kategorizimin, maturitetin). Gjithashtu siguroni raportin e përjashtimeve të bankës.
29. Listën e plasmanëve me bankat e tjera, kreditë e arkëtushme ndërbankare, kambialet tregtar, investimet në letrat me vlerë, dhe llogaritë e mjeteve të tjera me bilance materiale (p.sh. > 5% e mjeteve të përgjithshme).
30. Listën e të gjitha mjeteve të investuara jashtë.
31. Lista e llogarive të investimeve, duke përfshirë: shumën, valutën, norma e interesit, datën e fillimit dhe të maturitetit, dhe klasifikimin financiar të institucionit (vlerësimin). Gjithashtu të sigurojë një kopje të konfirmimit nga bankat korrespondente me 3 barazimet e fundit të llogarive.
32. Siguroni kopjen e raportit më të fundit të analizës së portofolit të investimeve, duke përfshirë rekomandimet e menaxhmentit sa i përket blerjeve dhe shitjeve potenciale.

III. Rreziku i Likuiditetit

33. Më datë xx xxxxxx xxxx, dërgoni kopjet e të gjitha politikave dhe procedurave të likuiditetit dhe menaxhimit të mjeteve - detyrimeve, me datat kur janë rifreskuar së fundmi dhe aprovuar nga bordi i drejtorëve, që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
34. Siguroni kopje të politikës dhe planit për fondet e likuiditetit për nevoja në kushte të jashtëzakonshme të bankës.
35. Siguroni kopje të stres-testit të likuiditetit të kryer nga banka.

36. Siguroni procesverbalet e mbledhjeve të komitetit për menaxhimin e mjeteve dhe detyrimeve (ALCO) ose të ndonjë komiteti tjetër lidhur me menaxhimin e likuiditetit, që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
37. Siguroni kopje të raportit të likuiditetit të bankës duke përfshirë raportet më të fundit te hendeqeve (gap) të maturitet dhe të strukturës së depozitave sipas llojit dhe maturitetit.
38. Siguroni detajet sa i përket ndryshimeve në: menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, planifikimin e likuiditetit apo burimet e financimit dhe nevojave, strategjisë së investimeve dhe politikën e likuiditetit të bankës ose planin e fondeve për nevoja në kushte të jashtëzakonshme të bankës, që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
39. Siguroni raportet e menaxhmentit të përdorura për të matur dhe monitoruar nevojat aktuale dhe të pritura për likuiditet.
40. Politikat dhe procedurat në lidhje me ndonjë aktivitet të derivativave financiare dhe raportet e menaxhmentit në lidhje me këto aktivitete.
41. Listën e 20 depozitarëve më të mëdhenj të bankës (emrin, llojin e llogarisë, bilancin, maturitetin dhe normën e interesit).
42. Strukturën e tanishme të normave të interesit në depozita dhe në kredi.
43. Kopjet e politikave dhe procedurave mbi menaxhimin e rrezikut të tregut.
44. Të gjitha raportet e menaxhmentit në lidhje me menaxhimin e rrezikut të tregut.

IV. Rreziku Operacional

45. Politikat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut operacional.
46. Procesverbalet e mbledhjeve të komitetit të rrezikut operacional, që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
47. Siguroni një listë të personelit përgjegjës për rrezikun operacional, CV-të e tyre dhe përgjegjësitë e tyre.
48. Të gjitha raportet e menaxhmentit në lidhje me menaxhimin e rrezikut operacional (raportet e përjashtimeve, çështjet e teknologjisë informative, mungesën e parasë së gatshme ose pajisjeve, etj).
49. Përmbledhje të policave të sigurimit të bankës duke përfshirë: llojin e policës së sigurimit (pronën, ndërprerjet e aktivitetit të bankës, mbrojtjen e drejtorëve, pajisjet, veturat, tejkalimin e përgjegjësisë, mashtrimet, policat shitesë).
50. Kopjet e raporteve të zyrtareve të sigurimit që paraqesin ndonjë ankesë të paraqitur që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx). Shëno nëse këto raporte i janë raportuar bordit të drejtorëve.

51. Listën e punëtorëve të cilët kanë lënë bankën (dorëhequr ose larguar), që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx) duke përfshirë: emrin dhe mbiemrin, pozitën, degën ose zyrën, datën e fillimit të punës, datën e largimit ose dorëheqjes dhe arsyen e lëshimit të punës.
52. Siguroni kopje e ndonjë procesi formal (ose joformal) të menaxhimit të rrezikut operacional dhe strategjinë (programin) e implementimit.
53. Nëse janë përdorur modele, siguroni informata në lidhje me atë se si menaxheri i rrezikut operacional i vlerëson modelet, shpeshhtësinë e vlerësimit të modeleve dhe pavarësinë e vlefshmërisë së modelit.
54. Listën e të gjitha produkteve të bankës dhe politikat për aprovimin e produkteve të reja.
55. Nëse banka transferon apo delegon ndonjë nga aktivitetet e saj apo teknologjisë informative të palët e jashtme, siguroni kopje të programit të bankës për menaxhimin e procesit të delegimit apo transferimit, gjithashtu politikat, procedurat, kontratat dhe raportin e menaxhmentit para se menaxhmenti të nënshkruajë me ofruesin e shërbimeve.
56. Siguroni informata sa i përket ndryshimeve organizative (duke përfshirë shkrirjet dhe përvetësimet/bashkimet), ndryshimet në profil dhe strategji, ndryshimet në produkte dhe shërbimet e ofruara, sistemet e teknologjisë informative, etj.
57. Siguroni raportet ose informatat tjera sa i përket: pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e brendshme, kërkesat ligjore dhe të rregullatorit, rezultatet e testeve të sigurisë së teknologjisë informative të institucionit dhe reagimit të menaxhmentit, rezultatet e testeve të planit të emergjencës dhe reagimit të menaxhmentit, si dhe raportet e fundit të sistemit të informimit të menaxhmentit për mastrimet, ndërprerjet e biznesit, dështimet e sistemit dhe humbjet gjatë procedimit.
58. Siguroni kopje të profilit të rrezikut operacional të bankës që janë paraqitur bordit të drejtorëve.
59. Siguroni informata të proceseve të bankave për mbledhjen e të dhënave të humbjeve operationale.

Teknologjia Informative

60. Më datë xx xxxxxx xxxx, dërgoni politikat dhe procedurat për teknologjinë informative dhe sigurinë e informacionit.
61. Më datë xx xxxxxx xxxx, dërgoni politikat dhe planet për vazhdimësinë e biznesit dhe rezultatet e testeve të realizuara gjatë dy viteve të fundit.
62. Listën e incidenteve që nga ekzaminimi i kaluar (xx xxxxxx xxxx) duke përfshirë numrin dhe volumin e humbjeve operationale, dështimet e

sistemeve, numrin e ndërhyrjeve (hakimeve) në sistemet e automatizuar të bankës, veprimet mashtruese të personelit dhe ndërrimet e stafit (në veçanti ndërrimet e personelit kyç).

63. Raport ose një listë me mangësitë e identifikuara nga auditorët lidhur me funksionimin e sistemeve që rritin ndjeshëm rrezikun e bankës.
64. Struktura organizative dhe përshkrimi i vendeve të punës për personelin e teknologjisë informative.
65. Raportet e departamentit të teknologjisë informative për menaxhmentin e bankës.
66. Lista dhe përshkrimi i aplikacioneve të teknologjisë informative në përdorim nga banka. Lokacioni i bazës së të dhënave kryesore të aplikacioneve dhe vendndodhjen e ekipit mbështetës / help - deskut. Specifikoni cilat janë të zhvilluara nga banka dhe cilat janë të blera dhe nga cila kompani.
67. Procedurat për kontrollimin e vendosjes / ndryshimit të të drejtave të qasjes së shfrytëzuesve në aplikacione, bazën e të dhënave dhe rrjet, për të gjitha aplikacionet e shfrytëzuara në bankë.
68. Raportet e menaxhmentit për departamentin e teknologjisë informative.
69. Strategjia e bankës për fushën e teknologjisë informative.
70. Raportet e auditimit të brendshëm të teknologjisë informative.
71. Listën e punëtorëve aktiv dhe qasjet e tyre në sistemet e bankës.
72. Listën e personave / firmave kontaktuese të jashtme për teknologjinë informative dhe sistemet e bankës që ata mbështesin.

V. Menaxhimi i rrezikut

73. Kopje te buxhetit të bankës për dy vitet e fundit.
74. Listën e të gjitha politikave të aprovuara nga bordi i drejtorëve, datën e aprovimit dhe datën e fundit të rishikimit apo korrigjimit.
75. Detajet sa i përket metodave të komunikimit të përdorura për të informuar personelin për ndryshimet në politika dhe/ose procedura të bankës.
76. Përmbledhje e të gjitha proceseve gjyqësore ndaj bankës që nga ekzaminimi i fundit i bankës (xx xxxxxx xxxx).

VI. Kapitali

77. Listën e aksionareve që kanë pronësi 5% ose më shumë të kapitalit të përgjithshëm të bankës, përfshirë: emrin e aksionarit, numrin e aksioneve

që posedojnë, përqindjen e përgjithshme të kapitalit, dhe llojin e aksioneve që posedojnë, (p.sh. të zakonshme, preferenciale, etj).

78. Raportet e përdorura nga menaxhmenti për të monitoruar dhe projektuar kërkesat për kapital që sigurojnë saktësinë e peshimit të rrezikut të përdorur për mbikëqyrjen e kalkulimeve të kapitalit.
79. Siguroni informacionin me shkrim për procesin e brendshëm të vlerësimit të mjaftueshmerisë së kapitalit.
80. Siguroni raportet ose procesverbalin e bordit të drejtorëve që tregon qasjen e bordit dhe menaxhmentit në lidhje me kapitalin ndaj rrezikut.

VII. Fitimet

81. Siguroni kopjen më të fundit të raportit të menaxhmentit për krahasimin e buxhetit me gjendjen aktuale, ndryshimet e përfshira dhe shpjegimet e ndryshimeve.
82. Raportet e menaxhmentit për trendin e të hyrave me shpjegimet e menaxhmentit.
85. Politikat dhe procedurat për ndërprerjen e përlllogaritjes së interesit për kreditë jo performuese.
86. Bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave të detajuara sipas datës xx xxxxxx xxxx.
87. Siguroni raportin më të fundit të menaxhmentit për të hyrat, duke përfshirë grafiket, tabelat dhe treguesit.

VIII. Auditimi dhe kontrollet e brendshme

88. Më datë xx xxxxxx xxxx, dërgoni etikën e bankës, politikat e auditimit të brendshëm dhe kontrolleve të brendshme dhe statutin e auditimit të brendshëm që tregon qëllimin, objektivat, organizimin, autoritetin dhe përgjegjësinë e Departamentit të Auditimit të Brendshëm.
89. Më datë xx xxxxxx xxxx, dërgoni planin e auditimit të brendshëm që adreson qëllimin, orarin, buxhetin e stafit, raportimin, buxhetin financiar dhe orarin për auditim gjatë dy viteve të fundit.
90. Siguroni listën e detajuar me detyrat dhe përgjegjësitë e auditorëve të brendshëm.
91. Siguroni manualin e procedurave të departamentit të auditimit për programin e punës së auditimit; nëse është e aplikueshme, auditimin e bazuar në rrezik / vlerësimin e rrezikut.

92. Siguroni të gjitha raportet e auditimit të përgatitura që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
93. Siguroni, të listuara, të gjitha gjetjet e auditimit, në pritje për zgjidhje, të pazgjidhura; duke përfshirë kohën dhe planin për zbatimin e masave korrigjuese.
94. Siguroni procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit të Auditimit që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
95. Siguroni listën e personelit të Departamentit të Auditimit, duke përfshirë udhëheqësin e auditimit, duke përfshirë CV-të e tyre. Detajet e kohëzgjatjes në marrëdhënie pune të personelit të auditimit, lëvizjet e stafit, si dhe siguroni përshkrimin e detyrave të punës apo pozitës.
96. Siguroni informacionet sa i përket programit të bankës për zhvillim profesional dhe trajnim të personelit të auditimit, duke përfshirë orientimin në mundësitë e trajnimit brenda dhe jashtë institucionit. Siguroni listën e të gjithë stafit të auditimit me trajnimet e ndjekura ose mbajtura që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
97. Siguroni letrën e angazhimit të auditimit të jashtëm, raportit dhe letrën e menaxhmentit për vitin e fundit dhe parafundit. Siguroni letrën e angazhimit për vitin aktual.
98. Siguroni ndonjë kontratë për aktivitetet e jashtme (outsource) si dhe raportet e jashtme apo (due diligence) e palëve të jashtme (kontraktorëve outsource).
99. Informatat në humbjet operacionale të shkaktuara që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).
100. Siguroni kopje të përgjigjeve të menaxhmentit mbi mangësitë e vërejtura në raportet e auditimit të brendshëm
101. Nëse banka ka program për sigurimin e cilësisë, ju lutem siguroni ndonjë standard dhe kriter që është vendosur për vlerësimin e performancës të funksioneve të auditimit të brendshëm. Siguroni ndonjë shqyrtim të sigurisë së kualitetit të performuar që nga ekzaminimi i fundit (xx xxxxxx xxxx).

IX. Financat dhe kontabiliteti

102. Siguroni politikat e kontabilitetit.
103. Siguroni një kopje të librit kryesor dhe analitikën e të gjitha formave raportuese në BQK, të raportuara më datë xx xxxxxx xxxx.

104. Siguroni listën e të gjitha degëve dhe nen-degëve, duke përfshirë emrin, adresën, emrin e menaxherit të degës apo nëndegës, numrin e personelit në secilin lokacion.

X. Rreziku i normës së interesit dhe rreziku i tregut

105. Siguroni kopjet e raporteve më të fundit të rrezikut të normave të interesit, duke përfshirë raportet e ALCO.
106. Siguroni ndonjë analizë të performuar nga banka sa i përket trendit historik dhe informatave të klientëve për të ndihmuar menaxhmentin të formojë dhe vlerësojë supozimet e sjelljeve të klientëve sa i përket parapagimit të kredive dhe tërheqjeve të depozitave.
107. Siguroni informata për skenarët e normave të interesit të përdoruar nga banka për të matur potencialin e ekspozimit të rrezikut të normave të interesit dhe frekuencën e rishikimit.

XI. Informata të tjera

108. Siguroni dy kompjuter me qasje në sistemin e bankës, me kodet dhe fjalëkalimet për qasje “read only” në sistemet kryesore të bankës. Kompjuterët e bankës duhet të kenë edhe lidhje me printer.
109. Siguroni, listën e të gjithë personelit të bankës me e-mail adresat e tyre dhe numrat e telefonave.

3.4. Hapi 5 – Ekzaminimet në vend (on-site)

3.4.1. Objektivat

- Përcaktimi dhe vërtetimi i gjendjes financiare dhe profilit të rrezikut të institucionit;
- Identifikimi i fushave që kanë nevojë për veprime korigjuuese;
- Rekomandimi i veprimeve të duhura korigjuuese;
- Vlerësimi i aktiviteteve të vazhdueshme të institucionit.

3.4.2. Përshkrimi

Ekzaminimet në vend janë pjesë e procesit të vazhdueshëm të mbikëqyrjes. Ato përbëhen nga një grup i procedurave të integruara dhe të përshtatura të ekzaminimit. Këto procedura janë të dizajnuara për:

- Të asistuar ekipin e ekzaminimit në përcaktimin e gjendjes dhe rrezikut të profilit të një banke;
- Identifikimin e fushave që kanë nevojë për veprime korrigjuese;
- Monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të bankës.

Për shkak që profilet specifike të rrezikut të institucionit bankar janë të ndryshme, BQK-ja pranon se mbikëqyrja efektive dhe efikase nuk mund të realizohet duke përdorur një grup të ngurtë të procedurave të ekzaminimit.

Ekzaminerët, duke bazuar në profilin e rrezikut të një institucioni përdorin qoftë procedurat minimale të vlerësimit të fushëveprimit, procedurat standarde të vlerësimit të fushëveprimit, ose një kombinim të të dyjave për të përshtatur aktivitetet e ekzaminimit për të siguruar që rreziqet brenda një institucioni janë identifikuar në mënyrë të duhur, të matur, të monitoruar dhe kontrolluar ose zbutur nga menaxhmenti i bankës.

3.4.3. Procedurat minimale të vlerësimit të fushëveprimit

Ekzaminerët do të përdorin procedurat minimale për vlerësimin e fushëveprimit për ekzaminim në fusha me rrezik të ulët për të vlerësuar nëse ndonjë ndryshim i rëndësishëm ka ndodhur në aktivitete, në profilin e rrezikut, në menaxhment apo në gjendjen financiare të bankës. Nëse nuk gjenden ndryshime në profilin e rrezikut të bankës, nuk ka nevojë për punë të mëtejshme. Megjithatë, nëse vlerësimi gjen fusha shqetësuese të mbikëqyrjes, ekzamineri përgjegjës i ekzaminimit ka fleksibilitetin për të zgjeruar fushëveprimin e ekzaminimit duke kompletuar procedurat e tjera nga procedurat standarde të vlerësimit të fushëveprimit.

3.4.4. Procedurat standarde të vlerësimit të fushëveprimit

Ekzaminerët do të përdorin procedurat standarde të vlerësimit të fushëveprimit për rishikime të fushave të aktiviteteve të rëndësishme me rrezik të lartë të vetvetishëm. Procedurat e përzgjedhura nga procedurat standarde të vlerësimit të fushëveprimit që duhet përfunduar duhet të jenë në përputhje me kompleksitetin e bankës dhe me nivelin e shqetësimeve mbikëqyrëse. Përderisa procedurat standarde të vlerësimit

përmbajnë procedura të detajuara ose hapa sqarues, ekzaminerët nuk do të duhej të kryenin secilën procedurë.

Qasja e ekzaminimeve në vend duhet të theksojë rëndësinë e përcaktimit dhe vërtetimit të kushteve të bankës gjatë ciklit mbikëqyrës. Në përgjithësi, gjatë aktiviteteve në vend, mbikëqyrësit fokusohen në identifikimin e origjinës së mangësive dhe duke u siguruar që menaxhmenti është duke marrë hapat e duhur dhe në kohë për të adresuar dhe korrigjuar të gjitha mangësitë dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre.

3.4.5. Sistemi i vlerësimit CAMELS

Të dy grupet e procedurave të vlerësimit mbulojnë rishikimin e të gjitha komponentëve të vlerësimit CAMELS, të funksionit të auditimit dhe kontrollit të brendshëm, dhe të gjitha rreziqet e identifikuara përkatësisht: rreziku e kreditor, tregut, likuiditetit, operacional, si dhe rreziku i vendit / transferit.

Sistemi i vlerësimit siguron një kornizë të përgjithshme për vlerësimin e të gjithë faktorëve të rëndësishëm financiar, operativ, dhe të pajtueshmërisë në mënyrë që të caktojë një përmbledhje, apo vlerësim mbikëqyrës të përgjithshëm për çdo institucion bankar. Qëllimi i sistemit të vlerësimit është për të reflektuar në mënyrë të njëjtë dhe gjithëpërfshirëse për kushtet e bankës, pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret si dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme.

Përkundër faktit që deri në një shkallë çdo bankë ka një grup të çështjeve dhe shqetësimeve mbikëqyrëse, sistemi uniform i vlerësimit paracaktuar nga karakteristikat dhe funksionet të caktuara, duke përfshirë faktorët cilësorë dhe sasiorë, të përbashkët për të gjitha kategoritë e institucioneve.

Ekzaminerët do të caktojnë një vlerësim për secilin nga komponentët e CAMELS për bankat duke përdorur shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson nivelin më të lartë të performancës, praktikat e duhura të menaxhimit të rrezikut dhe shkallën më të ultë të shqetësimit të mbikëqyrjes, ndërsa shkalla 5 tregon performancën më të dobët, praktika të papërshtatshme të menaxhimit të rrezikut dhe, për këtë arsye shkallën më të lartë të shqetësimit të mbikëqyrjes.

Vlerësimet për gjashtë komponentët individuale të CAMELS janë përmbledhur në një vlerësim të caktuar të përbërë i cili është vlerësuar në mënyrë të ngjashme me shkallë nga 1 deri në 5. Gjatë caktimit të një vlerësimi të përbërë, të gjithë faktorët relevant duhet të peshohen dhe vlerësohen. Në përgjithësi, këta faktorë përfshijnë: (i) përshtatshmërinë e bazës së kapitalit, vlerën neto dhe rezervat për mbështetjen e operacioneve të tanishme si dhe planet e ardhshme të rritjes ekonomike; (ii) kualitetin e kredive, investimeve dhe mjetet tjera; (iii) aftësinë për të gjeneruar të ardhura për të

ruajtur besimin e publikut, për të mbuluar humbjet dhe ofruar siguri të mjaftueshme dhe kthim tek depozituesit; (iv) aftësinë për të menaxhuar likuiditetin dhe financimin; (v) aftësinë për të përmbushur nevojat legjitime të komunitetit për shërbime financiare dhe për të mbuluar të gjitha detyrimet e depozitave të maturuara; (vi) aftësinë e menaxhimit për të administruar siç duhet të gjitha aspektet e biznesit financiar dhe planin për nevojat e ardhshme dhe rrethanat e ndryshuara.

Vlerësimi i menaxhmentit dhe administratës përfshin cilësinë e kontrolleve të brendshme, procedurave operative dhe të gjitha politikat e kreditimit, investimit dhe operative; pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret relevante si dhe përfshirjen e drejtorëve, aksionarëve dhe zyrtarëve. Në përgjithësi, caktimi i një vlerësimi të përbërë mund të përfshijë ndonjë faktorë tjetër që mbartet në mënyrë të ndjeshme në praktikën e menaxhimit të rrezikut dhe kushtet e përgjithshme dhe qëndrueshmërinë e institucionit.

Sistemi i vlerësimi CAMELS shërben si një mjet i dobishëm për identifikimin e problemeve apo përkeqësimit të kushteve si dhe për kategorizimin e mangësive në fushat e veçanta të komponentës. Më tej, sistemi i vlerësimi ndihmon BQK-në në monitorimin e trendeve të sigurisë dhe qëndrueshmërisë dhe në vlerësimin e fuqisë totale dhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Gjatë caktimit të vlerësimeve CAMELS, ekzaminerët duhet të përpiqen që të sigurohen që të gjitha bankat janë vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të njëjtte dhe se vëmendja mbikëqyrëse është e përqendruar në mënyrë të përshtatshme në bankat që shfaqin dobësi financiare dhe operacionale apo trende negative. Vlerësimet e komponentëve duhet gjithashtu të marrin në konsideratë madhësinë, sofistikimin, natyrën dhe kompleksitetin e veprimtarive të bankës, si dhe profilin e saj të rrezikut.

3.4.6. Procedurat

Për arsye të peshës që kanë procedurat në këtë fazë, ato janë paraqitur të ndara duke specifikuar për secilën procedurat minimale dhe ato standarde. Është filluar që nga procedurat lidhur me planifikimin dhe menaxhimin e ekzaminimit e deri te mbikëqyrja e konsoliduar.

A. PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I EKZAMINIMIT

1. Përcaktoni procedurat e ekzaminimit që do të kryhen në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe vlerësimit të bankës siç është përmbledhur në matricën e rrezikut. Të sigurohet se është duke u kryer fushëveprimi dhe procedurat e duhura të vlerësimit në bazë të vlerësimit të rrezikut:

Vlerësimi i ulët i rrezikut	Vlerësimi mesatar i rrezikut	Vlerësimi i lartë i rrezikut
Kryerja e vlerësimit minimal të fushëveprimit	Kryerja e vlerësimit standard të fushëveprimit	Zbatimi i procedurave standarde dhe procedura shtesë për të përfshirë në testimin e më shumë transaksioneve
Zbatimi i procedurave minimale	Zbatimi i procedurave standarde	

2. Kryeni procedurat e duhura të ekzaminimeve në fushat e caktuara të shqetësimit mbikëqyrës.
3. Dokumentoni në letra të punës (shembulli i letrave të punës është paraqitur në Shtojcën VII) punën e bërë që mbulon fushat e mëposhtme:
 - a) Objektivat e vlerësimit të fushëveprimit;
 - b) Përmbledhje e procedurave të kryera për të adresuar objektivat thelbësore të vlerësimit të fushëveprimit;
 - c) Të gjeturat dhe konkluzionet për fushën në shqyrtim;
 - d) Veprime korrigjuese të propozuara, sipas rastit.
4. Paraqitni letrat e punës për shqyrtim, dhe diskutoni gjetjet dhe përfundimet tuaja nga ekzaminimi në fushën e caktuar me ekzamineri përgjegjës për të siguruar se gjetjet janë të sakta, të mbështetura dhe të dokumentuara mirë.
5. Së bashku me ekzaminerin përgjegjës, diskutoni dhe dakordohuni për gjetjet dhe konkluzionet tuaja të ekzaminimit, me menaxhmentin përgjegjës të bankës për zonën e caktuar.
6. Ofroni gjetjet dhe konkluzionet nga ekzaminimi që kanë të bëjnë me, dhe janë relevante me fushat tjera të shqetësimeve mbikëqyrëse të mbikëqyrësit tjerë të caktuar në fusha të relevante.

7. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës, caktoni vlerësimin e duhur CAMELS dhe vlerësimin e duhur të rrezikut për fushën e caktuar.
8. Sipas rastit, përgatisni komentet për përfshirje në raportin e ekzaminimit.
9. Ekzamineri përgjegjës do të konsolidojë komentet nga ekzaminerët e tjerë në ekip në një draft raport të ekzaminimit. Raporti i ekzaminimit do të:
 - a) Përcaktojë objektivat dhe fokusin e ekzaminimit;
 - b) Deklarojë konkluzionet e ekzaminimit;
 - c) Identifikojë ndonjë problem të rëndësishëm, veprime të duhura korrigjuese, si dhe afate kohore për veprime korrigjuese.
10. Ekzamineri përgjegjës zhvillon një takim përmblyës me menaxhmentin e bankës për të diskutuar për gjetjet dhe konkluzionet e ekzaminimit. Gjatë takimit përmblyës, ekzamineri përgjegjës merr zotimet e menaxhmentit për të implementuar veprimet e rekomanduara korrigjuese.

Shtojca VII: Letrat e punës

Referenca e fajllit të letrave të punës:	P.sh: KAPITALI: (C)
Emri dhe mbiemri i ekzaminerit dhe nënshkrimi:	
Data e kompletimit:	
Rishikuar nga: Emri, mbiemri dhe nënshkrimi:	
Data e rishikimit:	
Emri i bankës:	XXXXXX
Informatat financiare të datës:	XX-XX-XXXX

KAPITALI (C)	
C-1	Përmbledhje e konkluzioneve të ekzaminimit
C-2	Porcedurat e fushëveprimit të ekzaminimit (vlerësimi i fushëveprimit minimal/standard)
C-3	
...	
...	
...	
...	
...	
...	

B. EKZAMINIMI I KUALITETIT TË MJETEVE DHE RREZIKUT KREDITOR**1. Përshkrimi**

1.1. Arrini një konkluzion përfundimtar dhe të përgjithshëm për kualitetin e mjeteve; nivelin e rrezikut kreditor; dhe drejtimin e rrezikut kreditor duke përdorur si në vijim:

- a) Vlerësimin e kualitetin e mjeteve (1, 2, 3, 4, ose 5);
- b) Vlerësimin e rrezikut kreditor (e ulët, e mesme, ose e lartë);
- c) Drejtimin e rrezikut kreditor (në rënie, stabil ose në rritje).

1.2. Komplettoni objektivat e këtij seksioni për të caktuar kualitetin e mjeteve dhe rrezikun kreditor. Gjatë caktimit të vlerësimeve, mbikëqyrëset duhet të konsultohet me ekzaminerin përgjegjës dhe me ekzaminierët e tjerë të duhur. Ekzaminierët duhet po ashtu të marrin parasysh faktorët e vlerësimit të përcaktuara në Udhëzuesin për Vlerësimin Sipas Sistemit CAMELS.

2. Procedurat e vlerësimit**2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal***Objektivi*

Përcaktoni vlerësimin e komponentës së kualitetit të mjeteve, ekzistimin e koncentrimet e kredive, përshtatshmërinë e rezervave për humbjet nga kreditë dhe lizingut, sasinë e rrezikut kreditor, cilësinë e menaxhimit të rrezikut kreditor dhe ndonjë shkelje të ligjit, vendimeve apo rregulloreve (p.sh. limitet e kreditimit, transaksionet e brendshme, etj.).

Procedurat

1. Në fillim të ekzaminimit, diskutoni me menaxhmentin përndryshimet aktuale ose të planifikuara:
 - a. Në politikat e kreditimit dhe administrimit të kredisë;
 - b. Në menaxhment apo personel të kreditimit;
 - c. Në produkte të kredisë, marketing dhe rritje të kredive;
 - d. Në rishikimin e kredive ose në sistemin e kredi dhënies; dhe,
 - e. Ndryshime të tjera në faktorë të jashtëm ose të brendshëm që mund të ndikojnë në kualitetin e kredive.

2. Rishikoni raportin e ekzaminimit të kaluar, raportet tjera të rëndësishme dhe informacionet tjera rregullative dhe korrespondencën për të identifikuar ndonjë çështje në këtë fushë që kërkon përcjellje të vazhdueshme.
3. Merrni informata mbi kualitetin e mjeteve dhe informata mbi rrezikun e ndërlidhur me kredi nga mbikëqyrësit e caktuar për të rishikuar procesverbalin nga takimi i bordit të drejtorëve. Përveç kësaj, rishikoni procesverbalin e komisionit të kredive për të kuptuar praktikatat e kreditimit të bankës.
4. Diskutoni me ekzaminierin përgjegjës për plotësimin e pjesës "Auditimi dhe Kontrolli i Brendshëm" nëse ka ndonjë gjetje të rëndësishme të auditimit në fushën e kredive që kërkojnë përcjellje, ose nëse është i nevojshëm një rishikim i dokumenteve të punës të auditimit.
5. Nëse nuk është ofruar më parë, merrni dhe rishikoni informacionin dhe dokumentet e mëposhtme, sipas rastit:
 - a. Politikatat dhe procedurat kreditore dhe çdo ndryshim të bërë që prej ekzaminimit të fundit;
 - b. Përbërjen dhe kualitetin e mjeteve;
 - c. Raportet më të fundit të shqyrtimit të kredive të raportuara nga stafi i brendshëm i bankës për shqyrtim të kredive;
 - d. Lista e kredive të riprogramuara dhe ripërtërira;
 - e. Raportet për kredi në vonesë dhe ato jo-përformuese;
 - f. Vlerësimi (poentimi) i brendshëm i kredive apo raportet për kategorizimin e kredive;
 - g. Lista e kredive problematike dhe vrojtuese;
 - h. Lista e kredive për personat e brendshëm, duke përfshirë të punësuarit;
 - i. Raportet për koncentrimin e kredive;
 - j. Detaji i të gjitha mjeteve tjera të cilat janë materiale për pasqyrat financiare;
 - k. Lista e zërave jashtë bilancore;
 - l. Çdo raport tjetër që mund të jetë i dobishëm për rishikimin e kësaj fushe.
6. Rishikoni një mostër të përshtatshëm të kredive. Në përgjithësi mostra duhet të përfshirë:
 - a. Kredi të reja, duke përfshirë ato bilancore dhe jashtë bilancore.
 - b. Kreditë e brendshme;
 - c. Kredi të mëdha (10% ose më shumë të kapitalit bazë);
 - d. Kredi në vonesa dhe jo-përformuese;

- e. Kredi të kritikuar më parë dhe kredi nga lista e bankës së kredive problematike dhe vrojtuese; dhe,
- f. Shembull tipik të kredive standarde ose në vonesa duke përdorur teknika të aprovuara statistikore të mostrimit.

Madhësia e mostrës duhet të bazohet në trendët dhe rrezikun e përgjithshëm të paraqitur nga ato segmente të portofolit të kredisë dhe duhet të paktën të mbulojë një përqindje të pranueshme të portofolit. Qëllimi i shqyrtimit është të përcaktojë nëse kreditë kanë treguar ndryshim si rezultat i ndryshimit në përzgjedhjen e rrezikut nga banka, praktikat e lejimit të ekspozimeve kreditore (underwriting) të bankës, administrimin e kredive, kriteret e vlerësimit të rrezikut ose çdo aspekt tjetër të menaxhimit të rrezikut të kredive. Ekzaminerët duhet të sigurohen që rishikimi i mbulon të gjitha kriteret e përdorura për shqyrtim dhe vlerësim të kualitetit e menaxhimit të rrezikut kreditor, siç janë përshkruar në matricën e rrezikut. Rishikimi mund të realizohet duke shqyrtuar dosjet e kredive, dokumentet e aprovimit dhe procesverbalet e komitetit të kredive. Dokumentacioni i shqyrtimit të dosjeve të kredive normalisht mund të jetë i kufizuar për komente përmbledhëse që detajon klasifikimin e kredisë dhe faktet që mbështesin atë.

- 7. Vlerëson pajtueshmërinë e bankës me kërkesa prudenciale. Gjetjet duhet t'i komunikohen mbikëqyrësit që bën rishikimin e menaxhmentit.
- 8. Nëse aktivitetet e bankës, profili i rrezikut apo kontrollet e rrezikut kanë ndryshuar konsiderueshëm apo nëse rishikimi i informacionit të mësipërm ngrit çështje substanciale, mbikëqyrësi duhet të zgjerojë fushëveprimin për të përfshirë objektiva apo procedura shtesë, sipas nevojës. Nëse ky rishikim nuk rezulton në ndonjë ndryshim apo çështje të rëndësishme, përmylleni kualitetin e mjeteve dhe rishikimin e rrezikut kreditor.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

Ekzaminerët duhet të përzgjedhin objektivat dhe procedurat e duhura të nevojshme për të vlerësuar gjendjen dhe rreziqet e bankës.

Objektivi 1

Përcaktimi i sasisë së rrezikut kreditor në portofolin e kredive.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 në seksionin e vlerësimit të fushëveprimit minimal, kryeni procedurat shtesë e mëposhtme:

1. Shqyrtoni raportet prudenciale dhe informacionet tjera rregullative dhe korrespondencën e ofruar nga banka për të vlerësuar madhësinë, përbërjen dhe trendët në portofolin e kredive dhe të gjitha ekspozimet jashtëbilancore. Keni parasysh:
 - a. Rritjen aktuale dhe të planifikuar të kredive në raport me kapitalin dhe limitet e rrezikut të bankës;
 - b. Fushat e rritjes së lartë;
 - c. Raportet e brendshme për menaxhimin e portofolit (përfshirë nga politikat e kredive, koncentrimet e kredive, etj.);
 - d. Zotime të jo të financuara dhe/ose të pa-tërhequra dhe zërat tjera jashtë bilancore; dhe,
 - e. Çdo informacion tjetër të lidhur me karakteristikat e rrezikut të portofolit të kredive si treguesit ekonomik, trendët industriale dhe produkteve të reja të planifikuara apo sapo të filluara.

2. Përdorni raportet e bankës për të zgjedhur një mostër të duhur të kredive nga sektorë të ndryshëm të portofolit të kredive të bankës (komercial, shitje me pakicë, etj.) Konsultohuni me ekzaminerin përgjegjës kur të bëni përzgjedhjen e mostrës. Keni parasysh:
 - a. Kreditë e mëdha mbi 10% të kapitalit të klasit të parë;
 - b. Koncentrimet e konsiderueshme të kredive sipas industrisë, rajonet, etj.;
 - c. Kredi të reja në produkte të reja kreditore dhe/ose portofolit rritet shpejtë;
 - d. Kredi të brendshme dhe kredi për bashkëpunëtorë (affiliates);
 - e. Kredi të identifikuar më parë me dobësi strukturore, kredi me përjashtimet nga politikat e kreditimit, përzgjedhja e rrezikut dhe standardet e lejimit (underwriting);
 - f. Kredi apo koncentrimet e kreditimit për bizneset apo industrinë që tregojnë shenja të dobësisë apo rrezik të lartë;
 - g. Zotimet jashtëbilancore;
 - h. Shembull tipik të kredive standarde ose vrojtuese duke përdorur teknika të pranuar statistikore të mostrimit.

Rreziku kreditor zakonisht paraqet rrezikun më të madh për të hyrat dhe kapitalin pasi që kreditë paraqesin pjesën më të madhe të gjithsej mjeteve. Portofoli i kreditor për këtë arsye përbën një përqindje të konsiderueshme të mjeteve që do të shqyrtohen.

Madhësia dhe përbërja e mostrës së kredisë duhet të jetë proporcionale me cilësinë e rrezikut kreditor, me përshtatshmërinë e menaxhimit të rrezikut, kushtet e bankës dhe objektivat e kualitetit të mjeteve dhe shqyrtimit të rrezikut kreditor. Madhësia e mostrës për nivel mesatar dhe të lartë të rrezikut duhet të përfshijë një mostër të pranueshme në pajtim me nivelin e rrezikut.

Llojet e kredive në mostër janë po aq të rëndësishme sikurse madhësia e portofolios së rishikuar. Mostra duhet të pozicionohet drejt rreziqeve mbizotëruese në portofol. Sa më i lartë rreziku që shfaqet për bankën, aq më gjithëpërfshirës do të jetë mbulueshmëria dhe testimi.

Në një institucion të qëndrueshëm, të menaxhuar mirë që përjeton disa shenja të ndryshimit, mbikëqyrësit duhet të mostrojnë një numër më të vogël të kredive të reja dhe të kalueshme për qëllim të përcaktimit të përshtatshmërisë së vazhdueshme të cilësisë së kredisë dhe të menaxhimit të rrezikut kreditor.

Nëse numri i përjashtimeve nga praktikat e shëndosha të lejimit të kredive ose nga praktikat e përzgjedhjes së rrezikut janë të rëndësishme, ose në qoftë se identifikimi i rrezikut apo administrimi i kredive nga ana e bankës është dyshimtë ose e mangët, ekzamineri duhet të zgjerojë mostrën për të përcaktuar arsyet, seriozitetin dhe efektin rrezikun kreditor. Gjithashtu, mund të kërkohen mostra shtesë, për shembull kur ka pasur rritje të konsiderueshme, ndryshim i kredive ose përzierjeve të produktit, përkeqësim të kushteve për kredi ose ekonomike, ndryshim i drejtimit strategjik apo i personelit kyç, ose menaxhmenti i portofolit të kredisë është i dyshimtë ose i mangët. Mostra shtesë duhet të shënjestrojë fushat e kreditimit që kanë nxitur mbulueshmërinë e zgjeruar të kredisë.

3. Analizoni kreditë dhe diskutoni ato në mënyrë të mjaftueshme me personelin e kreditimit për të përcaktuar një vlerësim dhe klasifikim për çdo kredi të rishikuar.
4. Dokumentoni dhe mbështetni arsyet për çdo klasifikim të kredive.
5. Mirëmbani një listë të kredive të identifikuara që kanë dobësi strukturore.
6. Mirëmbani një listë të kredive me informacion të pamjaftueshëm për kredive apo hipotekë. Keni parasysh:
 - a. Modelet ose arsyet e përjashtimeve; dhe,

- b. Lidhjen e përjashtimeve me proceset e kreditit.
7. Për kreditë me shuma të ulëta, të kryhet një analizë e portofolit. Keni parasysh:
 - a. Madhësinë e portofolit dhe shkallën e rritjes;
 - b. Ndryshimet në produkte, kanale të marketingut, standardet e lejimit, operacione, dhe në teknologji;
 - c. Nivelin dhe trendet në vonesat e kësteve dhe humbjeve;
 - d. Nivelet dhe trendet në ristrukturimit dhe ripërtëritjes.
8. Bazuar në rezultatet e analizës së portofolit kreditor me vlerë të ulët, përzgjidhni një mostër statistikore të kredive për të përcaktuar praktikatat e lejimit e ekspozimeve dhe llogarive të bankës.
9. Përcaktoni rrezikun kreditor të vetvetishëm në portofolin kreditor në tërësi duke pasur parasysh profilin e vlerësimit të rrezikut, praktikatat për përzgjedhjen e rrezikut dhe lejimit, koncentrimet, përjashtimet nga politikat e kredive, përjashtimet e kredisë dhe kolateralit, çmimin, mbulueshmërinë me kolateral, mjaftueshmërinë e analizës dhe praktikatat e administrimit të kreditit, treguesit ekonomik dhe sasinë e kredive që i nënshtrohen klasifikimit.

Objektivi 2

Përcaktoni sasinë e rrezikut kreditor të lidhur me mjete tjera përveç kredive.

Procedurat

1. Sipas rastit, merrni dhe shqyrtoni një listë të zërave vijues:
 - a. Plasmanet në bankat e tjera;
 - b. Kreditë e arkëtueshme ndërbankare;
 - c. Bono komerciale;
 - d. Debitorët e ndryshëm;
 - e. Investimet e letrave me vlerë;
 - f. Llogari të tjera të mjeteve me vlerë materiale.
2. Merrni një listë të investimeve të klasifikuara dhe të gjetura të tjera në lidhje me cilësinë dhe përbërjen e investimeve nga ekzaminerët, që vlerësojnë portofolin e investimeve.

3. Në diskutim me menaxhmentin e bankës dhe duke u bazuar në rishikimin e mjeteve të listuara më sipër, përcaktoni nëse ndonjë zë duhet të klasifikohet ose të deklarohet.

Objektivi 3

Përcaktoni përshtatshmërinë e rezervave për humbjet nga kreditë dhe lizing (ALLL).

Procedurat

1. Vlerësoni metodën e përdorur për të përcaktuar bilancin e rezervave për humbjet nga kreditë dhe lizing. Keni parasysh:
 - a. Arsyeshmërinë e procesit të menaxhimit;
 - b. Cilësinë dhe mjaftueshmërinë e dokumentacionit mbështetës;
 - c. Të gjeturat nga rishikimi i kualitetin e mjeteve dhe rrezikut kreditor.

2. Përcaktoni nëse metodologjia rezervave për humbjet nga kreditë dhe lizing ka dobësitë dhe nëse po, konsultohuni me ekzaminerin përgjegjës në mënyrë të pavarur për të përcaktuar mjaftueshmërinë e bilancit të rezervave për humbjet nga kreditë dhe lizing. Nëse rezervat për humbjet nga kreditë dhe lizing vlerësohen të pamjaftueshme:
 - a. Llogaritni provizionin e nevojshëm për të rivendosur rezervat për humbjet nga kreditë dhe lizingu në një nivel të përshtatshëm;
 - b. Drejtoni menaxhmentin e bankës për të bërë korrigjimet të nevojshme në librat bankare dhe të raporteve rregullative;
 - c. Sipas nevojës, shkëmbeni këto gjetje me ekzaminerët e tjerë.

Objektivi 4

Përcaktoni kualitetin e sistemeve për menaxhimin e rrezikut kreditor.

Procedurat

1. Përcaktoni nëse numri dhe natyra e kredive, kolateralit dhe përjashtimeve nga politikat, ndryshimet e vlerësimit të rrezikut, dhe/ose gjetjet e tjera nga rishikimi i kredive ngritin shqetësime në lidhje me cilësinë e funksionimit të administrimit të kredisë.

2. Përcaktoni nëse numri, përvoja dhe kompensimi i menaxhmentit të kredive dhe personelit mbështetës janë të mjaftueshme për të menaxhuar në mënyrë efektive nivelin e rrezikut të vetvetishëm kreditor në portofolin kreditor.
3. Vlerësoni afatet kohore, plotësinë, saktësinë dhe rëndësinë e sistemit të informimit të menaxhmentit për rrezikun kreditor. Merrni parasysh burimet e raporteve, kontrollat mbi përgatitjen e raporteve dhe a është vërtetuar saktësia e raporteve në mënyrë të pavarur. Raportet e menaxhimit të rrezikut duhet të mbulojnë burimet kryesore të rrezikut të kredisë të identifikuar në objektivat e mësipërme. Ky shqyrtim duhet të koordinohet me ekzaminerët përgjegjës për të gjitha fushat e ekzaminimit, duke përfshirë kontrollin e brendshëm, për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerëve që bëjnë shqyrtimin e rrezikut operacional.
4. Duke përdorur gjetjet nga objektivat e mëparshme, konsultohuni me ekzaminerët përgjegjës dhe me mbikëqyrësit e tjerë të duhur për të bërë vlerësime paraprake mbi përshtatshmërinë e sistemeve për menaxhimin e rrezikut të portofolit. Keni parasysh nëse:
 1. Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti njohin dhe kuptojnë rreziqet ekzistuese dhe të reja;
 2. Bordi i drejtorëve themelon, komunikon dhe kontrollon limitet e rrezikut;
 3. Menaxhmenti mat rrezikun në mënyrë të saktë dhe në kohë; Menaxhmenti me saktësi dhe në mënyrë të përshtatshme monitoron nivelet e përcaktuara të rrezikut.
5. Vlerëson sistemin e kontrollit të brendshëm të bankës mbi funksionin e kreditimit. Ekzaminerët duhet të marrin në konsideratë kontrollat përkatëse të listuara në objektivin 5 të pjesës "Auditimi dhe Kontrolli i Brendshëm" të vlerësimit standard. Mbikëqyrësit duhet gjithashtu të marrin në konsideratë kontrollat e tjera përkatëse për funksionimin e kreditimit.

Objektivi 5

Vlerësimi i pajtueshmërisë së bankës me kërkesat prudenciale. Gjetjet duhet t'i komunikohen mbikëqyrësit që bën shqyrtimin e menaxhmentit.

Objektivi 6

Rekomandoni veprime korigjuese.

Procedurat

Para kryerjes së procedurave të mëposhtme, vendosni nëse dëshironi të zgjeroni apo jo procedurat. Konsideroni nëse ekziston nevoja për procedurat e zgjeruara për fushat e shqetësimeve. Procedurat e zgjeruara janë në dispozicion në këtë Manual të Ekzaminimit. Shkalla në të cilën mbikëqyrësit do të zgjerojnë procedurat do të vendoset sipas rastit. Nëse procedurat e zgjeruara nuk janë të nevojshme, të vazhdohet si në vijim:

1. Diskutoni përfundimet preliminare me ekzaminerin përgjegjës duke adresuar:
 - a. Sasinë e rrezikut të kredisë;
 - b. Cilësinë e menaxhimit të rrezikut të kredisë;
 - c. Nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut të kredisë. Sipas nevojës, përditësoni Matricën e Rrezikut;
 - d. Vlerësimin e cilësisë së asetit;
 - e. Direktivat dhe/ose rekomandimet, nëse ka ndonjë.
2. Siguroni dhe diskutoni me menaxhmentin një listë të përjashtimeve të kredisë dhe kolateralit, përjashtimet e politikave, kreditë me dobësi strukturore, dhe asetet e klasifikuara, duke përfshirë çdo dallim në mes të klasifikimit të kredive të brendshme të bankës dhe klasifikimit nga ana e ekzaminerëve.
3. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe me ekzaminuesit tjerë, shpalosni dhe komunikoni me ekzaminuesit e tjerë, sipas rastit, çdo përfundim dhe gjetje nga cilësia e aseteve dhe rishikimi i rrezikut të kredisë që janë relevante me fushat e tjera që janë duke u shqyrtuar.
4. Përdorni rezultatet e procedurave të mësipërme dhe çdo gjetje tjetër të ekzaminimit të aplikueshëm për të shkruar komente mbi cilësisë e aseteve dhe të menaxhimit të rrezikut të kredisë për raportin e ekzaminimit.

C. EKZAMINIMI I RREZIKUT TË LIKUIDITETIT

1. Përshkrimi

1.1. Arrini një përfundim të përgjithshëm për rrezikun e likuiditetit të bazuar në sasi, nivel, dhe drejtim të rreziqeve për:

- a. Vlerësimin e Likuiditetit (1, 2, 3, 4 ose 5);
- b. Vlerësimin e rrezikut të Likuiditetit (e ulët, mesatar, ose i lartë);
- c. Drejtimi i rrezikut të likuiditetit (në rënie, stabil ose në rritje).

1.2. Komplettoni objektivat e këtij seksioni për të caktuar komponentin e likuiditetit dhe vlerësimet e rrezikut të likuiditetit. Në caktimin e vlerësimeve, ekzaminerët duhet të konsultohen me ekzaminerin përgjegjës dhe me ekzaminerët e tjerë të duhur. Kur të caktohet komponenti i likuiditetit dhe vlerësimi i rrezikut të likuiditetit, ekzaminerët duhet të marrin në konsideratë faktorët e vlerësimit të përcaktuar në Udhëzuesin për Vlerësimin sipas Sistemit CAMELS.

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi

Përcaktoni sasinë e rrezikut të likuiditetit, cilësinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, si dhe vlerësimin e komponentit të likuiditetit.

Procedurat

1. Në fillim të ekzaminimit, zhvilloni diskutime me menaxhmentin që mbulon ndryshimet aktuale ose të planifikuara:
 - a. Në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
 - b. Në planifikimin e likuiditetit ose të burimeve dhe nevojave të financimit;
 - c. Në strategjinë e investimeve;
 - d. Në planin e politikës së likuiditetit ose të financimit të paparashikuar.

2. Rishikoni raportin e ekzaminimit të kaluar, raportet prudente dhe informacionet e tjera rregullative dhe korrespondencën për të identifikuar ndonjë çështje që kërkojnë përcjellje të mëtejme në këtë fushë.
3. Merrni informata të ndërlidhura me likuiditet nga ekzaminuesit e caktuar për të rishikuar procesverbalet e takimit të bordit të drejtorëve dhe procesverbalet e komisionit të bordit të drejtorëve, që është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të likuiditetit dhe përcillni mëtej sipas nevojës çështjet që kërkojnë vëmendje.
4. Diskutoni me ekzaminerin përgjegjës për plotësimin e seksionit "Auditimi dhe Kontrolli i Brendshëm" të vlerësimit standard dhe përcillni më tej çdo gjetje të rëndësishme të auditimit të likuiditetit.
5. Merrni dhe rishikoni informacionin dhe dokumentet e mëposhtme, sipas nevojës:
 - a. Raportet e likuiditetit të bankës duke përfshirë raportin më të fundit të gepit të maturitetit;
 - b. Procesverbalet dhe raportet e Komitetit të Aseteve dhe Detyrimeve (ALCO) që nga ekzaminimi i fundit në vend.
6. Vlerësoni pajtueshmërinë e bankës me kërkesat prudenciale. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerit që bën shqyrtimin e menaxhimit.
7. Përcaktoni nëse ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në aktivitetet e bankës, profilin e rrezikut ose kontrolleve të rrezikut pas konsultimit me ekzaminerin që bëjnë rishikimin e fushave të tjera. Nëse jo, përmbyllni shqyrtimin e rrezikut të likuiditetit duke caktuar një vlerësim të duhur.
8. Nëse kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në aktivitetet e bankës, në profilin e rrezikut ose në kontrolle të rrezikut, zgjeroni fushëveprimin e rishikimit për të përfshirë objektiva ose procedura shtesë të përshkruara sipas vlerësimeve standarde.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

Objektivi 1

Përcaktoni përshtatshmërinë e likuiditetit dhe sasinë e rrezikut të likuiditetit.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të përshkruara në vlerësimin e fushpveprimit minimal, kryeni procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Merrni dhe shqyrtoni zërat e mëposhtëm:
 - a. Raportet më të fundit të likuiditetit;
 - b. Planin për financim të paparashikuar;
 - c. Gjetjet nga raportet e monitorimit jashtë-vendnit;
 - d. Listën e investimeve;
 - e. Çdo informacion ose raport tjetër që menaxhmenti ka përdorur (raportet ALCO, procesverbalet dhe pakot, etj).

2. Diskutoni investimet aktuale, likuiditetin, dhe strategjitë e menaxhimit të fondeve me menaxhmentin e duhur.

3. Identifikoni vëllimin dhe trendët në financim duke rishikuar:
 - a. Burimet e financimit, p.sh. me pakicë kundrejt me shumicë;
 - b. Nevojat e projektuara për financim kundrejt burimeve në dispozicion;
 - c. Financimi me shumicë që mund të jetë i ndjeshëm ndaj kreditit;
 - d. Përqendrimet e financimit;
 - e. Përdorimi dhe varësia në detyrime me maturitete afatshkurtëra;
 - f. Parashikimet e rritjes së aseteve;
 - g. Nivelet dhe trendet e aseteve likuide;
 - h. Zotimet jashtë bilancit;
 - i. Proporcionet e aseteve afatgjata të financuara nga detyrimet afatshkurtra.

4. Vlerësoni mjaftueshmërinë e burimeve të fondeve për të përmbushur nevojat e parashikuara ose të mundshme. Keni parasysh:
 - a. Asetet e tregut të parasë të ndërlidhura me nevojat e likuiditetit afatshkurtër;
 - b. Likuiditetet e tjera aktualisht në dispozicion të aseteve të ndërlidhura me nevojën e përgjithshme të likuiditetit letrave me vlerë p.sh. falas (të pangarkuara me borxhe);

- c. Burime të tjera të mundshme të likuiditetit të aseteve (rrjedha e parave nga kreditë, investimet dhe kontratat jashtë bilancit, etj.);
 - d. Kapaciteti i vlerësuar për të marrë hua nga tregu ndërbankar;
 - e. Kapaciteti i bankës për të rritur depozitat përmes çmimeve dhe përmes fushatave të drejtpërdrejta të marketingut për të përmbushur nevojat afatmesme dhe afatgjata të likuiditet;
 - f. Kapaciteti i bankës për të marrë hua në kuadër të programit të kolateralizuar të BQK-së ose lehtësirave të tjera të ngjashme të kolateralizuara të huamarrjes;
 - g. Kapaciteti për të lëshuar detyrime afatgjata dhe instrumente të borxhit për të përmbushur nevojat afatmesme dhe afatgjata për financim të likuiditet. Opsionet mund të përfshijnë:
 - Mobilizimin e depozitave;
 - Borxhet e varura;
 - Stoqet/aksionet.
5. Vlerësoni cilësinë e portofolit të investimeve si një burim potencial të likuiditetit. Keni parasysh si në vijim:
- a. Përqindjen dhe cilësinë e portofolit të investimeve që është i pazotuar;
 - b. Nivelin dhe ndikimin e zhvlerësimit të portofolit;
 - c. Shpërndarjen e maturimit të portofolit të investimeve;
 - d. Shpërndarjen e letrave me vlerë të caktuar të mbajtura deri në maturim dhe të disponueshme për shitje;
 - e. Trendet në rrjedhjen e parave të gatshme mujore nga portofoli i investimeve;
 - f. Ndikimi potencial i opsioneve të përfshira në modelet e rrjedhës së parasë.
6. Nëse banka mbështetet në mënyrë të konsiderueshme nga fondet me shumicë/të korporatave, shqyrtoni faktorët që ndikojnë në ofruesit e fondeve me shumicë/të korporatave. Keni parasysh si në vijim:
- a. Cilësinë e aseteve aktuale dhe potencialin për përkeqësim;
 - b. Përformancën dhe pritjet nga fitimet;
 - c. Ndryshimet në menaxhmentin e lartë të bankës;
 - d. Vëmendjen negative të mediave;

- e. Kufizimet ligjore.
7. Nëse banka mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në financimin e korporatave, diskutoni financimin me menaxhmentin për të përcaktuar:
 - a. Sesi financimi me shumicë i përshtatet strategjisë së përgjithshme të aseteve/detyrimit;
 - b. Çfarë lloje të mospërputhjeve ekzistojnë;
 - c. Nëse strategjia për financim me shumicë është përmbushja e pritjeve të fitimit.
 8. Duke marrë parasysh faktorët e mësipërm dhe të tjerë relevantë të vlerësimit të rrezikut, konsultohuni me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët e tjerë për të përcaktuar sasinë e rrezikut të likuiditetit.

Objektivi 2

Përcaktoni cilësinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 tashmë të kryera nën vlerësimin e fushëveprimit minimal, kryeni procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve ka artikuluar qartazi politikatat dhe udhëzimet që përcaktojnë linjat e autoritetit/përgjegjësinë për menaxhimin e likuiditetit dhe tolerancën e bordit të drejtorëve për rrezikun e likuiditetit. Keni parasysh nëse:
 - a. Ekziston një sistem i matjes që kap dhe mat sasinë e rrezikut të likuiditetit;
 - b. Kufizimet/udhëzimet janë definuar dhe iu komunikohen menaxhmentit dhe stafit tjetër relevant;
 - c. Kufizimet/udhëzimet janë të arsyeshme;
 - d. Planifikimi, buxhetimi dhe fushat e reja të produktit të ri e marrin parasysh likuiditetin në vendimet e tyre.
2. Përcaktoni nëse menaxhmenti ka planifikuar burime të përshtatshme të likuiditetit për të përmbushur nevojat e tanishme dhe potenciale të financimit.
3. Rishikoni planin e financimit të paparashikuar dhe përcaktoni nëse ajo detajon në mënyrë adekuate përgjegjësitë e menaxhimit, vlerësoni nevojat/burimet

potenciale të financimit sipas skenarëve të shumtë, dhe priorizoni veprimet e menaxhmentit për t'iu përgjigjur nevojave të financimit. Sigurohuni që plani është i përshtatshëm duke pasur parasysh kompleksitetin e rrethanave të bankës.

4. Përcaktoni nëse strategjitë e përdorura për të arritur kombinimin e dëshiruar dhe maturimin e aseteve dhe detyrimeve janë adekuate. Keni parasysh:
 - a. Diskutimin me menaxhmentin mbi strategjitë për rrezikun e likuiditetit të bankës;
 - b. Presionet konkurruese në tregun e bankave, duke i marrë parasysh të gjitha burimet e financimit (p.sh. rrjetin e degëve, financimin me shumicë, etj.);
 - c. Përputhja e maturimit;
 - d. Blerjet e aseteve ose shitjet apo huazimet dhe borxhet e varura;
 - e. Çmimet e kredive dhe depozitave; dhe,
 - f. Ekzistenca e zërave jashtë bilancit të gjendjes, të tilla si linjat e kredisë, kontratat derivative dhe zotimet e tjera.

5. Vlerësoni afatet kohore, plotësinë, saktësinë dhe rëndësinë e sistemit të menaxhimit të informatave për likuiditet. Konsideroni burimet e raporteve, kontrolleve mbi përgatitjen e raporteve dhe nëse saktësia e raporteve është validuar në mënyrë të pavarur. Ky shqyrtim duhet të koordinohet me ekzaminerin përgjegjës për të gjitha fushat e ekzaminimit për të shmangur angazhimet e dyfishta në të njëjtin fushë. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminuesit që shqyrton rrezikun operacional. Keni parasysh nëse sistemi i informimit të menaxhmentit monitoron:
 - a. Pajtueshmërinë me kufijtë e rrezikut;
 - b. Burimet dhe përdorimet e fondeve;
 - c. Përqendrimet e financimit;
 - d. Kostot e financimit;
 - e. Disponueshmërinë në kuadër të linjave të shitjes me shumicë të financimit; dhe,
 - f. Nevojat e parashikuara të financimit.

6. Vlerësoni sistemin e kontrollit të brendshëm mbi likuiditetit. Ekzaminerët duhet gjithashtu të marrin parasysh kontrollet e tjera përkatëse të likuiditetit.

7. Duke i përdorur gjetjet e mësipërme, konsultohuni me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët tjerë të duhur për të përcaktuar cilësinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Objektivi 4

Përcaktoni përbërjen dhe cilësinë e portofolit të investimeve

Procedurat

1. Shqyrtoni raportet e sistemit të menaxhimit të informatave të bankës për të vlerësuar:
 - a. Kthimet e investimeve dhe vlerat e tregut;
 - b. Ndikimin mbi fitimet dhe mjaftueshmërinë e kapitalit e shkaktuar nga dëmtimi i portofolit të investimeve.
2. Nga diskutimet me menaxhmentin dhe duke shqyrtuar raportet e brendshme, përcaktoni nëse ekziston një proces i përshtatshëm i kujdesit të duhur për të siguruar, që të gjitha letrat me vlerë janë blerë në përputhje me politikat e kreditimit për analizën e kreditit, marrjen në sigurim dhe miratim.
3. Nga diskutimet me menaxhmentin dhe duke rishikuar raportet e brendshme, vlerësoni trendët në cilësinë e kredisë së portofolit të investimeve mes ekzaminimeve. Përcaktoni nëse ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në profilin e rrezikut të kredisë së portofolit të investimeve dhe nëse ky ndryshim ka qenë i menaxhuar në mënyrë të duhur.
4. Nga diskutimet me menaxhmentin dhe duke rishikuar raportet e brendshme, përcaktoni nëse ka ndonjë letër me vlerë në portofol që është e pakualifikuar, në mospagesë ose nën shkallën e investimeve dhe shpërndani gjetjet, sipas rastit, tek ekzaminuesit që janë duke shqyrtuar rrezikun e kredisë, të ardhurat dhe mjaftueshmërinë e kapitalit.

Objektivi 5

Vlerësoni pajtueshmërinë e bankës me kërkesat prudenciale për likuiditet.

Procedurat

1. Vlerësoni pajtueshmërinë e bankës me ligjin në lidhje me asetet likuide dhe raportet prudenciale të likuiditetit. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerit që shqyrton menaxhimin.

Objektivi 6

Komunikoni gjetjet e ekzaminimit si dhe rekomandoni dhe inicioni veprimet e duhura korrigjuese.

Procedurat

1. Ofroni ekzaminerit vlerësimin e rrezikut të kredisë me një listë të investimeve të klasifikuara dhe komunikoni gjetjet për ekzaminuesit tjerë, sipas rastit
2. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminuesit e tjerë, identifikoni dhe komunikoni çdo përfundim dhe gjetje me ekzaminerët tjerë, sipas rastit nga shqyrtimi i likuiditetit, që janë relevante me fushat tjera që janë duke u shqyrtuar.
3. Në diskutim me ekzaminerin përgjegjës, ofroni përfundime preliminare në lidhje me:
 - a. Sasinë e rrezikut të likuiditetit;
 - b. Cilësinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
 - c. Nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut;
 - d. Vlerësimin e likuiditetit;
 - e. Ndikimi potencial ose aktual të rrezikut të likuiditetit mbi të ardhurat dhe kapitalin;
 - f. Direktivat dhe/ose rekomandimet, nëse ka.
4. Diskutoni të gjeturat dhe përfundimet me menaxhmentin lidhur me sasinë dhe cilësinë e rrezikut të likuiditetit dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Konsideratat për diskutime mund të përfshijnë:

- a. Përfundimet e përgjithshme;
 - b. Rekomandimet;
 - c. Mangësitë;
 - d. Nëse është e aplikueshme, zotimet nga menaxhmenti për të korrigjuar shkeljet e ligjeve dhe/ose çështjet që kërkojnë vëmendje të bordit të drejtorëve.
5. Sipas rastit, përgatisni komente për përfshirje në raportin e ekzaminimit. Konsideratat për komente mund të përfshijnë:
- a. Sasinë e rrezikut të likuiditetit;
 - b. Cilësinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
 - c. Nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut;
 - d. Vlerësimin e likuiditetit;
 - e. Ndikimin potencial ose aktual të rrezikut të likuiditetit mbi të ardhurat dhe kapitalin; dhe,
 - f. Direktivat dhe/ose rekomandimet, nëse ka.

D. EKZAMINIMI I RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT**1. Përshkrimi**

1.1. Përfundim: Të arrihet një përfundim i përgjithshëm mbi rrezikun e normës së interesit (RrNI), duke u bazuar në:

- Një vlerësim të RrNI (i ulët, mesatar, i lartë);
- Drejtimin e RrNI (në rënie, stabil apo në rritje).

1.2. Të plotësohen objektivat e kësaj pjese për të caktuar vlerësimin e RrNI. Në caktimin e vlerësimit, ekzamineri duhet të konsultohet me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët e tjerë të duhur.

2. Procedurat e vlerësimit**2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal**Objektivi

Të përcaktohet sasia e rrezikut dhe cilësia e menaxhimit të rrezikut për RrNI.

Procedurat

1. Në fillim të ekzaminimit, zhvilloni diskutime me menaxhmentin, duke mbuluar:
 - a. Ndryshimet aktuale apo të planifikuara të politikës së RrNI (d.m.th., strukturat e kufizimit, matjen e rrezikut, etj.);
 - b. Ndryshimet aktuale apo të planifikuara të procesit të menaxhimit të RrNI;
 - c. Ndryshimet materiale aktuale apo të planifikuara në strukturën e aseteve dhe obligimeve të bankës;
 - d. Ndryshimet aktuale apo të planifikuara në portofolin e investimeve dhe ndikimi e tij në RrNI.
2. Të shqyrtohet raporti i ekzaminimit i mëparshëm, raportet prudenciale dhe informacionet dhe korrespondenca tjetër rregullative për të identifikuar çfarëdo çështje në këtë fushë, të cilat kërkojnë përcjelljen e mëtejme.

3. Të merren informacione të ndërlidhura me RrNI nga ekzamineri i caktuar për të shqyrtuar procesverbalin e bordit të drejtorëve. Përveç kësaj, të shqyrtohen procesverbalet e ALCO për të kuptuar praktikat bankare për menaxhimin e RrNI.
4. Të diskutohet me ekzaminerin përgjegjës për përfundimin e pjesës së “Auditimit dhe Kontrollit të Brendshëm” të vlerësimit standard, nëse ka ndonjë gjetje të rëndësishme nga auditimi i RrNI që kërkon përcjellje, ose nëse kërkohet një shqyrtim i dokumenteve të punës të auditimit.
5. Të merren dhe shqyrtohen raportet më të fundit bankare të RrNI, duke përfshirë raportet e ALCO.
6. Të vlerësohet përputhshmëria e bankës me kërkesat prudenciale. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerit që shqyrton menaxhimin.
7. Nëse aktivitetet e bankës, profili i rrezikut, apo kontrollet e rrezikut kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, apo nëse shqyrtimi i informacionit të mësipërm ngre çështje substanciale, ekzamineri duhet të zgjerojë fushën e aktivitetit për të përfshirë objektiva apo procedura shtesë, sipas nevojës. Nëse ky shqyrtim nuk rezulton në ndonjë ndryshim apo çështje të rëndësishme, përfundoni shqyrtimin e RrNI.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

Objektivi 1

Përcaktoni sasinë e RrNI.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të përshkruara në vlerësimin e fushëveprimit minimal, kryeni procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Në fillim të ekzaminimit, zhvilloni diskutime me menaxhmentin, duke mbuluar:
 - a. Ndryshimet aktuale apo të planifikuara të politikës së RrNI (d.m.th., strukturat e kufizimit, matjen e rrezikut, etj.);
 - b. Ndryshimet aktuale apo të planifikuara të procesit të menaxhimit të RrNI;

- c. Ndryshimet materiale aktuale apo të planifikuara në strukturën e aseteve dhe obligimeve të bankës;
2. Shqyrtoni ekspozimin e zërave bilancore dhe jashtë bilancit të gjendjes. Keni parasysh:
 - a. Përbërjen dhe maturitetet e aseteve dhe obligimeve (Analiza e mangësive);
 - b. Paqëndrueshmërinë e marzhës së neto interesit me kalimin e kohës;
 - c. Nivelin dhe ndikimin e rrezikut bazë, rrezikut të kurbës së kthimit, rrezikut të opsioneve dhe rrezikut të ri-çmimit (rivlerësimit);
Mbështetjen e ofruar nga depozitat me kosto të ulët, të qëndrueshme dhe të jo-maturueshme (d.m.th. depozitat pa afat, kursimet).
3. Shqyrtoni nivelin dhe trendin e fitimeve në rrezik, nëse ka, siç tregohet në sistemin e bankës për matjen e rrezikut.
4. Shqyrtoni ekspozimin ndaj kapitalit të bankës. Nëse banka ka një volum të konsiderueshëm të rrezikut afatmesëm deri në afat më të gjatë të ri-çmimit dhe/ose pozicionet e ndërlidhura me mundësitë, të shqyrtohet niveli dhe trendi i ekspozimit ndaj kapitalit.
5. Shqyrtoni përdorimin dhe përcaktoni ekspozimin e bankës ndaj produkteve derivative, nëse është e zbatueshme.
6. Duke përdorur gjetjet nga kryerja e procedurave të mësipërme dhe duke marrë parasysh faktorët relevantë, konsultohuni me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminuerët e tjerë të duhur për të përcaktuar sasinë e RrNI.

Objektivi 2

Përcaktoni përshtatshmërinë dhe efikasitetin e praktikave të menaxhimit të rrezikut mbi portofolin e investimeve.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 të përshkruara në vlerësimin e fushëveprimit minimal, kryeni procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Vlerësoni nëse bordi i drejtorëve ka miratuar politika që përcaktojnë përgjegjësinë për menaxhimin e RrNI, komunikojnë tolerancën e rrezikut dhe ofrojnë udhëzime të rëndësishme për menaxhimin e RrNI.

2. Vlerësoni efikasitetin e menaxhmentit dhe bordi i drejtorëve në mbikëqyrjen e RrNI. Të merret parasysh:
 - a. Ekzistenca dhe arsyeshmëria e kufizimeve të aprovuara nga bordi i drejtorëve për ekspozimin ndaj RrNI;
 - b. Përputhshmëria me kufizimet e vendosura të rrezikut.
3. Përcaktoni nëse sistemi i menaxhimit të rrezikut i përdorur për matjen e efektit të ndryshimeve të normës së interesit në fitime është i përshtatshëm për nivelin dhe kompleksitetin e ekspozimit të bankës dhe nëse supozimet kryesore të përdorura nga banka janë të arsyeshme.
4. Përcaktoni nëse sistemi i menaxhimit të rrezikut, i përdorur për matjen e efektit të ndryshimeve të normës së interesit në vlerën ekonomike, është i përshtatshëm për nivelin dhe kompleksitetin e ekspozimit të bankës dhe nëse supozimet kryesore të përdorura nga banka janë të arsyeshme.
5. Përcaktoni nëse supozimet e përdorura në sistemin e matjes së rrezikut janë të dokumentuara me detaje të mjaftueshme në mënyrë që të mundësohet verifikimi i arsyeshmërisë dhe saktësisë së tyre.
6. Vlerësoni aftësinë dhe efikasitetin e menaxhmentit në menaxhimin e RrNI. Të merret parasysh:
 - a. Niveli i të kuptuarit të dinamikave të RrNI;
 - b. Aftësia për të reaguar ndaj presioneve konkurruese në tregjet financiare dhe lokale;
 - c. Nëse një prezantim i balancuar i rrezikut dhe kthimit janë marrë në konsideratë në mënyrë të duhur në strategjitë e aseteve/obligimeve;
 - d. Aftësia për të parashikuar dhe për t'iu përgjigjur kushteve ekonomike të pafavorshme ose në ndryshim, si dhe normave të interesit;
 - e. Nëse shkathtësitë e stafit janë të përshtatshme për nivelin e kompleksitetit dhe rrezikut.
7. Vlerësoni afatin kohor, plotësinë, saktësinë dhe rëndësinë e sistemit të menaxhimit të informatave. Të merren parasysh burimet e raporteve, kontrolleve mbi përgatitjen e raportit dhe nëse saktësia e raporteve vërtetohet në mënyrë të pavarur. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminuesit që shqyrton rrezikun operacional.
8. Përcaktoni nëse një proces kompetent dhe i pavarur i shqyrtimit vlerëson periodikisht efektivitetin e sistemit të menaxhimit të RrNI. Në shqyrtimin e

mjeteve matëse, ekzaminuesit duhet të përcaktojnë nëse supozimet e përdorura janë të arsyeshme dhe nëse vargu i skenarëve të konsideruar të normës së interesit janë të përshtatshëm.

9. Vlerësoni aftësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi RrNI. Ekzaminerët duhet gjithashtu të marrin në konsideratë kontrollet e tjera përkatëse për RrNI.
10. Duke përdorur gjetjet nga procedurat e mësipërme, përcaktoni nëse sistemi i menaxhimit të rrezikut për të identifikuar, matur, monitoruar, kontrolluar ose lehtësuar RrNI është efikas.

Objektivi 3

Vlerësoni pajtueshmërinë e bankës me kërkesat prudenciale të RrNI.

Objektivi 4:

Përcaktoni nëse duhet të zgjerohen procedurat.

Të merret në konsideratë nëse ekziston nevoja për procedurat e zgjeruara në fushat më shqetësimeve. Procedurat e zgjeruara janë në dispozicion në këtë manual të ekzaminimit. Shkalla në të cilën ekzaminuesit do t'i zgjerojnë procedurat do të vendoset sipas rastit.

Objektivi 5:

Rekomandoni veprime korigjuese.

1. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët tjerë, identifikoni dhe komunikoni ekzaminuesve tjerë, sipas rastit, çfarëdo përfundimi dhe gjetje nga shqyrtimi i RrNI që është e rëndësishme për fusha të tjera që janë duke u shqyrtuar.
2. Në diskutim me ekzaminerin përgjegjës, ofroni përfundime paraprake rreth:
 - a. Sasisë së RrNI;
 - b. Cilësisë së menaxhimit të RrNI;
 - c. Nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimit të rrezikut të RrNI;
 - d. Efektet aktuale apo potencial të RrNI në fitimet dhe kapitalin.

E. EKZAMINIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

1. Përshkrimi

1.1. Arrini një përfundim të përgjithshëm për rrezikun operacional të bazuar në:

- Vlerësimin e rrezikut operacional (i ulët, i mesatar apo i lartë)
- Drejtimin e rrezikut operacional (në rënie, stabil apo në rritje).

1.2. Përbushni objektivat e këtij seksioni për të vlerësuar rrezikun operacional. Ekzamineri duhet të konsultohet me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminere të tjerë.

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi 1

Përcaktoni sasinë e rrezikut dhe cilësinë e menaxhimit të rrezikut operacional.

Procedurat

1. Në fillim të ekzaminimit, zhvilloni diskutime me menaxhmentin, duke mbuluar:
 - a. Dështimet aktuale të sistemit, ndërprerjet e shërbimit dhe mashtrimet që nga ekzaminimi paraprak;
 - b. Ndryshimet aktuale ose të planifikuara për iniciativat aktuale ose të reja të biznesit;
 - c. Ndryshimet në politikat dhe procedurat për të rregulluar aktivitetet ose produktet e reja;
 - d. Se si e monitoron menaxhmenti cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimeve të kontraktuara dhe funksionet mbështetëse;
 - e. Ndryshimet në gjendjen financiare apo cilësia e shërbimeve të ofruara nga shitësit e teknologjisë informative dhe/ose ofruesit e tjerë të shërbimeve;
 - f. Ndryshimet aktuale ose të planifikuara tek shitësit, sistemet, aplikacionet, kanalet e shpërndarjes ose personeli;

- g. Ndryshimet në sigurinë e informacioneve apo proceset e paparashikuara të planifikimit;
 - h. Ndryshimet në proceset apo raportet që menaxhmenti i përdorë për të monitoruar rrezikun operacional;
 - i. Ndikimin e modeleve që nuk performojnë siç është synuar në fitime, menaxhimin e rrezikut dhe mjaftueshmërinë e provizioneve për humbje nga kreditë dhe lizingjet; dhe ,
 - j. Ndikimin e ndryshimeve të theksuara më lart mbi rrezikun operacional të institucionit.
2. Shqyrtoni raportin e ekzaminimit paraprak, raportet prudenciale, informacionet dhe korrespondenca tjetër rregullative për të identifikuar çfarëdo çështje që kërkon përcjellje në këtë fushë.
3. Merrni informacione të ndërlidhura me rrezikun operacional nga ekzaminerët e caktuar për shqyrtimin e procesverbalit të bordit të drejtorëve.
4. Diskutoni me ekzaminerin përgjegjës për plotësimin e pjesës "Auditimi dhe Kontrolli i Brendshëm" së vlerësimit standard, për çfarëdo gjetje të rëndësishme nga auditimi i rrezikut operacional, të cilat kërkojnë përcjellje të mëtejme.
5. Shqyrtoni informacionet dhe raportet mbi:
 - a. Përputhshmërinë me politikat dhe procedurat e brendshme, kërkesat ligjore dhe rregullative;
 - b. Informatat e tregut të jashtëm në lidhje me ngjarjet dhe kushtet që mund të kenë një ndikim në operacionet e institucionit;
 - c. Rezultatet e testeve të sigurisë së teknologjisë së informacionit të institucioneve dhe reagimin e menaxhmentit;
 - d. Rezultatet e testeve të planit paraprak të institucionit dhe reagimin e menaxhmentit;
 - e. Profilin e rrezikut operacional të institucionit, të dorëzuar në bordin e drejtorëve;
 - f. Raportet e kohëve të fundit të sistemit të informimit të menaxhmentit mbi mashtrimet, ndërprerjet e biznesit, dështimet e sistemit dhe humbjet nga përpunimi;
 - g. Iniciativat dhe zhvillimet e mëdha të teknologjisë informative;
 - h. Planet për vazhdimësinë e biznesit dhe disponueshmërinë e vendit alternativ.

6. Vlerësoni përputhshmërinë e bankës me ligjet dhe kërkesat tjera prudenciale, të cilat përfshijnë:
 - a. Ligjet në fuqi;
 - b. Rregulloret në fuqi;
 - c. Publikime të tjera të ndryshme të BQK-së.

Objektivi 2

Komunikoni gjetjet e ekzaminimit dhe iniconi një veprim të duhur korrigjues

Procedurat

1. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës, ofroni një përfundim të gjetjeve. Të merren parasysh:
 - a. Gjetjet nga të gjitha fushat tjera që janë nën ekzaminim;
 - b. Përfundimi i përgjithshëm;
 - c. Çfarëdo rekomandimi të menaxhmenti.
2. Zgjeroni fushëveprimin e aktiviteteve për të përfshirë objektivat apo procedurat shtesë, sipas rastit, nëse aktivitetet e institucionit, profili i rrezikut, apo kontrollet e rrezikut kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, apo nëse shqyrtimi i informacionit të mësipërm ngre çështje thelbësore.
3. Nëse ky shqyrtim nuk rezulton në ndonjë ndryshim të konsiderueshëm apo çështje, përfundoni shqyrtimin e menaxhimit të rrezikut operacional përmes përgatitjes, sipas rastit, të komenteve për përfshirje në raportin e ekzaminimit.

2.2 Vlerësimi i fushëveprimit standard

Objektivi 1

Përcaktoni sasinë e rrezikut dhe cilësinë e menaxhimit të rrezikut operacional.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 në vlerësimin e fushëveprimit minimal, kryeni edhe procedurat e mëposhtme shtesë:

Objektivi 2

Vlerësoni cilësinë e menaxhimit të rrezikut operacional.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 në vlerësimin e fushëveprimit minimal, kryeni edhe procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Shqyrtoni strukturën organizative, përshkrimet e vendit të punës, kompensimi, lëvizjet e personelit dhe programet e trajnimit për të siguruar, që banka ka një numër të mjaftueshëm të personelit me ekspertizën që kërkon banka.

Mbani lidhje me ekzamineret që vlerësojnë menaxhmentin dhe funksionin e auditimit dhe kontrollet e brendshëm për të shmangur dyfishimin e punëve.

2. Shqyrtoni efikasitetin e menaxhmentit të bankës dhe monitorimin e shitësit dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve, duke vlerësuar:
 - a. Procesin e përzgjedhjes së shitësit/ofruesit të shërbimit;
 - b. Udhëzimet e kontratës, duke përfshirë mbrojtjen e privatësisë së klientit;
 - c. Monitorimin e performancës së shitësit apo ofruesit të shërbimit sipas kontratës, duke përfshirë disponueshmërinë e informacionit financiar dhe qasjen në operacionet dhe auditimet e sigurisë së ofruesit të shërbimit;
 - d. Sipas nevojës, disponueshmërinë apo qasjen në kodin burimor të aplikacionit dhe dokumentacionin për programet, që nuk janë të zhvilluara ose mirëmbajtura nga banka.
3. Shqyrtoni politikat e sigurimit për të përcaktuar nëse ato janë aktuale dhe ofrojnë mbulim adekuat.
4. Përcaktoni nëse ka ndarje të detyrave dhe përgjegjësisive në fushat e operimit dhe të përpunimit të të dhënave. Të merren parasysh:

- a. Përgatitja e inputit;
 - b. Futja e të dhënave;
 - c. Operimi i sistemit të kompjuterit;
 - d. Përpunimi i refuzimeve (informacionet e papranueshme) dhe transaksionet e padërguara;
 - e. Verifikimi i transaksioneve;
 - f. Raportet e përjashtimeve;
 - g. Gjendja e raporteve të përgatitura dhe shpërndarja e tyre.
5. Përcaktoni përshtatshmërinë e planit emergjent për rifillimin e biznesit. Të merret në konsideratë nëse:
- a. Plani jep mekanizma alternativ për rifillimin e shërbimit në rast të një ndërprerje;
 - b. Plani adreson në mënyrë të duhur të gjitha aktivitetet apo shërbimet thelbësore për misionin;
 - c. Bordi i drejtorëve ose një komitet i bordit të drejtorëve rishikojnë në baza vjetore planin.
6. Përcaktoni nëse është kryer validimi vjetor i planit të emergjencës, duke përfshirë testimin e vendit alternativ dhe nëse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë janë të informuar mbi fushëveprimin dhe rezultatet e "backup" testit .
7. Përcaktoni përshtatshmërinë dhe përputhshmërinë me politikën e sigurisë së teknologjisë informative. Të merret në konsideratë nëse politika është:
- a. Miratuar dhe shqyrtuar periodikisht nga bordi i drejtorëve;
 - b. Është përshtatur, sipas nevojës, me ndryshimet në ambientin apo sistemet e përpunimit të bankës (apo të shitësit);
 - c. Raporte përshkruese tek bordi i drejtorëve ose komiteti i bordit të drejtorëve mbi statusin e përgjithshëm të sigurisë së teknologjisë informative dhe pajtueshmërinë e bankës me politikat.
8. Shqyrtoni raportet e sistemit të informimit të menaxhmentit për sistemet dhe aktivitetet e rëndësishme të teknologjisë informative për të siguruar që identifikimi, matja, monitorimi dhe kontrolli/lehtësimi i rrezikut janë në përputhje me kompleksitetin e teknologjisë dhe mjedisin operativ të

bankës. Sistemi i informimit të menaxhmentit duhet të jetë në kohë, i saktë, i plotë dhe relevant. Të merret në konsideratë:

- a. Kapaciteti i sistemeve, përfshirë vëllimet më të mëdha të përpunimit;
- b. Performanca gjatë kohës së operimit (në kohë) dhe ndërprerjet e përpunimit;
- c. Monitorimi i rrjetit, duke përfshirë edhe përpjekjet për depërtim dhe zbulimin e sulmuesit;
- d. Regjistrimet e aktivitetit dhe raportet e sigurisë për ndryshimet në operacione, program dhe parametër, përdorimin e terminaleve, etj;
- e. Vëllimi dhe trendët e humbjeve nga gabimet, mashtrimi dhe zërat e papërputhshëm.

Objektivi 3

Shenim: Shqyrtimi duhet të koordinohet me ekzaminierit përgjegjës për shqyrtimin e rreziqeve të tjera dhe pjesa e kontrollit të brendshëm e ekzaminimit për të shmangur dyfishimin e punëve.

Procedurat

1. Përcaktoni nëse ka kontrole adekuate dhe gjurmë të auditimit mbi kërkesat për ndryshimin e fajllit kryesor (master file) si ndryshimet e adresës, datat e duhura, zgjatja afatit të pagesave të kredisë ose rinovimet, normat e interesit të kredisë apo depozitave dhe treguesi i tarifës së shërbimit. Merrni në konsideratë:
 - a. Individët e autorizuar për të bërë ndryshime dhe përgjegjësitë mbi konfliktet e mundshme në vendin e punës;
 - b. Dokumentacioni/gjurmët e auditimit të ndryshimeve të autorizuara;
 - c. Procedurat e përdorura për verifikimin e saktësisë së ndryshimeve në dosjen kryesore.
2. Vlerësoni adekutshmërinë e kontroleve mbi ndryshimet në sistemet, programet, dojset së të dhënave dhe aplikacionet e bazuara në kompjuterët personalë. Të merren në konsideratë:
 - a. Procedurat për zbatimin e përditësimeve, publikimeve dhe ndryshimeve të programit;
 - b. Kontrollat për të kufizuar dhe monitoruar përdorimin e shërbimeve për ndryshimin e të dhënave;

- c. Përdorimet e menaxhimit të procesit për të përzgjedhur sistemin dhe parametrat e sigurisë së programit (p.sh., nëse parametrat janë bërë në bazë të këshillave të qëndrueshme teknike apo ishin thjesht parametra të parazgjedhur);
 - d. Kontrollat për të parandaluar ndryshimet e paautorizuara të sistemit dhe parametrat e sigurisë së programeve;
 - e. Procesi dhe autorizimet për të ndryshuar parametrat e aplikacionit.
3. Përcaktoni nëse nivelet e qasjes në internet (e bllokuar, vetëm për lexim, përditëso, refuzo, etj) të punonjësve përputhen me përgjegjësitë aktuale të punës.
 4. Vlerësoni efikasitetin e administrimit të fjalëkalimit për fjalëkalimet e punonjësve dhe klientëve, duke marrë parasysh kompleksitetin e mjedisit të përpunimit dhe llojin e informacionit të qasur. Merrni në konsideratë:
 - a. Nëse fjalëkalimet janë konfidenciale (të njohura vetëm për punëtorin/klientin);
 - b. Nëse procedurat për ndryshimin e fjalëkalimit sigurojnë ruajtjen e konfidencialitetit;
 - c. Shpeshtësia e ndryshimeve të kërkuara në fjalëkalim;
 - d. Përbërja e fjalëkalimit (numri dhe lloji i karaktereve);
 - e. Siguria e fjalëkalimeve gjatë kohës që ruhen në dosje në kompjuter, gjatë transmetimit dhe në regjistrimet aktivitetit dhe raportet e shtypura.
 5. Përcaktoni nëse banka ka hequr/rivendosur profilet dhe fjalëkalimet e paracaktuara nga sistemet dhe pajisjet e reja, dhe përcaktoni nëse qasja në nivel të administratorit të sistemit është e kontrolluar në mënyrë adekuate.

Objektivi 4

Vlerësoni efikasitetin e kontrolleve për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave, d.m.th. parandalimin e zbulimit të paqëllimshëm të informacionit konfidencial.

Procedurat:

1. Vlerësoni sistemet e përdorura për monitorimin e qasjes dhe zbulimin e përpjekjeve të paautorizuara të brendshme apo të jashtme për të hyrë në sistemet e bankës (d.m.th., zbulimin e sulmuesit).

2. Vlerësoni kontrollin dhe sigurinë për të dhënat e transmetuara në vendet ose nga vendet në distancë. Të merret në konsideratë:
 - a. Lloji të dhënave të transmetuara;
 - b. Përdorimi i enkriptimit ose teknikave tjera të sigurisë (p.sh., firewalls);
 - c. Qasja në komponentët e rrjetit (serverët, ruterët, linjat telefonike, etj) që mbështesin transmetimin e të dhënave.

3. Vlerësoni kontrollet mbi qasjen nga distanca (përmes modemit apo linkut në internet) për të siguruar vetëm përdorimin/qasjen nga përdoruesit e autorizuar.

Objektivi 5

Vlerësoni përshtatshmërinë e politikave dhe procedurave të bankës për të siguruar disponueshmërinë e informacionit të automatizuar dhe mbështetjen e vazhdueshme për produktet dhe shërbimet e bazuara në teknologjinë informative.

Procedurat

1. Vlerësoni planifikimin për aktivitetet e menaxhimit të ngjarjeve. Të merren në konsideratë:
 - a. Procedurat e emergjencës dhe planet e evakuimit;
 - d. Reagimi ndaj sulmit apo depërtimit në rrjet;
 - e. Raportimi tek agjencitë e duhura rregullative apo agjencitë e zbatimit të ligjit.

2. Vlerësoni proceset dhe procedurat për parandalimin e shkatërrimit të dosjeve elektronike dhe mediave tjera të ruajtura. Të merret në konsideratë:
 - a. Shpeshtësia e krijimit të kopjeve rezervë të dosjes;
 - b. Qasja në dosjet rezervë dhe mediumin ruajtës (disqet, shiritat, etj.);
 - c. Lokacioni i ruajtjes jashtë dosjeve;
 - d. Mbrojtja e rrjeteve dhe kompjuterëve personal nga viruset.

3. Përcaktoni nëse qasje në zonën e kompjuterëve, mediumet elektronike dhe furnizimet e artikujve të negociueshëm ka vetëm personeli i autorizuar dhe nëse pajisjet dhe rrjetet mbështetëse të shërbimeve thelbësore të misionit janë

të siguruara në mënyrë të përshtatshme. Të merret në konsideratë siguria fizike, si dhe kontrollet mjedisore.

Objektivi 6

Vlerësoni proceset e bankës për menaxhimin e rrezikut operacional

Procedurat

1. Analizoni raportet e aplikueshme të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, pasi që ato ndërlidhen me rreziqet operationale.
2. Përcaktoni nëse vëllimi dhe natyra e mashtrimit dhe humbjeve të përpunimit, rrjeti dhe ndërprerjet e përpunimit, gabimet në përpunim të raportuara nga klientët, apo kritikët e auditimit ulin cilësinë e aktiviteteve dhe shërbimeve të automatizuara.
3. Përcaktoni nëse procesi i bankës për vlerësimin e rrezikut për informimin e klientëve dhe testimi i kontrolleve, sistemeve dhe procedurave kyçe në sistemin e sigurisë së bankës janë në përpjesëtim me ndjeshmërinë e informacioneve, si dhe kompleksitetin dhe fushëveprimin e aktiviteteve të bankës.
4. Vlerësoni afatin kohor, plotësinë, saktësinë dhe rëndësinë e sistemit të informimit të menaxhmentit për rrezikun operacional. Të merret në konsideratë burimi i raporteve, kontrollet mbi përgatitjen e raportit, si dhe validimi i pavarur i saktësisë së raportit. Raportet e menaxhimit të rrezikut duhet të mbulojnë burime të mëdha të rrezikut operacional, të identifikuara më lartë.
5. Përmes përdorimit të gjetjeve nga procedurat e mësipërme, të kombinuara me të dhënat nga ekzamineri përgjegjës dhe ekzaminerët tjerë, të bëhen vlerësimet paraprake mbi cilësinë e sistemeve të menaxhimit të rrezikut operacional. Të merret në konsideratë nëse:
 - a. Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti njohin dhe kuptojnë rreziqet ekzistuese dhe rreziqet e reja;
 - b. Bordi i drejtorëve krijon dhe komunikon politikat për administrimin e rrezikut operacional;
 - c. Menaxhmenti matë rrezikun në mënyrë të saktë dhe në kohë;
 - d. Menaxhmenti monitoron në mënyrë të saktë dhe të duhur kufizimet e përcaktuara të rrezikut.

Objektivi 7

Të vlerësohet përputhja e bankës me ligjet dhe kërkesat tjera prudenciale.

Procedurat:

1. Vlerësimi i përputhshmërisë me ligjet dhe kërkesat tjera prudenciale duhet të përfshijë:
 - a. Ligjet dhe Rregulloret;
 - b. Rregulloret e BQK-së;
 - c. Publikimet e tjera të BQK-së.

Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerit që shqyrton menaxhimentin.

Objektivi 8

Komunikoni gjetjet nga ekzaminimi dhe inicioni veprimet e duhura korrigjuese.

Procedurat:

1. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës, ofroni një përfundim të gjetjeve dhe arrini në një vlerësim të rrezikut operacional. Merrni në konsideratë:
 - a. Gjetjet nga të gjitha fushat e tjera të ekzaminimit;
 - b. Përfundimin e përgjithshëm;
 - c. Ndonjë rekomandim për menaxhmentin.
2. Përcaktoni ndikimin në rrezikun e përgjithshëm dhe drejtimin e vlerësimeve të rrezikut për çdo rrezik të identifikuar, përmes kryerjes së procedurave të mësipërme.
3. Përcaktoni, në konsultim me ekzaminerit përgjegjës, nëse rreziqet e identifikuara janë mjaftueshëm të rëndësishme për të fituar vëmendjen e bordit të drejtorëve në raportin e ekzaminimit.
4. Diskutoni të gjeturat dhe përfundimet me menaxhmentin në lidhje me rrezikun operacional. Konsideratat për diskutim mund të përfshijnë:
 - a. Përfundimet e përgjithshme;
 - b. Rekomandimet;
 - c. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve;

- d. Mungesat; dhe,
 - e. Nëse është e nevojshme, zotimin nga menaxhmenti për korrigjimin e mungesave të vërejtura dhe/ose çështjet që kërkojnë vëmendjen e bordit të drejtorëve.
5. Sipas nevojës, përgatitni komentet për përfshirje në raportin e ekzaminimit. Konsideratat për komente mund të përfshijnë:
- a. Sasinë e rrezikut të operacional;
 - b. Cilësinë e menaxhimit të rrezikut
 - c. Nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut operacional;
 - d. Ndikimin e ekspozimit aktual apo potencial ndaj rrezikut operacional në fitime dhe kapital;
 - e. Direktiva/rekomandime, nëse ka.

F. EKZAMINIMI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

1. Përshkrimi

1.1. Përfundim:

- Kapitali vlerësohet: 1, 2, 3, 4 apo 5.

1.2. Përbushni objektivat e kësaj pjese për të caktuar vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit. Në caktimin e vlerësimit, ekzamineri duhet të konsultohet me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminierët e tjerë të caktuar në pozicionet përkatëse. Gjatë caktimit të vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit, ekzaminierët duhet të marrin parasysh faktorët e vlerësimit, të cilët janë të përcaktuar në Udhëzuesin për vlerësimin sipas sistemit CAMELS.

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi 1

Përcaktoni vlerësimin e kapitalit dhe çfarëdo ndikimi potencial në vlerësimin e rrezikut në bankë.

Procedurat

1. Në fillim të ekzaminimit, zhvilloni diskutime me menaxhmentin, duke mbuluar:
 - a. Gjendjen e tanishme financiare të bankës dhe planet e saj të ardhshme në lidhje me politikën e dividendës, rritjen e kapitalit dhe shpërndarjen, produktet e reja, si dhe iniciativat e tjera strategjike që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm në kapital;
 - b. Strukturën aktuale aksionare të bankës dhe ndryshimet aktuale apo të planifikuara në kontrollin e pronësisë, nëse ka.
2. Shqyrtoni raportet paraprake të ekzaminimit, raportet prudenciale, informatat tjera të rregullatorit si dhe korrespondencat për të identifikuar ndonjë problem në këtë fushë që kërkon përcjellje të vazhdueshme.

3. Merrni informatat në lidhje me mjaftueshmërinë e kapitalit nga ekzamineri i caktuar për shqyrtimin e procesverbaleve të bordit të drejtorëve.
4. Diskutoni me ekzaminerin e caktuar për ekzaminimin e fushës "Auditimi dhe Kontrolli i Brendshëm" të vlerësuar sipas fushëveprimit standard dhe merrni ndonjë gjetje të rëndësishme nga auditimi i mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilat kërkojnë përcjellje të vazhdueshme.
5. Merrni dhe shqyrtoni informatat dhe dokumentet në vijim, sipas rastit:
 - a. Llogaritjet aktuale të bankës të kapitalit të bazuar në rrezik (kapitali rregullatorë);
 - b. Rezultatet nga fushat tjera të ekzaminimit që mund të ndikojnë në mjaftueshmërinë e kapitalit (p.sh. fitimet, kualiteti i mjeteve, etj.).
6. Shqyrtoni informacionet në vijim për të identifikuar trendet e mjaftueshmërisë e kapitalit të bankës:
 - a. Raportet e analizave financiare nga jashtë, gjatë monitorimit të aktiviteteve;
 - b. Raportet e përdorura nga menaxhmenti i bankës për të monitoruar dhe planifikuar kërkesat e kapitalit;
 - c. Treguesit e bankës në krahasim me bankat tjera të grupit të njëjtë krahasues.
7. Vlerësoni pajtueshmërinë e bankës me kërkesat prudenciale. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerit që shqyrton menaxhmentin.
8. Pas konsultimit me ekzaminerët që shqyrtojnë fusha tjera, ekzamineri i fushës përkatëse duhet të merr parasysh nëse aktivitetet e bankës, profili i rrezikut, apo kontrollet e rrezikut kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Nëse shqyrtimi i informacionit të mësipërm ngre çështje substanciale, ekzamineri duhet të zgjerojë fushën e aktivitetit për të përfshirë objektiva apo procedura shtesë, sipas nevojës. Nëse ky shqyrtim nuk rezulton në ndonjë ndryshim apo çështje të rëndësishme, përfundoni shqyrtimin e kapitalit.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

Objektivi 1

Përcaktoni mjaftueshmërinë dhe kualitetin e kapitalit.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5, në kuadër të vlerësimit sipas fushëveprimit minimal, kryeni edhe procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Vlerësoni gjasat e ndikimit të pikave në vijim në mjaftueshmërinë aktuale apo të ardhshme të kapitalit të bankës:
 - a. Dividendës dhe politikës së dividendës;
 - b. Fitimeve;
 - c. Kualiteti i mjeteve dhe mjaftueshmëria e provizioneve për humbjet nga kreditë dhe lizingjet;
 - d. Rritja historike dhe e planifikuar;
 - e. Aktivitetet bilancore dhe jashtëbilancore;
 - f. Iniciativat strategjike, duke përfshirë çfarëdo plani për rritjen dhe shpërndarjen e kapitalit apo shtesat të rëndësishme dhe të reja të kapitalit;
 - g. Planet financiare dhe buxhetet, duke përfshirë kostot e zëvendësimit për asetet fikse dhe teknologjinë;
 - h. Produktet, shërbimet apo kanalet e reja të shpërndarjes;
 - i. Organizatat e ndërlidhura (amë, vartëse, partnere, etj.).
2. Vlerësoni burimet tjera të kapitalit. Të merren në konsideratë:
 - a. Gjendja financiare e aksionarëve kryesorë, amë, apo filialeve;
 - b. Potenciali për ofertuesit publik ose privat.
3. Vlerësoni në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët tjerë, informacionet në lidhje me rreziqet neto apo drejtimin e çfarëdo rreziku që mund të ketë një ndikim negativ në mjaftueshmërinë e tanishme ose të ardhshme të kapitalit.

Objektivi 2

Të përcaktohet kualiteti i sistemeve të menaxhimit të rrezikut përmes diskutimeve me menaxhmentin dhe analizimi i informacioneve të nevojshme.

Procedurat

Përveç pikës 7 në kuadër të vlerësimit sipas fushëveprimit minimal, kryeni procedurat shtesë në vijim:

1. Vlerësoni sistemin e kontroleve të brendshme të bankës mbi llogaritë kapitale. Gjithashtu merrni në konsideratë kontrollet e tjera përkatëse të kapitalit.
2. Vlerësoni afatet kohore, plotësinë, saktësinë dhe rëndësinë e sistemit të informimit të menaxhmentit për kapitalin. Merrni në konsideratë burimet e raporteve, kontrollet gjatë përgatitjes së raporteve dhe nëse saktësia e raporteve është vërtetuar në mënyrë të pavarur. Ky shqyrtim duhet të koordinohet me ekzaminerët e caktuar për të gjitha fushat funksionale të ekzaminimit, duke përfshirë kontrollet e brendshme, për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve; gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerit që shqyrton rrezikun operacional.

Objektivi 3

Rekomandoni veprimet korrigjuese, nëse ka.

Procedurat

1. Rregulloni llogaritjen e raportuar të kapitalit të bankës për të pasqyruar rezultatet e ekzaminimit, duke pasur parasysh:
 - a. Rekomandimet për provizione shtesë për humbjet nga kreditë dhe lizingjet;
 - b. Gabimet, nëse ka, në raportimin financiar;
 - c. Rekomandimet për shlyerjet direkte të aseteve, nëse ka.
2. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët tjerë, identifikoni dhe komunikoni ekzaminerëve tjerë, sipas nevojës, konkluzionet dhe gjetjet nga shqyrtimi i kapitalit që janë të rëndësishme për fushat e tjera nën shqyrtim.

3. Në diskutim me ekzaminerin përgjegjës, ofroni konkluzionet preliminare në lidhje me:
 - a. Vlerësimin e kapitalit;
 - b. Direktivat dhe/apo rekomandimet, nëse ka.
4. Diskutoni dhe pajtohuni me menaxhmentin e bankës në lidhje me vlerësimin tuaj preliminar dhe rekomandimet, siç është konkluduar në pikën 3 më lartë.
5. Të përdoren rezultatet e procedurave të mësipërme dhe të gjitha të gjeturat tjera nga ekzaminimi, të zbatueshme për të hartuar komentet e përshtatshme për raportin e ekzaminimit.

G. EKZAMINIMI I FITIMEVE

1. Përshkrimi

1.1. Përmbledhje:

- Fitimet vlerësohen: 1, 2, 3, 4 apo 5.

1.2. Përmbushni objektivat e kësaj pjese për të caktuar vlerësimin e fitimeve. Në caktimin e vlerësimeve, ekzamineri duhet të konsultohet me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët e tjerë të caktuar. Gjatë caktimit të vlerësimit të fitimeve, ekzamineri duhet të marrin parasysh faktorët e vlerësimit të përcaktuar në Udhëzuesin për vlerësimin sipas sistemit CAMELS.

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi 1

Përcaktoni komponentin e vlerësimit të fitimeve dhe çfarëdo ndikimi potencial në vlerësimin e rrezikut në bankë.

Procedurat

1. Në fillim të ekzaminimit, diskutoni me menaxhmentin e bankës në lidhje me:
 - a. Buxhetin dhe procesin e buxhetimit, si dhe ndryshimet e planifikuara, nëse ka;
 - b. Gjendjen e tanishme financiare dhe pritjet e menaxhmentit për të ardhmen si dhe,
 - c. Trendin e fitimeve dhe shpjegimet e menaxhmentit për variancat.
2. Shqyrtoni raportet e mëparshme të ekzaminimit, raportet prudenciale, informatat tjera të rregullatorit si dhe korrespondencat për të identifikuar çështje në fitimet që kërkon përcjellje të mëtejme.

3. Merrni informacione të ndërlidhura me fitimet nga ekzaminerët e caktuar për shqyrtimin e procesverbaleve të bordit të drejtorëve.
4. Diskutoni me ekzaminerin përgjegjës për përfundimin e pjesës së "Auditimit dhe Kontrollit të Brendshëm" të vlerësuar sipas fushëveprimit standard dhe merrni gjetjet e rëndësishme nga auditimi mbi fitimet të cilat kërkojnë përcjellje të mëtejme.
5. Merrni dhe shqyrtoni informacionet dhe dokumentet në vijim, sipas rastit:
 - a. Planin strategjik dhe të biznesit;
 - b. Bilancin më të fundit të gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave;
 - c. Buxhetin;
 - d. Politikat dhe procedurat mbi ndërprerjen e përlogaritjes të interesit të mjeteve joperformuese;
 - e. Çfarëdo raporti tjetër në lidhje me fitimet.
6. Përcaktoni nëse ka pasur ndryshime të konsiderueshme në aktivitetet bankare, profilin e rrezikut apo kontrollet e rrezikut pas konsultimit me ekzaminerët që shqyrtojnë fushat tjera. Nëse jo, përfundoni shqyrtimin e fitimeve duke caktuar vlerësimin e duhur.
7. Nëse kanë ndodhur ndryshime të konsiderueshme në aktivitetet bankare, profilin e rrezikut apo kontrollet e rrezikut, zgjerojeni fushëveprimin e shqyrtimit duke përfshirë objektiva apo procedura të përcaktuara në kuadër të vlerësimit sipas fushëveprimit standard.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

Objektivi 1

Përcaktoni kualitetin dhe përbërjen e fitimeve.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 në kuadër të vlerësimit sipas fushëveprimit minimal, kryeni edhe procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Identifikoni trendët në performancën e fitimeve të bankës dhe përcaktoni nëse trendi i fitimeve të bankës është duke u përmirësuar, stabil apo janë në rënie, përmes shqyrtimit të informacioneve në vijim:
 - a. Raportet e analizave financiare të përpiluara nga kthimet periodike prudenciale;
 - b. Raportet e bankës të përdorura për monitorimin dhe planifikimin e fitimeve (p.sh. llogaritë e menaxhmentit, raportet e variancës, etj.);
 - c. Fitimet aktuale të bankës në krahasim me buxhetin dhe grupin e bankave krahasuese;
 - d. Raportet krahasuese të profitabilitetit me bankat tjera të grupit të njëjtë krahasues.
2. Diskutoni me menaxhmentin dhe merrni shpjegime mbi trendët dhe variancat e identifikuara të fitimeve.
3. Analizoni fitimet e bankës duke ekzaminuar:
 - a. Përbërjen dhe burimet kryesore të fitimeve;
 - b. Marzhat neto të interesit;
 - c. Të ardhurat dhe shpenzimet nga jo interesi;
 - d. Rezervat për kreditë;
 - e. Zërat jashtëbilancor;
 - f. Ndryshimet në përbërjen e bilancit të gjendjes;
 - g. Çmimet e kredive dhe depozitave;
 - h. Fitimet nga filialet;
 - i. Fitimet nga linjat me rrezik të lartë të biznesit; dhe,
 - j. Politikën e dividendës së bankës.
4. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët e tjerë, vlerësoni nëse niveli apo drejtimi i ndonjë rreziku ka ndikim negativ në fitimet aktuale ose të ardhshme të bankës.
5. Rregulloni fitimet e raportuara të bankës për të pasqyruar rezultatet e ekzaminimit, ku është e nevojshme dhe planifikoni të ardhurat neto për vitin aktual. Njoftoni për rregullimet ekzaminerët e duhur.

Objektivi 2

Përcaktoni përshtatshmërinë e procesit të buxhetimit të bankës.

Procedurat:

1. Shqyrtoni dhe përcaktoni arsyeshmërinë e faktorëve në vijim në buxhetin e bankës:
 - a. Supozimet ekonomike, të tregut dhe supozimet e tjera;
 - b. Planin e biznesit të bankës dhe strategjitë;
 - c. Raportet e variancave dhe raportet e tjera shtesë buxhetore.

Objektivi 3

Përcaktoni kualitetin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut përmes diskutimeve me menaxhmentin dhe analizave të raporteve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm dhe çfarëdo raporti tjetër relevant.

Procedurat

1. Vlerësoni sistemin e kontrollave të brendshme të bankës mbi llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ekzaminerët duhet të marrin parasysh edhe kontrollet tjera që i përkasin fitimeve.
2. Vlerësoni afatet kohore, plotësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, si dhe raportet tjera informative të menaxhmentit për të ardhurat. Shqyrtoni:
 - a. Burimin e raporteve;
 - b. Kontrollet gjatë përgatitjeve të raporteve;
 - c. Nëse është vërtetuar në mënyrë të pavarur saktësia e raportit.
3. Ky shqyrtim duhet të koordinohet me ekzamineret përgjegjës për të gjitha fushat funksionale të ekzaminimit, duke përfshirë kontrollet e brendshme, për të shmangur dyfishimin e punëve; gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminuesit që shqyrton rrezikun operacional.

Objektivi 4

Caktoni vlerësimin dhe rekomandoni veprimet korigjuese, nëse ka.

Procedurat

1. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminert tjerë, identifikoni dhe komunikoni ekzaminert tjerë, sipas nevojës, përfundimet dhe gjetjet nga shqyrtimi i fitimeve të cilat janë relevante për fushat e tjera nën shqyrtim.
2. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës, arrini në konkluzione prelimnare mbi:
 - a. Vlerësimin e fitimeve; dhe
 - b. Direktivat dhe/ose rekomandimet, nëse ka ndonjë.
3. Diskutoni dhe pajtohuni me menaxhmentin e bankës në lidhje me vlerësimin tuaj fillestar dhe rekomandimet, siç është konkluduar në hapin 2 më lartë.
4. Duke përdorur rezultatet e procedurave të mësipërme dhe të gjitha të gjeturat tjera nga ekzaminimi, përpilo komentet e përshtatshme për raportin e ekzaminimit.

H. EKZAMINIMI I MENAXHMENTIT

1. Përshkrimi

1.1. Përmbledhje:

- Menaxhmenti vlerësohet: 1, 2, 3, 4 apo 5.

1.2. Kompletoni objektivat e këtij seksioni që të caktoni vlerësimin e menaxhmentit.

Shumë nga hapat në këto procedura të ekzaminimit kërkojnë mbledhjen e informatave nga, ose shqyrtimin e informatave me ekzaminerët në fusha të tjera. Pasi që fushat e tjera mund të përfshijnë procedura të ekzaminimit që adresojnë proceset e menaxhimit, diskutoni shqyrtimin me ekzaminerët e tjerë për të zvogëluar barrën mbi bankën dhe për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve. Ndani të dhënat e ekzaminimit që të keni një verifikim efektiv të pajtueshmërisë dhe t'i ndihmoni ekzaminerët në vlerësimin e integritetit të sistemit të informimit të menaxhmentit. Kur të bëni vlerësimin e menaxhmentit, ekzaminerët duhet të marrin parasysh faktorët e vlerësimit të përcaktuara në Udhëzuesin për vlerësimin sipas sistemit CAMELS.

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi 1

Përcaktoni komponentin e vlerësimit të menaxhmentit dhe merreni parasysh ndikimin potencial të këtyre gjetjeve në vlerësimin e rrezikut të bankës.

Procedurat

1. Në fillim të ekzaminimit, diskutoni me menaxhmentin e bankës pikat në vijim:
 - a. Çdo ndryshim apo ndryshim të propozuar në menaxhmentin e lartë dhe/ose bordin e drejtorëve dhe komitetet e tij;
 - b. Miratimin e planit strategjik nga bordi i drejtorëve;
 - c. Planet financiare dhe operationale, në qoftë se janë të ndara nga plani strategjik;

- d. Burimet dhe personelin e nevojshëm për përmbushjen e qëllimeve strategjike;
 - e. Çdo ndryshim në produktet, shërbimet, kanalet e shpërndarjes, ofruesit e shërbimeve, etj.;
 - f. Planet e vazhdimësisë së menaxhmentit.
2. Shqyrtoni informacionin dhe dokumentet e mëposhtme:
- a. Procesverbalet e bordit të drejtorëve dhe komiteteve të bordit të drejtorëve që nga ekzaminimi i fundit;
 - b. Procesverbalin e komiteteve të menaxhmentit që nga ekzaminimi i fundit;
 - c. Raportet e mëparshme të ekzaminimit që kanë të bëjnë me menaxhmentin dhe përgjigjet e bordit të drejtorëve;
 - d. Raportet e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm; dhe,
 - e. Korrespondencën në mes të bankës dhe BQK-së.
3. Diskutoni me ekzaminerin përgjegjës për shqyrtimin e fushës së auditimit dhe kontrollit të brendshëm, të vlerësuar sipas fushëveprimit minimal dhe siguron çfarëdo gjetje të rëndësishme për menaxhmenti nga të dy fushat, që ka nevojë të përcillet më tutje.
4. Në konsultim me ekzaminerët, vlerësoni shqyrtimin fushave tjera, pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret dhe politikat që kanë të bëjnë me menaxhimin e bankës. Duhet të shqyrtohen pikat vijuese:
- a. Shkeljet e mundshme të ligjeve dhe rregulloreve;
 - b. Nëse shkeljet e mëparshme të ligjeve janë korrigjuar në mënyrë të përshtatshme;
 - c. Sasinë e ekspozimit të rrezikut në të ardhurat e bankës dhe kapitalit për shkak të mospërshtatjes me ligjet, rregulloret, politikat, ose praktikatat e qëndrueshme financiare.
5. Përcaktoni nëse ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në aktivitetet e bankës, profilin e rrezikut, ose kontrolle të rrezikut pas konsultimit me ekzaminerët që janë caktuar për të shqyrtuar fushat tjera. Nëse jo, përfundojeni shqyrtimin e menaxhmentit duke e caktuar një vlerësim të duhur.

6. Nëse kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në aktivitetet e bankës, profilin e rrezikut ose kontrollet e rrezikut, zgjerojeni fushëveprimin e shqyrtimit për të përfshirë objektiva ose procedura shtesë të përshkruara nën seksionin e vlerësimit sipas fushëveprimit standard.

2.2 Vlerësimi i fushëveprimit standard

Cilësia e menaxhimit të rrezikut

Politika

Objektivi 1

Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve i ka miratuar politikat adekuate për të gjitha fushat e rëndësishme të bankës.

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 dhe 5 në kuadër të vlerësimit sipas fushëveprimit minimal, kryeni edhe procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Siguroni një listë të të gjitha fushave të operacioneve të bankës që administrohen sipas dispozitave të objektivave dhe politikave të aprovuara nga bordi i drejtorëve.
2. Përcaktoni nëse janë zbatuar politikat. Vlerësoni:
 - a. Veprimin ose mosveprimin e menaxhmentit për zbatimin e politikave dhe procedurave të duhura;
 - b. Çdo politikë që nuk është dokument pune;
 - c. Arsyen pse disa politika të caktuara nuk janë zbatuar, ose nëse janë zbatuar, nuk janë duke u ndjekur.
3. Përcaktoni se si bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti sigurojnë që politikat e miratuara janë duke u ndjekur dhe që përjashtimet janë të dokumentuara.
4. Së bashku me ekzaminerët e caktuar për shqyrtimin e secilës fushë të bankës, përcaktoni nëse politikat janë të duhura (disa teste mund të jenë të nevojshme).
5. Përcaktoni arsyeshmërinë e politikës së bankës për pushimet. A u kërkohet menaxhmentit dhe të punësuarve që të marrin dy javë radhazi të pushimit, në qoftë se ata kanë të drejtë në të?

Proceset

Procesi i politikëbërjes

Objektivi 1

Përcaktoni përshtatshmërinë e procedurave operative, programeve dhe praktikave të bankës.

Procedurat:

1. Përcaktoni nëse procesi i politikëbërjes i merr parasysh pikat në vijim:
 - a. Kërkesat rregullatore;
 - b. Rreziqet e vetvetishme;
 - c. Planet strategjike, operative dhe të kapitalit;
 - d. Gjendjen financiare të bankës;
 - e. Dallimet në mes të qëllimeve të planifikuara dhe gjendjes aktuale;
 - f. Origjinën e politikave dhe procesin e miratimit.
2. Përcaktoni pikëpamjen e menaxhmentit dhe të kuptuarit e funksioneve të planifikimit dhe hartimit të politikave dhe ndikimin e tyre në efikasitetin e operacioneve.
3. Vlerësoni sistemin e përdorur nga menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve për të siguruar shqyrtimin periodik dhe rishikimin e politikave.

Planifikimi

1. Përcaktoni nëse menaxhmenti ka identifikuar llojin e organizatës që dëshiron që banka të jetë në të ardhmen dhe se si planifikon që ta arrijë këtë qëllim në të ardhmen, dhe nëse kjo ka marrë miratimin bordit të drejtorëve.
2. Përcaktoni se si është organizuar banka nga bordi i drejtorëve dhe si merren vendimet e mëdha, duke marrë parasysh:
 - a. Drejtimin e dhënë nga bordi i drejtorëve dhe ndjekja e atij drejtimi nga ana e menaxhmentit;
 - b. Përfshirjen e drejtorëve në proces;
 - c. Nëse menaxhmenti i bën prezantimet në bord të drejtorëve në lidhje me produktet, aktivitetet e reja, etj.;

- d. Si merren vendimet për përvetësime, shitje të asetëve dhe hapje të degëve;
 - e. Nëse banka është e pavarur ose anëtarë i një holding kompanie;
 - f. Për bankat anëtare të një holding kompanie, vlerësoni shkallën e autonomisë në bërjen e politikave, zhvillimin e produkteve, përcaktimin e tregut "niche", reklamimin, hulumtimin e tregut dhe hyrjen apo daljen nga një treg.
3. Përcaktoni teknikat që i përdorë menaxhmenti në planifikim duke marrë parasysh:
- a. Si janë vendosur qëllimet, objektivat, parametrat dhe supozimet dhe se si komunikohen ato;
 - b. Si vlerësohen aktivitetet bankare;
 - c. Planet e veprimit, duke përfshirë kërkesat e resurseve;
 - d. Përfshirjen e drejtorëve, menaxherëve të lartë dhe menaxherëve të mesëm;
 - e. Roli i kryeshefit ekzekutiv.
4. Përcaktoni sesi i përfshin menaxhmenti faktorët konkurrues kur bën plane, zhvillon produkte të reja, ose hyn në tregje të reja, duke e marrë parasysh:
- a. Pikëpamjen e menaxhmentit ndaj konkurrentëve tradicional dhe jotradicional;
 - b. Avantazhet dhe disavantazhet krahasuese, në krahasim me konkurrencën.
5. Përcaktoni nëse menaxhmenti i identifikon dëshirat dhe nevojat e konsumatorëve përpara se të bëjë plane, zhvillojë produkte të reja, apo tregje të reja, duke marrë parasysh:
- a. Llojet e përdorura të hulumtimit të tregut, të tilla si anketat, grupet e fokusit, shërbimet e jashtme; dhe,
 - b. Dosjet e informimit të konsumatorëve dhe studimet e profilit.
6. Përcaktoni se si menaxhmenti planifikon produktet e reja. A merr parasysh:
- a. Kujdesin e duhur ("Due diligence") /studimet e fizibilitetit;

- b. Parashikimet financiare - duke përfshirë se kur produktet do të sigurojnë një kthim dhe kur do të rivlerësohet rentabiliteti i produkteve;
 - c. Analiza e rrezikut/përgjegjësisë;
 - d. Opinionet ligjore;
 - e. Nivelin e përfshirjes së departamentit të auditimit.
7. Përcaktoni nëse menaxhmenti e matë efektin e planeve të veta në operacionet e tij duke marrë parasysh:
 - a. Rrezikun;
 - b. Kërkesat rregullatore;
 - c. Gjendjen financiare të bankës;
 - d. Aftësinë e menaxhmentit dhe kërkesat e burimeve njerëzore;
 - e. Objektet fizike;
 - f. Mjaftueshmërinë e sistemit për menaxhimin e informatave dhe sistemeve operative për ta përballuar rritjen;
 - g. Përzierjen aktuale të produkteve dhe zhvillimin e ardhshëm të produkteve;
 - h. Mjedisin teknologjik;
 - i. Perceptimin publik;
 - j. Trendët sociologjik.
8. Përcaktoni nëse janë vendosur qëllimet dhe objektivat për të ardhmen dhe nëse drejtorët i kanë miratuar ato dhe menaxherët janë në dijeni të tyre. Merrni parasysh:
 - a. Vizionin e kryeshefit ekzekutiv / bordit të drejtorëve për të ardhmen;
 - b. Misionin e bankës (çfarë është ose çfarë do të dëshironte bordi i drejtorëve të jetë ai);
 - c. Qëllimet dhe objektivat kualitative e po ashtu edhe kuantitative;
 - d. Pjesëmarrjen e drejtorëve dhe niveleve të ndryshme të menaxhmentit;
 - e. Si u komunikohen informatat atyre që kanë nevojë t'i dinë ato.
9. Përcaktoni nëse menaxhmenti ka plane të hartuara për të arritur qëllimet dhe objektivat e deklaruara. Merrni parasysh:
 - a. Nëse ekzistojnë planet e veprimit;

- b. Si zbatohen planet e veprimit;
 - c. Llogaridhënien e menaxhmentit;
 - d. Kërkesat për resurse;
 - e. Komunikimin.
10. Përcaktoni se si e vlerëson menaxhmenti vlefshmërinë e planeve të veprimit për të shmangur konfliktet midis njësive të biznesit të bankës. Merrni parasysh:
- a. Kapacitetin e bankës për të furnizuar me burimet e nevojshme (njerëz, sisteme, objekte/pajisjet, reklamat) për zbatimin e planeve;
 - b. Dispozicionin e njerëzve, sistemeve, objekteve;
 - c. Llogaridhënien e menaxherëve për zbatimin e planeve dhe arritjen e objektivave;
 - d. Përfshirjen e kryeshefit ekzekutiv dhe bordit të drejtorëve.
11. Përcaktoni se si janë vlerësuar planet pas zbatimit dhe nëse planet janë mjaftueshëm fleksibile për të marr parasysh të papriturat apo ndryshimet. Merrni parasysh:
- a. Shpeshhtësinë dhe metodën e vlerësimit;
 - b. Përfshirjen e kryeshefit ekzekutiv dhe bordit të drejtorëve;
 - c. Llogaridhënien e menaxherëve për zbatimin e planeve dhe arritjen e objektivave;
 - d. Nëse bordi i drejtorëve i shqyrton dhe miraton planet;
 - e. Ekzistencën e sistemeve për t'i bërë ndryshimet;
 - f. Ekzistencën e sistemit për të raportuar progresin drejt objektivave.
12. Përcaktoni nëse plani (strategjik) afatgjatë ofron kornizë për zhvillimin e planeve (operacionale) afatshkurtra.
13. Përcaktoni mekanizmat ekzistues për të siguruar pajtueshmërinë në mes të planeve afatshkurtra dhe afatgjata duke i informuar ose duke u informuar nga ekzaminuesit e tjerë për pikat vijuese:
- a. Planin / buxhetin vjetor financiar;
 - b. Planin e kapitalit;
 - c. Planin e aseteve/detyrimeve;

- d. Planin e marketingut;
- e. Planin e aseteve fikse;
- f. Çdo plan tjetër.

14. Përcaktoni nëse vendimet e mëdha janë marrë në kontekstin e planit të përgjithshëm të institucionit.

Personeli

Ekzamineri duhet të bisedojë me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët tjerë në marrjen e konkluzioneve në lidhje me përshtatshmërinë e personelit të bankës ose të menaxhmentit të lartë.

Objektivi 1

Përcaktoni nëse aktivitetet e personelit të bankës janë të monitoruara nga menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve për të siguruar konsistencë me qëllimet e bankës dhe me çdo ligj, rregullore dhe politikë në fuqi.

Procedurat

1. Përcaktoni se si menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve e përcaktojnë nëse struktura organizative e bankës pasqyron me saktësi nivelet funksionale të përgjegjësisë dhe vijat e autoritetit.
2. Përcaktoni nëse bankat i kanë përshkrimet / përgjegjësitë e punës të shkruara.
3. Përcaktoni se si menaxhmenti siguron që përshkrimet e punës janë të qarta dhe reflektojnë detyrat dhe përgjegjësitë. Merrni parasysh:
 - a. Përshtatshmërinë e njohurive dhe aftësive të kërkuara;
 - b. Bazën për vlerësimin e performancës;
 - c. Metodën e përdorur në zhvillimin ose mbikëqyrjen e procesit të përshkrimit të vendeve të punës;
 - d. Marrëdhënien me programin e kompensimit.
4. Përcaktoni se si e siguron menaxhmenti personelin adekuat në të gjitha nivelet. Merrni parasysh:
 - a. Metodatat e rekrutimit;

- b. Standardet e performancës;
 - c. Programet e trajnimit;
 - d. Planet e vazhdimësisë së menaxhmentit;
 - e. Programet e kompensimit; dhe,
 - f. Përfitimet e punonjësve.
5. Përcaktoni se si e vlerëson menaxhmenti performancën e punonjësve.
 6. Përcaktoni se si e vlerëson bordi i drejtorëve performancën e menaxhmentit.
 7. Përcaktoni se si menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve sigurojnë që rrogat dhe përfitimet janë të drejta dhe konkurruese.
 8. Përcaktoni metodën të cilën e përdor menaxhmenti për të promovuar një sistem efektiv të komunikimit. Merrni parasysh sistemet e tilla si:
 - a. Takimet me stafin;
 - b. Intervistat me punonjësit;
 - c. Doracakët e punonjësve, buletinet, etj.;
 - d. Memot për të gjithë punonjësit, e-mailat si dhe komunikimet tjera.

Kontrollet

Objektivi 1

Për të siguruar që menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve kanë krijuar sisteme efektive të kontrollit për të përmbushur përgjegjësitë e tyre dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

Procedurat:

1. Rishikoni funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm pasi që ato ndërlidhen me menaxhmentin. Merrni parasysh:
 - a. Shqyrtimin e transaksioneve të brendshme nga menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve për pajtueshmëri me ligjet, rregulloret dhe politikatat;
 - b. Veprimi korrigjues me kohë i menaxhmentit për të adresuar mangësitë e shfaqura nga ekzaminimet e rregullatorit, auditimet e jashtme / të brendshme, pajtueshmëria, dhe/ose funksionet e brendshme shqyrtuese.

2. Përcaktoni sistemet që i përdorin menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve për të kontrolluar dhe monitoruar aktivitetet. Merrni parasysh:
 - a. Kontrollat e brendshme;
 - b. Mbulimin e auditimit;
 - c. Shqyrtimin e kualitetit të mjeteve (përfshirë rishikimin e kredive);
 - d. Sistemet e menaxhimit të rrezikut;
 - e. Sistemet e menaxhimit të pajtueshmërisë.

3. Përcaktoni shkallën në të cilën bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti janë të përfshirë në sistemet e kontrollit. Merrni parasysh:
 - a. Përshtatshmërinë, afatin kohor, si dhe shpërndarjen e raporteve të ndryshme;
 - b. Shqyrtimin periodik për të përcaktuar respektimin e politikave dhe procedurave.

4. Përcaktoni nëse banka ka një program të auditimit të jashtëm / brendshëm të miratuar nga bordi i drejtorëve. Vlerësoni përshtatshmërinë e programit. Merrni parasysh:
 - a. Pavarësinë e auditorëve, përfshirë linjat raportuese;
 - b. Kualifikimin e auditorëve;
 - c. Mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e programit të auditimit;
 - d. Efikasitetin e përgjigjes së menaxhmentit ndaj auditimit të brendshëm si dhe në korrigjimin e shqetësimeve të identifikuara të auditimit;
 - e. Shkallën dhe efikasitetin e mbikëqyrjes së komitetit të auditimit;
 - f. Shqyrtimin i auditimit të jashtëm për auditorët e brendshëm;
 - g. Rezultatet e aktiviteteve mbikëqyrëse të mëparshme.

5. Përcaktoni procesin e përdorur nga menaxhmenti për të siguruar që kontrollet e brendshme funksionojnë siç duhet. Merrni parasysh:
 - a. Burimet dhe saktësinë e informacionit;
 - b. Shqyrtimin e kontrolleve të brendshme kur ndodhin ndryshimet në operacione;
 - c. Rolet në zhvillimin e produkteve të reja apo ndryshimet në operacione;

- d. Trajnimin e personelit për të siguruar që ndiqen politikat dhe procedurat e përcaktuara;
 - e. Përpjekjet e bëra nga bordi i drejtorëve dhe menaxherët për të korrigjuar mangësitë;
 - f. Marrëdhëniet me auditorin e brendshëm.
6. Shqyrtoni sistemet e vendosura për monitorim të kualitetit të mjeteve. Merrni parasysh:
- a. Pavarësinë e personelit;
 - b. Saktësinë e problemeve të identifikuara dhe vlerësuara;
 - c. Mbulimin e mjeteve gjatë një cikli;
 - d. Efikasitetin si një sistem i paralajmërimit të hershëm.
7. Shqyrtoni sistemet për menaxhim të rrezikut. Merrni parasysh:
- a. Përqendrimet e kredisë ose aktiviteteve tjera;
 - b. Produktet dhe shërbimet ekzistuese;
 - c. Produktet dhe shërbimet e reja;
 - d. Aktivitetet jashtëbilancore; dhe,
 - e. Përfshirja/të kuptuarit e bordit të drejtorëve.
8. Shqyrtoni programin e menaxhimit të pajtueshmërisë. Merrni në konsideratë:
- a. Llogaridhënien;
 - b. Fushat e mbuluara dhe thellësinë e mbulueshmërisë;
 - c. Përpjekjet për monitorim dhe përputhje me kërkesat e reja, aty ku është e nevojshme;
 - d. Raportimin;
 - e. Korrigjimin e mangësive;
 - f. Kualifikimet e atyre që janë të përfshirë;
 - g. Kërkesat rregullative.

Objektivi 2

Përcaktoni nëse sistemi për menaxhimin e informatave i përdorur nga menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve matë në mënyrë të përshtatshme performancën e bankës, ndihmon në procesin e vendimmarrjes dhe vlerëson efikasitetin e politikave, proceseve dhe mekanizmat e kontrollit ekzistuese.

Procedurat

1. Përcaktoni nëse gjetjet dhe përfundimet nga sistemet e kontrollit të brendshëm japin informacion të përshtatshëm, të shpejtë, të saktë, të dobishëm dhe të kuptueshëm për menaxhmentin dhe bordin e drejtorëve. Merrni parasysh:
 - a. Shqyrtimet e kualitetit të mjeteve (përfshirë rishikimin e kredive);
 - b. Krahasimet e performancës financiare dhe buxhetit;
 - c. Raportet e menaxhimit të fondeve;
 - d. Raportet e komiteteve të bordit të drejtorëve.
2. Përcaktoni çfarë mekanizma ekzistojnë për të siguruar informacionet relevante, të sakta, të dobishme, dhe në kohë.
3. Vlerësoni shpërndarjen e informacionit në mes të niveleve të menaxhmentit të bankës dhe në mes të departamenteve të tilla si:
 - a. Menaxhmenti dhe drejtorët e tjerë;
 - b. Menaxhmenti dhe stafi;
 - c. Banka dhe kompania holding ose filialet.
4. Analizoni efikasitetin e sistemit për menaxhimin e informatave. Merrni parasysh:
 - a. Njohuritë dhe të kuptuarit e menaxhmentit për sistemet e informacionit;
 - b. Përdorimi i të dhënave në procesin e vendimmarrjes.

Kokluzionet

Objektivi 1

Komunikoni gjetjet e ekzaminimit dhe ndërmerrni veprimet e duhura korrigjuese.

Procedurat

1. Në konsultim me ekzaminuesin përgjegjës, siguroni konkluzionet e të gjeturave. Merrni parasysht:
 - a. Gjetjet nga të gjitha fushat e tjera që janë duke u ekzaminuar;
 - b. Konkluzionin e përgjithshëm;
 - c. Çdo rekomandim për menaxhmentin;
 - d. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve.
2. Përcaktoni ndikimin e përgjithshëm dhe drejtimin e vlerësimeve të rrezikut për çdo rrezik të zbatueshëm të identifikuar duke kryer procedurat e mësipërme.
3. Përcaktoni, në konsultim me ekzaminuesin përgjegjës, nëse rreziqet e identifikuar janë mjaftueshëm të rëndësishme që të meritojnë t'i sjellim ato në vëmendjen e bordit të drejtorëve në raportin e ekzaminimit.
4. Diskutoni gjetjet me menaxhmentin dhe bini dakord për përfundimet në lidhje me rreziqet e zbatueshme. Çështjet për diskutime mund të përfshijnë:
 - a. Konkluzionet e përgjithshme;
 - b. Rekomandimet;
 - c. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve;
 - d. Mangësitë;
 - e. Nëse është e zbatueshme, zotimin nga menaxhmenti për të korrigjuar shkeljet e ligjeve dhe/ose çështjeve që kërkojnë vëmendjen e bordit të drejtorëve.
5. Sipas nevojës, përgatitni komentet për përfshirje në raportin e ekzaminimit. Çështjet për komente mund të përfshijnë:
 - a. Shpeshhtësinë dhe efikasitetin e takimeve;
 - b. Efikasitetin e bordit të drejtorëve dhe komiteteve të menaxhmentit
 - c. Rolin e menaxhmentit në krijimin dhe zbatimin e politikave;
 - d. Çdo mospërputhje të madhe në politika;
 - e. Cilësinë e raporteve për menaxhmentin;
 - f. Shkeljet e ligjeve, rregulloreve dhe rregullave.

I. EKZAMINIMI I NDJESHMËRISË NDAJ RREZIKUT TË TREGUT

1. Përshkrimi

1.1. Përmbledhje:

- Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut vlerësohet: 1, 2, 3, 4 apo 5.

1.2. Përfundoni objektivat e këtij seksioni që të caktoni ndjeshmërinë e vlerësimit të komponentit ndaj rrezikut të tregut. (Shënim: Rreziku i tregut përfshinë: RrNI, rrezikun e çmimit si dhe rrezikun e këmbimit valutor).

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi 1

Përcaktoni komponentin e vlerësimit të ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut, sasinë e rrezikut dhe cilësinë e menaxhimit të rrezikut për RrNI, rrezikun e çmimit dhe rrezikun nga konvertimi i valutës së huaj.

Procedurat

1. Në fillim të aktivitetit mbikëqyrës, diskutoni me menaxhmentin që mbulon ndryshimet e mëposhtme aktuale dhe të planifikuara:
 - a. Ndryshimet e politikës së RrNI (p.sh. strukturën e limiteve, matjen e rrezikut);
 - b. Ndryshimet në procesin e menaxhimit të RrNI;
 - c. Ndryshimet materiale në strukturën e aseteve dhe obligimeve të bankës;
 - d. Ndryshimet në ndikimin e portofolit të investimeve mbi RrNI; dhe,
 - e. Ndryshimet në nivelin e çmimit ose rrezikun nga konvertimi i valutës së huaj.
2. Diskutoni me ekzaminerin përgjegjës për plotësimin seksionit të auditimit dhe kontrollit të brendshëm të vlerësuar sipas fushëveprimit minimal dhe siguroni çfarëdo gjetje të rëndësishme mbi ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut për përcjellje.

3. Siguroni dhe shqyrtoni informacionet dhe dokumentet e mëposhtme, për çfarëdo çështje mbi ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut, sipas nevojës:
 - a. Procesverbalin e bordit të drejtorëve dhe komiteteve të bordit të drejtorëve që nga ekzaminimi i fundit;
 - b. Procesverbalet e komiteteve të menaxhmentit që nga ekzaminimi i fundit;
 - c. Raportet e mëhershme të ekzaminimit që kanë të bëjnë me përgjigjet e menaxhmentit dhe bordit të drejtorëve;
 - d. Raportet e auditorit të brendshëm dhe të jashtëm,
 - e. Procesverbalet e ALCO.
4. Përcaktoni pajtueshmërinë e bankës me ligjet dhe rregulloret përkatëse. Merrni parasysh:
 - a. Instrumentet statusore;
 - b. Rregullat e BQK dhe publikimeve tjera.
5. Përcaktoni nëse ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në aktivitetet e bankës, profilin e rrezikut, ose kontrolleve të rrezikut pas konsultimit me ekzaminerët tjerë që janë duke i shqyrtuar fushat e tjera. Nëse jo, përmbyllni shqyrtimin e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut duke caktuar një vlerësim të duhur.
6. Nëse kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në aktivitetet e bankës, profilin e rrezikut ose kontrollet e rrezikut, zgjeroni fushëveprimin e shqyrtimit për të përfshirë objektiva ose procedura shtesë të përshkruara nën vlerësimet standarde të fushëveprimit.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

Objektivi 1

Përcaktoni përshtatshmërinë dhe efikasitetin e praktikave të menaxhimit të rrezikut të portofolit të investimeve.

Procedurat

1. Vlerësoni mbikëqyrjen e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë duke marrë parasysh:

- a. Proceduren e miratimit të politikave kryesore;
 - b. Rishikimin vjetor të strategjive dhe politikave të investimit;
 - c. Vendosjen e limiteve dhe procedurave të rrezikut që të sigurohet pajtueshmëria;
 - d. Se sa mirë i kuptojnë këto aktivitete bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i cili nuk është i përfshirë drejtpërdrejt apo në bazë ditore në aktivitetet investuese.
2. Shqyrtoni analizat e para investimeve të fundit dhe vlerësoni nëse analizat japin informacion të mjaftueshëm për të kuptuar ndjeshmërinë e çmimeve të letrave me vlerë.
 3. Vlerësoni se sa mirë menaxhmenti monitoron portofolin e investimeve duke marrë parasysh si më poshtë:
 - a. Nëse rreziqet e rëndësishme në aktivitetet e investimeve të bankës janë kuptuar dhe raportuar si duhet;
 - b. Përfundimi dhe dokumentimi i stres-testit mbi llojet e letrave me vlerë, siç kërkohet, në politikën apo procedurat e investimeve të bankës;
 - c. Vlerësimet periodike të ekspozimit të rrezikut të përgjithshëm dhe performancës së përgjithshme të portofolit të investimeve.

Rreziku i Normës së Interesit

Objektivi 2

Përcaktoni sasinë e rrezikut të normës së interesit (RrNI).

Procedurat

1. Vlerësoni ekspozimin e pozicioneve bilancore dhe jashtë bilancore. Merrni parasysh:
 - a. Përbërjen dhe karakteristikat e rrezikute të maturitetit të aseteve dhe detyrimeve dhe strukturat e rrjedhës së parasë;
 - b. Paqëndrueshmërinë e neto marzhës së interesit gjatë periudhave kohore;
 - c. Nivelin dhe ndikimin e rrezikut bazë, rrezikut të kurbës së kthimit, rrezikut të opsioneve dhe rrezikut të rivlerësimit të çmimit, sipas nevojës;
 - d. Mbështetja e ofruar nga depozitat me kosto të ulët, të qëndrueshme të jo maturueshme.

2. Vlerësoni nivelin dhe trendin e fitimeve me rrezik siç tregohet nga sistemi i matjes së rrezikut të bankës.
3. Vlerësoni ekspozimin ndaj vlerës ekonomike të kapitalit të bankës. Merrni parasysh nivelin dhe tendencën për volum të konsiderueshëm të rrezikut të rivlerësimit të çmimit afatmesëm deri afatgjatë dhe / ose pozicioneve të ndërlidhura me opsionet.

Fitimet me rrezik (earnings-at-risk) dhe vlera ekonomike e kapitalit duhet të maten në bazë të një ndryshimi minimal në normat e interesit të ± 200 pikëve bazë brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajve.

4. Vlerësoni performancën dhe efikasitetin e çdo strategjie mbrojtëse në vijim e sipër.
5. Përcaktoni sasinë e RrNI në konsultim me ekzaminerin përgjigjës dhe ekzaminerët e tjerë.

Objektivi 3

Përcaktoni cilësinë e menaxhimit të RrNI.

Procedurat:

1. Siguroni informacionin e ndërlidhur me RrNI nga ekzamineri i caktuar për shqyrtimin e procesverbaleve të bordit të drejtorëve, si dhe shqyrtimin procesverbaleve të çdo komiteti përgjigjës për mbikëqyrjen e RrNI.
2. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve ka aprovuar politikat që përcaktojnë përgjegjësitë për menaxhimin e RrNI, komunikimin e tolerancës së rrezikut, dhe që sigurojnë udhëzime të qëndrueshme për menaxhimin e RrNI.
3. Vlerësoni efikasitetin e menaxhmentit dhe bordi i drejtorëve në mbikëqyrjen e RrNI. Merrni parasysh:
 - a. Ekzistencën dhe arsyeshmërinë e limiteve të aprovuara nga bordi i drejtorëve për fitimet dhe / ose vlerën ekonomike me rrezik;
 - b. Pajtueshmërinë me limitet e përcaktuara të rrezikut;
 - c. Adekuatshmërinë e kontrolleve mbi procesin e menaxhimit të RrNI;
 - d. Të kuptuarit e menaxhmentit për RrNI dhe aftësinë e tyre për të parashikuar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate ndaj ndryshimeve në normat e interesit apo kushtet ekonomike.

4. Përcaktoni nëse sistemi i menaxhimit të rrezikut që përdoret për të matur të fitimet me rrezik është i përshtatshëm për nivelin dhe kompleksitetin e ekspozimit të bankës, dhe nëse supozimet kryesore të përdorura për të matur fitimin-me rrezik janë të arsyeshme.
5. Përcaktoni nëse sistemi i menaxhimit të rrezikut që përdoret për të matur vlerën ekonomike me rrezik është i përshtatshëm për nivelin dhe kompleksitetin e ekspozimit të bankës, dhe nëse supozimet kryesore të përdorura për të matur fitimet-me rrezik janë të arsyeshme.

Shënim:Llogaritja e vlerës ekonomike të kapitalit të rastit-bazë dhe rritja dhe rënia e mjedisit të normës së interesit është metoda më efektive e matjes së rrezikut për bankat me pozicione të rëndësishme të rrezikut në afat më të gjatë ose të lidhura me opsionet.

6. Përcaktoni nëse supozimet e përdorura në sistemin e matjes të rrezikut janë të dokumentuara në mënyrë të mjaftueshme.
7. Vlerësoni aftësinë e dhe efikasitetin e menaxhmentit në menaxhimin e RrNI. Merrni parasysh:
 - a. Nivelin e të kuptuarit të dinamikës së RrNI;
 - b. Aftësinë për t'iu përgjigjur presioneve konkurruese në tregjet financiare dhe lokale;
 - c. Nëse një prezantim i balancuar i rrezikut dhe kthimit janë marrë parasysh në mënyrë të përshtatshme në strategjinë e mjeteve dhe detyrimeve;
 - d. Aftësinë për të parashikuar dhe për t'iu përgjigjur kushteve jo të favorshme apo të ndryshueshme ekonomike dhe normave të interesit;
 - e. Nëse aftësitë e stafit janë të përshtatshme për nivelin e kompleksitetit dhe rrezikut.
8. Vlerësoni afatet kohore, përmbushjen, saktësinë, dhe rëndësinë e sistemit të informimit të menaxhmentit. Koordinoni këtë shqyrtim me ekzaminerët përgjegjës për të gjitha fushat funksionale të ekzaminimit për të shmangur dyfishimin e punëve. Gjetjet duhet t'i komunikohen ekzaminerit që shqyrton fushën e teknologjisë informative.
9. Përcaktoni nëse një proces kompetent, i pavarur i shqyrtimit vlerëson periodikisht efikasitetin e sistemit të menaxhimit të RrNI.

10. Vlerësoni adekuatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm mbi RrNI, dhe nga ky vlerësim përcaktoni nëse sistemi i menaxhimit të rrezikut për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar RrNI është efektiv.

Rreziku i çmimit dhe rreziku i këmbimit valutor

Objektivi 4

Përcaktoni nivelin e rrezikut të çmimit ose rrezikun e këmbimit valutor.

Procedurat

1. Nga aktivitetet tregtuese të bankës përcaktoni, investimet në valuta të huaja ose çfarëdo veprimtarie tjetër që e nënshtron bankën ndaj rrezikut të çmimit apo të këmbimit valutor:
 - a. Sasinë e rreziqeve në lidhje me kapitalin dhe të ardhurat e bankës;
 - b. Cilësia e sistemeve të menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë:
 - Aftësinë ose ekspertizën e menaxhmentit të bankës;
 - Adekuatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rrezikut.

Objektivi 5

Përcaktoni rëndësinë e rrezikut të tregut ndaj kapitalit dhe fitimeve të bankës.

Procedurat

1. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminerët tjerë, vendosni nëse niveli i përgjithshëm ose drejtimi i ndonjë rreziku të vërejtur gjatë shqyrtimit të ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut ka pasur ose pritet të ketë, një ndikim negativ në kapital apo në fitimin e bankës.

Objektivi 6

Komunikoni gjetjet e ekzaminimit dhe filloni veprimet e duhura korrigjuese.

Procedurat:

1. Në diskutim me ekzaminerin përgjegjës, jepni konkluzionet preliminare në lidhje me:
 - a. Sasinë e rrezikut;

- b. Cilësinë e menaxhimit të rrezikut;
 - c. Nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut të normës së interesit, çmimit, këmbimit valutor, apo të ndonjë rreziku tjetër të aplikueshëm; dhe,
 - d. Rekomandimet për strategjinë mbikëqyrëse.
2. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminierët tjerë, identifikoni dhe komunikoni tek ekzaminierët tjerë, sipas nevojës, të gjitha konkluzionet dhe gjetjet nga ekzaminimi i ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut që janë relevante për fushat e tjera në procesin e ekzaminimit.
 3. Përcaktoni, në konsultim me ekzaminerin përgjegjës, nëse rreziqet e identifikuar janë të rëndësishme mjaftueshëm për të merituar sjelljen e tyre në vëmendjen e bordit të drejtorëve dhe raportin e ekzaminimit.
 4. Diskutoni gjetjet me menaxhmentin dhe bini dakord për konkluzionet në lidhje me cilësinë edhe të funksionit të auditimit edhe kontrollit të brendshëm. Çështjet për diskutime mund të përfshijnë:
 - a. Konkluzionet e përgjithshme;
 - b. Rekomandimet;
 - c. Mangësitë; dhe,
 - d. Nëse është e zbatueshme, zotimin nga menaxhmenti për të korrigjuar shkeljet e ligjeve dhe/ose çështjet që kërkojnë vëmendje të bordit të drejtorëve.
 5. Duke përdorur rezultatet e procedurave të mësipërme dhe të gjitha të gjeturat e tjera të zbatueshme të ekzaminimit, përgatitni komentet për përfshirjen në raportin e ekzaminimit.

J. EKZAMINIMI I AUDITIMIT DHE KONTROLLEVE TË BRENDSHME

1. Përshkrimi

1.1. Përmbledhje:

- Auditimi vlerësohen duke e vlerësuar cilësinë e tij që mund të jetë: i dobët, i pranueshëm apo i fortë.
- Kontrollat e brendshme vlerësohen duke i vlerësuar sistemet në tërësi si të dobëta, të pranueshme apo të forta.

1.2. Plotësoni objektivat e këtij seksioni për të vlerësuar cilësinë e auditimit të përgjithshëm të bankës dhe të sistemit të kontrolleve të brendshme. Gjatë përfundimit të këtyre vlerësimeve, ekzamineri duhet të konsultohet me ekzaminerin përgjegjës dhe ekzaminert tjerë. Merrni parasysh faktorët e mëposhtëm kur të vlerësoni cilësinë e auditimit dhe kontrollit të brendshëm:

- Mbikëqyrja nga bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti;
- Sistemet dhe proceset;
- Raportimin;
- Personelin.

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi 1

Përcaktoni cilësinë e auditimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe merrni parasysh ndikimin potencial të këtyre gjetjeve në vlerësimin e rrezikut të bankës.

Procedurat:

1. Në fillim të ekzaminimit, diskutoni me menaxhmentin e bankës pikat në vijim:
 - a. Auditimin apo sistemet e kontrollit të brendshëm në funksion dhe ndryshimet e planifikuara, nëse ka;
 - b. Ndryshimet në politikat dhe procedurat që rregullojnë funksionin e auditimit dhe të kontrollit të brendshëm, nëse ka;
 - c. Ndryshimet në komitetin e auditimit të bordi i drejtorëve, strukturën e departamentit të auditimit, menaxhmentin dhe personelin;
 - d. Planin e auditimit;

- e. Si i mbikëqyrë menaxhmenti aktivitetet e kontrollit të brendshëm;
 - f. Ndonjë ndryshim të rëndësishëm në strategji ose aktivitete të biznesit që mund të ndikojë në kontrollin e brendshëm;
 - g. Ndonjë faktor tjetër të jashtëm që mund të ndikoj ose mund të ketë ndikuar në funksionin e kontrollit të brendshëm.
2. Rishikoni raportin e ekzaminimit paraprak dhe korrespondencat e tjera për të identifikuar çështjet e auditimit dhe të kontrollit të brendshëm që kërkojnë përcjellje të mëtejme.
 3. Rishikoni informacionin dhe dokumentet e mëposhtme:
 - a. Manualin e politikave dhe procedurave të auditimit dhe kontrollit të brendshëm;
 - b. Kontratat respektivisht marrëveshjet e kontraktimit (nëse funksioni është i kontraktuar);
 - c. Përshkrimin e detajuar të detyrave dhe përgjegjësiive të auditorit të brendshëm;
 - d. Procesverbalet e komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve dhe procesverbalet e tjera nga mbledhjet e bordit të drejtorëve, që nga ekzaminimi i kaluar;
 - e. Planet e auditimit për periudhat e rishikuara, të brendshme dhe të jashtme;
 - f. Raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për periudhën e rishikuar, duke përfshirë letrën e menaxhmentit dhe çdo pohim të menaxhmentit dhe miratim të pavarur të kontabilistit publik mbi kontrollin e brendshëm;
 - g. Kohëzgjatja, ndryshimi në personelin e auditimit si dhe konkurset e hapura; dhe,
 - h. Informacioni i humbjeve operationale të shkaktuara gjatë 12 muajve të fundit.
 4. Diskutoni dhe merrni nga ekzaminerët përgjegjës për kompletimin e fushave tjera ndonjë gjetje të konsiderueshme nga auditimi dhe kontrolli i brendshëm që kërkon përcjellje të mëtejme.
 5. Vlerësoni pajtueshmërinë me ligjet dhe kërkesat e tjera prudenciale, dhe ndani gjetjet me ekzaminerët që janë duke rishikuar mmenaxhmentin.
 6. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës, përcaktoni nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme në aktivitetet e bankës, profilin e rrezikut, apo kontrole të rrezikut, dhe/apo nëse rishikimi i mësipërm i auditimit dhe

kontrolleve të brendshme ngrit çështje substanciale. Nëse jo, përmbyllni shqyrtimin e fitimeve duke i caktuar një vlerësim të duhur.

7. Nëse kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në aktivitete të bankës, profil të rrezikut ose kontrolle të rrezikut, dhe/apo nëse rishikimi i auditimit dhe kontrolleve të brendshme ngrit çështje substanciale, zgjeroni fushëveprimin e rishikimit për të përfshirë objektiva ose procedura të tjera të përshkruara në vlerësimin standard.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

2.2.1 Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm

Mbikëqyrja nga bordi i drejtorëve dhe komiteti

Objektivi 1

Përcaktoni cilësinë e përgjithshme të mbikëqyrjes së bordit të drejtorëve dhe komitetit të funksionit të auditimit të bankës..

Procedurat

Përveç procedurave 1, 2, 3, 4 në kuadër të vlerësimit sipas fushëveprimit minimal, aplikoni edhe procedurat e mëposhtme shtesë:

1. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve ose komiteti i auditimit i kryen punët e listuara në vijim:
 - a. Rishikon dhe miraton strategjitë, politikat, programet e auditimit (duke përfshirë pajtueshmërinë me ligje dhe rregullore) dhe strukturën organizative, duke përfshirë përzgjedhjen respektivisht ndërprerjen dhe kompensimin e auditorëve të jashtëm apo auditorëve të brendshëm të kontraktuar me pagesë;
 - b. Përcakton oraret dhe agjendat për takime të rregullta me auditorë të brendshëm dhe të jashtëm;
 - c. Mbikëqyr drejtpërdrejt funksionet e auditimit për të siguruar që auditorët e brendshëm dhe të jashtëm janë të pavarur dhe objektiv në gjetjet e tyre;

- d. Punon me auditorët e brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar që banka ka mbulueshmëri të plotë të auditimit për të përballur rreziqet dhe kërkesat e paraqitura nga aktivitetet e saj aktuale dhe të planifikuara;
 - e. Ka rol të rëndësishëm në punësimin e personelit të lartë të auditimit të brendshëm, në caktimin e kompensimit të tyre dhe në vlerësimin e performancës së menaxherit të auditimit të brendshëm;
 - f. Shqyrton dhe miraton planet vjetore të auditimit (dhe çdo ndryshim të tyre) për auditime të brendshme dhe të jashtme;
 - g. Mban auditorët të cilët janë plotësisht të kualifikuar për auditimin e llojeve të aktiviteteve në të cilat banka është angazhuar;
 - h. Takohet me mbikëqyrësit të paktën një herë në çdo cikël mbikëqyrës për të diskutuar gjetjet e rishikimit të BQK-së në funksionet e auditimit të bankës;
 - i. Monitoron, gjurmon dhe kur është e nevojshme, bën disiplinimin për të siguruar përgjigje efektive dhe në kohë nga ana e menaxhmentit për të korrigjuar dobësitë e kontrollit dhe shkeljet e ligjeve/rregulloreve të shënuara në raportet e auditimit të brendshëm ose të jashtëm apo në raportin e ekzaminimit.
2. A e ka krijuar bordi i drejtorëve një komitet të auditimit? Nëse po, a janë anëtarët e komitetit:
- a. Të pavarur nga menaxhmenti i bankës?
 - b. Të gjithë drejtorë të jashtëm ose të paktën shumica drejtorë të jashtëm?
3. Shqyrtoni dokumentacionin që ka të bëjë me vlerësimin e menaxhmentit mbi kontrollet e raportimit financiar dhe vet hetimin e tij. Keni parasysh nëse:
- a. Menaxhmenti mban të dhënat e shqyrtimit të tij;
 - b. Rezultatet e shqyrtimit janë diskutuar me komitetin e auditimit;
 - c. Vlerësimi i menaxhmentit mbi kontrollet e raportimit financiar dhe pajtueshmërinë me ligjet përkatëse janë në përputhje me gjetjet e auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe gjetjet e ekzaminimit mbikëqyrës.

Auditimi i brendshëm

Objektivi 2

Përcaktoni mjaftueshmërinë e mbikëqyrjes nga bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti të funksionit të auditimit të brendshëm të bankës.

Procedurat

1. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve në proporcion me aktivitetet e bankës dhe profilin e rrezikut, ka themeluar një program të auditimit të brendshëm që:
 - a. Në mënyrë adekuate monitoron sistemet e kontrollit të brendshëm;
 - b. Është i pavarur dhe objektiv;
 - c. Përbëhet nga personeli i kualifikuar;
 - d. Në mënyrë adekuate teston dhe rishikon sistemet e informacionit;
 - e. Në mënyrë adekuate dokumenton testet, gjetjet, si dhe veprimet korrigjuese;
 - f. Verifikon dhe rishikon veprimet e menaxhmentit që adreson dobësitë materiale;
 - g. Kërkon nga bordi i drejtorëve apo komiteti i auditimit që të rishikojë efektivitetin e sistemeve të auditimit të brendshëm.

2. Përcaktoni nëse programi i auditimit të brendshëm të bankës përfshin:
 - a. Një statut të auditimit që përcakton qëllimin, objektivat, organizimin, autoritetin dhe përgjegjësitë e departamentit të auditimit;
 - b. Një plan auditimi që adreson qëllimet, oraret, buxhetin e personelit, raportimin dhe nëse është e aplikueshme, buxhetet financiare;
 - c. Një manual të politikave dhe procedurave për programet e punës së auditimit dhe nëse është e aplikueshme, vlerësim të auditimit i bazuar në rrezik dhe kontraktim të punës së auditimit të brendshëm; dhe,
 - d. Një program për zhvillim profesional dhe trajnim të stafit të auditimit, duke përfshirë orientimin dhe mundësitë e trajnimit në vend apo të jashtëm dhe pa shkëputje nga puna.

3. Rishikoni procesverbalet e bordit të drejtorëve apo të komitetit të auditimit dhe pakot informuese të përgatitura nga departamenti i auditimit të

dërguara në komitetin e auditimit apo në bordin e drejtorëve për të përcaktuar nëse:

- a. Bordi i drejtorëve ose komiteti i tij i auditimit ka miratuar zyrtarisht programin e auditimit të brendshëm si dhe planin apo orarin vjetor të auditimit;
 - b. Raportet e auditimit të brendshëm dhe informacione tjera të lidhura me auditim të dorëzuara rregullisht tek bordi i drejtorëve ose komiteti i saj i auditimit janë të mjaftueshme për monitorimin efektiv të performancës dhe progresit të auditimit të brendshëm drejt përmbushjes së planeve dhe orareve të miratuara të auditimit;
 - c. Programi i auditimit të brendshëm dhe plani vjetor rishikohen dhe përditësohen periodikisht nga departamenti i auditimit të brendshëm, me ndryshimet e raportuara në bordin e drejtorëve ose në komitetin e auditimit;
 - d. Është arritur progres në drejtim të përfundimit të programit ose planit të auditimit dhe bordi i drejtorëve ose komiteti i auditimit ka aprovuar ndryshimet e rëndësishme të programit/planit të auditimit;
 - e. Konsideratë e arsyeshme i është dhënë kërkesave për personel, kompensim dhe kërkesave të trajnimit;
 - f. Menaxhmenti nuk merr pjesë padrejtësisht ose nuk dominon mbi drejtorët ose mbikëqyrjen e komitetit të auditimit të funksionit të auditimit të brendshëm.
4. Përcaktoni nëse auditori i brendshëm raporton drejtpërdrejt te bordi i drejtorëve ose në një komitet të përshtatshëm të auditimit.
 5. Përcaktoni nëse menaxhmenti merr masat e duhura dhe me kohë mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe nëse e raporton veprimin te bordi i drejtorëve ose komiteti i tij i auditimit.
 6. Përcaktoni nëse aktivitetet e funksionit të auditimit të brendshëm janë në përputhje me qëllimet afatgjata të institucionit dhe i përgjigjen nevojave të kontrollit të tij të brendshëm.
 7. Nëse banka ka një program të sigurimit të cilësisë, vlerësoni përshtatshmërinë dhe efektivitetin e programit duke përcaktuar nëse:
 - a. Janë themeluar standardet dhe kriteret për vlerësimin e performancës së funksionit të auditimit të brendshëm;
 - b. Është kryer sigurimi i cilësisë në mënyrën vijuese, me:
 - mbikëqyrje të vazhdueshme nga menaxheri i auditimit të brendshëm;

- shqyrtime periodike të brendshme nga një ekip apo individë nga stafi i auditimit të brendshëm;
 - shqyrtime të jashtme nga persona të kualifikuar të pavarur nga banka.
- c. Një raport formal me shkrim ose me gojë, është hartuar dhe kujt i drejtohet raporti (p.sh. menaxherit të auditimit të brendshëm, menaxhmentit të lartë, ose bordi i drejtorëve apo komitetit të auditimit);
- d. Shqyrtime të sigurimit të cilësisë janë kryer rregullisht.
8. Shqyrtoni politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me funksionin e auditimit të brendshëm të bankës, përfshirë, sipas nevojës, ato që lidhen me auditime të bazuara në rrezik dhe kontraktimet e aktiviteteve të auditimit të brendshëm. Merrni parasysh nëse politikat e shkruara:
- a. Janë shqyrtuar dhe miratuar në mënyrë të përshtatshme nga bordi i drejtorëve ose nga komiteti i tij i auditimit në bazë vjetore;
 - b. E pasqyrojnë siç duhet autoritetin dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga akti themelues i auditimit apo deklaratës së misionit;
 - c. Vendorsin fushëveprimin dhe shpeshësinë e duhur për auditime të brendshme duke konsideruar:
 - Qëllimin dhe objektivat e auditimeve;
 - Vlerësimet e kontrollit dhe të rrezikut;
 - Ciklet e auditimit; dhe,
 - Marrëdhëniet dhe kërkesat e raportimit.
 - d. Vendorsin udhëzime të përshtatshme për burimet njerëzore të përfshira në funksionin e auditimit. Keni parasysh:
 - Organizimin dhe pavarësinë e departamentit të auditimit;
 - Përgjegjësitë e stafit të auditimit;
 - Standardet dhe kualifikimet e punës;
 - Trajnimin dhe zhvillimin; dhe,
 - Vlerësimet e performancës.

Objektivi 3

Vlerësoni pavarësinë dhe kompetencat e atyre që menaxhojnë dhe kryejnë funksionet e auditimit të brendshëm, nëse janë apo jo punonjës të bankës.

Procedurat

1. Vlerësoni përvojën e punës dhe arsimimin e auditorit të brendshëm dhe stafit duke shqyrtuar rezymetë e auditorit të brendshëm / menaxherit, stafit të ri të auditimit të brendshëm, ose stafi që është promovuar kohëve të fundit në nivele të larta, duke vënë në dukje:
 - a. Nivelin e arritur të arsimit;
 - b. Eksperiencën e konsiderueshme të punës, veçanërisht në fushën e auditimit të bankave, duke përfshirë fusha të specializuara;
 - c. Çdo certifikim siç është një auditor bankar i certifikuar, auditor i brendshëm i certifikuar, auditor i certifikuar i sistemeve të informacionit, ose kontabilist publik i certifikuar;
 - d. Anëtarësim në shoqata profesionale.
2. Rishikoni përshkrimet e vendeve të punës për pozita të ndryshme të auditimit dhe diskutoni me menaxherin e auditimit pikat në vijim:
 - a. Kërkesat arsimore dhe të përvojës për pozita të ndryshme të auditimit, duke përfshirë ato për fusha të specializuara;
 - b. Programet për vazhdimin e arsimimit dhe zhvillimit profesional, duke përfshirë shërbimet financiare dhe auditim të teknologjisë dhe fusha të specializuara; dhe,
 - c. Mbikëqyrjen e auditorëve.
3. Nëse konsiderohet e përshtatshme, shqyrtoni vlerësimet e performancës së menaxherit të auditimit dhe stafit të auditimit. Përcaktoni sesi ndikojnë përparësitë dhe dobësitë e identifikuaratë aftësive ose shkathtësive mbikëqyrëse, teknike ose ndërpersonale në cilësinë e funksionit të auditimit të brendshëm.
4. Vlerësoni lëvizjen e personelit dhe vendet e lira të punës të auditimit, duke u fokusuar në arsyet e lëvizjes / konkurseve të punës dhe efektin e tyre në funksionin e auditimit të brendshëm.
5. Përcaktoni nëse ka ndonjë linjë raportuese ose detyra operative të caktuara për auditorin që nuk është në përputhje me funksionin e auditimit të brendshëm. Nëse ekziston linjë raportuese ose detyra operative, përcaktoni nëse pavarësia është komprometuar ose nëse situata është e kontrolluar dhe monitoruar në mënyrë të duhur. Pavarësia mund të rrezikohet nëse auditori:

- a. Raporton te personi nga menaxhmenti i lartë, qoftë zyrtari kryesor për financa ose zyrtar i ngjashëm;
 - b. Ka raportim, funksionim të dyfishtë në komitetin e auditimit për çështjet e auditimit dhe menaxhmentit të lartë për çështjet administrative;
 - c. Ka përgjegjësi për operimin e sistemit të kontrolleve të brendshme ose në të vërtetë kryen detyrat ose aktivitetet operacionale.
6. Përcaktoni nëse auditori ka ndonjë marrëdhënie, siç janë lidhjet familjare me punonjësit e tjerë të bankës, që është në kundërshtim me funksionin e auditimit të brendshëm.
 7. Përcaktoni nëse ka ndonjë kufizim të vendosur në programin e auditimit të brendshëm, duke përfshirë imponimin e orarit ose kufizime buxhetore nga menaxhmenti.

Objektivi 4

Përcaktoni përshtatshmërinë dhe besueshmërinë e punës së kryer nga ana e auditorëve të brendshëm.

Procedurat:

1. Përfshini ekzaminerët përgjegjës për fusha të tjera për të marrë dhe shqyrtuar kopjet e:
 - a. Raporteve të auditimit të brendshëm;
 - b. Letrave të punës së auditimit të brendshëm.

Shënim:Në shumicën e situatave, shqyrtimi i letrave të punës të cilat dokumentojnë procedurat dhe testimin e kryer nga auditori i brendshëm duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur konkluzionet në lidhje me cilësinë dhe besueshmërinë e funksionit të auditimit të brendshëm.

2. Shqyrtoni programin e auditimit të brendshëm të bankës për plotësinë dhe pajtueshmërinë para miratimit nga ana e bordit të drejtorëve ose komitetit të auditimit.
3. Analizoni vlerësimin e auditorit të brendshëm të kontrolleve të brendshme të departamenteve dhe krahasoni atë me vlerësimet e kontrollit të bëra nga ekzaminerët.
4. Shqyrtoni raportet e auditimit të brendshëm për të përcaktuar nëse ato janë të përshtatshme dhe të përgatitura në përputhje me politikën e auditimit.

Konsideroni shpërndarjen e raporteve, afatet kohore, përmbajtjen dhe përcjelljen e mëtejme.

5. Vlerësoni planin më të fundit të auditimit dhe përcaktoni nëse është ofruar mbulueshmëria e mjaftueshme dhe vlerësimi i rrezikut të brendshëm për të gjitha fushat e operimit.
6. Nëse auditori përdor mostrimin në testimin e kontrollit, verifikimin e asetëve, testimin e transaksioneve, auditimeve administrative, etj, përcaktoni nëse programi i punës së auditimit adreson:
 - a. Objektivat e testimit;
 - b. Procedurat për përmbushjen e objektivave;
 - c. Popullacioni për mostrim;
 - d. Metodatat e mostrimit;
 - e. Përzgjedhja dhe justifikimi i një mostre përfaqësuese, e mjaftueshme për të mbështetur konkluzionet;
 - f. Vlerësimin e rezultateve dhe dokumentimi i konkluzioneve.
7. Vlerësoni fushëveprimin e punës së auditorit të brendshëm në raport me madhësinë, natyrën dhe shtrirjen e aktiviteteve të bankës dhe profilin e rrezikut të bankës.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm të Kontraktuar (Outsource)

Objektivi 5

Nëse funksioni i auditimit të brendshëm, ose ndonjë pjesë e saj është i kontraktuar për ofruesit e jashtëm, përcaktoni efektivitetin dhe besueshmërinë e punës së kontraktuar për auditim të brendshëm.

Procedurat:

1. Merrni dhe vlerësoni dokumentet e mëposhtme:
 - a. Kontraktimin e marrëveshjeve apo angazhimeve për auditim të brendshëm;
 - b. Kontraktimin e raporteve për auditim të brendshëm;
 - c. Kontraktimin e politikave të auditimit, nëse ka.

2. Vlerësoni kontratën/letrën e marrëveshjes së kontraktimit në mes të ofruesit dhe bankës dhe përcaktoni nëse kontrata / letra në mënyrë adekuate:
 - a. Definon pritjet dhe përgjegjësitë sipas kontratës për të dy palët;
 - b. Përcakton fushëveprimin, shpeshtësinë dhe tarifat që duhet paguar për punën që do të kryhet nga ofruesi i jashtëm;
 - c. Përshkruan përgjegjësitë për ofrimin dhe marrjen e informacionit, siç janë lloji dhe shpeshtësia e raportimit të ofruesit tek menaxheri i auditimit të bankës, menaxhmenti i lartë, dhe komiteti i auditimit apo bordit të drejtorëve në lidhje me rezultatet dhe statusin e punës;
 - d. Vendos protokollin për ndryshimin e kushteve të angazhimit, veçanërisht për zgjerimin e punës së auditimit në qoftë se lindin çështjet e rëndësishme, si dhe kushtet për mospagim dhe përfundim të kontratës;
 - e. Thekson se raportet e auditimit të brendshëm janë pronë e bankës dhe specifikon pronësinë e letrave të punës së auditimit të brendshëm. Nëse ofruesi mban pronësinë e fletëve të punës, kontrata duhet të përcaktojë se bankës do t'i ofrohen kopjet e letrave të punës që ajo i vlerëson të nevojshme, dhe se punonjësit e autorizuar të bankës do të kenë qasje të arsyeshme dhe kohë të mjaftueshme në letrat e punës së ofruesit;
 - f. Vë në dukje se aktivitetet e auditimit të brendshëm të ofruesit iu nënshtrohen shqyrtimit nga BQK-ja dhe ekzaminerëve do t'iu jepet qasje e plotë dhe me kohë të mjaftueshme në të gjitha raportet e kontraktuara të auditimit të brendshëm, programet e auditimit, letrat e punës së auditimit, dhe memorandumet dhe korrespondenca e përgatitur nga ofruesi i kontraktuar;
 - g. Specifikon vendndodhjen dhe kohën se sa ofruesi do të mban raportet e kontraktuara të auditimit të brendshëm dhe dokumentet të ndërlidhura me punë. Nëse letrat e punës janë në format elektronik, marrëveshja duhet gjithashtu të adresojë çështjen mirëmbajtjes nga ana e ofruesit të softuerit për të lehtësuar shqyrtimin nga banka apo ekzaminërii letrave të punës;
 - h. Krijon procese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe dispozita kompenzuese për përcaktimin se kush do të bartë koston e dëmeve që rrjedhin nga gabimet, lëshimet dhe neglizhenca;
 - i. Thekson se ofruesi nuk do të kryej funksionet e menaxhmentit, të merr vendime të menaxhmentit, apo vepron/paraqitet në cilësinë e njëjtte të një anëtarit të menaxhmentit të bankës apo të një punonjësi të bankës.
3. Përcaktoni, përmes diskutimeve me menaxhmentin e bankës apo shqyrtimit të dokumentacionit relevant, nëse bordi i drejtorëve ose komiteti i auditimit

ka ushtruar kujdes të mjaftueshëm për të kënaqur veten me kompetencën dhe objektivitetin e ofruesit para se të hyjnë në marrëveshje kontraktimi.

4. Aranzhoni një takim me ofruesin dhe diskutoni programin e auditimit të brendshëm të ofruesit të kontraktuar. Keni parasysh:
 - a. Kuptueshmërinë e ofruesit mbi profilin e rrezikut të bankës dhe biznesit;
 - b. Teknikat e marrjes së mostrave nga ofruesi për testimin e kontrolleve të brendshme;
 - c. Programin e trajnimit të ofruesit për stafin e tij të auditimit;
 - d. Komunikimin dhe raportimin tek bordi i drejtorëve të bankës, komiteti i auditimit dhe menaxhmenti i bankës;
 - e. Nëse procedurat e auditimit të ofruesit janë të përshtatura për çdo klient ose janë të përgjithshme;
 - f. Metodat e ofruesit për rishikimin e kontrolleve të brendshme;
 - g. Metodat e përdorura për të strukturuar kontratat e ofruesit;
 - h. Si e siguron ofruesi pavarësinë / koordinimin me aktivitetet e auditimit të jashtëm;
 - i. Standardet e dokumentimit të letrave të punës.
5. Rishikoni raportet e lëshuara të auditimit të brendshëm kontraktuar dhe një mostër të dokumenteve të auditimit të brendshëm të kontraktuar për të përcaktuar përshtatshmërinë dhe përgatitjen e tyre në përputhje me programin e auditimit dhe marrëveshjen për kontraktim.
6. Përcaktoni nëse marrëveshja e kontraktimit ruan ose përmirëson cilësinë e funksionit të auditimit të brendshëm dhe kontrollet e brendshme të institucionit. Kini parasysh:
 - a. Fushëveprimin dhe cilësinë e punës së auditimit të brendshëm;
 - b. Strukturën e përgjithshme të kontrollit të brendshëm;
 - c. Vlerësimin e auditimit dhe kontrollit;
 - d. Respektimin e kushteve të angazhimit;
 - e. Konsistencën me politikat e auditimit, planet e auditimit, dhe pritjet e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit;
 - f. Njoftimi i ofruesit për secilin proces, personel ose ndryshime të tjera që ndikojnë në punën e kontraktuar.

7. Përcaktoni nëse fushëveprimi i punës së auditimit të kontraktuar është rishikuar në mënyrë të duhur kur mjedisi, aktivitetet, ekspozimet ndaj rrezikut, apo sistemet e bankës ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme.
8. Përcaktoni përmes diskutimeve me menaxhmentin e bankës dhe ofruesin nëse banka dhe ofruesit e bankës kanë diskutuar dhe përcaktuar se standardet e aplikueshme të pavarësisë janë duke u përmbushur.
9. Nëse ka arsye të mjaftueshme për të vërë në pikëpyetje pavarësinë, objektivitetin, ose kompetencën e ofruesit, atëherë diskutoni situatat me ekzaminerin përgjegjës, bordin e drejtorëve dhe komitetin e auditimit dhe ofruesin për të sqaruar apo zgjidhur çështjet.
10. Nëse gjetjet e ekzaminimit tregojnë se nuk mund të ketë mbështetje në punën e ofruesit, diskutoni vlerësimin me bordin e drejtorëve, menaxhmentin dhe palën e prekur para finalizimit të raportit të ekzaminimit.

Objektivi 6

Përcaktoni nëse proceset e analizës së rreziqeve të brendshme janë adekuate për madhësinë e bankës, natyrën dhe shtrirjen e aktiviteteve të shërbimeve financiare, si dhe profilit të rrezikut të bankës.

Procedurat:

1. Përcaktoni nëse banka ka standarde dhe procese të duhura për auditime të bazuara në rrezik si dhe vlerësime interne të rrezikut. Standardet dhe proceset e tilla duhet të:
 - a. Identifikojnë bizneset, linjat e produkteve, shërbimet apo funksionet dhe aktivitetet si dhe çështjet e pajtueshmërisë brenda atyre fushave që duhet të auditohen;
 - b. Zhvillojnë profilet e rrezikut që identifikojnë dhe përcaktojnë faktorët e rrezikut dhe kontrollit dhe menaxhimin e rrezikut dhe strukturat e kontrollit për çdo biznes, linjë të produktit, shërbim apo funksion;
 - c. Krijojnë procesin për klasifikimin ose vlerësimin e faktorëve të rrezikut për njësitë e biznesit, departamentet, produktet apo funksionet, duke përfshirë kornizat kohore;

- d. Përshkruajnë sesi përdoret procesi për të përcaktuar planet e auditimit, alokimin e resurseve, fushëveprimet e auditimeve dhe shpeshhtësinë e ciklit të auditimit;
 - e. Aplikojnë planet e auditimit përmes planifikimit, zbatimit, raportimit dhe përcjelljes.
2. Përzgjidhni një mostër të subjekteve të auditueshme bankare dhe përcaktoni arsyeshmërinë e vendimit të analizës së rrezikut të brendshëm, duke përfshirë edhe modelin e aplikuar të rrezikut.
 3. Përcaktoni nëse shpeshhtësia e auditimeve është e arsyeshme dhe është duke u përmbushur.
 4. Nëse është e aplikueshme, përcaktoni cilësinë dhe efektivitetin e monitorimit të vazhdueshëm të auditimit të brendshëm të operacioneve biznesore të bankës.

Auditimi i Jashtëm

Objektivi 1

Përcaktimi i përshtatshmërisë së mbikëqyrjes së bordit të drejtorëve të funksionit të auditimit të jashtëm.

Procedurat

1. Rishikoni procesverbalet e bordit të drejtorëve apo të komitetit të auditimit, ose përmbledhjet e tyre, si dhe pakot informuese të auditimit të paraqitura në bordin e drejtorëve ose komitetin e auditimit, dhe vlerësoni nëse është vërejtur pjesa në vijim:
 - a. Miratimi formal i programit dhe orarit të auditimit të jashtëm, apo arsyet që mbështesin çdo vendim për të hequr dorë nga një program i auditimit të jashtëm;
 - b. Monitorimi i raporteve të auditimit të jashtëm për të përcaktuar nëse programi dhe orari i miratuar i auditimit të jashtëm është duke u respektuar;
 - c. Rezultatet e çdo vote të marrë në lidhje me auditimin e jashtëm;

- d. Konfirmimi se komiteti i auditimit me menaxhmentin dhe auditorët e jashtëm shqyrton raportet e auditimit të jashtëm në kohë të duhur;
 - e. Diskutimi i pavarësisë së auditorit të jashtëm.
2. Gjurmoni shpërndarjen e raporteve të auditimit të jashtëm për të përcaktuar nëse auditori i jashtëm i raporton bordit të drejtorëve ose komitetit të auditimit.
 3. Përcaktoni nëse menaxhmenti i përgjigjet në mënyrë të duhur dhe në kohë ndaj tëgjeturave dhe rekomandimeve të auditimit të jashtëm.
 4. Përcaktoni nëse aktivitetet e funksionit të auditimit të jashtëm janë në përputhje me qëllimet afatgjata të institucionit dhe i përgjigjën nevojave të kontrollit të brendshëm dhe raportimit financiar.
 5. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve ose komiteti i auditimit, të paktën një herë në vit i identifikon fushat kryesore të rrezikut në aktivitetet e institucionit dhe vlerëson shkallën e nevojës së auditimit të jashtëm për secilën fushë.
 6. Përcaktoni se fushëveprimi i shërbimeve të auditorëve të jashtëm shkon përtej auditimeve statutore për të përfshirë auditime tjera të veçanta si tejnologjia informative, kontrolli i brendshëm, auditimet e kredive dhe të pajtueshmërisë.
 7. Shqyrtoni letrën e angazhimit dhe planet e auditimit të jashtëm për të vlerësuar nëse programi i auditimit të jashtëm është i duhur duke pasur parasysh madhësinë e bankës, natyrën dhe shtrirjen e aktiviteteve dhe operacioneve të saj, si dhe profilin e saj të rrezikut.
 8. Lexoni letrat e angazhimit që mbulojnë aktivitetet e auditimit ose shërbime këshilluese të menaxhimit (dmth, jo-audituese apo të konsulencës) të kryera nga auditorët e jashtëm. Përcaktoni nëse letrat adresojnë:
 - a. Qëllimin, fushëveprimin dhe tarifën e shërbimeve të auditimit ose të konsulencës;
 - b. Periudhën që do të mbulohet nga shërbimet e auditimit ose të konsulencës;
 - c. Raportet që pritet të krijohen;
 - d. Çdo kufizim në fushëveprimin e shërbimeve të auditimit ose të konsulencës;
 - e. Qasjen e ekzaminerëve në letrat e punës së auditimit.

Objektivi 2

Rishikoni pavarësinë dhe objektivitetin e atyre që ofrojnë funksionin e auditimit të jashtëm.

Procedurat

1. Përcaktoni nëse bordi i drejtorve ose komiteti i tij i auditimit dhe auditori i jashtëm kanë diskutuar ndonjë shërbim financiar, të punësimit, biznesit, apo shërbim joauditor që mund të komprometojë ose duket se komprometon pavarësinë e auditorit të jashtëm.
2. Përcaktoni nëse banka kohëve të fundit ka ndryshuar auditorët e jashtëm dhe diskutoni me menaxhmentin e duhur arsyet për ndryshim. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar mosmarrëveshjeve midis auditorit të jashtëm dhe menaxhmentit lidhur me parimet përkatëse të kontabilitetit të aplikueshme për transaksionet apo çështjet e veçanta.

2.2.2 Cilësia e kontrollit të brendshëm

Mjedisi i kontrollit

Objektivi 1

Përcaktoni nëse mjedisi i kontrollit të bankës përfshin parimet e kontrollit të fortë të brendshëm

Procedurat

1. Vlerësoni efektivitetin e mjedisit të kontrollit. Keni parasysh:
 - a. Integritetin, etikën dhe kompetencën e personelit;
 - b. Strukturën organizative të bankës;
 - c. Filozofinë e menaxhmentit dhe stilin e operimit;
 - d. Ndikimet e jashtme që ndikojnë në operacione dhe praktika;
 - e. Politikat dhe praktikat e personelit;
 - f. Vëmendjen dhe orientimin e ofruar nga bordi i drejtorëve dhe komitetet e tij, sidomos komitetet e menaxhimit të rrezikut apo auditimit.

2. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve periodikisht rishikon politikat dhe procedurat për të siguruar që janë themeluar vlerësimet e duhura të rrezikut dhe proceset e kontrollit.
3. Përcaktoni nëse ka një sistem të vendosur të auditimit ose sistem tjetër të kontrollit për të testuar dhe monitoruar në mënyrë periodike pajtueshmërinë me politikat/procedurave e kontrollit të brendshëm dhe të raportoj në nivel të bordit të drejtorëve për mospajtueshmëri.
4. Përcaktoni nëse sistemi i informimit të menaxhmentit i ofron bordit të drejtorëve informacionin që i duhet për të marr vendime të informuara dhe me kohë.
5. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve apo menaxhmenti komunikon politikat në lidhje me rëndësinë e kontrollit të brendshëm dhe sjelljen e duhur të të gjithë punonjësve.
6. Përcaktoni nëse ekzistojnë kodet e mirësjelljes apo politikat e etikës. Merrni parasysh nëse:
 - a. Sistemet e auditimit ose sistemet e tjera të kontrollit ekzistojnë për të testuar periodikisht pajtueshmërinë me kodet e mirësjelljes apo politikat e etikës;
 - b. Sistemi i auditimit apo sistemi tjetër i kontrollit të personelit në mënyrë rutinore rishikon politikat dhe trajnimet në lidhje me etikën apo kodet e mirësjelljes.

Vlerësimi i rrezikut

Objektivi 2

Përcaktoni nëse sistemi i vlerësimit të rrezikut të bankës i lejon bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të planifikojnë dhe t'i përgjigjen rreziqeve ekzistuese dhe të reja në aktivitetet e bankës.

Procedurat:

1. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti përfshijnë personel të auditimit ose ekspertë tjerë të kontrollit të brendshëm në procesin e përcaktimit të rrezikut dhe të vlerësimit të rrezikut.

2. Përcaktoni nëse procesi i përcaktimit/vlerësimit të rrezikut përfshin anëtarë të mjaftueshëm të stafit të cilët janë kompetent, të ditur dhe të pajisur me burime të mjaftueshme.
3. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti diskutojnë dhe vlerësojnë siç duhet rreziqet dhe marrin në konsideratë çështjet e kontrollit gjatë fazave paraplanifikuese për produktet dhe aktivitetet e reja.
4. Përcaktoni nëse personeli i auditimit apo ekspertët tjerë të kontrollit të brendshëm janë të përfshirë në rastin kur banka bën zhvillimin e produkteve dhe aktiviteve të reja.
5. Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti konsiderojnë dhe trajtojnë siç duhet çështjet e teknologjisë.
6. Përcaktoni përshtatshmërinë e bonot e mbulueshmërisë (blanket bond) ose mbulueshmërisë tjetër të sigurimit të rrezikut në lidhje me profilin e rrezikut të bankës.

Aktivitetet e kontrollit

Objektivi 3

Përcaktoni nëse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë kanë krijuar aktivitete efektive të kontrollit në të gjitha linjat e biznesit.

Procedurat

1. Përcaktoni nëse ekzistojnë politika dhe procedura për të siguruar që vendimet të merren me miratime dhe autorizime të duhura për transaksione dhe aktivitete.
2. Përcaktoni nëse ekzistojnë procese për të siguruar që:
 - a. Performanca dhe integriteti i çdo funksioni janë të kontrolluara dhe të verifikuara në mënyrë të pavarur;
 - b. Llogaritë janë barazohen vazhdimisht, në mënyrë të pavarur, dhe në kohë të duhur dhe se zërat e veçuar, si zërat bilancor dhe jashtë-bilancor, janë zgjidhur/rregulluar dhe barazuar;
 - c. Përrjashtimet e politikave janë minimale dhe përrjashtimet janë raportuar te menaxhmenti; dhe,

- d. Të punësuarit në pozita të ndjeshme ose me aktivitete të ndërlidhura me rrezik nuk kanë kontroll absolut mbi fushat, p.sh. ndarjen apo rotacionin e detyrave, kërkesat për pushime, kontrollet e dyfishtë apo kujdestari e përbashkët mbi qasje në asete.
3. Përcaktoni nëse linjat e raportimit të një linje biznesi ose fushë funksionale sigurojnë pavarësi të mjaftueshme të funksionit të kontrollit.
 4. Përcaktoni nëse praktikrat operuese janë në konflikt me fushat e përcaktuara të përgjegjësisë dhe kontrollit.
 5. Përcaktoni nëse auditimi i brendshëm apo funksionet tjera të shqyrtimit të kontrollit janë mjaft të pavarura. Keni parasysh:
 - a. Ku raporton funksioni, administrativisht, brenda bankës;
 - b. Kujt, apo në çfarë niveli, funksioni i raporton rezultatet e punës së kryer;
 - c. Nëse praktikrat janë në përputhje me standardet e përcaktuara; dhe,
 - d. Nëse menaxhimi padrejtësisht ndikon në afatet kohore të proceseve të analizës së rrezikut dhe ato të kontrollit.
 6. Përcaktoni nëse bordi i drejtorve dhe menaxhmenti i lartë kanë vendosur procedura adekuate për sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Keni parasysh:
 - a. Shpeshtësinë e testimit dhe raportimit për pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret;
 - b. Nëse i janë dhënë vëmendje dhe përcjellje e mëtejme e duhur shkeljeve të ligjeve dhe rregulloreve.

Sistemet e kontabilitetit, informimit dhe komunikimit

Objektivi 4

Përcaktoni nëse sistemet e kontabilitetit, informacionit dhe komunikimit të institucionit sigurojnë, që aktivitetet e ndërlidhura me rrezik janë brenda udhëzimeve të politikave dhe sistemet janë testuar dhe rishikuar në mënyrë adekuate.

Procedurat

1. Vlerësoni mjaftueshmërinë e sistemeve të kontabilitetit duke përcaktuar nëse:
 - a. Sistemet identifikojnë, mbledhin, analizojnë, klasifikojnë, regjistrojnë, dhe raportojnë siç duhet transaksionet e institucionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;
 - b. Sistemet përfshijnë të gjitha asetet dhe detyrimet e përfshira në transaksione.

2. Të vlerësohet përshtatshmëria e sistemit të informimit të menaxhmenetit duke përcaktuar:
 - a. Llojin, numrin dhe thellësinë e raporteve të gjeneruara për aktivitete operative, financiare, menaxheriale dhe të pajtueshmërisë;
 - b. Nëse raportet janë të mjaftueshme për të drejtuar dhe kontrolluar siç duhet institucionin; dhe,
 - c. Nëse qasja e raporteve në sisteme të informacionit është e kufizuar siç duhet.

3. Vlerësoni mjaftueshmërinë e sistemeve të komunikimit duke vlerësuar nëse:
 - a. Informacioni i rëndësishëm është komunikuar në të gjithë bankë (nga lart poshtë dhe anasjelltas) duke u siguruar se personeli e kupton rolin e vet në sistemet e kontrollit, në bashkëveprimin e aktiviteteve të tyre me të tjerët dhe në llogaridhënien e tyre për aktivitetet që ata ushtrojnë; dhe,
 - b. Informacioni i rëndësishëm është dhënë për palët e jashtme siç janë rregullatorët, aksionarët dhe klientet.

4. Vlerësoni shpeshtësinë dhe plotësinë e verifikimit të sistemit të kontabilitetit, informacionit dhe komunikimit.

Vetëvlerësimi dhe monitorimi

Objektivi 5

Përcaktoni nëse bordi i drejtorve dhe menaxhmenti i lartë mbikëqyrin siç duhet kontrollat e brendshme, rishikimet e kontrollit dhe gjetjet e auditimit.

Procedurat:

1. Përcaktoni nëse bordi i drejtorve ose një komitet i caktuar i bordi të drejtorve ka shqyrtuar veprimet e menaxhmentit për t'u marrë me dobësitë materiale të kontrollit dhe sigurohet se veprimet korrigjuese janë objektive dhe adekuate.
2. Përcaktoni frekuencën dhe tërësinë e raportimeve tek bordi i drejtorve ose komitetit të bordit të drejtorëve ose menaxhmenti i lartë.
3. Përcaktoni përshtatshmërinë e të bordit të drejtorëve ose të komitetit të tij në rishikimin e auditimit dhe funksionet tjera të kontrollit.
4. Vlerësoni përshtatshmërinë dhe pavarësinë e auditimit apo funksionit tjetër të kontrollit.
5. Përcaktoni nëse përgjigjet e menaxhmentit për gjetjet e auditimit apo kontrollit tjetër janë të dokumentuara plotësisht dhe të evidentuara për përcjellje të mëtejme adekuate.

Objektivi 6

Komunikoni gjetjet e ekzaminimit dhe inicioni veprimet e duhura korrigjuese.

Procedurat

1. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjes, ofroni konkluzionet për gjetjet.
Keni parasysh:
 - a. Gjetjet nga të gjitha fushat e tjera të ekzaminuara;
 - b. Konkluzionet e Përgjithshme; dhe,

- c. Çdo rekomandim për menaxhmentin.
2. Përcaktoni se si cilësia e funksionit të auditimit dhe kontrolleve të brendshëm ndikon në vlerësimin e nivelit të përgjithshëm dhe drejtimin të rrezikut për çdo rrezik të zbatueshëm të identifikuar gjatë kryerjes së procedurave të mësipërme.
3. Në konsultim me ekzaminerin përgjegjës përcaktoni, nëse rreziqet e identifikuara janë mjaft të rëndësishme për të merituar sjelljen e tyre të vëmendja e bordit të drejtorëve në raportin e ekzaminimit.
4. Diskutoni gjetjet me menaxhmentin dhe dakordohuni rreth konkluzioneve në lidhje me cilësinë e funksionit të auditimit dhe kontrollit të brendshëm. Diskutimet duhet të përfshijnë:
 - a. Konkluzionet e përgjithshme;
 - b. Rekomandimet;
 - c. Mangësitë;
 - d. Nëse është e aplikueshme, zotim nga menaxhimi për të korrigjuar shkeljet e ligjeve dhe/ose çështjeve që kërkojnë vëmendje të bordit të drejtorëve.
5. Siç kërkohet, përgatisni komente për përfshirje në raportin e ekzaminimit. Komentet duhet të përfshijnë:

Cilësia e funksionit të auditimit

- a. Aftësia dhe efektiviteti i proceseve të auditimit të bankës për të vlerësuar dhe zbuluar rrezikun në operacionet e bankës;
- b. Mjaftueshmëria e politikave, procedurave, programeve të auditimit dhe mbikëqyrjen e bordit të drejtorëve ose të komitetit të auditimit;
- c. A operojnë në përputhje me politikat, standardet, rregullat, dhe rregulloret e vendosura auditorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe ofruesit e kontraktuar;
- d. Disponueshmëria dhe mjaftueshmëria e informacionit rreth, ose të krijuar nga funksioni i auditimit dhe i ofruar për menaxhmentin dhe bordi të drejtorëve ose komitetin e auditimit;
- e. Dobësitë e identifikuara në fushat e rëndësishme nga auditimet e brendshme apo të jashtme dhe progresi i menaxhmentit në korrigjimin e atyre dobësive;

- f. Gjetjet e raportit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm te cilat nuk kanë marrë përgjigje nga menaxhmenti, si dhe çdo shqetësim apo rekomandim tjetër që rezulton nga rishikimi i funksioneve të auditimit;
- g. Rekomando veprimet korigjuese, nëse është e aplikueshme, dhe angazhimet e menaxhmentit.

Cilësia e kontrolleve të brendshme

- a. Nëse mjedisi i kontrollit të brendshëm paraqet rrezik aktual ose potencial të panevojshëm për performancën financiare të bankës;
- b. Mjaftueshmëria e politikave, procedurave dhe programeve të kontrollit të brendshëm për të kontrolluar dhe kufizuar rrezikun në operacionet bankare;
- c. Nëse personeli operon në përputhje me politikat e vendosura dhe nëse jo, shkaqet dhe pasojat;
- d. Mjaftueshmëria e informacionit në funksionin e kontrollit të brendshëm të marrë nga bordi i drejtorëve apo komitetit të tij dhe menaxhmenti;
- e. Dobësit e identifikuar nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm apo ndonjë kontroll tjetër në fusha të rëndësishme dhe progresin e bordi i drejtorve dhe menaxhmentit në adresimin e atyre dobësive;
- f. Gjetjet nga raporti i auditimit ose rishikimi tjetër i kontrollit që nuk kanë marrë përgjigje nga menaxhmenti, si dhe ndonjë shqetësim apo rekomandim tjetër që rezulton nga rishikimi i funksioneve të kontrollit të brendshëm; dhe,
- g. Rekomando veprimet korigjuese, nëse është e aplikueshme dhe angazhimet e menaxhmentit.

K. EKZAMINIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

1. Përshkrimi

-

2. Procedurat e vlerësimit

2.1. Vlerësimi i fushëveprimit minimal

Objektivi 1

Vlerëso menaxhimin e fushës së teknologjisë informative.

Procedurat

1. Vlerëso politikat, procedurat, standardet e teknologjisë informative dhe sigurisë së informacionit.
 - a. Verifiko disponimin e politikave, procedurave, standardeve, etj;
 - b. Verifiko nivelin e aprovimit të politikave, procedurave, standardeve, etj;
 - c. Verifiko periudhën e aprovimit dhe rishikimit të politikave, procedurave, standardeve, etj;
 - d. Verifiko minutat e takimeve të bordit kur janë aprovuar politikat, procedurat standardet, etj;
 - e. Vlerëso adekuatshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave, procedurave, standardeve, etj;
2. Vlerëso nëse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë janë të informuar për zhvillimet dhe rreziqet nga fusha e teknologjisë informative.
3. Analizo strukturën organizative të departamentit të teknologjisë informative dhe vlerëso nivelin e mbulueshmërisë me staf adekuat të fushave të caktuara të TI-ve.

Objektivi 2

Vlerëso adekuatshmërinë e sistemit kryesor bankar.

Procedurat:

1. Verifiko vlefshmërinë dhe kushtet e kontratës për licencë dhe mirëmbajtje të sistemit kryesor bankar me kompaninë që ka ofruar shërbimin;
2. Verifiko disponimin me udhëzues për përdorim të sistemit (manual) adekuat dhe të detajuar për përdorimin adekuat të sistemit nga shfrytëzuesit.
3. Verifiko disponueshmërinë e sistemit me raporte audituese ose loga adekuate për monitorimin e veprimeve përkatësisht modifikimeve dhe fshirjeve duke përfshirë të gjitha të dhënat e nevojshme për evidentimin e personit që ka kryer ndryshimin dhe personin që ka autorizuar ndryshimin, momentin e kryerjes së ndryshimit, vlerat para dhe pas ndryshimit etj.

Objektivi 3

Vlerëso adekuatshmërinë e nivelit të sigurisë fizike të pajisjeve të teknologjisë informative.

Procedurat:

1. Vlerëso adekuatshmërinë e pajisjeve harduerike që janë në përdorim nga institucioni.
 - a. Disponueshmërinë e pajisjeve dhe sistemet operative në përdorim;
 - b. Niveli i përdorimit dhe pronarët e pajisjeve llaptop;
 - c. Disponimi me antivirus adekuat dhe funksional;
 - d. Metodatat e përdorura për enkriptim;
2. Verifiko nivelin e sigurisë në dhomën e ruajtjes së serverëve:
 - a. Adekuatshmëria e monitorimit të qasjeve në dhomën e serverëve;
 - b. Numri dhe niveli i stafit të autorizuar për qasje në dhomën e serverëve;
 - c. Mbrojta adekuate nga rreziqet e ambientit jashtëm në rast të ekspozimit direkt;

- d. Disponimi me kamera monitoruese, vendndodhja e qendrës së monitorimit dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së inqizimeve në hapësirën e dhomës së serverëve;
 - e. Disponimi me detektorë të lëvizjes (alarmi), detektorë të tymit në rast zjarri, detektorë të lagështisë dhe sensorë të temperaturës;
 - f. Pajisjet rezervë për furnizim me rrymë dhe mbajtjen e temperaturës konstante;
 - g. Pajisjet adekuate dhe funksionale për shuarje automatike të zjarrit;
 - h. Evidentimi i hyrje / daljeve në dhomën e serverëve nga kontraktorë të jashtëm për qëllime servisimi;
 - i. Verifiko disponimin me procedurë adekuate për përdorimin e kartelës/çelësit rezervë për përdorim në rastet emergjente nga personat përgjegjës.
3. Verifiko nëse bëhet ruajtja e rregullt e bazës së të dhënave të sistemit kryesor bankar në lokacion të jashtëm nga dhoma e serverëve, në vend të sigurte dhe me qasje të kufizuar vetëm nga persona të autorizuar. Mënyra e transportimit të të dhënave të sistemit kryesor bankar në rast të nxjerrjes jashtë bankës të bëhet në mënyrë të mbrojtur dhe të enkriptuar ashtu që të pamundësohet qasja në këto të dhëna.

2.2. Vlerësimi i fushëveprimit standard

Objektivi 1

Vlerëso politikat e teknologjisë informative dhe sigurisë së informacionit.

Procedurat:

1. Vlerëso politikat, procedurat, standardet e teknologjisë informative.
 - a. Verifiko disponimin e politikave, procedurave, standardeve etj;
 - b. Verifiko nivelin e aprovimit të politikave, procedurave, standardeve etj;
 - c. Verifiko periudhën e aprovimit dhe rishikimit të politikave, procedurave, standardeve etj;

- d. Verifiko procesverbalet e takimeve të bordit të drejtorve ose organeve tjera të bankës kur janë aprovuar politikat, procedurat standardet etj;
 - e. Vlerëso adekuatshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave, procedurave, standardeve etj;
2. Vlerëso politikat, procedurat, standardet e sigurisë së informacionit:
 - a. Verifiko disponimin e politikave, procedurave, standardeve etj;
 - b. Verifiko nivelin e aprovimit të politikave, procedurave, standardeve etj;
 - c. Verifiko periudhën e aprovimit dhe rishikimit të politikave, procedurave, standardeve etj;
 - d. Verifiko minutat e takimeve të bordit kur janë aprovuar politikat, procedurat standardet etj;
 - e. Vlerëso adekuatshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave, procedurave, standardeve etj;
 3. Vlerëso strategjinë e institucionit për fushën e teknologjisë informative dhe nëse funksionet e TI-ve kanë procese efektive të menaxhimit për të realizuar strategjinë.

Objektivi 2

Vlerëso menaxhimin e fushës së teknologjisë informative.

Procedurat

1. Vlerëso nëse bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë janë të informuar për zhvillimet dhe rreziqet nga fusha e teknologjisë informative.
2. Analizo strukturën organizative të departamentit të teknologjisë informative dhe vlerëso nivelin e mbulueshmërisë me staf adekuat të fushave të caktuara të teknologjisë informative.
3. Shqyrto përshkrimet e vendit të punës së stafit të departamentit të teknologjisë informative si dhe përgatitjen e tyre profesionale.
4. Shqyrto raportet e departamentit të teknologjisë informative për raportim tek menaxhmenti duke analizuar të dhënat:
 - a. Intervali kohor i raportimit;

- b. Niveli i informacionit të raportuar, përkatësisht gjithë përfshirja e çështjeve në raporte;
 - c. Saktësia dhe azhurniteti i informacionit të raportuar;
 - d. Niveli menaxherial ku raportohet;
5. Vlerëso disponimin dhe funksionimin e komiteteve për teknologjinë informative dhe siguri.
- a. Shqyrto periudhën e mbajtjes së takimeve të rregullta të komiteteve;
 - b. Shqyrto përbërjen dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të komiteteve në takime;
 - c. Shqyrto përmbajtjen e procesverbaleve të takimeve të komiteteve të mbajtura nga ekzaminimi i fundit;
6. Vlerëso kualitetin dhe adekuatshmërinë e auditimeve të brendshme për teknologjinë informative duke analizuar gjetjet në raportet e auditimit të teknologjisë informative.

Objektivi 3

Vlerëso adekuatshmërinë e harduerit dhe softuerit të shfrytëzuar nga institucioni.

Procedurat:

1. Vlerëso adekuatshmërinë e pajisjeve harduerike që janë në përdorim nga institucioni.
 - a. Disponueshmërinë e pajisjeve dhe sistemet operative në përdorim;
 - b. Niveli i përdorimit dhe pronarët e pajisjeve llaptop;
 - c. Disponimi me antivirus adekuat dhe funksional;
 - d. Metodatat e përdorura për enkriptim;
2. Vlerëso adekuatshmërinë e softuerëve në shfrytëzim nga institucioni.
 - a. Qëllimi i përdorimit të softuerit;
 - b. Licencat përkatëse për shfrytëzim të softuerit;
 - c. Vlefshmëria e softuerit dhe afati i skadimit të licencës;

- d. Vlefshmëria dhe kushtet e kontratave për mirëmbajtje të softuerit nga kompanitë përkatëse në rastet kur aplikohet (p.sh. kontrata për mirëmbajtje të softuerit kryesor bankar);
3. Analizo listën e firmave kontraktuese të jashtme dhe shërbimeve që këto firma i ofrojnë institucionit si dhe vendndodhjen e tyre.
4. Verifiko strukturën e organizimit të rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të komunikimit të institucionit.
5. Verifiko numrin e ofruesve të internetit me të cilët institucioni ka marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të internetit përkatësisht nëse institucioni disponon me ofrues të shërbimeve të internetit rezervë për aktivizim në rast të mosfunksionimit të njërit prej ofruesve të internetit.

Objektivi 4

Vlerëso adekuatshmërinë e nivelit të sigurisë fizike të pajisjeve të teknologjisë informative.

Procedurat:

1. Verifiko nivelin e sigurisë në dhomën e ruajtjes së serverëve.
 - a. Adekuatshmëria e monitorimit të qasjeve në dhomën e serverëve;
 - b. Numri dhe niveli i stafit të autorizuar për qasje në dhomën e serverëve;
 - c. Mbrojta adekuate nga rreziqet e ambienti i jashtëm në rast të ekspozimit direkt;
 - d. Disponimi me kamera monitoruese, vendndodhja e qendrës së monitorimit dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së inqizimeve në hapësirën e dhomës së serverëve;
 - e. Disponimi me detektorë të lëvizjes (alarmi), detektorë të tymit në rast zjarri, detektorë të lagështisë dhe sensorë të temperaturës;
 - f. Pajisjet rezervë për furnizim me rrymë dhe mbajtjen e temperaturës konstante;
 - g. Pajisjet adekuate dhe funksionale për shuarje automatike të zjarrit;
 - h. Evidentimi i hyrje / daljeve në dhomën e serverëve nga kontraktorë të jashtëm për qëllime servisimi;

- i. Verifiko disponimin me procedurë adekuate për përdorimin e kartelës/çelësit rezervë për përdorim në rastet emergjente nga personat përgjegjës.

Objektivi 5

Vlerëso adekuatshmërinë e sistemit kryesor bankar.

Procedurat

1. Verifiko vlefshmërinë dhe kushtet e kontratës për licencë dhe mirëmbajtje të sistemit kryesor bankar me kompaninë që ka ofruar shërbimin;
2. Verifiko disponimin me udhëzues për përdorim të sistemit (manual) adekuat dhe të detajuar për përdorimin adekuat të sistemit nga shfrytëzuesit.
3. Vlerëso nëse menaxhimi i sistemit bëhet nga niveli adekuat përkatësisht rolet përkatëse dhe se stafi përgjegjës për menaxhim disponon me njohuri adekuate të përdorimit.
4. Verifiko disponueshmërinë e sistemit me raporte audituese ose loga adekuate për monitorimin e veprimeve përkatësisht modifikimeve dhe fshirjeve përfshirë të gjitha të dhënat e nevojshme për evidentimin e personit që ka kryer ndryshimin dhe personin që ka autorizuar ndryshimin, momentin e kryerjes së ndryshimit, vlerat para dhe pas ndryshimit etj.
5. Verifiko nëse fjalëkalimet e shfrytëzuesve për qasje në sistemin kryesor bankar ruhen të enkriptuara në mënyrë adekuate ashtu që mos t'i mundësohet askujt qasja në leximin e tyre.
6. Verifiko nëse bëhet ruajtja e rregullt e bazës së të dhënave të sistemit kryesor bankar në lokacion të jashtëm nga dhoma e serverëve, në vend të sigurte dhe me qasje të kufizuar vetëm nga persona të autorizuar. Mënyra e transportimit të të dhënave të sistemit kryesor bankar në rast të nxjerrjes jashtë bankës të bëhet në mënyrë të mbrojtur dhe të enkriptuar ashtu që të pamundësohet qasja në këto të dhëna.
7. Verifiko qasjet e stafit në të dhënat e sistemin kryesor bankar varësisht prej pozitave që kanë, posaçërisht për të rolet me të drejta administrative dhe rolet me të drejta për modifikimin dhe fshirjen e të dhënave në sistem.
8. Vlerëso periudhën kohore të nevojshme për kompaninë përgjegjëse për mirëmbajtje të sistemit, për përgjigje dhe rregullimin e problemeve dhe gabimeve që raportohen te kompania për zhvillim apo rregullim.

Objektivi 6

Vlerëso nivelin e kontrollit dhe sigurisë së qasjeve të shfrytëzuesve.

Procedurat

1. Verifiko procesin e kërkesës dhe autorizimit për hapjen e një shfrytëzuesi, modifikimin e të drejtave të shfrytëzuesit dhe pasivizimin e një shfrytëzuesi.
2. Verifiko metodat e aplikuara dhe intervalet periodike të rishikimit periodik të qasjeve të të gjithë shfrytëzuesve.
3. Verifiko qasjet aktive, qasjet e dyfishta dhe të drejtat përkatëse në sistemin kryesor bankar të punëtorëve aktiv të institucionit.
4. Verifiko qasjet aktive eventuale të punëtorëve që janë jashtë punës ose që nuk duhet të kenë qasje por vazhdojnë të kenë qasje aktive në sistemin kryesor bankar.
5. Verifiko qasjet aktive dhe qasjet e dyfishta në rrjetin e institucionit (domain) të punëtorëve aktiv të institucionit dhe punëtorëve pasiv që janë jashtë punës dhe nuk duhet të vazhdojnë të kenë qasje aktive.

Objektivi 7

Vlerëso nivelin e kontrolleve për mbrojtjen e informacionit nga qasjet, zbulimet dhe modifikimet e paautorizuara.

Procedurat

1. Verifiko a disponon institucioni me staf përgjegjës për sigurinë e informacionit. A vepron i pavarur nga departamenti i teknologjisë informative dhe a kryen raportime periodike të menaxhmenti mbi sigurinë e informacionit në institucionin.
2. Analizo dhe vlerëso procedurat për raportimin e incidenteve të sigurisë së informacionit.
3. Verifiko zbatimin e masave mbrojtëse të sigurisë së informacionit përmes kategorizimit të dokumenteve dhe kontrollimit të qasjeve në dokumentet

përkatëse sipas kategorizimit. Verifiko disponimin me procedura përkatëse për kategorizimin e dokumenteve.

4. Verifiko zbatimin e formularëve për marrëveshje mbi konfidencialitetin të aplikuar për gjithë stafin e institucionit.
 - a. Verifiko kufizimet e qasjeve në internet sa i përket faqeve të internetit të lejuara / ndaluara.
 - b. Verifiko listën e stafit me qasje në internet dhe niveli i qasjes së lejuar;
 - c. Verifiko listën e kategorizimit të faqeve të internetit të lejuara / kufizuara për qasje;
5. Verifiko kufizimet e qasjeve në porte për përdorimin e pajisjeve periferike, përkatësisht analizo listë e stafit me qasje të aprovuara duke verifikuar pozitat dhe arsyet e lejimit të qasjeve të tilla.
6. Verifiko procedurën e përcjelljes së fjalëkalimeve tek stafi përkatës, masat mbrojtëse për ruajtjen e konfidencialiteti, nivelin e kompleksitetit të fjalëkalimit të lejuar për përdorim dhe intervalin kohorë deri në skadimin e fjalëkalimit.

Objektivi 8

Vlerëso angazhimin dhe gatishmërinë e institucionit për vazhdimësinë e biznesit.

Procedurat

1. Vlerëso aftësinë e sistemeve rezervë dhe prezencën e planeve për vazhdimësinë e biznesit për të zvogëluar mundësinë e ndërprerjes së biznesit.
2. Vlerëso politikën / planin për vazhdimësinë e biznesit.
 - a. Verifiko disponimin me politikë / plan për vazhdimësinë e biznesit;
 - b. Verifiko nivelin e aprovimit të dokumentit;
 - c. Verifiko periudhën e aprovimit dhe rishikimit të dokumentit;
 - d. Vlerëso adekuatshmërinë dhe zbatueshmërinë e dokumentit;
3. Verifiko caktimin dhe aprovimin e ekipit përgjegjës për vazhdimësinë e biznesit, si dhe personave zëvendësues të ekipit.

4. Verifiko kryerjen e testimeve periodike për vazhdimësinë e biznesit dhe vlerëso adekuatshmërinë, intervalet kohore ndërmjet testeve dhe rezultatet e këtyre testeve.
5. Verifiko mbajtjen e trajnimeve për vazhdimësinë e biznesit dhe vlerëso adekuatshmërinë dhe përfshirjen e gjithë stafit në këto trajnime.

Objektivi 9

Vlerëso adekuatshmërinë e nivelit të sigurisë fizike të pajisjeve të teknologjisë informative në lokacionin rezervë për kthim prej fatkeqësive.

Procedura

1. Verifiko nivelin e sigurisë në dhomën e ruajtjes së serverëve në lokacionin rezervë për kthim prej fatkeqësive.
 - a. Adekuatshmëria e monitorimit të qasjeve në dhomën e serverëve;
 - b. Numri dhe niveli i stafit të autorizuar për qasje në dhomën e serverëve;
 - c. Mbrojta adekuate nga rreziqet e ambientit të jashtëm në rast të ekspozimit direkt;
 - d. Disponimi me kamera monitoruese, vendndodhja e qendrës së monitorimit dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së inqizimeve në hapësirën e dhomës së serverëve;
 - e. Disponimi me detektorë të lëvizjes (alarmi), detektorë të tymit në rast zjarri, detektorë të lagështisë dhe sensorë të temperaturës;
 - f. Pajisjet rezervë për furnizim me rrymë dhe mbajtjen e temperaturës konstante;
 - g. Pajisjet adekuate dhe funksionale për shuarje automatike të zjarrit;
 - h. Evidentimi i hyrje / daljeve në dhomën e serverëve nga kontraktorë të jashtëm për qëllime servisimi;
 - i. Verifiko në çfarë baza bëhet bartja e kopjes së të dhënave nga lokacioni primarë në lokacionin rezervë.
 - j. Verifiko disponimin me procedurë adekuate për përdorimin e kartelës/çelësit rezervë për përdorim në rastet emergjente nga personat përgjegjës.

Objektivi 10

Vlerëso nivelin e sigurisë së bankingut elektronik (e-Banking).

Procedura

1. Verifiko marrëveshjen për mirëmbajtje të sistemit të bankingut elektronik me kompaninë që ofron shërbimin dhe vendndodhjen e kompanisë.
2. Verifiko mjaftueshmërinë dhe adekuatshmërinë e stafit të institucionit për menaxhimin e bankingut elektronik përkatësisht menaxhimin të shfrytëzuesve.
3. Vlerëso nivelin e kontrolleve të sigurisë për verifikimin dhe autentifikimin e klientit, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave, parandalimin dhe zbulimin e ndërhyrjeve.
4. Verifiko faqen e institucionit për shërbimet e bankingut elektronik për të verifikuar organizimin, strukturën, operimin dhe fushën e aktiviteteve të bankingut elektronik.
5. Verifiko planet për kthimin në rast të fatkeqësive të teknologjisë dhe biznesit së bankingut elektronik dhe funksionimin e shërbimit gjatë ndërprerjeve të shërbimeve.
6. Identifiko ndonjë ndryshim të aplikuar ose planifikuar në aktivitetet dhe shërbimet e bankingut elektronik.

L. KONKLuzionet e Ekzaminimit

1.1. Përmbledhje:

- Vlerësimi i bankës është: 1, 2, 3, 4, apo 5.
- Profili i përgjithshëm i rrezikut të bankës është: i ulët, mesatar apo i lartë.

1.2. Për të përfunduar ciklin mbikëqyrës, ekzaminerë do të përmbushin të gjitha objektivat sipas kësaj pjese, pavarësisht përcaktimit të rrezikut të bankës.

Objektivi 1

Përcaktoni dhe përditësoni vlerësimin e përgjithshëm të bankës dhe vlerësimet e tjera rregullative, sipas nevojës.

Procedurat

1. Merrni parasysh gjetjet nga fushat në vijim:
 - a. Auditimi dhe kontrolli i brendshëm;
 - b. Mjaftueshmëria e kapitalit;
 - c. Kualiteti i mjeteve;
 - d. Aftësia e menaxhmentit;
 - e. Kualiteti dhe sasia e fitimeve;
 - f. Mjaftueshmëria e likuiditetit;
 - g. Ndjeshmëria e tregut; dhe,
 - h. Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret.
2. Siguroni se vlerësimi i të gjitha komponentëve ka marrë parasysh:
 - a. Madhësinë e bankës;
 - b. Sofistikimin e bankës;
 - c. Natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të bankës; dhe,
 - d. Profilin e rrezikut të bankës

Objektivi 2

Të përcaktohet profili i rrezikut duke përdorur sistemin për vlerësimin e rrezikut.

Procedurat

1. Shënoni konkluzionet në lidhje me sasinë e rrezikut, cilësinë e menaxhimit të rrezikut, rrezikun neto dhe drejtimin e rrezikut neto për secilën nga pesë kategoritë e rrezikut.
2. Duke përdorur vlerësimet e bëra në pesë rreziqe individuale, ekzamineri përgjegjës duhet të përcaktojë vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të institucionit. Profili i përgjithshëm i rrezikut nuk është thjeshtë një mesatare, por një kombinim i vlerësimit të të gjitha rreziqeve individuale. Në përcaktimin e profilit të përgjithshëm të rrezikut, EP duhet të përdorë gjykimin për të peshuar të gjitha rreziqet për nga rëndësia relative e secilit rrezik.

Objektivi 3

Finalizimi i ekzaminimit.

Procedurat

1. Përgatitja e raportit përmbledhës lidhur me takimin përmblyës të ekzaminimit - përgatitet nga ekzamineri përgjegjës bazuar në inputet e pranuar nga ekzaminierët. Secili ekzaminier përgatit dhe dërgon pjesën e vet (letrat e punës) tek ekzamineri përgjegjës për fushë të caktuar të cilët më pastaj pas shqyrtimit i nënshkruajnë ato së bashku me ekzaminierin dhe versionin final e dërgon tek ekzamineri përgjegjës i ekzaminimit;
2. Dërgimi i raportit përmbledhës tek DRA – nënkupton shqyrtimin e raportit përmbledhës para takimit përmblyës me bankë;
3. Takimi me DRA-në lidhur me vlerësimin përfundimtar – përfshinë diskutimin në nivel departamenti lidhur me vlerësimin preliminar të bankës. Në takim marrin pjesë, përveç drejtorit dhe udhëheqësve të divizioneve për fushën përkatëse edhe stafi i DRA-së, ekzaminierët senior si dhe ekzaminierët tjerë të ftuar nga drejtori;

4. Takimi përmbyllës i ekzaminimit – nënkupton mbajtjen e takimit me menaxhmentin e lartë të bankës së ekzaminuar. Në takim marrin pjesë: drejtori i departamentit, udhëheqësit e divizioneve për fushën përkatëse si dhe ekzamineri përgjegjës;
5. Dërgimi nga ekipi tek ekzamineri përgjegjës i draft-raporteve – nënkupton fazën e përgatitjes së draft-raportit të ekzaminimit ku secili ekzaminer përgjegjës për fushën e ekzaminuar dërgon pjesën e vet tek ekzamineri përgjegjës i ekzaminimit;
6. Përfundimi i angazhimit të ekipit përveç (ekzaminertit përgjegjës) – pas dërgimit dhe nënshkrimit të letrave të punës tek ekzaminerë përgjegjës, përfundon çdo angazhim i ekipit të ekzaminerëve të caktuar paraprakisht;
7. Përgatitja dhe dërgimi nga ekzamineri përgjegjës i draft-raportit – nënkupton fazën e dërgimit të draft-raportit tek udhëheqësi i divizionit të fushës përkatëse;
8. Shqyrtimi i draft-raportit të ekzaminimit – nënkupton analizimin, komentimin dhe shqyrtimin e draft-raportit të ekzaminimit nga udhëheqësi i divizionit të fushës përkatëse;
9. Shqyrtimi dhe dërgimi i draft-raportit të ekzaminimit – pas shqyrtimit të draft-raportit të ekzaminimit nga udhëheqësi i divizionit të fushës përkatëse, draft-raporti në fjalë dërgohet te drejtori i departamentit për shqyrtim;
10. Diskutimi me zëvendësguvernatorin për mbikëqyrje financiare lidhur me gjetjet – nënkupton diskutimin e draft-raportit duke shpalosur te zëvendësguvernatori për mbikëqyrje financiare gjetjet kryesore të draft-raportit;
11. Dërgimi i draft-raportit tek banka për shqyrtim – pas shqyrtimit të detajuar të tij, draft-raporti i dorëzohet bankës për komentim;
12. Pranimi i komenteve nga banka – paraqet periudhën kur banka ushtron të drejtën e komentimit të gjetjeve të draft-raportit si dhe dërgimit të komenteve të faktuara në BQK;
13. Finalizimi dhe dërgimi i raportit final të ekzaminimit – përfshin periudhën e shqyrtimit me kujdes të komenteve të bankave si dhe finalizimin e raportit të ekzaminimit. Megjithatë, nëse banka vlerësohet të jetë subjekt i masave përmirësuese, bankës i ofrohet një deklaratë e detajuar duke përshkruar faktet dhe ligjin që mbështesin ekzistencën e shkeljes dhe do t'i japë bankës mundësi të plotë të ofrojë fakte dhe argumente se pse ndëshkimi nuk do të

duhet të shqiptohet. Në raste ankimimi, banka duhet të procedoj konform Rregullores për Procedurat e Shqiptimit të Ndëshkimeve Administrative.

14. Në rast se bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të ekzaminimit të fundit banka vlerësohet me notën 3, 4 ose 5 finalizimi dhe nënshkrimi i raportit të ekzaminimit duhet të shoqërohet me vendim të Bordit Ekzekutiv të BQK-së.

Objektivi 4

Përcjellja e vazhdueshme dhe monitorimi.

Procedurat:

1. Ekzamineri përgjegjës duhet që vazhdimisht të përcjellë statusin e përmbushjes së rekomandimeve të ekzaminimit, njohuritë themelore, profilin e rrezikut si dhe vendimet përkatëse (nëse ka). Frekuenca e përcjelljes së statusit duhet të korrespondojë me afatet e cekura në raportin e ekzaminimit, përfshirë vendimet përkatëse.
2. Përveç asaj që u cek më lartë, ekzamineri përgjegjës për bankë duhet të përpiloj një raport përmbledhës për bankën në baza të rregullta tremujore duke përfshirë statusin e përmbushjes së rekomandimeve të ekzaminimit, njohuritë themelore, profilin e rrezikut si dhe vendimet përkatëse (nëse ka).

Shtojca VIII. Axhenda (programi) e ekzaminimit

Përshkrimi	Përgjegjës	Kohëzgjatja (në ditë pune)
EKZAMINIMI I PLOTË		
PERIUDHA PARA EKZAMINIMIT		
1	<i>Përcaktimi i ekipit të ekzaminimit</i>	UDMV, DDMB 1 ditë pune
2	<i>Kërkesa ndaj Autoritetit Mbyqyres të Bankes meqë dhe caktimin (potencial) të stafit për bashkëngjitje në ekipin e ekzaminimit</i>	DDMB -
3	<i>Informimi paraprak i ekzaminimit</i>	DDMB -
4	<i>Përgatitja e "Core Knowledge"</i>	EP 10 ditë pune
5	<i>Kërkesa ndaj DSFAE lidhur me ambientin ekonomik në Kosovë dhe Turqi</i>	DDMB 1 ditë pune

6	<i>Kërkesa ndaj DRA-së lidhur me stres-test dhe raporte relevante</i>	<i>EP</i>	1 ditë pune
7	<i>Dërgimi nga DSFAE lidhur kërkesa si më lartë</i>	<i>DSFAE</i>	1 ditë pune
8	<i>Përgatitja e profilit të rrezikut nga pikëpamja "on-site"</i>	<i>EP</i>	10 ditë pune
9	<i>Përgatitja dhe dërgimi i stres-testit dhe raporteve relevante nga DRA-ja</i>	<i>DRA</i>	2 ditë pune
10	<i>Përgatitja e "scope memo"</i>	<i>EP</i>	10 ditë pune
11	<i>Përcaktimi i detyrave specike për stafin e ekzaminimit</i>	<i>EP, UDMV</i>	2 ditë pune
12	<i>Përgatitja e letër kërkesës dhe letër informimit</i>	<i>EP</i>	2 ditë pune
13	<i>Dërgimi i letër kërkesës dhe letër informimit</i>	<i>DDMB</i>	1 ditë pune
14	<i>Parapërgatitja për fillimin e ekzaminimit</i>	<i>Ekipi i ekzaminimit</i>	15 ditë pune
15	<i>Takim me ekipin e ekzaminimit</i>	<i>DDMB, UDMV</i>	1 ditë pune
16	<i>Çështje logjistike të ekzaminimit</i>	<i>EP, UDMV</i>	2 ditë pune
PERIUDHA E EKZAMINIMIT			
17	<i>Takimi hapës i ekzaminimit</i>	<i>DDMB, UDMV, EP</i>	1 ditë pune
18	<i>Periudha e ekzaminimit</i>	<i>Ekipi i ekzaminimit</i>	25 - 30 ditë pune
19	<i>Takimet e rregullta me ekzaminierin përgjegjës</i>	<i>DDMB, UDMV</i>	1 takim në javë
PERIUDHA PAS EKZAMINIMIT			
20	<i>Përgatitja e raportit përmbledhës lidhur me takimin përmbyllës të ekzaminimit</i>	<i>EP</i>	5 ditë pune
21	<i>Dërgimi i raportit përmbledhës tek DRA</i>	<i>EP</i>	1 ditë pune
22	<i>Takimi me DRA-në lidhur me vlerësimin përfundimtar</i>	<i>Ekipi i ekzaminimit</i>	1 ditë pune
23	<i>Takimi përmbyllës i ekzaminimit</i>	<i>DDMB, UDMV, EP</i>	1 ditë pune
24	<i>Dërgimi nga ekipi tek ekzaminierin përgjegjës i draft-raporteve</i>	<i>Ekipi i ekzaminimit</i>	5 ditë pune
25	<i>Përfundimi i angazhimit të ekipit përveç ekz. përgjegjës</i>	-	-
26	<i>Përgatitja dhe dërgimi nga ekzaminierin përgjegjës i draft-raportit</i>	<i>EP</i>	10 ditë pune
27	<i>Shqyrtimi i draft-raportit të ekzaminimit</i>	<i>UDMV</i>	5 ditë pune
28	<i>Shqyrtimi dhe dërgimi i draft-raportit të ekzaminimit</i>	<i>DDMB</i>	3 ditë pune
29	<i>Diskutimi me Zëvendësgubernatorin lidhur me gjetjet</i>	<i>DDMB, UDMV, EP</i>	2 ditë pune
30	<i>Dërgimi i draft-raportit tek banka për shqyrtim</i>	<i>DDMB</i>	-
31	<i>Pranimi i komenteve nga banka</i>	<i>Banka</i>	5 - 10 ditë

		pune
32	<i>Finalizimi dhe dërgimi i raportit final të ekzaminimit</i>	<i>EP, UDMV, DDMB</i> 10 ditë pune

Shtojca IX. Formati i raportit të ekzaminimit

P Ë R M B A J T J A

1. Informata mbi historikun
 - 1.1 Informata për bankën
 - 1.2 Fushëveprimi i ekzaminimit
 - 1.3 Takimi përmbyllës i ekzaminimit
2. Komentet përfundimtare të ekzaminimit
3. Vlerësimi i rrezikut dhe përmbledhja e klasifikimit
 - 3.1. Menaxhmenti / Qeverisja
 - 3.2. Rreziku kreditor dhe kualiteti i mjeteve
 - 3.3. Rreziku i likuditetit
 - 3.4. Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut
 - 3.5. Auditimi i brendshëm
 - 3.6. Kontrollat e brendshme
 - 3.7. Rreziku operacional
 - 3.8. Mjaftueshmëria e kapitalit
 - 3.9. Fitimet
 - 3.10. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve
 - 3.11. Menaxhimi i pajtueshmërisë
4. Çështjet që kërkojnë vëmendje
5. Përmbledhje e vlerësimeve të rreziqeve dhe CAMELS
 - 5.1. Matrica e rrezikut dhe përshkrimi i vlerësimit të rreziqeve
 - 5.2. Tabela e vlerësimit CAMELS
 - 5.3. Menaxhmenti / Qeverisja
 - 5.3.1. Fushëveprimi
 - 5.3.2. Vlerësimi i komponentës CAMELS / menaxhmenti
 - 5.4. Rreziku kreditor dhe kualiteti i mjeteve

- 5.4.1. Tabela e vlerësimit të rrezikut kreditor
- 5.4.2. Vlerësimi i komponentets CAMELS / kualiteti i mjeteve
- 5.4.3. Fushëveprimi
- 5.4.4. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- 5.5. Rreziku i likuiditetit dhe menaxhimi i mjeteve dhe detyrimeve
 - 5.5.1. Tabela e vlerësimit të rrezikut të likuiditetit
 - 5.5.2. Vlerësimi i komponentets CAMELS / likuiditeti
 - 5.5.3. Fushëveprimi
 - 5.5.4. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- 5.6. Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut
 - 5.6.1. Tabela e vlerësimit të rrezikut të tregut
 - 5.6.2. Vlerësimi i komponentets CAMELS / Ndeshmëria ndaj rrezikut të tregut
 - 5.6.3. Fushëveprimi
 - 5.6.4. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- 5.7. Rreziku opracional
 - 5.7.1. Tabela e vlerësimit të rrezikut operacional
 - 5.7.2. Fushëveprimi
 - 5.7.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- 5.8. Auditimi i brendshëm
 - 5.8.1. Fushëveprimi
 - 5.8.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore
 - 5.8.3. Komiteti i auditimit
 - 5.8.4. Auditimi i jashtëm

- 5.9. Kontrollat e brendshme
 - 5.9.1. Fushëveprimi
 - 5.9.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- 5.10. Teknologjia Informativë
 - 5.10.1. Fushëveprimi
 - 5.10.2. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore

- 5.11. Mjaftushmëria e kapitalit
 - 5.11.1. Tabela e vlerësimit të komponentets CAMELS/ kapitali
 - 5.11.2. Fushëveprimi
 - 5.11.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore
- 5.12. Fitimet
 - 5.12.1. Tabela e vlerësimit të komponentets CAMELS/ fitimet
 - 5.12.2. Fushëveprimi
 - 5.12.3. Konkluzionet dhe gjetjet kryesore
- 6. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve
- 7. Menaxhimi i pajtueshmërisë
- 8. Shtojcat
 - 8.1. Bilanci i gjendjes
 - 8.2. Zërat jashtbilancor
 - 8.3. Pasqyra e të ardhurave
 - 8.4. Kapitali Bazë - Raporti (struktura e kapitalit)
 - 8.5. Mjetet e peshuar me rrezik
 - 8.6. Klasifikimi i mjeteve dhe rezervat e kërkuara
 - 8.7. Përmebledhje e mjeteve të klasifikuara
 - 8.8. Përmbledhje e mjeteve me vonesa
 - 8.9. Mjetet/zërat subjekt të klasifikimit
 - 8.10. Koncentrimet
 - 8.11. Ndryshimet në rezerva për humbjet nga kreditë
 - 8.12. Raporti mbi mbi mjetet likuide
- 9. Nënshkrimi i antarëve të bordit të drejtorëve dhe kryeshefit ekzekutiv

Përmbajtja e Raportit të Ekzaminimit

Ky raport i ekzaminimit përbëhet nga gjashtë nene/ndarje të mëdha, siç është paraqitur në vijim.

1. Informata mbi historikun
2. Komentet perfundimtare të ekzaminimit

3. Vleresimi i rrezikut dh permbledhja e klasifikimit
4. Çështjet që kërkojnë vëmendje
5. Përmbledhje e vlerësimeve të rreziqeve dhe CAMELS
6. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve
7. Menaxhimi i pajtueshmërisë
8. Shtojcat
9. Nënshkrimi i antarëve të bordit të drejtorëve dhe kryeshefit ekzekutiv

Përshkrim i shkurtër i secilit nen të raportit, si në vijim:

1. Informata mbi historikun

Përmban: Informata per bankën, Fushëveprimi i ekzaminimit dhe takimi përmbyllës i ekzaminimit. Përfshin: Informat për bankën duke përfshir, daten e licencimit të bankës, strukturën e pronësisë, kapitalin aksionar dhe informatat tjera për bankën. Fushëveprimi i ekzaminimit përfshinë, procedurat të cilat do të përdoren gjate ekzaminimit për çdo rrezik dhe komponent të CAMELS-it, si dhe përshkruhen arsyet e përdorimit të tyre. Gjithashtu, përfshihen edhe çështjet e tjera të aktivitetit të bankës. Në takimin përmbyllës, komunikohen rezultatet e ekzaminimit me menaxhment të bankës dhe ceken pjesëmarrësit në takim nga BQK dhe banka..

2. Komentet perfundimtare te ekzaminimit

Përmbanë: çështjet të cilat kërkojnë vëmendje, duke listuar ato.

3. Vleresimi i rrezikut dhe permbledhja e klasifikimit

Përmbanë: kokluzinet e ekzaminimit lidhur me vlerësimet e rrezikut dhe vlerësimin CAMELS, Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve dhe menaxhimin e pajtueshmërisë. Përfshinë: Menaxhmenti/Qeverisja, Rreziku kreditor dhe kualiteti i mjeteve, Rreziku i likuiditetit, Ndjeshmeria ndaj rrezikut te tregut, Auditimi i brendshëm, Kontrolltet e brendshme, Rreziku operacional, Mjaftueshmëria e kapitalit, fitimet, shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve, menaxhimi i pajtueshmërisë.

4. Çështjet që kërkojnë vëmendje

Përmban: listohen çështjet që kërkojnë vëmendje nga bordi i drejtorve dhe menaxhmenti për sigurimin e korigjimit brenda afateve të përcaktuara kohore. Përfshin: Listimi i çështjes, rekomandimi dhe afati kohor.

5. Përmbledhje e vlerësimeve të rreziqeve dhe CAMELS

Përmban: matrikësen e rreziqeve dhe përshkrimin e e vlerësimit të rreziqeve, tabelën e vlerësimit CAMELS duke përshkrua çdo komponent të tij, auditimin e brendshëm, kontrollet e brendshme dhe teknologjinë informative.

Ekzaminerët duhet të paraqesin rezultatet e vlerësimit të sasisë së çdo lloj rreziku, për kualitetin e menaxhimit të rrezikut, nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut të caktuar për 12 muajt e ardhshëm. Ekzaminerët duhet gjithashtu të paraqesin arsyet për konkuzionet e tyre në lidhje me sasinë e çdo llojit të rrezikut, kualitetin e menaxhimit të rrezikut nivelin e përgjithshëm të rrezikut dhe drejtimin e rrezikut të caktuar. Ekzaminerët, së paku duhet të komentojnë mbi rreziqet e mëposhtme: rrezikun kreditor, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional.

Përmbledhje e vlerësimit të komponentëve të CAMELS:

Ekzaminerët duhet të vlerësojnë komponentët e CAMELS në formë tabelare për ekzaminimin aktual dhe dy ekzaminimet e fundit.

Ekzaminerët duhet të vlerësojnë secilin komponentë të CAMELS dhe të japin arsyet për një vlerësim të tillë. Ekzaminerët duhet të japin të paktën nformacionin e mëposhtëm në lidhje me secilin komponent:

1. Mjaftueshmeria e kapitalit

Ekzaminerët raportojn mbi konkluzionet e tyre lidhur me kapitalin e bankës dhe nëse ai i plotëson kërkesat minimale rregullatore. Në konkluzione merren parasysh:

- a) Adekuatshmëria e kapitalit të bankës, duke përfshirë ndikimin e cilësisë së aseteve, zërat jashtëbilancor dhe fitimet;
- b) Trendet dhe ndryshimet në nivelin dhe strukturën e kapitalit;
- c) Krahasimi i rritjes së kapitalit dhe aseteve;
- d) Mjaftueshmeria e provizioneve për humbjet nga kredit dhe lizingjet dhe efektet e saj në kapital kur është e pamjaftueshme;
- e) Politika e dividendes dhe ndikimi i saj në kapital;
- f) Aftësia/gatishmëria e menaxhmentit dhe aksionarëve për të mbajtur një nivel të mjaftueshëm të kapitalit;
- g) Çdo kapital shtesë që nevojitet për të përmbushur kërkesat rregullative.

2. Kuliteti i mjeteve

Ekzaminerët raportojn konkluzionet e tyre në lidhje me:

- a) Adekuatshmërinë e standardeve të kreditimit, praktikave të shëndosha të administrimit të kredive dhe praktikave për identifikimin e rrezikut;
- b) Nivelin, shpërndarjen, vështirësitë dhe trendin e problemit: i klasifikuar, jopërllogaritëse i riprogramuara, në vonesë dhe mjetet joperformuese për transaksionet bilancore dhe jashtëbilancore;
- c) Adekuatshmërinë e provizioneve për humbjet nga kredit dhe lizingjet dhe rezervat e aseteve tjera;
- d) Rrezikun kreditor që rrjedh nga, apo reduktohet nga, transaksionet jashtëbilancore siç janë zotimet e pafinancuara, derivatet kreditorë, letrat kreditorë komerciale apo ato “standby”.
- e) Diversifikimin dhe cilësinë e portofolit kreditor dhe të investimeve;
- f) Shtrirjen e aktiviteteve të letrave me vlerë dhe ekspozimit ndaj palëve në aktivitetet tregtuese;
- g) Ekzistencën e koncentrimin të aseteve;
- h) Adekuatshmerinë e kredisë dhe politikave për investime, procedurave dhe praktikave;
- i) Adekuatshmërinë e kontrolleve të brendshme, rishikimi i brendshëm i kredive dhe sistemi i informimit të menaxhmentit; dhe
- j) Vëllimi dhe natyra e përjashtimeve në dokumentacionin e kredisë.

3. Menaxhmenti

Ekzaminerët raportojn mbi përfundimet e tyre në lidhje me:

- a) Aftësinë e menaxhmentit për të përcaktuar rreziqet e ndërlidhura me shërbimet financiare dhe gjendjen ekonomike;
- b) Aftësinë e bordit të drejtorve dhe të menaxhmentit për të identifikuar, matur dhe kontrolluar apo zbutur rreziqet esenciale që lidhen me operacionet e bankës;
- c) Aftësinë e bordit të drejtorve dhe menaxhmentit për të planifikuar dhe të adresuar ndryshimet negative dhe për të menaxhuar rreziqet si pasojë e kushteve të paqëndrueshme ekonomike, si dhe për të futur lloje të reja të aktiviteteve dhe produkteve;
- d) Aftësinë e bordit të drejtorve dhe të menaxhmentit për të siguruar një nivel të mjaftueshëm të kapitalit, të cilësisë së aseteve, të ardhurave dhe të likuiditetit;

- e) Pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret bankare si dhe shërbimet financiare; politikat dhe procedurat e brendshme;
- f) Efektivitetin e strukturës organizative;
- g) Përshtatshmërinë dhe aplikueshmërinë e planeve të biznesit (strategjike, afat-shkurtër) dhe zbatimi i tyre;
- h) Përshtatshmërinë dhe zbatimin e politikës së burimeve njerëzore;
- i) Efektshmërinë dhe kontrollet e brendshme duke përfshirë zbatimin dhe pajtueshmërinë e tyre;
- j) Saktësinë, afatin kohor dhe efektivitetin e sistemit të informimit të menaxhmentit dhe sistemeve për monitorimin e rrezikut që i përshtaten madhësisë, kompleksitetit dhe profilit të rrezikut të bankës;
- k) Pavarësinë e funksioneve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, fushëveprimin, shpeshhtësinë, dhe përshtatshmërinë e kontroleve të auditimit duke përfshirë komentet për atë se si i adreson menaxhmenti rekomandimet e auditimit;
- l) Veprimet e menaxhmentit, të cilat rezultojnë në ekspozimin e bankës ndaj rreziqeve të larta (vetë-kreditimit, keqpërdorimit të autoritetit, konfliktit të interesit); dhe
- m) Përgjigjet e menaxhmentit ndaj rekomandimeve të mëparshme rregullatore, pajtueshmërinë dhe gatishmërinë për të ndërmarrë veprime korigjuese.

4. Fitimet

Ekzaminerët raportojn mbi konkluzionet e tyre në lidhje me:

- a) Nivelin dhe trendet e fitimeve;
- b) Cilësinë dhe strukturën e fitimeve;
- c) Përshtatshmërinë e provizioneve për humbjet e mundshme;
- d) Nivelin dhe trendin e llojeve kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- e) Dobësinë në zërat e papaguar, transaksionet e letrave me vlerë (të shënuara sipas tregut), llojet e aktiviteteve me rreziqe të larta, dhe burimet jokonvencionale të të ardhurave;
- f) Kontrollin mbi të ardhurat dhe shpenzimet, duke përfshirë analizën e variancave të buxhetit kundrejt atij aktual;
- g) Dobësitë në fondet e shtrenjta;
- h) Korigjimet me kohë në bilancin e gjendjes për të siguruar raport të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve;

- i) Ndikimin e ankesave të mundshme në bankë që rrjedhin nga kontestet gjyqësore; dhe,
- j) Të ardhurat dhe zërat e shpenzimeve që duhet të korrigjohen në përputhje me rezultatet e ekzaminimit.

5. Likuiditeti

Ekzaminerët raportojnë mbi konkluzionet e tyre në lidhje me:

- a) Trendet, nivelet dhe burimet e mjeteve likuide (d.m.th të atyre mjeteve që lehtësisht mund të konvertohen në para të gatshme);
- b) Tregjet e parasë dhe burimet e tjera të financimit;
- c) Llojet e burimeve të financimit në zërat bilancor dhe jashtëbilancor;
- d) Stabilitetin e fondeve të tërhequra në raport me nivelin e ndjeshmërisë së bankës ndaj burimeve të shtrenjta dhe të paqëndrueshme të financimit (fondet ndërbankare etj);
- e) Aftësinë dhe kompetencat e menaxhmentit për të përcaktuar, matur, monitoruar, kontrolluar dhe zbutur pozicionin e likuiditetit të bankës;
- f) Përshtatshmërinë e sistemit të informimit të menaxhmentit, planit rezervë dhe pajtueshmërinë me kërkesat për likuiditet, duke përfshirë vendimmarrjen e duhur dhe me kohë në fushën e menaxhimit të fondeve;
- g) Ndikimin e mundshëm të rreziqeve të tjera në likuiditet; dhe,
- h) Pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e vetë bankës për menaxhimin e fondeve.

6. Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut

Ekzaminerët raportojnë mbi konkluzionet e tyre në lidhje me:

- a) Përshtatshmërinë e politikave, praktikave dhe procedurave të bankës për normën e interesit dhe rreziqet e këmbimeve valutore;
- b) Përshtatshmërinë e sistemeve të matjes të përdorura nga banka për të vlerësuar rrezikun e normës së interesit dhe këmbimit valutor;
- c) Ekzistencën dhe efikasitetin e limiteve të përcaktuar për të kontrolluar ndryshimet e mundshme të rreziqeve në krahasim me madhësinë e aseteve të bankës, nivelin e aktiviteteve dhe mjaftueshmërinë e kapitalit;
- d) Efektshmërinë e kontrolleve të brendshme, duke përfshirë delegimin e autoriteteve si dhe ndarjen e detyrave në mënyrën e duhur; dhe

- e) Përshtatshmërinë e rishikimeve periodike dhe justifikimet e auditimit të brendshëm dhe/ose të jashtëm në lidhje me saktësinë, strukturën dhe supozimet e përdorura në procesin e identifikimit të rreziqeve, si dhe rolin e tyre në sigurimin e pajtueshmërisë së bankës me limitet e përcaktuara dhe kërkesat rregullatore.
6. Shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve
Përmbanë: listimin e shkeljeve ligjore me të cilat banka ishte në mospajtueshmëri të evidentuara gjatë ekzaminimit.
7. Menaxhimi i pajtueshmërisë
Përmban: listimin e mospajtueshmërive të bankës me politikat, procedurat dhe dokumentet e brendshme të saj, të evidentuara gjatë ekzaminimit.
8. Shtojcat
Përmban: informata të ndryshme për të mbështetur vërejtjet dhe konkluzionet e ekzaminimit. Përfshinë: Bilanci i gjendjes, Zërat jashtbilancor, Pasqyra e të ardhurave, Kapitali Bazë - Raporti (struktura e kapitalit), Mjetet e peshuara me rrezik, Klasifikimi i mjeteve dhe rezervat e kërkuara, Përmebledhje e mjeteve të klasifikuara, përmebledhje e mjeteve me vonesa, mjetet/zërat subjekt të klasifikimit, koncentrimet, ndryshimet në rezerva për humbjet nga kreditë, raporti mbi mbi mjetet likuide.
9. Nënshkrimi i antarëve të bordit të drejtorëve dhe kryeshefit ekzekutiv
Përmban: nënshkrimet e antarëve të bordit të drejtorëve dhe kryeshefit ekzekutiv lidhur me raportin e ekzaminimit.

M. PËRCAKTIMI I SHPESHTËSISË SË EKZAMINIMIT

Bankat klasifikohen në pesë zona të ndara, sipas vlerësimit të tyre përfundimtar: Zona e bardhë, zona e gjelbër, zona e verdhë, zona portokalli, zona e kuqe. Secila zonë duhet të mundësojë ciklin e ekzaminimit, intensitetin e ekzaminimit të bankës relevante, qëndrimin e BQK-së ndaj bankës relevante, si dhe metodat e aplikimit që duhet të zbatohen.

Një cikël i ekzaminimit përbëhet nga periudhat nga 6 deri në 24 muaj, të cilat përcaktohen sipas zonave në të cilat ato janë ndarë .

Zona e bardhë: Bankat që kanë vlerësimin e përgjithshëm “1” përfshihen në zonën e bardhë dhe këto banka kërkojnë aktivitete të rralla të ekzaminimit. Cikli i ekzaminimit përcaktohet të jetë më së paku 24 muaj. Aktiviteti në nivel të ulët i ekzaminimit konsiderohet si adekuat.

Zona e gjelbër: Bankat që kanë vlerësimin e përgjithshëm “2” përfshihen në zonën e gjelbër dhe këto banka janë subjekt i aktiviteteve të ekzaminimit nga mbikëqyrja në vend së paku një herë në 18 muaj.

Zona e verdhë: Bankat që kanë vlerësimin e përgjithshëm “3” përfshihen në zonën e verdhë. Tek këto banka aplikohet ekzaminimi nga mbikëqyrja në vend i nivelit të mesëm. Cikli i ekzaminimit është përcaktuar të jetë së paku çdo 12 muaj.

Zona portokalli: Bankat që kanë vlerësimin e përgjithshëm “4” përfshihen në zonën portokalli. Tek këto banka aplikohet ekzaminim intensiv. Cikli i ekzaminimit është përcaktuar të jetë në së paku çdo 6 muaj. Duhet të aplikohet një program korigjues në bankë për përmirësimin e kontrolleve.

Zona e kuqe: Bankat që kanë vlerësimin e përgjithshëm “5” përfshihen në zonën e kuqe. Tek këto banka aplikohet ekzaminimi intensiv. Cikli i ekzaminimi është përcaktuar të jetë ndërmjet 0 deri në 6 muaj. Kërkohej veprim i menjëhershëm korigjues për përmirësimin e profilit të rrezikut të bankës.

Vlerësimi Përgjithshëm	Zona	Shpeshtësia e ekzaminimit
1	Zona e bardhë	Së paku në çdo 24 muaj
2	Zona e gjelbër	Së paku në çdo 18 muaj
3	Zona e verdhë	Së paku në çdo 12 muaj
4	Zona portokalli	Së paku në çdo 6 muaj
5	Zona e kuqe	Së paku në çdo 0-6 muaj

N. MBIKËQYRJA E KONSOLIDUAR

Një institucion i thjeshtë financiar, i angazhuar në një aktivitet të vetëm, është relativisht i hapur për tu mbikëqyrur. Megjithatë institucionet financiare zgjerojnë, diversifikojnë, bëjnë investime dhe formojnë filiale. Ato gjithashtu formojnë partneritete dhe marrin kompani të tjera. Ato zgjerojnë operacione në kompani tjera, angazhohen në licencimin dhe autorizimin. Me kaq shumë ndryshime, mbikëqyrësve ju nevojitet të mbledhin informacionet e nevojshme për të fituar një pamje të duhur të strukturës komplekse të biznesit. Informatat financiare të konsoliduara në mënyrë të përshtatshme sigurojnë bazën për mbikëqyrësit në vlerësimin e fuqisë financiare, rreziqeve dhe profitabilitetit të organizatës së konsoliduar dhe në aplikimin e rregulloreve kyçe prudenciale në bazë të konsoliduar. Megjithatë, mbikëqyrja e konsoliduar është shumë më e gjerë sesa konceptet e konsolidimit të kontabilitetit.

Pasi që bankat ndërmarrin një shumëllojshmëri të aktiviteteve të ndryshme të biznesit në lloje të ndryshme të entiteteve operative dhe nëpër shumë vende, është e rëndësishme që një grup bankar të mbikëqyret në bazë të konsoliduar duke qenë se rreziqet mund të dalin nga çdo pjesë e grupit. Fushëveprimi i mbikëqyrjes së konsoliduar është menduar të jetë gjithëpërfshirës dhe duhet të mbulojë entitetet jo-bankare brenda grupit, si dhe entitetet që janë përtej fushëveprimit të konsolidimit të kontabilitetit. Përveç kësaj, ajo duhet të mbulojë kompaninë mëmë të bankës, si dhe filialet e kompanisë mëmë.

Për mbikëqyrje efikase nevojitet bashkëpunimi me autoritetet relevante dhe zbatimi i kërkesave prudenciale.

Gjatë ekzaminimit të grupit bankar, ekzamineri duhet të sigurohet që entitetet brenda grupit bankar dhe brenda konglomeratit më të gjerë dhe të përzier janë:

- Burim i mbështetjes (për shembull, mbështetja e menaxhmentit dhe kapitale);
- Nuk janë burim i dobësisë;
- Grupi duhet të jetë në një pozicion që t'i sigurojë bankës/grupit bankar mbështetje të kapitalit dhe likuiditetit nëse kërkohet kështu, si dhe jo shterim i mundshëm i burimeve të kapitalit dhe likuiditetit të bankës/grupit bankar;
- Janë identifikuar dobësitë e kompanive brenda grupit që mund të kërcënojnë pozicionin e bankës/grupit bankar.


Së pari, ekzamineri duhet të kuptojë strukturën e përgjithshme të grupit bankar (bankën dhe filialet e bankës) dhe grupit më të gjerë (kompania mëmë, filialet e kompanisë mëmë). Për të kuptuar këtë:

- Kuptoni marrëdhënien e bankës me entitetet e tjera grupore;

- Kuptoni aktivitetet e të gjitha pjesëve materiale të grupit;
- Kuptoni dhe vlerësoni menaxhimin e gjerë grupor të rreziqeve;
- Mbikëqyrni aktivitetet e bankave vendore dhe kërkoni mbylljen e zyrave të huaja; apo vendosni kufizime në aktivitete nëse:
 - Mbikëqyrja nga menaxhmenti apo pritja nuk është adekuate (në krahasim me rreziqet);
 - Nuk mund të fitojnë qasje në informacionet e kërkuara;
 - Këto paraqesin rreziqe ndaj bankës apo grupit bankar.
- Shqyrtoni aktivitetet e kompanive mëmë dhe filialeve të tyre për të përcaktuar ndikimin në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e bankës dhe grupit bankar.
- Bashkëpunoni dhe koordinohuni me agjencitë / njësitë tjera mbikëqyrëse (vendore dhe ndërkufitare).

Mund të ketë lloje të ndryshme të strukturave të grupit. Fushëveprimi i mbikëqyrjes së konsoliduar do të ndryshojë në bazë të strukturave të ndryshme të grupit.

Struktura e grupit e llojit A (Tipari kryesor dallues i këtij lloji është se kompania mëmë rregullohet/mbikëqyret nga BQK-ja)




Ekzamineri duhet të ekzaminojë strukturën e grupit të llojit A në baza të konsoliduara, që përfshinë:

- Vlerësimin e masave kuantitative (burimet kryesore janë: kthimet bankare në ekspozimet e mëdha, mjaftueshmëria e kapitalit dhe likuiditeti në baza të konsoliduara dhe auditorët e jashtëm që vërtetojnë saktësinë e kthimeve bankare dhe mjaftueshmërinë e sistemit të përpilimit të kthimit): Këto masa janë mjaftueshmëria e kapitalit, likuiditeti, ekspozimet e mëdha dhe palët e lidhura.
- Kryerjen e vlerësimit të cilësisë në strukturën organizative të grupit, qeverisjen e korporatave dhe cilësinë e menaxhimit, sistemet për menaxhimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme. Burimet e informacionit, sipas kërkesës, të cilat do t'iu ndihmojnë në vlerësimin e rreziqeve të ndërlidhura janë: tabela e organizimit të grupit, struktura dhe politika e menaxhimit të rrezikut në grup,

pasqyrat financiare të audituara dhe të konsoliduara të grupit apo kompanive tjera relevante të grupit, raportet e menaxhimit të rrezikut në nivel të grupit (p.sh. mbi ekspozimet e mëdha, ekspozimet e lidhura, mjaftueshmërinë e kapitalit, rrezikun e likuiditetit dhe rreziqet e tjera të larta) dhe raportet e tjera informative të menaxhimit në nivel grupi.


- Për vlerësimin e operacioneve ndërsektoriale dhe ndërkufitare të grupit shfrytëzohen politikat e formuara në kuadër të BQK-së dhe MM-ve të nënshkruara me autoritetet e huaja. Qëllimet janë: përcaktimi i roleve dhe përgjegjësiwe përkatëse të rregullatorëve, minimizimi i dyfishimit të përpjekjeve rregullative, mbyllja e boshllëqeve në kufijtë rregullativ dhe promovimi i asistencës së ndërsjellë, si dhe shkëmbimi i informacioneve.

Struktura e grupit e llojit B (Tipari kryesor dallues i këtij lloji është se kompania mëmë rregullohet/mbikëqyret jashtë Kosovës)



Nëse grupi bankar në Kosovë është pjesë e grupeve ndërkombëtare bankare (struktura e grupit e llojit B), mbikëqyrja e konsoliduar përfundimtare e grupit relevant financiar i besohet rregullatorëve vendor bankar (Entiteti i rregulluar nga ana e BQK-së dhe filialet e tij janë akoma subjekt i parimeve të dhëna më sipër për strukturën e grupit të llojit A).

Struktura e grupit e llojit C (Tipar kryesor dallues i këtij lloji është se kompania mëmë nuk rregullohet/nuk mbikëqyret jashtë apo brenda e Kosovës)



Megjithatë, nëse kompania mëmë është një kompani holding e parregulluar (Struktura e grupit e llojit C), kjo kompani holding dhe kompanitë simotra brenda grupit duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit më të detajuar. Ekzamineri vlerëson nëse “kontrolluesi” është i aftë dhe i duhuri.

Faktorët që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së një kompanie holding përfshijnë: strukturën e grupit, cilësinë e qeverisjes korporative të grupit dhe pikpamjet e menaxhimentit, profilin e rrezikut dhe fuqinë e përgjithshme financiare të grupit, menaxhimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme.

1. Struktura e grupit: struktura të mjaftueshme, transparente, ligjore, menaxheriale dhe operacionale të linjave të mëdha biznesore për mbikëqyrësin, për të përcaktuar:

- Degët apo filialet e mëdha, vendi kryesor i biznesit dhe vendndodhja e menaxhimentit kryesor të linjave kryesore të biznesit;
- Mënyrën në të cilën grupi menaxhohet dhe kontrollohet në nivel të lartë, dhe aty ku është relevante, mënyrat se si menaxhohen operacionet ndërkufitare;
- Linjat kryesore të llogaridhënies brenda grupit;
- Lidhjet kyçe të korporatave, financiare dhe të tjera ndërmjet AI dhe anëtarëve të tjerë të grupit;
- Nivelin në të cilin struktura korporative e grupit mund të ndikojë në mbikëqyrjen dhe rregullimin e grupit bankar;
- Shkallën në të cilën kompanitë amë dhe filialet e grupit bankar mbikëqyren nga rregullatorët tjerë vendorë (brenda ose jashtë BQK-së) ose autoritetet rregullative jashtë shtetit.

2. Cilësia e qeverisjes korporative të grupit dhe mbikëqyrja e menaxhimit:

- Përbërja e bordit dhe komitetit të auditimit të kompanisë relevante holding;

- Njohuria dhe ekspertiza e mjaftueshme e bordit dhe menaxhmentit të lartë të kontrolluesit;
- Mbikëqyrja e transaksioneve të rëndësishme me palët e lidhura (veçanërisht ato që përfshijnë grupin bankar);
- Shkalla e ndikimit të ushtruar nga kontrolluesi në kryerjen e punëve të grupit bankar konform me të;
- Njohuritë e kontrolluesit, përvoja, kompetenca, qëndrueshmëria e gjykimit dhe kujdesi që kërkohen për drejtimin e grupit bankar
- Çfarëdo të dhëna të dënimeve penale, shkelja e akteve ligjore ose rregullatore, mos-përputhja e kodeve jo-statusore, vërejtja apo skualifikimi nga organet profesionale apo rregullative.

3. Profili i rrezikut: rreziqet kryesore të vetvetishme në grup:

- Operacionet kryesore dhe strategjitë e përgjithshme e biznesit
- Entitetet apo njësitë biznesore që ndërmarrin rreziqe
- Tendencat dhe aktivitetet kryesore që mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme profilin e rrezikut
- Rreziku potencial i paraqitur nga kompanitë tjera të grupit tek grupi bankar, në veçanti:
 - Transaksionet brenda grupit të grupit bankar duhet të kryhen në mënyrë të pavarur;
 - Aftësia për t'i bërë ballë shpërndarjes nga grupi p.sh. Aftësia e grupit bankar për të rritur kapitalin dhe kërkuar likuiditetin nga tregu.

4. Fuqia e përgjithshme financiare e grupit:

- Aftësia për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për grupin bankar në rast nevojë:
 - Nëse kontrolluesi është shtetëror;
 - Profitabiliteti dhe likuiditeti i grupit;
 - Pozita e kapitalit;
 - Drejtimi strategjik;
 - Çfarëdo çështje që mund të dëmtojnë fuqinë financiare të grupit.
- Leter mbështetje nga kontrolluesi për të konfirmuar politikën e tyre për sigurimin e mbështetjes së kapitalit dhe/ose likuiditetit për grupin bankar, në rast nevojë.

5. Adekutshmëria e menaxhimit të rrezikut dhe kontrolleve të brendshme:

- Përfshirja e bordit dhe menaxhmentit të lartë në nivel grupi në menaxhimin e rrezikut;
- Mënyra në të cilën funksioni i menaxhimit të rrezikut organizohet dhe kryhet në baza të gjëra grupore;
- Procesi i grupit për menaxhimin e kapitalit;
- Procesi i grupit për menaxhimin e likuiditetit;
- Mekanizmi i grupit për kontrollet e brendshme, veçanërisht pavarësia dhe kompetenca e auditorëve të brendshëm.

Kontrolluesi pritët të dërgojë informacione në nivel të grupit tek BQK-ja në baza vjetore, apo nëse është e nevojshme më shpesh. Informacionet në nivel të grupit përfshijnë:

- Strukturën organizative të grupit;
- Përmbledhjen e kornizës së grupit për menaxhimin e rrezikut;
- Pasqyrat e konsoliduara dhe të audituara financiare dhe informacionet tjera relevante financiare të kompanisë holliding;
- Pasqyrat e audituara financiare të kompanive tjera relevante të grupit.

Kontrolluesi duhet ta njoftojë BQK-në menjëherë për çfarëdo zhvillimi në nivel të grupit që mund të ndikojë në qëndrimin e bankës/grupit bankar. Kjo përfshin:

- Çfarëdo çështje që mund të dëmtojë në mënyrë të konsiderueshme kapitalin dhe/ose likuiditetin e grupit;
- Ekspozimet e konsiderueshme financiare në grup dhe kreditimi i lidhur
- Ngarkesën e krijuar mbi asetet e grupit që do të sjellë vlerën totale të të gjitha ngarkesave të rëndësishme;
- Ekspozimet financiare të konsiderueshme brenda grupit;
- Blerjen, themelimin, shitjen apo mbylljen e çfarëdo dege me rëndësi të veçantë;
- Ndryshim të rëndësishëm në aktivitetet kryesore të çfarëdo kompanie brenda grupit;
- Ndryshimin e kryeshefit ekzekutiv apo drejtorëve të kontrolluesit.

Vlerësimi i mbikëqyrjes në grup do të përfshihet në raportin e ekzaminimit. Qëllimi kryesor është që të sigurohet një mbikëqyrje efektive në grup dhe institucionet tjera brenda grupit të sigurojnë mbështetje dhe jo të jenë burim i dobësive për bankën/grupin bankar.

O. UDHËZUESI PËR VLERËSIMIN SIPAS SISTEMIT CAMELS

Pjesët në vijim përmbajnë përkufizimet e vlerësimeve të përgjithshme dhe të komponentëve, si dhe përshkrimet dhe përkufizimet për pesë komponentet.

1. Vlerësimi i përgjithshëm

Vlerësimet e përbëra bazohen në një vlerësim të kujdesshëm të performancës menaxheriale, operacionale, financiare dhe pajtueshmërisë së një banke. Gjashtë komponentët kyç të përdorur për vlerësimin e gjendjes financiare dhe operacioneve të bankës janë: Mjaftueshmëria e **K**apitalit, kualiteti i mjeteve, aftësia e **M**enaxhmentit, sasia dhe cilësia e **F**itimeve, mjaftueshmëria e **L**ikuiditetit dhe **N**djeshmërisë ndaj rrezikut të tregut. Shkalla e vlerësimit varion nga 1 deri në 5, siç përcaktohet më poshtë:

1.1. Vlerësimi i përgjithshëm: 1

Bankat në këtë grup janë të qëndrueshme në çdo aspekt dhe në përgjithësi kanë komponentët e vlerësuar si 1 ose 2. Dobësitë janë të vogla dhe mund të trajtohen në mënyrë rutine nga bordi i drejtorve dhe menaxhmenti. Këto banka janë më të afta të përballojnë ndryshimet e papritura të kushteve të biznesit dhe janë rezistente ndaj ndikimeve të jashtme, si paqëndrueshmëria ekonomike në zonën e tyre të tregtisë. Këto banka janë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret. Si rezultat i kësaj, bankat paraqesin performancën më të fuqishme dhe praktikatat për menaxhimin e rrezikut, në krahasim me madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut dhe nuk japin shkas për shqetësim nga ana e mbikëqyrjes.

1.2. Vlerësimi i përgjithshëm: 2

Bankat në këtë grup janë thelbësisht të qëndrueshme. Që një bankë të marrë këtë vlerësim, në përgjithësi asnjë vlerësim i komponentit nuk duhet të jetë më rigoroz se 3. Janë të pranishme vetëm dobësi të moderuara dhe qëndrojnë mirë në kuadër të aftësive dhe gatishmërisë së bordit të drejtorve dhe menaxhmentit për t'u korrigjuar. Këto banka janë të qëndrueshme dhe janë në gjendje të përballojnë luhatjet e biznesit. Këto banka janë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret. Praktikatat e përgjithshme të menaxhimit të rrezikut janë më të kënaqshme në krahasim me madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të institucionit. Nuk ekzistojnë

shqetësime materiale mbikëqyrëse dhe, si rezultat, reagimi mbikëqyrës është jozyrtar dhe i kufizuar.

1.3. Vlerësimi i përgjithshëm: 3

Bankat në këtë grup paraqesin një shkallë të shqetësimit mbikëqyrës në një ose më shumë prej fushave apo komponentve që vlerësohen. Këto banka paraqesin një kombinim të dobësive që mund të variojnë nga mesatarisht të rënda deri në të rënda. Megjithatë, madhësia e mangësive në përgjithësi nuk do të shkaktojë që një komponent të vlerësohet më rigoroz se 4. Menaxhmenti mund të mos ketë aftësinë apo gatishmërinë për të adresuar në mënyrë efektive dobësitë brenda kornizave të përshtatshme kohore. Bankat në këtë grup në përgjithësi janë më pak në gjendje të përballojnë luhatjet e biznesit dhe janë më të ndjeshme ndaj ndikimeve të jashtme sesa ato të vlerësuara si 1 ose 2. Përveç kësaj, këto banka mund të mos jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Praktikrat e menaxhimit të rrezikut mund të jetë më pak se të kënaqshme në krahasim me madhësinë e bankës, kompleksitetin dhe të profilin e rrezikut. Këto banka kërkojnë më shumë se mbikëqyrje normale, të cilat mund të përfshijnë veprime formale ose joformale të zbatimit. Megjithatë, dështimi duket i pamundur, duke pasur parasysh gjendjen e përgjithshme dhe kapacitetin financiar të këtyre bankave.

Vlerësimi "3" ose më i keq do të shpejtojë veprimin mbikëqyrës të BQK-së. Mund të aplikohet një rezolutë (vendim) ndaj bordit të drejtorëve, një memorandum mirëkuptimi, një marrëveshje me shkrim ose një urdhër për ndërprerje.

1.4. Vlerësimi i përgjithshëm: 4

Bankat në këtë grup në përgjithësi paraqesin praktikrat dhe kushtet e pasigurta dhe të paqëndrueshme. Ekzistojnë mangësi serioze financiare ose menaxheriale që rezultojnë në performancë të pakënaqshme. Problemet variojnë nga ai rigoroz në deri në mangësi kritike. Dobësitë dhe problemet nuk janë duke u adresuar apo zgjidhur në mënyrë të kënaqshme nga bordi i drejtorve dhe menaxhmenti. Në përgjithësi, bankat në këtë grup nuk janë në gjendje të përballojnë luhatjet e biznesit. Ato mund të jenë në mos-përputhje të konsiderueshme me ligjet dhe rregulloret. Praktikrat e menaxhimit të rrezikut janë në përgjithësi të papranueshme në krahasim me madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të bankës. Kërkohet vëmendje e afërt mbikëqyrëse, që do të thotë, në shumicën e rasteve, për të adresuar problemet është i nevojshëm të ndërmerren masa. Dështimi është një mundësi e dallueshme në qoftë se problemet dhe dobësitë nuk janë adresuar dhe zgjidhur në mënyrë të kënaqshme.

1.5. Vlerësimi i përgjithshëm: 5

Bankat në këtë grup paraqesin praktika apo kushte jashtëzakonisht të pasigurta dhe jo të qëndrueshme, një performancë thelbësisht të mangët dhe shpesh përmbajnë praktika të papërshtatshme të menaxhimit të rrezikut në krahasim me madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të bankës. Bankat me këtë vlerësim paraqesin shqetësimin më të madh mbikëqyrës. Vëllimi dhe serioziteti i problemeve janë përtej aftësisë apo gatishmërisë së menaxhmentit për të kontrolluar apo korigjuar ato. Nevojitet menjëherë ndihmë e jashtme financiare apo ndihmë tjetër në mënyrë që banka të ketë sukses. Nevojitet vëmendje mbikëqyrëse e vazhdueshme. Bankat në këtë grup përbëjnë një rrezik të madh dhe kanë shumë potencial për dështim.

2. Vlerësimet e komponenteve

Vlerësimet e Sistemit të paralajmërimit të hershëm (Early Warning Systems) të **K**apitalit, **K**ualitetit të mjeteve, **F**itimit, **L**ikuiditetit dhe **N**djeshmërisë ndaj rrezikut të tregut (CAELS) do të përdoren si vlerësime preliminare gjatë vlerësimit të secilit komponent të CAMELS. Vlerësimet finale për secilin komponent do të përcaktohen pas marrjes në konsideratë të faktorëve tjerë të vlerësimit, siç listohen nën secilin komponent.

Secila nga përshkrimet e komponentit të vlerësimit ndahet në dy pjesë, në një listë të faktorëve kryesorë të vlerësimit që kanë të bëjnë me atë komponent dhe një përshkrim të shkurtër të çdo vlerësimi numerik për atë komponent. Disa nga faktorët e vlerësimit janë përsëritur në një ose më shumë komponentë tjerë për të përforcuar marrëdhënien reciproke ndërmjet komponentëve. Lista e faktorëve të vlerësimit për çdo vlerësim të komponentit nuk është sipas rëndësisë.

2.1. Mjaftueshmëria e kapitalit

Mjaftueshmëria e kapitalit vlerësohet në bazë të, por nuk kufizohet vetëm në një vlerësimi të faktorëve si në vijim:

- 1) Niveli dhe cilësia e kapitali dhe gjendja e përgjithshme financiare e institucionit;
- 2) Aftësia e menaxhmentit për të adresuar nevojat për kapital shtesë;
- 3) Natyra, trendi dhe vëllimi i aseteve problematike dhe mjaftueshmëria e provizioneve për humbjet e mundshme dhe rezervat tjera;

- 4) Përbërja e bilancit të gjendjes, duke përfshirë natyrën dhe shumën e pasurive të paprekshme, përqendrimin e rrezikut dhe rreziqet që lidhen me aktivitetet jo-të zakonshme;
- 5) Ekspozimi ndaj rrezikut i përfaqësuar nga aktivitetet jashtë bilancit të gjendjes;
- 6) Cilësia dhe qëndrueshmëria e të ardhurave dhe arsyeshmëria e dividendëve;
- 7) Perspektivat dhe planet për rritje, si dhe përvoja e kaluar në menaxhimin e rritjes; dhe,
- 8) Qasja në tregjet e kapitalit dhe burimet tjera të kapitalit, duke përfshirë mbështetjen e dhënë nga kompania mëmë.

Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit:

Vlerësimi 1: tregon një nivel të fortë të kapitalit në krahasim me profilin e rrezikut të bankës.

Vlerësimi 2: tregon një nivel të kënaqshëm të kapitalit në krahasim me profilin e rrezikut të bankës.

Vlerësimi 3: tregon një nivel më pak se i kënaqshëm i kapitalit që nuk e mbështet plotësisht profilin e rrezikut të bankës. Vlerësimi tregon një nevojë për përmirësim, edhe nëse niveli i kapitalit të bankës tejkalon kërkesat minimale rregullative dhe statutore.

Vlerësimi 4: tregon një nivel të mangët të kapitalit. Në vazhden e profilit të rrezikut të bankës, qëndrueshmëria e bankës mund të kërcënohet. Mund të kërkohet ndihma nga aksionarët ose burimet e tjera të jashtme për mbështetje financiare.

Vlerësimi 5: tregon një nivel kritik dhe të mangët të kapitalit të tillë sa që është e kërcënuar qëndrueshmëria e bankës. Kërkohet ndihma e menjëhershme nga aksionarët ose burimet e tjera të jashtme për mbështetje financiare.

2.2. Kualiteti i mjeteve

Kualiteti i mjeteve të një banke vlerësohet në bazë të, por nuk kufizohet vetëm në një vlerësim të faktorëve të mëposhtëm:

- 1) Përshtatshmëria e standardeve të , qëndrueshmëria e praktikave të administrimit të kredisë dhe përshtatshmëria e praktikave të identifikimit të rrezikut.
- 2) Niveli, shpërndarja, rigoroziteti dhe trendi i mjeteve problematike, të klasifikuara, jo-akruale, të ristrukturuara, me vonesa dhe mjeteve joperformuese për transaksionet si brenda dhe jashtë bilancit të gjendjes.
- 3) Mjaftueshmëria e provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë dhe lizingjet dhe rezervave të tjera sipas vlerësimit të mjeteve.
- 4) Rreziku i kredisë që del apo reduktohet nga transaksionet jashtë bilancit të gjendjes, të tilla si: zotimet e pashfrytëzuara , derivatet e kredisë, letrat komerciale të kredisë dhe letra standby së kredisë.
- 5) Diversifikimi dhe kualiteti i portfolios se kredive dhe të investimeve.
- 6) Shtrirja e aktiviteteve me letra me vlerë dhe ekspozimit ndaj palëve të ndërlidhura në aktivitetet tregtare.
- 7) Ekzistenca e përqendrimeve të mjeteve.
- 8) Mjaftueshmëria e politikave, procedurave dhe praktikave të kredisë dhe investimit.
- 9) Aftësia e menaxhmentit për të administruar siç duhet asetet e saja, duke përfshirë edhe identifikimin në kohë dhe mbledhjen e mjeteve problematike.
- 10) Mjaftueshmëria e kontrolleve të brendshme dhe sistemi i informimit të menaxhmentit.
- 11) Dokumentimi i vëllimit dhe natyrës së përjashtimeve të kredive.

Vlerësimi i kualitetit të mjeteve:

Vlerësimi 1: tregon praktika të fuqishme të administrimit të kualitetit të a dhe kredive. Dobësitë e identifikuara për nga natyra janë të vogla dhe ekspozimi i rrezikut është modest në raport me mbrojtjen e kapitalit dhe aftësitë e menaxhmentit. Kualiteti i mjeteve në banka të tilla kërkon shqetësimin minimal mbikëqyrës.

Vlerësimi 2: tregon praktika të kënaqshme të administrimit të kualitetit të mjeteve dhe kredive. Niveli dhe serioziteti i klasifikimeve dhe dobësitë tjera garantojnë një nivel të kufizuar të vëmendjes mbikëqyrëse. Ekspozimi ndaj rrezikut është në përputhje me mbrojtjen e kapitalit dhe aftësitë e menaxhmentit.

Vlerësimi 3: tregon se praktikave të administrimit të kualitetit të mjeteve dhe kredive janë më pak se të kënaqshme. Trendet mund të jenë të qëndrueshme ose tregojnë një përkeqësim në kualitetin e mjeteve ose një rritje në

ekspozimin ndaj rrezikut. Niveli dhe serioziteti i mjeteve të klasifikuara, dobësive tjera dhe rreziqeve kërkojnë një nivel të ngritur të shqetësimit mbikëqyrës. Në përgjithësi ekziston një nevojë për të përmirësuar praktikën e administrimit të kredive dhe të menaxhimit të rrezikut.

Vlerësimi 4: i caktohet bankave me praktika të mangëta të administrimit të kualitetit të mjeteve apo kredive. Nivelet e rrezikut dhe mjeteve problematike janë të konsiderueshme, të kontrolluara në mënyrë joadekuate dhe e bëjnë bankën subjekt ndaj humbjeve të mundshme që, nëse nuk kontrollohen, mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e saj.

Vlerësimi 5: paraqet praktika të mangëta të administrimit të kualitetit të mjeteve ose kredive që paraqesin rrezik të pashmangshëm për qëndrueshmërinë e bankës.

2.3. Menaxhmenti

Aftësia dhe performanca e bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit vlerësohet në bazë të, por nuk kufizohet në, një vlerësim të faktorëve si në vijim :

- 1) Niveli dhe cilësia e mbikëqyrjes dhe mbështetja e të gjitha aktiviteteve të institucioneve nga bordi i drejtorve dhe menaxhmenti.
- 2) Aftësia e bordit të drejtorve dhe menaxhmentit, në rolet e tyre përkatëse, për të planifikuar dhe reaguar ndaj rreziqeve që mund të lindin nga ndryshimi i kushteve të biznesit apo fillimin e aktiviteteve ose produkteve të reja.
- 3) Formulimi i politikave dhe procedurave dhe udhëzimeve të përshtatshme për të udhëhequr aktivitetet e biznesit të bankës.
- 4) Mjaftueshmëria dhe përputhja me politikën e duhura të brendshme dhe kontrollet që adresojnë veprimet dhe rreziqet e aktiviteteve të rëndësishme.
- 5) Saktësia, afati kohor dhe efikasiteti i sistemit të informimit të menaxhmentit dhe sistemeve për monitorimin e rrezikut të përshtatshme për madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të bankës.
- 6) Mjaftueshmëria e auditimeve dhe kontrolleve të brendshme për të promovuar operacione efikase dhe raportim të besueshëm financiar dhe rregullativ, mbrojtja e aseteve dhe sigurimi i përputhshmërisë me ligjet, rregulloret dhe politikën e brendshme.
- 7) Përgjegjshmëria në rekomandime nga auditorët dhe autoritetet mbikëqyrëse.
- 8) Vazhdimësia e menaxhmentit.
- 9) Shkalla në të cilën bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti ndikohet nga, ose është i ndjeshëm ndaj, ndikimit dominues ose përqendrimit të autoritetit.

- 10) Arsyeshmëria e politikave të kompensimit dhe shmangia e vetëtrajtitimit.
- 11) Gatishmëria e treguar për të shërbyer nevojat e shërbimeve financiare të komunitetit.
- 12) Performanca e përgjithshme e bankës dhe profili i saj i rrezikut.

Vlerësimi i menaxhmentit:

- Vlerësimi 1:** tregon performancë të fortë nga ana e bordit të drejtorve dhe menaxhmentit, si dhe praktikave të forta të menaxhimit të rrezikut në raport me madhësinë e bankës, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut. Të gjitha rreziqet e mëdha në vazhdimësi dhe në mënyrë efektive identifikohen, maten, monitorohen dhe kontrollohen apo zvogëlohen. Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti kanë treguar aftësinë për të adresuar shpejt dhe me kohë problemet dhe rreziqet ekzistuese si dhe ato potenciale.
- Vlerësimi 2:** tregon performancë të kënaqshme nga ana e bordit të drejtorve dhe menaxhmentit, dhe praktikave të kënaqshme të menaxhimit të rrezikut në raport me madhësinë e bankës, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut. Dobësitë e vogla mund të ekzistojnë, por nuk janë qenësore për sigurinë dhe shëndetin e bankës dhe janë duke u adresuar. Në përgjithësi, rreziqet dhe problemet e rëndësishme janë identifikuar në mënyrë efektive, janë matur, monitoruar, kontrolluar apo zvogëluar.
- Vlerësimi 3:** tregon performancë të bordit të drejtorve dhe menaxhmentit e cila ka kanë nevojë për përmirësim të praktikave për menaxhimin e rrezikut që janë më pak se të kënaqshme, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarive të bankës. Aftësitë e bordit të drejtorëve apo menaxhmentit mund të jenë të pamjaftueshme për llojin, madhësinë apo kushtet e bankës. Problemet dhe rreziqet e mëdha mund të jenë identifikuar, matur, monitoruar, kontrolluar apo zvogëluar në mënyrë joadekuate.
- Vlerësimi 4:** tregon mangësi në performancën e bordit të drejtorve dhe menaxhmentit ose në praktikave për menaxhimin e rrezikut që janë joadekuate duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve të një institucioni. Niveli i problemeve dhe rrezikut të ekspozimit të bankës është i lartë. Problemet dhe rreziqet e mëdha janë identifikuar, matur, monitoruar, kontrolluar apo zbutur në mënyrë joadekuate prandaj kërkohet veprim i menjëhershëm nga bordi i drejtorve dhe menaxhmenti për të ruajtur qëndrueshmërinë e bankës. Zëvendësimi ose forcimi i bordit të drejtorëve ose menaxhmentit mund të jetë i nevojshëm.

Vlerësimi 5: tregon performancë kritike dhe të mangët të bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit apo praktikat e dobëta të menaxhimit të rrezikut. Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti nuk kanë demonstruar aftësi për të korigjuar problemet dhe për të zbatuar praktika të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut. Problemet dhe rreziqet e theksuara janë identifikuar, matur, monitoruar, kontrolluar ose zbutur në mënyrë joadekuate, ndaj tani kërcënojnë qëndrueshmërinë e bankës në vazhdimësi. Zëvendësimi ose forcimi i bordit të drejtorëve apo menaxhmentit është i nevojshëm.

2.4. Fitimet

Vlerësimi i fitimeve të bankës bazohet por nuk është i kufizuar, në një vlerësim të faktorëve të mëposhtëm të vlerësimit:

- 1) Niveli, trendet dhe stabiliteti i të ardhurave.
- 2) Aftësia e bankës për të siguruar kapital të mjaftueshëm përmes fitimeve të mbajtura.
- 3) Cilësia dhe burimet e fitimeve.
- 4) Niveli i shpenzimeve në lidhje me operacionet.
- 5) Përshtatshmëria e sistemeve të buxhetimit, proceseve të parashikimit dhe sistemi i informimit të menaxhmentit në përgjithësi.
- 6) Mjaftueshmëria e mbajtjes së provizioneve për humbje nga kreditë dhe lizingjet.
- 7) Ekspozimi i fitimeve ndaj rrezikut të tregut.

Vlerësimi i fitimeve:

Vlerësimi 1: tregon fitime të forta. Fitimet janë më se të mjaftueshme për të mbështetur operacionet dhe për ruajtjen e kapitalit adekuat dhe nivelet e kompensimit/lejueshmërisë pasi që të jetë marrë parasysh cilësia e aseteve, rritja dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në cilësinë, sasinë dhe trendin e fitimeve.

Vlerësimi 2: tregon të ardhurat që janë të kënaqshme. Fitimet janë të mjaftueshme për të mbështetur operacionet, si dhe ruajtjen e niveleve adekuate të kapitalit dhe kompensimit/lejueshmërisë kur kihet parasysh cilësia e aseteve, rritja dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në cilësinë, sasinë dhe trendin e fitimeve. Fitimet që janë relativisht statike, apo që janë duke përjetuar një rënie të lehtë, mund të marrin kategorizimin 2 me kusht

që niveli i fitimeve të bankës është adekuat në aspektin e faktorëve vlerësues të listuar më sipër.

Vlerësimi 3: tregon fitimet që duhet të përmirësohen. Fitimet mund të mos i mbështesin plotësisht operacionet dhe të sigurojnë akumulimin e niveleve të kapitalit dhe shumave të shpenzimeve në raport me gjendjen e përgjithshme të bankës, rritjen dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në cilësinë, sasinë dhe trendin e fitimeve.

Vlerësimi 4: tregon fitimet që janë të mangëta. Fitimet janë të pamjaftueshme për të mbështetur operacionet dhe ruajtjen e niveleve adekuate të kapitalit dhe shpenzimeve. Bankat e kategorizuara kështu mund të karakterizohen nga luhatje të parregullta në të ardhurat neto ose në margjinën e neto interesave, zhvillimin e trendeve të theksuara negative, fitime nominale ose të paqëndrueshme, humbjet të përhershme, ose një rënie substanciale në fitime nga vitet e kaluara.

Vlerësimi 5: tregon të ardhurat që kanë mangësi kritike. Fitimet e kategorizuara si 5 tregojnë humbjet që paraqesin një kërcënim të veçantë për qëndrueshmërinë e një banke përmes rënies së kapitalit.

2.5. Likuiditeti

Likuiditeti është vlerësuar në bazë të, por jo i kufizuar në, një vlerësim të faktorëve të mëposhtëm:

- 1) mjaftueshmëria e burimeve të likuiditetit krahasuar me nevojat e tanishme dhe të ardhshme si dhe aftësia e bankës për të përmbushur nevojat për likuiditet pa ndikuar negativisht në operacionet apo gjendjen e saj.
- 2) Disponueshmëria e asetëve lehtësisht të konvertueshme në para të gatshme pa humbje të panevojshme.
- 3) Qasja në tregjet e parave dhe burimet e tjera të financimit.
- 4) Niveli i diversifikimit të burimeve të financimit, si ato bilancore ashtu edhe ato jashtëbilancore.
- 5) Shkalla e mbështetjes në burimet e paqëndrueshme afatshkurtëra, përfshirë huazimet dhe depozitat e afatizuara për të financuar asetet afatgjata.
- 6) Trendi dhe stabiliteti i depozitave.
- 7) Aftësia e menaxhmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar ose zvogëluar pozicionin e likuiditetit të bankës duke përfshirë efikasitetin e

strategjive të menaxhimit të fondeve, politikave të likuiditetit, MIS dhe planet e financimit të paparashikuar.

Vlerësimi i likuiditetit:

- Vlerësimi 1:** tregon nivele të forta të likuiditetit dhe praktikave të zhvilluara mirë për menaxhimin e fondeve. Banka ka qasje të besueshme në burime të mjaftueshme të fondeve me kushte të favorshme për të përmbushur nevojat e tanishme dhe ato të parashikuara për likuiditet.
- Vlerësimi 2:** tregon nivele të kënaqshme/pranueshme të likuiditetit dhe praktikave të menaxhimit të fondeve. Banka ka qasje në burime të mjaftueshme të fondeve me kushte të pranueshme për të përmbushur nevojat e tanishme dhe ato të parashikuara për likuiditet. Dobësi të vogla mund të vërehen në praktikave të menaxhimit të fondeve.
- Vlerësimi 3:** tregon nevojën për përmirësim të niveleve të likuiditetit ose praktikave për menaxhimin e fondeve. Banka e kategorizuar si 3 mund të mos ketë qasje të menjëhershme në fonde, me kushte të arsyeshme, si dhe mund të evidentohen dobësi të theksuara në praktikave të menaxhimit të fondeve.
- Vlerësimi 4:** tregon mangësi kritike në nivelet e likuiditetit ose praktika joadekuate të menaxhimit të fondeve. Bankat e kategorizuara 4 nuk mund të kenë ose të jenë në gjendje që të sigurojnë një vëllim të mjaftueshëm të fondeve me kushte të arsyeshme për të plotësuar nevojat për likuiditet.
- Vlerësimi 5:** tregon nivelet e likuiditetit ose praktikave të menaxhimit të fondeve që kanë mangësi kritike duke kërcënuar në vazhdimësi qëndrueshmërinë e bankës. Bankat e kategorizuara si 5 kanë nevojë për ndihmë të menjëhershme financiare të jashtme për të përmbushur detyrimet në maturim apo nevojat e tjera të likuiditetit.

2.6. Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut

Komponenti i ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut, reflekton shkallën në të cilën ndryshimet në normën e interesit, normat e këmbimit valutor, çmimet e mallrave ose të aksioneve, ndikojnë në fitimet ose kapitalin ekonomik të bankës. Kur vlerësohet ky komponent, duhet marrë në konsideratë:

- 1) aftësinë e menaxhimit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar apo zvogëluar rrezikun e tregut;
- 2) madhësinë e institucionit;

- 3) natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të bankës; dhe
- 4) mjaftueshmërinë e kapitalit dhe fitimeve të saj në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut të tregut.

Dy komponentët më të zakonshëm të ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut janë normat e interesit dhe këmbimeve valutore, për të cilat faktorët e vlerësimit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në të poshtëshënuarat:

- 1) ndjeshmëria e fitimeve të institucionit apo vlera ekonomike e kapitalit të saj ndaj ndryshimeve negative në normat e interesit dhe këmbimeve valutore;
- 2) aftësia e menaxhmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar apo zvogëluar ekspozimin ndaj rrezikut të tregut duke marrë parasysh madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të institucionit;
- 3) natyra dhe kompleksiteti i ekspozimit ndaj rrezikut të tregut, që rrjedhin nga pozicionet jo të tregtueshme.
- 4) natyra dhe kompleksiteti i ekspozimit ndaj rrezikut të tregut, që rrjedhin nga pozicionet tregtare.

Vlerësimi i ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut:

Vlerësimi 1: tregon se ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut është e kontrolluar mirë dhe se ka potencial minimal që performanca e fitimeve apo pozita e kapitalit do të ndikohen negativisht. Praktikrat për menaxhimin e rrezikut janë të forta për nga madhësia, sofistikimi dhe rreziku i tregut i pranueshëm nga banka. Niveli i të ardhurave dhe kapitalit ofrojnë mbështetje të konsiderueshme për shkallën e rrezikut të tregut të marrë përsipër nga banka.

Vlerësimi 2: tregon se ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut është e kontrolluar në mënyrë adekuate dhe se ka vetëm potencial të vogël që performanca e fitimeve ose pozita e kapitalit do të ndikohen negativisht. Praktikrat e menaxhimit të rrezikut janë të kënaqshme për nga madhësia, sofistikimi, dhe niveli i rrezikut të pranuar nga banka. Niveli i fitimeve dhe kapitalit siguron mbështetjen e duhur për shkallën e rrezikut të tregut të marrë përsipër nga institucioni.

Vlerësimi 3: tregon se kontrolli i ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut ka nevojë për përmirësim apo që ka potencial të theksuar që performanca e fitimeve ose pozicioni i kapitalit do të ndikohen negativisht. Praktikrat e menaxhimit të rrezikut duhet të përmirësohen duke pasur parasysh

madhësinë, sofistikimin, dhe nivelit të rrezikut të marrë përsipër nga banka. Niveli i fitimeve dhe kapitalit mund të mos mbështesë në mënyrë adekuate shkallën e rrezikut të tregut të marrë përsipër nga banka.

Vlerësimi 4: tregon se kontrolli i ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut është i papranueshëm ose që ekziston potencial i lartë që performanca e fitimeve apo pozita e kapitalit do të ndikohen negativisht. Praktikrat e menaxhimit të rrezikut janë të mangëta për nga madhësia, sofistikimi, dhe niveli i rrezikut të pranuar nga banka. Niveli i të ardhurave dhe kapitali ofrojnë mbështetje të pamjaftueshme për shkallën e rrezikut të tregut të marrë sipër nga banka.

Vlerësimi 5: tregon se kontrolli i ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut është i papranueshëm ose që niveli i rrezikut të marrë përsipër nga banka është një kërcënim i pashmangshëm për qëndrueshmërinë e saj. Praktikrat e menaxhimit të rrezikut janë tërësisht joadekuate për nga madhësia, sofistikimi, niveli i rrezikut që ka marrë përsipër banka.

3.5. Hapi 6 – Ekzaminimet nga jashtë (off-site)

3.5.1. Objektivat

- Për të qenë në rrjedha me ngjarjet dhe ndryshimet në profilin e rrezikut të bankës.
- Për të siguruar aplikimin në kohë të veprimeve korrigjuese dhe për t'u siguruar se këto veprime janë duke arritur rezultatet e dëshiruara.

3.5.2. Përshkrimi

Qëllimi i mbikëqyrjes nga jashtë (off-site) është i dyzuar: analiza në vazhdimësi e të dhënave financiare bankare periodike dhe rishikimet e vazhdueshme për t'u siguruar se masat korrigjuese janë marrë në kohën e duhur dhe se nga këto masa janë arritur rezultatet e dëshiruara.

BQK-ja vlerëson rreziqet në baza të vazhdueshme përmes analizave mujore bazuar në dhënat financiare të pranuar nga çdo bankë. Kjo i jep mundësinë BQK-së për të monitoruar dhe vlerësuar pozitën dhe performancën aktuale të çdo banke, si dhe atë të industrisë gjatë periudhave të ndryshme kohore. Kjo sjell mbylljen e ciklit mbikëqyrës pasi kthehet në hapat 1 dhe 2 të procesit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

Ekzaminerët duhet të jenë në gjendje që të monitorojnë në vazhdimësi gjendjen financiare të bankave. Mbasi që nuk është e mundur prezenca e vazhdueshme në

teren, sistemi i mbikëqyrjes nga jashtë, shpesh i quajtur monitorim, është bërë një metodë e pranuar gjerësisht brenda mbikëqyrjen bankare.

Ekzaminerët nga jashtë shqyrtojnë raportet periodike të paraqitura në autoritetin mbikëqyrës. Këto raporte analizohen për qëllime të mbikëqyrjes së kujdesshme duke rishikuar të dhënat financiare. Analistët financiar (ekzaminerët) i përdorin këto të dhëna për të identifikuar fushat e mundshme problematike në fazë të hershme. Në një sistem funksional të mbikëqyrjes bankare, problemet apo mangësitë e zbuluara nëpërmjet mbikëqyrjes nga jashtë paraqesin nevojën për ekzaminime në vend.

Mbikëqyrja nga jashtë ka disa avantazhe, të tilla si:

- Monitorimin e bankave në mënyrë të rregullt, të paktën çdo tre muaj, ose çdo muaj, madje edhe çdo javë në disa fusha kyçe të tilla si likuiditeti.
- Krahasimi i bankave me njëra - tjetrën duke përdorur një bazë të dhënash standarde dhe të dhëna të tilla që përpunohen lehtë në kompjuter.
- Nevojitet më pak staf për mbikëqyrjen nga jashtë dhe bëhet plotësimi i punës intensive të mbikëqyrjes në vend.
- Zbulimi i shpejtë i ndryshimeve në pozicionet financiare në mes të ekzaminimeve në vend.
- Alokimi i burimeve të vlefshme në planifikimin e ekzaminimit duke identifikuar fushat me interes dhe duke zgjedhur kohën dhe qëllimin e duhur të ekzaminimit.

Është po njësoj e rëndësishme të kuptohen të metat që shpesh karakterizojnë mbikëqyrjen nga jashtë (off-site):

- Nëse standardet e duhura të kontabilitetit nuk janë përcaktuar dhe vënë në zbatim, të dhënat mund shpesh të jetë çorientuese apo të pasakta.
- Të dhënat e paraqitura mund të jenë të pasakta ose jo të plota, veçanërisht për bankat me një rrjet të gjerë degësh. Të dhënat që përdoren shpesh nuk janë të hartuara për qëllime të prudencës, veçanërisht nëse qëllimi kryesor i raportimit financiar është për politikën monetare apo për qëllime statistikore.
- Të dhënat jo gjithmonë evidentojnë fushat problematike dhe nuk ofrojnë arsye për ekzistencën e problemeve të tilla.

Kompjuterizimi i raportimit i ofron BQK-së raportet e prudencës nga një sërë raportesh të ndryshme të paraqitura në bankë. Raporte të tilla përdoren si indikatorë mbi kapitalin, kualitetin e mjeteve, fitimet, likuiditetin si dhe ndjeshmërinë ndaj tregut (CAELS). Duke përdorur këto të dhëna, raportet për të gjitha bankat, analistët përdorin dy metoda bazë për analizë:

- Analiza e trendit: ku analisti kërkon të shohë nëse disa tregues kyç tregojnë trend përmirësimi apo përkeqësimi me kalimin e kohës. Një shembull i kësaj do të ishte raporti i kredive me vonesa ose kredive jo përformuese ndaj totalit të kredive; nëse raporti është në rritje, kjo mund të jetë një shenjë se kualiteti i mjeteve është duke u dobësuar.
- Analiza e grupit të njëjtë të bankave (peer group): ku banka krahasohet me banka të tjera me karakteristika të ngjashme duke përdorur disa tregues kyç. Kjo lloj analize do të tregojë, për shembull, nëse raporti i kapitalit të një banke është më i lartë në krahasim me bankat e tjera të përmasave të ngjashme ose në qoftë se një banke me raport të ulët apo në rënie në krahasim me bankat e ngjashme ka nevojë për më shumë vëmendje nga ana e mbikëqyrjes.

Duke përdorur analizën e trendit dhe atë të grupit të njëjtë të bankave nga të dhënat e raportuara ekzaminerët zbulojnë fushat e dobëta apo problemet që lindin në bankë të cilat duhet të pasohen me shqyrtim të mëtejshëm, zakonisht duke kryer një ekzaminim në vend ose takime me udhëheqës të bankës.

Është e rëndësishme të kuptohet se analiza nga jashtë është vetëm një hap në procesin e mbikëqyrjes. Ajo duhet të jetë e integruar plotësisht në të gjithë procesin, veçanërisht me ekzaminimet në vend në mënyrë që të jetë me të vërtetë efektive. Mbikëqyrja off-site mund të ndihmojë në ofrimin e disa paralajmërimeve të hershme për zonat me problem potencial në bankë, por ajo nuk mund në vetvete të jetë një sistem i plotë për mbikëqyrjen efektive të bankave.

Monitorimi i Masave Korrigjuese - pasi banka është këshilluar mbi fushat tek të cilat masa korrigjuese janë të nevojshme dhe të pritshme, BQK-ja kryen periodikisht shqyrtime të kohpaskohshme për t'u siguruar mbi zbatimin në kohë të masave korrigjuese.

Objektivi i këtyre rishikimeve të kohpaskohshme është të vlerësojë zbatimin e direktivave mbikëqyrëse dhe rekomandimet e bëra për këtë institucion. Ekzamineri përgjegjës për bankën e caktuar mban në vazhdimësi një listë të çështjeve të ngritura gjatë ekzaminimit në vend, si dhe të analizave nga jashtë për t'u diskutuar me menaxhmentin e institucionit brenda një afati kohor të specifikuar. Këto rezultate jo vetëm që i komunikohen bankës, por përfshihen edhe në përditësimet e Përmbledhjes Institucionale.

3.5.3. Procedurat

Analizat e vazhdueshme nga jashtë:

I. Pranimi i raporteve financiare nga bankat:

- A. Shënimin e datës kur janë pranuar të dhënat;
 - B. Kontaktoni bankën nëse raporti nuk është pranuar deri në datë 15 të çdo muaji;
 - C. Nëse të dhënat nuk janë pranuar ashtu si janë kërkuar, kontaktoni bankën dhe kërkonit shpjegim për vonesën e raportit dhe siguronit datën e dërgimit nga banka;
 - D. Në qoftë se një bankë vazhdimisht dorëzon me vonesë raportet e saj, bëni një rekomandim për të ndërmarrë masa korrigjuese;
- II. Rishiko të dhënat e pranuar me gabime materiale, të tilla si tabelat të pakompletuara apo gabime të cilat janë në kundërshtim me udhëzimet e BQK-së mbi raportimin.
- A. Sigurohuni që numrat dhe format të përputhen.
 - B. Identifikoni gabimet që janë bërë vazhdimisht nga shumica e bankave. Në këtë rast, udhëzimet e BQK-së për raportim mund të kenë nevojë të rishikohen apo qartësohen.
- III. Përgatituni për të përfunduar dhe/ose përditësuar përmbledhjen e gjendjes së bankës.
- A. Shqyrtoni raportet e fundit nga ekzaminimet dhe vlerësimet CAMELS për secilën bankë individualisht.
 - B. Shqyrtoni çdo dokument në lidhje me çdo masë të ndërmarrë nga BQK kundrejt bankës.
 - C. Rishikoni korrespondencat me bankën për çdo letër ndërmjet BQK-së dhe bankës, artikujt e revistave dhe gazetave që kanë të bëjnë me aktivitetet e bankës dhe personelin e saj, publicitetin e pa rregullt, ngjarjet negative ekonomike në komunitet dhe në vendin e origjinës së një banke me pronësi të huaj, fatkeqësitë natyrore, vdekjen apo zhdukjen e ndonjë bankieri, angazhimin me barrë të madhe financiare në një institucionin financiar si një sponsor në një projekt të madh apo zhvillimor, etj.
 - D. Rishikoni çdo aplikacion për licencim, qoftë i miratuar më parë apo në pritje, të tilla si shkrirjet, blerjet, ose themelimet e degëve apo filialeve të reja.
 - E. Rishikoni të dhënat e ndërlidhura me bankën të tilla si ndryshim të auditorit të jashtëm, përvetësime të mëdha, pagesë më të lartë apo më të ulët të kredive të klasifikuara më parë.

IV. Kompletoni dhe/ose përditësoni përmbledhjen institucionale të bankës.

A. Gjendja e përgjithshme: Përmbli dhni komentet mbi gjendjen e përgjithshme të bankës bazuar në nivelin e shqetësimit, vlerësimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe përshtatshmërinë e pikëpamjes së menaxhmentit. Çdo çështje kyçe/shqetësim në lidhje me strategjitë e përdorura duhet gjithashtu të theksohet.

B. Përmbledhje mbi bankën:

1. Përshkrimi: Shikoni historinë e bankës në pika të shkurta, ndër të tjera, datën e themelimit, ndryshimet në emër (nëse ka), shkrirjet dhe blerjet, konvertimet e licencës bankare, etj.
2. Struktura e aksionarëve: Evidentoni emrat e aksionarëve që zotërojnë 10% ose më shumë të aksioneve në qarkullim, numrin e aksioneve të mbajtura dhe përqindjen e aksioneve gjatë tre viteve të fundit. Në qoftë se banka është në pronësi të një firme ose kompanie mëmë, këto të dhëna të përftohen edhe për kompaninë apo strukturën aksionare mëmë – për aq sa ka njohuri. (Rishikim të raporteve vjetore të firmës ose kompanisë mëmë për të marrë këtë informacion).
3. Struktura e kapitalit: Struktura e kapitalit të bankës gjatë tre viteve të fundit në formë tabelle.
4. Organizatat e ndërlidhura: Të paraqitura në formë tabelle, degët e bankës, nëndegët dhe çdo organizatë tjetër përkatës që tregon përqindjen nën pronësinë e bankës për secilën – apo sesi është e ndërlidhur organizata.
5. Vizioni, misioni dhe strategjia: konstatoni vizionin, misionin, vlerat, qëllimet strategjike dhe iniciativat e bankës. Komentoni iniciativat strategjike, parashikimet, projeksionet e bankës për zonat kyç të performancës, projektin buxhetor, dhe/ose tregjet dhe produktet e reja.
6. Linjat kryesore funksionale: Identifikoni linjat dhe produktet kryesore funksionale të ofruara nga banka. Gjithashtu përfshini shërbimet kryesore mbështetëse të tilla si teknologjia e informimit dhe komunikimit.
7. Korniza për menaxhimin e rrezikut: ofroni detaje të strukturave të menaxhimit të rrezikut, sistemeve dhe procedurave të përdorura për të menaxhuar rreziqet e ndryshme që paraqiten në operacionet e bankës. Rolet dhe përgjegjësitë e individëve dhe departamenteve të përfshira në procesin e menaxhimit të riskut duhet të shqiptohen qartë. Raportet e bordit të drejtorve dhe ato të udhëheqësisë së lartë, limitet ekzistuese dhe aftësitë e sistemeve të teknologjisë informative duhet të adresohen.

8. Rrjeti i degëve: shënosi numrin e degëve, agjencive, dhe pikave të tjera të përfaqësimit si dhe adresat e tyre përkatëse.
9. Përbërja e stafit: shënosi numrin e përgjithshëm të të punësuarve, duke treguar stafin menaxherial dhe jomenaxherial të bankës. Kur është e nevojshme, komentoni mbi përshtatshmërinë e kapitalit njerëzor veçanërisht në fushat kyçe operative, në lidhje me numrin, kualifikimet dhe aftësitë e tyre.
10. Auditorët e jashtëm: tregoni emrat, adresat, numrat e telefonit të auditorëve dhe avokatëve të ngarkuar dhe tregoni numrin e viteve gjatë të cilave këta auditorë dhe avokatë kanë ofruar shërbim për bankën. Përveç kësaj, merrni të dhëna për detyra të tjera të konsulencës që ata mund t'i kenë ofruar bankës.
11. Bordi i drejtorëve: paraqitni në formë table, emrat, moshën, profesionet, kualifikimet, përvojën, dhe udhëheqësi të tjera të të gjithë anëtarëve të bordit të dhe kompanive në të cilat ata kanë aksione. Për më tepër, anëtarët e bordit të drejtorëve duhet të tregojë në mënyrë eksplicite çdo marrëdhënie tjetër biznesi që ata apo bashkëshortët/et e tyre kanë me bankën.
12. Menaxhmenti i lartë: paraqitni në formë table, emrat, moshën, kualifikimet dhe përvojën e të gjithë menaxherëve të lartë dhe kompanitë në të cilat ata kanë aksione. Për më tepër, menaxhmenti i lartë duhet të zbulojë në mënyrë eksplicite çdo marrëdhënie tjetër të biznesit që ata apo bashkëshortët/et e tyre kanë me bankën.
13. Komitetet e bordit të drejtorëve: paraqitni përbërjen e komiteteve të ndryshme të bordit të drejtorëve dhe termat e tyre të referencës. Komentoni ndonjë parregullsi.
14. Komitetet e menaxhmentit: Paraqitni përbërjen e komiteteve të ndryshme të menaxhmentit dhe termat e tyre të referencës. Komentoni ndonjë parregullsi.
15. Pasqyrë e menaxhmentit: Komentoni mbi mjaftueshmërinë e mbikëqyrjes së bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit në drejtim të:
 - a. Kuadrit të përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut;
 - b. Politikat dhe procedurat në fushat kyçe të rrezikut;
 - c. Sistemet e kontrollit të brendshëm;
 - d. Planifikimit strategjik dhe hartimin e politikave.

Gjithashtu komentoni mbi sistemin e informimit të menaxhmentit në aspektin e besueshmërisë dhe të prodhimit në kohë të raporteve financiare dhe/ose raporteve të kërkuara nga rregullatori.

16. Njëzet huamarrësit më të mëdhenj: Paraqitni në formë tabele, njëzet huamarrësit më të mëdhenj duke treguar partnerët, limitin, bilancin aktual, dhe datën e maturimit, natyrën e ekspozimit, dhe llojin e kolateralit. Më tej, paraqitni shumën e papaguar të huasë për çdo huamarrës si përqindje të kapitalit rregullator.
17. Njëzet depozituesit më të mëdhenj: Paraqitni në formë tabele, njëzet depozituesit më të mëdhenj duke treguar emrin e klientit, shumën dhe llojin e depozitës. Përveç kësaj, tregoni normën e interesit të afatizimit.
18. Pozicionimi në industri: Paraqitni në formë tabele, pozicionin e bankës në raport me bankat e tjera të të njëjtit nënsektor. Tregoni shumën e përgjithshme të depozitave, kredive, aseteve dhe kapitalin e përgjithshëm sipas shumës, përqindjes dhe pjesëmarrjes në treg.

C. Rezultatet e ekzaminimit, gjetjet e auditimit dhe të vlerësimit të jashtëm kreditor.

1. Rezultatet e ekzaminimeve të kaluara në vend: paraqitni në formë tabele, rezultatet e tri ekzaminimeve të fundit në vend duke treguar vlerësimin e përgjithshëm respektiv dhe atë CAMELS si dhe vlerësimin e rrezikut.
2. Gjetjet materiale (signifikante) nga ekzaminimi i fundit në vend: Përmbledhni gjetjet materiale të ekzaminimit të fundit në vend.
3. Gjetjet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm: Përmbledhni materiale (signifikante) të kontroleve më të fundit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe pikat kryesore të takimeve - përmyllëse me auditorët.
4. Vlerësimi i jashtëm kreditor: Tregoni rezultatet e vlerësimit më të fundit të bërë nga banka për veten apo nga kompania mëmë. Paraqitni vlerësimin, datën kur është realizuar vlerësimi, si dhe emrin e kompanisë ose agjencisë vlerësuese.

D. Analiza nga jashtë (sipas të dhënave të fundit):

Bëni një përmbledhje të konkluzioneve të përgjithshme mbi bankën, bazuar në kthimet financiare më të fundit, dhe komentoni mbi sa vijon (shihni Shtojcën X: Përmbledhjen e treguesve kryesor):

1. D1 – Mjaftueshmëria e kapitalit
2. D2 – Kualiteti i mjeteve

3. D3 – Menaxhmenti
4. D4 – Fitimet
5. D5 – Menaxhimi i likuiditetit dhe i fondeve
6. D6 – Ndjeshmëria ndaj rrezikut të tregut

E. Shkeljet e ligjit dhe mospajtueshmëria me kërkesat rregullative dhe mbikëqyrëse:

Komentoni mbi pajtueshmërinë e bankës me legjislacionin në fuqi. Theksoni çdo shkelje që është vërejtur dhe veprimin e ndërmarrë ose që do të merret.

F. Shqyrtimi i rrethanave të jashtme:

Identifikoni dhe komentoni mbi çfarëdo faktori të jashtëm mjedisor që mund të kenë ndikim negativ në operacionet dhe gjendjen e bankës; për shembull, prona, borxhet dhe tregjet e kapitalit, si dhe kushtet e tjera të rëndësishme ekonomike.

G. Qëndrueshmëria financiare dhe vlerësimi i stres testit:

1. Shqyrtimi i Stabilitetit Financiar: Komentoni mbi performancën financiare të bankës, përparësitë dhe, dobësitë emrit, dobësitë dhe efektin e përhapjes së dobësive (contagion effect) në sistemin financiar, në rast të vonesës.
2. Tregoni supozimet dhe rezultatet e stres testit të kryer nga Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare, departamentet e tjera brenda BQK-së, si dhe nga vetë banka.

V. Kompletoto dhe/ose përditëso matricën e rrezikut:

- A. Përcakto sasinë apo nivelin e rrezikut të vetvetishëm në çdo fushë funksionale ose aktivitet;
- B. Vlerëso përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rrezikut për të menaxhuar rreziqet për secilën fushë funksionale;
- C. Përcakto profilin e rrezikut për çdo fushë funksionale;
- D. Përcakto profilin e rrezikut të përgjithshëm të vetvetishëm për çdo rrezik të vetvetishëm në bankë;

- E. Vlerëso përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të rrezikut të përgjithshëm për çdo rrezik të vetvetishëm në bankë (për sistemin e menaxhimit të rrezikut dhe bazat e përgjithëshme);
 - F. Vlerëso përbërjen e rrezikut të përgjithshëm për çdo rrezik të vetvetishëm në bankë;
 - G. Përcakto drejtimin e rrezikut të përgjithshëm për çdo rrezik të vetvetishëm në bankë;
 - H. Përcakto rrezikun e përgjithshëm të vetvetishëm në të gjithë bankën, sistemet e përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, rrezikun e përgjithshëm të përbërë, dhe drejtimin e rrezikut të përgjithshëm të përbërë.
- VI. Kompletimi me shkrim vlerësimin e rrezikut i cili duhet të përfshijë si në vijim:
- A. Një vlerësim të përgjithshëm të rrezikut të bankës;
 - B. Llojet e rreziqeve të vetvetishme, nivelin dhe drejtimin e tyre;
 - C. Identifikimin e të gjitha funksioneve kryesore, linjave të biznesit, dhe produkteve prej nga rrjedhin rreziqe të mëdha;
 - D. Një përshkrim të sistemit të menaxhimit të rrezikut në bankë;
 - E. Ndërlidhjen ndërmjet gjasave për ndodhjen e një ngjarje të pafavorshme dhe ndikimi që mund të shkaktojë ajo në bankë; dhe,
 - F. Një koment mbi sistemin e konsoliduar të menaxhimit të rrezikut dhe funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.
- VII. Monitorimi i masave korrigjuese:
- A. Merrni dhe rishikoni korrespondencën e kohëve të fundit dhe raportet të tjera të paraqitura nga banka.
 - B. Krahaso hapat e ndërmarrë me ato që janë kërkuar nga BQK-ja.
 - C. Kryej analiza të fushave me shqetësim për të konstatuar nivelin e përmirësimit, nëse ka.
 - D. Bazuar në rezultatet e pikës III, përcaktoni masat mbikëqyrse që duhen ndjekur dhe përditësuar në Planin e Mbikëqyrjes, nëse është e nevojshme, për të pasqyruar një nga sa vijon: vazhdo të ndjekësh planin e mbikëqyrjes; shto afatet kohore të raportimit; cakto kohën për ekzaminimet e fokusuara; ndrysho masat korrigjuese. Nëse është e nevojshme, paraqit planin e mbikëqyrës të rishikuar menaxhimentit të departamentit për miratim.

3.5.4. Shtojca X: Përmbledhje e treguesve kryesor

1. **Kreditë joperformuese / kreditë mesatare ose kreditë bruto:** nëse > 10 për qind, atëherë kualiteti i mjeteve duhet të monitorohet nga afër.
2. **Kreditë jopërformuese / kapitali i përgjithshëm:** nëse > 35 për qind, kualiteti i mjetevedhe kapitali duhet të monitorohet nga afër. Nëse > 100 për qind, atëherë banka duhet të konsiderohet si institucion problematik.
3. **Rezervat për humbjet në kredi dhe lizing / kreditë bruto:** nëse < 1 përqind banka duhet të inkurajohet të rritë Lejimet për humbjet në kredi dhe lizing në baza të rregullta.
4. **Kreditë jo performuese / provizionet për humbjet në kredi dhe lizing:** nëse provizionet për humbjet në kredi dhe lizing janë të pamjaftueshme për të mbuluar kreditë jo performuese, atëherë rezervat për humbjet në kredi dhe lizing janë shumë të pamjaftueshme.
5. **Humbjet neto / mesatarja e nivelit të kredive:** nëse raporti është i lartë kur krahasohet me banka të njëjta ose kur krahasohet me të dhënat historike të bankës, atëherë kërkoni shpjegim pse është kështu.
6. **Investimet e përkohshme (afatshkurta) / gjithsej mjetet:** Duhet të jenë të mjaftueshme të shfrytëzohen si burim sekondar i likuiditetit nëse është e nevojshme (standardi është të paktën 10 për qind).
7. **Investimet e përkohshme (afatshkurta) / detyrimet paqëndrueshme (afatshkurtra):** reflekton se sa detyrime të paqëndrueshme janë financuar nga mjetet afatshkurtra. Nëse janë financuar < 100 për qind sigurohuni që menaxhmenti e ka një plan apo mënyrë për pagim të detyrimeve të paqëndrueshme nëse lind nevoja.
8. **Kreditë neto / depozitat bazë:** nëse > 100 për qind sigurohuni që menaxhmenti e kupton se çdo rritje e mëtejshme e kredive do të financohet nga detyrimet e paqëndrueshme. Kështu që, çdo kredi e re duhet të jetë e kualitetit të lartë dhe afat shkurtër. Sigurohuni që banka nuk po financon kredi afatgjatë me detyrime të paqëndrueshme afat shkurtër.
9. **Varësia nga detyrimet e paqëndrueshme:** nëse është pozitive do të thotë se detyrimet e paqëndrueshme, të cilat do të mund të lënë bankën shpejt, po financojnë mjetet afatgjata. Përcaktoni se sa gjatë menaxhmenti synon të mbetet në këtë pozitë dhe vlerësoni rrezikun e përgjithshëm në bankë.
10. **Kreditë neto / totali i depozitave:** nëse raporti është > 70 për qind rritja e kredisë duhet të monitorohet nga afër dhe menaxhmenti i bankës, duhet të inkurajohet që të zvogëlojë ndonjë rritje të mëtejshme në portofolin e kredisë.

11. **Kthimi mesatar në mjete (RoAA):** trendi historik i bankës është i rëndësishëm, dhe krahasimi me bankat e njëjta duhet të analizohet. Mbaj shënim çdo devijim të rëndësishëm.
12. **Margjina neto e interesit (NIM):** trendi është shumë i rëndësishëm si dhe krahasimi me bankat e njëjta. Shënoni çdo divergjencë.
13. **Shpenzimet neto nga jo interesi ndaj mjeteve mesatare:** Trendi është shumë i rëndësishëm si dhe krahasimi me bankat e njëjta. Shënoni çdo divergjencë.
14. **Mjetet mesatare / numri i stafit me kohë të plotë:** Trendi është shumë i rëndësishëm si dhe krahasimi me bankat e njëjta. Shënoni çdo divergjencë.
15. **Shpenzimet mesatare të stafit me kohë të plotë / Numri i stafit me kohë të plotë:** Trendi është shumë i rëndësishëm si dhe krahasimi me bankat e njëjta. Shënoni çdo divergjencë.
16. **Kapitali i klasit të parë / mjetet e peshuara me rrezik:** Nëse është nën kërkesat rregullative të BQK-së, bankës duhet t'i kërkohej që menjëherë të jetë në pajtueshmëri konform kërkesave rregullatore për mjaftueshmërin e kapitalit.
17. **Gjithsej kapitali / mjetet e peshuara me rrezik:** Nëse është nën kërkesat rregullative të BQK-së, bankës duhet t'i kërkohej që menjëherë të jetë në pajtueshmëri konform kërkesave rregullatore për mjaftueshmërin e kapitalit.
18. **Gjithsej kapitali / mjetet mesatare:** Nëse trendi i raportit është në rënie duhet të kërkojmë të dimë nga menaxhmenti i bankës pse kemi rënje sepse kapitali duhet të rritet së bashku me mjetet.
19. **Dividenda (në para të gatshme) / të ardhurat neto:** Nëse > 30 për qind, rritja e kapitalit duhet të monitorohet për t'u siguruar që ajo rritet aq shpejt sa mjetet, depozitat e përgjithshme, etj.
20. **Kthimi mesatar në ekuitet (RoAE):** Një bankë duhet të përpiqet që gjithmonë të mbajë këtë tregues \geq se 15 për qind. Çdo raport $<$ se 10 për qind duhet të shtyjë menaxhmentin e bankës të kërkojë mënyra për të përmirësuar fitimet.

4. EKZAMINIMI I DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

Gjate ekzaminimit të degëve të bankave të huaja do të përdoren procedurat e njëjta të vlerësimit të fushëveprimit minimal dhe standard, sikurse me rastin e ekzaminimit të bankave.

Gjatë vlerësimit të degëve të bankave të huaja do të përdoret sistemi i vlerësimit “AIM”, që përbëhet nga komponentët siç vijon:

1. Kualiteti i mjeteve;
2. Kontrollat e brendshme dhe auditimi; dhe
3. Menaxhmenti.

Gjatë vlerësimit të komponentëve do të përdoren: 1,2,3,4 dhe 5, sic janë të specifikuara me rastin e vlerësimit të bankave dhe do të bazohet sipas Udhëzuesit për Vlerësimin sipas Sistemit CAMELS.

5. HYRJA NË FUQI

Ky manual hyn në fuqi në datën e miratimit.

Bedri Hamza



Kryesues i Bordit Ekzekutiv



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org